




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e LVI-të (pesëdhjetegjashtë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **30 korrik 2025**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën **10:00**, dhe propozoj këtë;

REND TË DITËS

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:
18 prill 2025 e vazhduar më 28 maj 2025; 28 maj 2025; 19 qershor 2025; 26 qershor 2025.
2. Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2025) dhe Rekomandimet
3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizim me mëshqerra"
4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizim me makineri prodhuese për biznese"
5. Kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
5.1. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025 (Bashkëngjitur shkresa e MAPL-së)
5.2. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029237/25 i datës 28.05.2025 (Bashkëngjitur shkresa e MAPL-së)
5.3. Vendimi nr.prot.01-020/04-0029236/25 i datës 28.05.2025 (Bashkëngjitur shkresa e MAPL-së)
6. Të ndryshme

Nr.Prot.01-016/01-0042399/25
Podujevë, datë; 21 korrik 2025



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LII-të (pesëdhjetedy)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 18 prill 2025.

Mbledhja filloi në orën 10:30 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Donjetë Baliu, kurse mungoi Kasib Bashota, Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi; kurse mungoi Ilir Koprani, Qendresa Haliti.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani, kurse mungoi Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri; Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;)

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i KFOR-LMT; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, para se të fillojmë me mbledhjen unë e kam një vërejtje që një numër i madh i anëtarëve të Kuvendit nuk po vinë me kohë, unë në ora 10:05 kam qenë sallë kështu që të në të ardhmen të vijmë me kohë në sallë dhe të fillojmë mbledhjet sipas kohës së përcaktuar, kështu që të jemi më të përgjegjshëm sepse shikoni tani po e fillojmë mbledhjen me gjysmë ore vonesë, qytetarët na presin para ekraneve ta fillojmë me kohë.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, sigurisht jemi në dijeni ish anëtarja e Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje znj.Drita Pajaziti, ka kandiduar dhe ka siguruar votat e mjaftueshme për tu zgjedhur Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtur më 09 shkurt 2025.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, duke respektuar rregullativën ligjore në fuqi, e përmendura më 13 mars 2025 përmes e-mailit drejtuar Kryetarit të Komunës dhe mua si Kryesues i Kuvendit, ka paraqitur dhënien e dorëheqjes së parevokueshme nga të qenit anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës, dorëheqje të cilën e ka përsëritur edhe në formë fizike të nënshkruar më 18

mars 2025. Mandej janë zhvilluar procedurat për zëvendësimin e të përmendurës dhe në këtë aspekt më datë 21 mars 2025 KQZ ka marrë Vendimin nr.01/757-2025 sipas të cilit zonja Donjetë Baliu është emëruar anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës duke zëvendësuar ish anëtarin zonja Drita Pajaziti.

Me këtë rast zonja Donjetë Baliu është kontaktuar dhe njoftuar lidhur me këtë e cila tani edhe është prezente sot këtu, andaj kërkohet që të jap betimin solemn para Kuvendit të Komunës, mirëpo paraprakisht kërkoj nga Komisioni për verifikimin e mandateve që paraprakisht të bëjë verifikimin e mandatit. Pra ftoj anëtarët e Komisionit znj.Donjetë Sheqiri, znj.Sebastina Vokri dhe znj.Endritë Murati, që të bëjnë verifikimin e mandatit të të përmendurës dhe të paraqesin raport të shkurtër rreth këtij procesi.

znj.Sebastina Vokri, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve, paraqiti raportin përkatës, theksoi, në bazë të Vendimit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve me nr.01/757-2025 konstatojmë se pas dorëheqjes së znj.Drita Pajaziti si anëtare e Kuvendit të Komunës, emërohet znj.Donjetë Baliu si anëtare e re e Kuvendit të Komunës së Podujevës, i dëshirojmë suksese.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pas verifikimit të mandatit nga ana e Komisionit në fjalë, konsideroj se tani gjithçka është në rregull, andaj ftoj znj.Donjetë Baliu të ngritën në këmbë dhe të jap betimin solemn, mirëpo paraprakisht sqaroj se unë e lexoj pjesë pjesë tekstin e betimit, kurse ti e përsërit me zë atë, me të vetmin ndryshim që në fillim të tekstit ti e cek emrin dhe mbiemrin tuaj, andaj nëse jeni gati fillojmë.

Me tekstin si në vijim, Donjetë Baliu jep betimin anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës.

“Unë, DONJETË BALIU, betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, urime, tani mund ta nënshkruash deklaratën e betimit dhe me këtë akt nga tani je anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë. Tani vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot është data 18 prill dhe kjo datë e mbajtjes së kësaj seance koicidon me një ngjarje të dhimbshme të cilën e kemi kaluar ne si Shqiptarë e si Kosovë e në veçanti Treva e Llapit ku me këtë datë kemi pasë ofensivën serbe e cila ka shkaktuar dhimbje, ka shkaktuar humbje jetësh me të vetmin se ata kanë dashtë lirinë dhe me të vetmin se ata kanë qenë Shqiptarë.

Po ju rikujtoj se më 18 prill 1999 ka filluar ofensiva në fshatrat Bellopojë, Dyz, Koliq, Grashticë, Makoc dhe Llukar, dhe në atë datë dhe në atë javë janë vrarë 228 persona, 122 nga ata kanë qenë bashkëqytetarë tanë të Komunës së Podujevës, 106 të tjerë bashkëkombës tanë të Komunës së Prishtinës dhe 61 prej tyre janë vrarë më 18 prill, 43 prej tyre janë vrarë më 19 prill dhe 18 prej tyre janë vrarë më datën 21 dhe 22 prill.

Në shenjë respekti dhe përkujtimi për të gjithë ata të rënë, dhe në shenjë përkujtimi për masakrat që ka përjetuar popullata jonë deri sa kemi ardhur te ndërtimi i Shtetit Republikës së Kosovës, ju ftoj me 1 minutë heshtje për respektimin e gjithë atyre të rënëve dhe gjithë të rënëve andej Kosovës.

Mbahet 1 minutë heshtje në shenjë respekti dhe përkujtimi për të gjithë të rënë nga ofensiva serbe nga 18 deri më 22 prill 1999 në Trevën e Llapit dhe Gollakut, dhe në shenjë përkujtimi për masakrat që ka përjetuar popullata jonë deri ndërtimin e Shtetit Republikës së Kosovës, si dhe në respektim të të gjithë të rënëve gjithandej Kosovës.

I përmotshëm qoftë kujtimi për të gjithë të rënë për lirinë e Kosovës, lavdi jetës dhe veprës së tyre, ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, propozoj që punimet e mbledhjes t'i vazhdojmë deri në ora 11:30 dhe pastaj të shkojmë në pauzë deri në ora 14:00, dhe gjatë kësaj kohe në mënyrë të organizuar të shkojmë në fshatin Dyz për homazhe.

Njëzëri nga të pranishmit mbështetet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit që nga ora 11:30 të shkohet në pauzë deri në ora 14:00, me qëllim që në mënyrë të organizuar si Kuvend të bëjnë homazhe në fshatin Dyz.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, po ashtu para se të fillojmë me rendin e ditës unë e kam një përgjigje ndaj anëtarit të Kuvendit z.Arjant Topanica i cili në mbledhjen e kaluar ka dal në foltore me disa procesverbale duke më akuzuar mua që unë e kam thënë pa arsye që z.Arjant Topanica.

Pra zotëri Topanica ka dal me disa procesverbale duke thënë që nuk ka munguar asnjëherë në vitin 2024, kështu që unë i kam faktet këtu me vete që z.Arjant Topanica më 31.07.2024 ka munguar në mbledhje (në të dyja pjesët e mbledhjes), pastaj mbledhja e dytë që ka munguar i përmenduri është më 04.11.2024 (po ashtu në të dyja pjesët e mbledhjes para dhe pas dite), ju paraqes edhe listat e pjesëmarrjes në mbledhje ku nënshkruhen asambleistët e të cilat mund t'i verifikoni edhe ju Grupi i LDK-së, madje ka munguar edhe në pjesën e dytë të mbledhjes së jashtëzakonshme që është mbajtur më 18.04.2024, pastaj në pjesën e dytë të mbledhjes së datës 30.12.2024.

Kështu që nuk do të merresha me z.Arjant Topanicën po që se do ta linte këtë punë vetëm aq sa u diskutua në atë mbledhje por ky ka dal edhe në media duke më akuzuar për të drejtat dhe kinse unë nuk po i di detyrat e mia si Kryesues i Kuvendit.

Shumë Komuna të Kosovës siç është njëra prej tyre Komuna e Obiliqit e ka pikën e parë për mungesat e anëtarëve të Kuvendit, por unë nuk kam dashtë të merrem me atë çështje, kush ka dashtë është arsyetuar kush nuk ka dashtë nuk e ka bërë, mirëpo konkretisht nuk jam marrë me atë që një pikë të tillë ta fus në rend të ditës si pikë të parë për tu arsyetuar dhe deklaruar për mungesat e bëra por kushdo që ka dëshiruar e ka sjellë arsyetimin, kush nuk ka dashtë nuk i ka sjellë dhe nuk i dim arsyet. Kështu që nuk dua të akuzohem pa fakte, në qoftë se ka fakte secili unë i pranoj.

z.Arjant Topanica, theksoi, unë atë ditë kam reaguar për arsye se në mënyrë të drejtpërdrejtë mu ke drejtuar ti kryesues duke më thënë që kam shumë mungesa, dhe tani kjo shumë, është relative.

Kryesuesi i Kuvendit, ndërhyrë duke i thënë parafolësit në fjalë që ti ke thënë për Kryetarin e Komunës që po mungon në mbledhje, unë të kam thënë leje këtë Arjant se edhe ti ke mungesa dhe këtë si me shaka të kam thënë, kaq ka qenë.

z.Arjant Topanica, vazhdoi, më lejo ta përfundoj i nderuar Kryesues sepse unë e kam edhe incizimin kur t'i më ke thënë që kam shumë mungesa, pra kjo është citim fjalë për fjalë që ti Kryesues e ke thënë atë ditë, prandaj po e përsërisë edhe njëherë që kjo shprehja, shumë, është relative, andaj për atë arsye kam kërkuar që t'i nxjerrësh mungesat e të gjithëve sepse nuk është as marre as për keqardhje ajo që ti po e thua më ka ardhë keq t'jua nxjerrë mungesat, ngase për ata jemi të thirrur, prandaj kam kërkuar të nxirret raporti për të gjitha mungesat e asambleistëve.

Sa i përket mbledhjes së fundit, nuk e kam thënë as aty se nuk kam asnjë mungesë, por kam thënë që nga raportet dhe procesverbalet të cilat i kam marrë në ueb faqe të Komunës të cilat i kam shkarkuar dhe në të gjitha procesverbalet ka figuruar emri im që kam qenë prezent, nuk kam thënë asnjëherë sepse me vetëdije e di sa herë kam munguar, por dy herë brenda vitit ka arsye njeri, madje edhe nëse ke kërkuar edhe të kam njoftuar për disa mungesa ku të kam shkruar ty Kryesues dhe shefin e Grupit tim, dhe kanë qenë mungesa të arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ti i nderuar Arjant i ke prezantuar të gjitha procesverbalet duke thënë se nuk ke munguar asnjëherë në këto procesverbale që i prezantove. Pra kjo ka qenë dhe nuk po e zgjatim më shumë këtë çështje, vetëm deshta të të tregoj që ke munguar në disa mbledhje dhe me kaq përfundon kjo çështje.

z.Arjant Topanica, theksoi, në të gjitha procesverbalet që i kam paraqitur ka qenë emri im dhe i nënvizuar për çka e ka fokusuar edhe kamera, përndryshe unë nuk kam prezantuar procesverbale të viteve tjera e as procesverbale ku nuk ka figuruar emri im.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish rreth kësaj çështje, vazhdoi, edhe pse nuk është mirë të hapim debat më tutje rreth kësaj çështje, mirëpo ti i nderuar atë ditë nuk e ke prezantuar asnjë procesverbal që ke munguar, përse nuk e prezantove ndonjë ku ke munguar.

z.Arjant Topanica, sërish theksoi, të gjitha procesverbalet kanë qenë në ueb faqe të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, shikoni unë këtu i kam mungesat për të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe mos më detyroni t'jua lexoj të gjithëve si në shkollë fillore, prandaj të mos bëjmë shaka, përfundoj kjo çështje. Pra kush dikush të akuzon është obligim t'i përgjigjet, andaj edhe unë asgjë nuk kam bërë vetëm se i'u përgjigja z.Arjant Topanicës, si dhe mund t'i përgjigjem secilit ngase këtu me vete i kam listat e nënshkruara të pjesëmarrësve për çdo mbledhje.

z.Arjant Topanica, sërish theksoi, i nderuar Kryesues nënshkrimet në listat e pjesëmarrjes janë gjë tjetër kurse procesverbalet janë gjë tjetër dhe unë i kam printuar të gjitha procesverbalet që kanë qenë në ueb faqe zyrtare, nuk kam thënë që në lista sepse e kam ditë që kam munguar dy herë, por në procesverbale që kanë qenë në ueb faqe të Komunës në të gjitha kam qenë prezent.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, përfundoj kjo çështje dhe u sqarua e tëra, mirëpo zyrtari përkatës z.Enis Sheholli procesverbalet i përgatitë në bazë të nënshkrimeve të pjesëmarrjes dhe për këtë që e them kam besim të plotë.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, te pika Të Ndryshme ish dashtë të diskutohet kjo çështje, prandaj i nderuar Kryesues je duke e shkel Rregulloren dhe je duke na e harxhuar kohën kot, kështu që leje këtë çështje në pikën Të Ndryshme dhe atje diskuto sa të dëshirosh me kolegun z.Arjant Topanica.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, nuk është kjo problem i juaji i nderuar Maloku, nuk është e jotja që ti duhesh me u marrë me këtë, përndryshe unë do ta leja këtë çështje për në pikën Të Ndryshme por në atë pikë nganjëherë po mbesim pa kuorum, mirëpo po të nisemi nga ajo që në fund të mbledhjes sa mbeteni në sallë atëherë na dalin rreth 17-18 e që i kemi lutur për të qëndruar në sallë. Por t'i kishim nënshkrimet e pjesëmarrjes në fund të mbledhjes ku di unë ku do dilnim, por nuk po hyjmë andej. Faleminderit për këshilla.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit që në fillim të fjalës tënde e potencove që disa Kuvende Komunale e kanë pikë të veçantë arsyetimin e mungesave, vërtetë ashtu është dhe një gjë të tillë e kam parë edhe unë, dhe nga ajo për mbarëvajtje të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës ku jemi përgjegjës ne, unë mendoj se do të duhej që të propozohet si pikë e veçantë qoftë sot qoftë një ditë tjetër dhe fare nuk jam prej atyre që duhet të fshihemi për rregullsinë e punës së anëtarëve të Kuvendit sepse fundja jemi këtu për të përfaqësuar dikë dhe ai dikush në një formë duhet të ketë në monitorim për punës që bënë çdo njëri.

Nëse Kuvendi Komunal, ne kolegët dhe koleget mendojmë që duhet të vëmë në spikam do të propozoja që në një seancë të ardhshme që një për një të gjithë ta kemi temë trajtimi rregullsinë apo mbarëvajtjen e punës së Kuvendit, dhe po ta kemi kështu do të mund të debatoni deri sa të lodheshim, ndërsa në këtë rastin sikurse që ishte po i bie që hymë pa rend dite por çfarë t'i bëjmë Kryesuesi është vet shefi dhe fol çka të dojë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e gjithë arsyeja ime ishte që t'i përgjigjem sepse edhe z.Arjant Topanica jashtë rendit të ditës ka kërkuar fjalën dhe është marrë me këtë çështje, prandaj mendova që ta lë në pikën Të Ndryshme por e mendova që zotëri Topanica mund të mos jetë këtu prezent në atë pikë dhe pastaj dalin paqartësi tjera, kështu që ne e dim kush rrinë dhe kush nuk rrinë deri në fund të mbledhjeve.

Përndryshe ne që nga sot mund ta bëjmë që nënshkrimet e pjesëmarrjes t'i lëm për në fund të mbledhjes, për çka edhe ju pyes se a dëshironi të jetë kështu, mund të votojmë, e hedh në votim.

z.Burim Hasani, theksoi, i nderuar Kryesues, formën se si e potencuat ju mendoj se sërish mund të ketë lëshime sepse mund të ketë raste që ndonjëri prej anëtarëve të Kuvendit mund të mos jetë prezent deri në fund të mbledhjes dhe pak para se të përfundoj mbledhje vie nënshkruhet dhe figuron sikurse pjesëmarrës, kështu që këtë çështje mendoj se është mirë ta lëmë kështu siç është.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se kjo çështje përfundoj, tani vazhdojmë me rendin e ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa së bashku me pikën shtesë të rekomanduar nga ky Komitet e cila nëse përkrahet, renditet si pikë e 10 e rendit të ditës kurse pika Të Ndryshme renditet e 11-ta.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe duke përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e këtij Komiteti dhe dërguar së bashku me konstatimet e KPF-së.

Rendi i miratuar i ditës:

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit ë Komunës të mbajtura më: 05.03.2025 dhe 13.03.2025
2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për projektin e shpezëtarisë”
4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për pemëtari”
5. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me pajisje për bletë”
6. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025
8. Propozim vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi
9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (emërimi i anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës).
10. Propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” Sh.A. në Podujevë
11. Të Ndryshme

**1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:
05.03.2025 dhe 13.03.2025**

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi dy procesverbale nga dy mbledhjet paraprake të Kuvendit të Komunës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën nëse jo i hedh në votim kështu siç janë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin në sallë, miratohen dy procesverbalet si në këtë pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, më lejoni që para juve të prezantoj këtë pikë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me bartjen e të hyrave vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2024 dhe në bazë të ligjit ne si Komunë e kemi të drejtën t'i bartim për shpenzim dhe për investime në vitin 2025 në programe dhe në projekte të cilat i konsiderojmë të nevojshme që këto mjet të barten.

Të hyra vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2024 janë 890,001.09€ nga këto 413,539.01€ është tejkalim i të hyrave vetanake të cilat janë tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara në vitin 2024 dhe ne tani kemi të drejtë që këtë tejkalim të të hyrave vetanake ta bartim për shpenzim në vitin 2025.

Këto të hyra barten në programin e Planifikimit Hapësinorë dhe Rregullativ në vlerë totale prej 168,000.00€ siç janë në projektet sikurse në dokumentacionin e propozim vendimit ku destinohen mjete buxhetore për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Shtedim-10,000.00€; Balloc-20,000.00€; Sibofc-10,000.00€; Gllamnik-10,000.00€; Lluzhan-10,000.00€; Shakovicë-20,000.00€; Shajkofc-20,000.00€; Sfeqël-10,000.00€; Repë-20,000.00€; Tërnavicë-20,000.00€; Dobërdol-10,000.00€; Gërdofc-8,000.00€, që në total i janë 168,000.00€.

Pastaj në programin Infrastrukturë publike janë 307,432.50€ e që nga këto janë tri projekte: Ndërtimi i stacionit të autobusëve-123,432.50€; Ndërtimi i kanalizimit nga fshati Lluzhan-Lupq, Gërdoc-Lluzhan dhe Majac-Lupq-Kolektori-114,000.00€; Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të Lumit Llap në Qytet-70,000.00€, e që në total është shuma prej 307,432.50€.

Në programin e Arsimit 350,000.00€, nga këto 200,000.00€ janë për shkollën e fshatit Shajkoc që janë obligime kontraktuale, ndërsa për projekte të cilat janë të pakontraktuara janë 3 anekse të tri shkollave "Ibrahim Rugova", "Enver Maloku", "Xheladin Rekaliu" e që normalisht se vlera e këtyre projekteve duhet të jetë shumë më e madhe mirëpo këto do të jenë në planifikimin buxhetor për vitin 2026 si shtesë të cilat nevojiten për përfundimin e këtyre projekteve.

Gjithashtu edhe në programin e Shëndetësisë janë 19,711.05€ dhe atë për renovimin e objekteve shëndetësore.

Në Shërbime Kulturore janë 44,857.54€ dhe atë për renovimin e Teatrit të Qytetit.

Si pjesë e këtij vendimi siç edhe e ceka bëhet fjalë vetëm për ndryshim të dy çështjeve, pra te pjesa e tejkalimit të të hyrave shtohet 1 cent, do të thotë nuk është 413,539.00€ por është 413,539.01€ kjo për arsye se vendimi duhet të jetë i sakt, si dhe një arsyetim që duhet të jetë pjesë e këtij vendimi është se pse këto janë transferuar të gjitha në kategorinë e investimeve kapitale, arsyeja

është se këtu i kemi disa obligime kontraktuale të cilat duhet t'i mbulojmë dhe disa projekte të cilat nuk janë obligime kontraktuale mirëpo që është konsideruar e nevojshme të investohet.

Ne si Ekzekutiv i Komunës e kemi të drejtën të propozojmë në cilat do kategori të cilat i shohim më të arsyeshme dhe normalisht ju si Kuvend i Komunës pastaj në qoftë se e shihni të arsyeshme që ta votoni këtë propozim vendim, dhe po e them se e kemi të drejtën t'i bartim në cilëndo kategori të cilën ne e konsiderojmë të arsyeshme, e që është konsideruar e arsyeshme që të gjitha këto të jenë në kategorinë e investimeve kapitale.

z.Haki Rudari, theksoi, ne kemi një propozim venim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe shuma e tyre siç e ceku edhe drejtori parafolës është 890,000.00€, shumë e mjeteve e cila bartet nëpër programe dhe kategori ekonomike si vijon: Planifikim Hapësinor 168,000.00€, pa i përmendur kodet dhe fshatrat se ku do të barten mjetet buxhetore, mandej në Infrastrukturë Publike kemi një shumë prej 307,432.00€, në Arsimin Fillor 350,000.00€, në Shëndetësi 19,711.00€ dhe në Shërbime Kulturore 44,857.00€.

pra thënë thjeshtë kjo shumë e cila bartet në këto kategori ne si Grup konsiderojmë se janë në interes të qytetarëve për arsye se po preket infrastruktura publike, arsimi, shëndetësia, kultura dhe shumë projekte të tjera andaj në emër të grupit të LVV-së ne i japim përkrahje dhe mbështetje si dhe besojmë që do të vazhdojmë me projekte të reja.

z.Naim Çunaku, theksoi, sigurisht që mjetet e mbetura të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të Komunës edhe ne si Grupim e mbështesim që ato mjete duhet të barten dhe duhet të realizohen projekte për vitin 2025 dhe sigurisht që me ato mjete që janë drejtpërdrejtë taksa të qytetarëve e vlen që me nikoqirllëk dhe në projekte të qëlluara të lehtësojnë jetën gjegjësisht t'i kontribuojnë zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës tonë.

Nga ajo që kemi para vetës, u potencua edhe nga drejtori i DBF-së, kemi një tejkalim të të hyrave vetanake gati gjysmë për gjysmë. Nëse kemi tejkalim 413,539.00€ nga shuma e gjithmbarshme prej 890,000.00€ del ajo që e thash se gjysma apo më tepër se gjysma e kësaj shume, dhe kur t'i krahasojmë këto shuma a na dërgon konkludimi që kemi pas një planifikim jo të mirë sepse t'ja huqësh një planifikimi gjysmë për gjysmë, veç planifikim të mirë s'mund ta quajmë.

U përmenden kodet buxhetore dhe nuk po dua t'i përsërisë sepse u përmenden nga dy parafolësit, dhe kategoritë të cilat ata kanë menduar që duhet të shpërndahen gjegjësisht që duhet të orientohen këto mjete, drejtori me të drejtë e tha që ne e kemi të drejtën të propozojmë dhe ashtu është por propozimi vlen para Kuvendit dhe Kuvendi është ai që mendon dhe e jep verdiktin që a janë menduar që ato mjete të destinohen sakt dhe sipas nevojave të qytetarëve, dhe këtu jemi në rregull, por gjatë analizës së këtyre orientimeve apo destinimin e këtyre mjeteve na dalin shumë projekte të cilat natyrisht se janë të mirëseardhura dhe nuk po dua të jem në kundërshti me to, por edhe të arsyeshme po i quaj, mirëpo një fakt që nuk po duam ta kuptojmë dhe që është duke ndodh në vazhdimësi kjo është se projektet miratohen në Kuvend së bashku me projektbuxhetin kur e kemi miratuar në këtë rast në muajin shtator të vitit paraprak dhe ai është orientimi se ku duhet të harxhohet paraja dhe se ku ka vendosur Kuvendi Komunal si organ politik bërës dhe si organ vendimmarrës se ku e ka paraparë t'i orientoj, ndërsa një pjesë e mirë këtyre projekteve që sot na janë paraqitur nuk mund t'i gjejmë në projektbuxhetin që kemi vendosë ne.

Sa jemi duke anashkaluar atë primaren që buxheti është ai të cilin e ka dhënë Kuvendi edhe me konsultime qytetare, kurse Ekzekutivi i Komunës ka vetëm një detyrë që atë buxhet ta shpenzoj gjegjësisht ta qon aty ku ka vendosë Kuvendi i Komunës, dhe tani na dalin ashtu qysh na kanë dal edhe përpara shumë projekte që nuk figurojnë fare në projektbuxhet, por me qejfe, dëshira, me propozime nga më të ndryshmet, shkojnë duke e anashkaluar vendimmarrjen në Kuvend.

Për fund po mundohem të them edhe dy fjali, shpërndarja që e përmendi drejtori i DBF-së, për investime kapitale vërtetë po ta shohësh sa mjete buxhetore nga kategoria e shpenzimeve kapitale na janë tërheqë dhe na janë cunuar projektet shkaku i vendimeve gjyqësore, mirëpo t'i shohësh asfaltimet se sa rrugë janë paraparë me një shumë prej 168,000.00€ do të uroja që vërtetë të mund të realizohen por vërtetë ai që i sheh vetëm mund të qesh sepse vetëm qesharake mund të jetë por jo projekte të cilat mund të realizohen. Unë po i përmendi vetëm disa; asfaltimi i disa rrugëve me 10,000.00€ po ku mund të asfaltohen disa rrugë me 10,000.00€ apo ato vetëm rrugë nuk mund të jenë, pastaj asfaltimi i disa rrugëve me 8,000.00€ e që nëse propozuesi e ka pas synimin që të përmend më shumë fshatra për kuptime elektorale jemi në rregull, por në kuptimin e realizimit të këtyre projekteve me këto shuma gjithë këtë rrugë, veç të realizohen nuk munden sepse ato janë ndoshta me 10 metra gjatësi nëse merret se sa kushton sot një m² e asfaltit e që nuk di si mund të quhet rrugë kur ta zëm me 8,000.00€ llogariteni sa mund të shtrohet.

Ne Grupi i LDK-së do ta përkrahim sepse nuk dashurojmë të jemi bllokues në kuptimin e bartjes së të hyrave sepse ato të hyra e thash edhe në fillim janë taksa të qytetarëve por të kemi kujdesë sepse nuk mund t'i orientojmë taksat e qytetarëve gjegjësisht të shpenzojmë buxhetin pa vendime të Kuvendit, përndryshe po të ishte një shtet i mirëfilltë, një demokraci e zhvilluar, një gjyqësor në nivel, sigurisht se do të hasnim në pengesa nga ta.

z.Bashkim Syla, theksoi, sot po diskutojmë për propozim vendimin për bartjen e të hyrave vatanke nga viti 2024 në vitin 2025, të hyra të cilat në vitin 2024 kanë qenë 890,000.00€ prej të cilave 413,539.00€ janë tejkalim i të hyrave vetanake, të hyra të cilat janë planifikuar të shpenzohen në programe siç janë Planifikimin Hapësinor 168,000.00€, Shërbime të Shëndetësisë 19,000.00€, Shërbime Kulturore 44,000.00€, Infrastrukturë 307,000.00€ dhe në Arsime 350,000.00€.

shumica e këtyre projekteve dhe këtyre mjeteve janë të destinuara për projekte të cilat janë obligime kontraktuale si dhe për çdo planifikim është dhen në fund një sqarim.

Edhe nga drejtori i DBF-së dhe drejtori i DSHPMSH-së janë dhënë disa sqarime në mbledhjen e KPF-së se shumica e këtyre mjeteve janë destinuar për projekte të cilat janë planifikuara me kontrata dy vjeçare dhe arsyeja është për shkak të zbatimit të Kontratës Kolektive e që me vendime gjyqësore Komunës së Podujevës i janë marrë afër 4 milion euro dhe atë kryesisht nga Kontrata Kolektive për mësimdhënësit. Edhe pse unë nuk jam kundër këtyre mjeteve që kanë shkuar për mësimdhënës mirëpo si proces si proces jam shumë kundër dhe është shkuar gabim ngase edhe pse ka pasë zotim por edhe premtim elektorale që Kryetari i Komunës do të bëjë marrëveshje me mësimdhënësit dhe kjo çështje do të kryhet pa shkuar te Përmbaruesi dhe pa shkuar tek paditë e Avokatëve, kështu që Komuna e Podujevës afërsisht në vitin 2024 i ka humbur afër 1 milion euro për Përmbarues dhe nga paditë e Avokatëve të mësimdhënësve.

Ne në mbledhjen e KPF-së, në propozim për të cilin i falënderoj sepse kanë qenë mirëpritës edhe Nënkrjetarja e Komunës, drejtorët prezent të Drejtorive që ishte propozim i imi që të ndahen një pjesë e mjeteve buxhetore për funksionalizimin e nënkalimit tek shkolla në fshatin Gllamnik për çka jemi dakorduar të gjithë si KPF së bashku me drejtorët prezent dhe Nënkrjetaren e Kuvendit që fillimisht të merren sqarime prej MMPHI se a kemi të drejtë të ndërhyjmë në projektin e nënkalimit, përfshirë këtu edhe për punën e pronës dhe pastaj të vijnë me një sqarim me informata përkatëse dhe të vazhdohet tutje.

Ne Grupi i PDK-së do ta përkrahim, është obligim ligjor bartja e të hyrave vetanake, mirëpo sa i përket procesit të vendimeve gjyqësore unë e kam thënë dhe e them sërish se është proces i menaxhuar gabimisht.

z.Ragip Fetahu, theksoi, më bëri të diskutoj paksa fjalimi i kolegut asambleist z.Naim Çunaku i cili e tha se bartja e të hyrave vetanake nga një vit në vitin tjetër është keq planifikim, për çka ndoshta të kam kuptuar drejt i nderuar kolegë por ndoshta edhe jo, mirëpo më lejoni të bëjë një sqarim përse ndodh kjo bartje e mjeteve financiare prej një viti në vitin tjetër, arsyeja është që ju e dini që burimet financiare në Komunë janë nga dy degë që janë; nga të hyrat vetanake dhe tjetra që është grnati qeveritar. Grantet qeveritare kryesisht kanalizohen nëpër projekte të cilat kryhen brenda një viti kurse të hyrat vetanake lihen sa e di unë si mundësi për bartje nëpër projekte në vitet e ardhshme për shkak se ekziston kjo mundësi dhe unë mendoj se kjo është një mirë planifikim dhe një politikë e mirë për shfrytëzimin e të hyrave vetanake dhe të granateve qeveritare nga Komuna jonë dhe në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar kolegë zotëri Fetahu, unë veten nuk e kam dëgjuar por nëse jam kuptuar ashtu qysh e potencove ti unë kërkoj falje, por nuk mendoj se bëjë aq llapsuzë dhe e devijoj aq shumë unë, kjo në kuptimin që e the se unë e kam kuptuar kështu.

Po mundohem të jem më i sakt në fjalorë sepse fjalën keq klasifikim e përmenda kur nga të hyrat vetanake në shumë 890,000.00€, tejkalim të të hyrave vetanake kemi 413,539.00€ dhe kur e zbresim këtë shumë të tejkalimit nga ajo prej 890,000.00€ na del sa janë planifikuar. Do të thotë përafërsisht del që kemi rreth 400,000.00€ që kanë qenë të planifikuara, kurse janë realizuar rreth 400,000.00€ më tepër, andaj këtu e kam thënë se është keq planifikim ngase të planifikosh 400,000.00€ e t'i realizosh 890,000.00€ veç planifikim i mirë nuk mund t'i themi, përndryshe planifikimi mund të ndryshoj për një nuancë por jo gjysmë për gjysmë, prandaj kjo ishte jo që unë më parë deshta ta vë në spikam.

Po ashtu te një çështje tjetër i nderuar z.Ragip Fetahu nuk kam qare pa tu falënderuar, të falënderoj që ne tani po e bëjmë vitin e katërt të këtij mandati dhe ti na e sqarove si krijohet buxheti i Komunës, kush e përbën buxhetin e Komunës, pastaj na tregove se e kemi grantin qeveritar edhe të hyrat vetanake, por prap se prap diçka ke harruar se nuk e ke mësuar mirë, harrove t'i përmendësh edhe donacionet dhe vendimet gjyqësore, kështu që unë po ta komplimentoj këtë dhe po të tregoj se buxheti i Komunës përbëhet nga granti qeveritar, donacionet, të hyrat vetanake, dhe tani nëse duam t'i shpjegojmë të hyrat vetanake tani kemi shumë shkallë por nuk po dua t'ju marrë kohë, mirëpo si do qoftë ju falënderoj që na shpjegove.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë që në fund të këtij diskutimi drejtori i DBF-së të na sqaroj dhe të na informoj për donacionet. Kjo shuma që është tejkalim i të hyrave vetanake 413,539.00€ sa prej tyre janë donacione dhe sa janë donacione të bartura prej vitit 2023 në vitin 2024, kështu që atëherë e dim sakt sa kemi tejkalim të të hyrave vetanake edhe pse këto hyjnë në këtë kod buxhetor sepse nuk ka mundësitë hyjnë diku tjetër.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta drejtori me qëllim e la si me pikëpyetje dhe nuk i shpjegoi mirë për të dalë dilema të tilla. Për ta plotësuar sakt kolegun parafolës z.Naim Çunaku që tha është keq planifikim, ashtu sakt është sepse shembull, të hyrat e planifikuara 1,859,659.00€, të realizuara 1,710,894.00€, me përqindje i bie diku rreth 92%.

Shembull tjetër, planifikimi i tatimit në pronë 705,256.00€ kurse realizimi është 347,162.00€ apo 49%. Pastaj tatimi në tokë, planifikimet janë 143,739.00€ kurse realizimi zero euro.

Të hyrat tatimore, planifikimi është 1,010,674.00€ kurse realizimi është 1,363,731.00€, e që këtu ka tejkalim sepse plani është bërë keq dhe i bie keq klasifikim.

Tek të hyrat tjera ishin shembull, 562,304.00€ e që këto janë prej gjobave në trafik nga Policia e Kosovës e që drejtori i DBF-së nuk e përmendi fare. Mandej ka të hyra edhe nga Gjykata dhe nga Agjencioni i Pyjeve e që këtu sigurisht se që është shitur ndonjë masë drusore

Kështu që u dashtë drejtori i DBF të sqaronte dhe shpjegonte më shumë në mënyrë që të mos dalin pastaj këto dilema dhe nuk e përmendi borxhin që është për tatimin në pronë rreth 4 milion e gjysmë së bashku me biznese.

z.Fatum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, falënderoj të gjithë për çështjet të cilat i shtruan lidhur me bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025, dhe po përpiqem që në formë të përmbledhur t'i jap të gjitha sqarimet për çështjet të cilat u ngritën nga parafolësit.

Komuna e Podujevës e ka pasë planifikimin e të hyrave vetanake për vitin 2024 1,860,000.00€ dhe prej kësaj shume tani janë mbledhje 413,539.00€ më shumë, prandaj i nderuar zotëri Çunaku nuk është çështja midis 890,000.00€ por planifikimi ka qenë 1,860,000.00€, mirëpo edhe kur kemi të bëjmë me çështjen e planifikimit të të hyrave vetanake, ashtu qysh bëhet edhe planifikimi i buxhetit që ka grantin e përgjithshëm, grantin e arsimit, grantin e shëndetësisë, edhe të hyrat vetanake. Planifikimi i buxhetit vije me Qarkoren Buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe kjo Ministria bazohet duke marrë mesataren e të hyrave vetanake të tri viteve paraprake dhe vazhdimisht është fat i mirë që ne po kemi tejkalim të të hyrave vetanake, dhe pastaj ne kur e dërgojmë planifikimin e të hyrave vetanake në Ministrinë e Financave mbi bazën e të cilave ndërtohet edhe Qarkorja Buxhetore, për arsye se ata marrin informacione dhe propozime prej neve, gjithmonë e kemi një planifikim më që i ofrohet limitit që ne mendojmë se do të mbledhim, por ata Ministria e kanë standard dhe rregullore që e marrin mesataren e tri viteve të kaluara, prandaj kjo nuk është keq klasifikim por është realizim i mirë i të hyrave vetanake që do të thotë se ne po kemi tejkalim të të hyrave nga ajo e planifikuar.

Pra nuk është prej 890,000.00€ por është prej shumës 1,860,000.00€, dhe këtu nuk është që ne e kemi planifikuar sakt por është mesatarja e tri viteve të kaluara.

Sa i përket çështjes që u cek lidhur me Urbanizmi që ka disa projekte me asfaltim me shuma nga 10,000.00€, 20,000.00€ dhe që bëhet fjalë për përshkrimin e projekteve, ta zëm, çdo projekt ka një kod buxhetor shembull në këtë rast kodi 49273-asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim si projekt i parë që është në këtë propozim vendim, projekt ky i cili ekziston për shumë vite në Komunën e Podujevës sepse asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim gjithherë është me këtë kod por që përshkrimin e ka “asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim”, sikurse që janë edhe për fshatra tjera që janë të llastuara në këtë dokument, dhe këto 10,000.00€ që janë paraparë bëhet fjalë për obligime kontraktuale për çka e kemi sqaruar edhe në mbledhjen e KPF-së, pra do të thotë se ka një kontratë e cila është rreth 168,000.00€ që është për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Balloc dhe Shtedim, andaj për t'u mbuluar financiarisht kjo kontratë që e ceka që ka qenë me atë vlerë për asfaltimin e disa rrugëve nevojiten 10,000.00€ tek asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtedim dhe 20,000.00€ për asfaltimin e rrugëve në fshatin Balloc sepse bëhet fjalë për të njëjtën Kontratë që do të thotë se janë obligime kontraktuale.

Kësaj radhe Ministria e Financave na ka obliguar që në propozim vendimin përkatës i cili miratohet në Kuvendin e Komunës, pjesë përbërëse të vendimit të jenë edhe arsyeshmëritë, andaj siç e keni parë pas çdo programi ku barten të hyrat vetanake janë edhe arsyetimet përkatëse ku thuhet se këto janë obligime kontraktuale, pra nuk bëhet fjalë për asfaltimin e disa rrugëve ta zëm në fshatin Lluzhan me 10,000.00€ por është obligim kontraktual sepse ajo ka qenë vlerë më e madhe e kontratës dhe tani edhe mbulohet financiarisht, andaj për këtë po besoj që është përmbledhë kjo çështje.

Asamblisti z.Ekrem Rrahmani i shtroi disa çështje për të cilat veç se u përgjigja sa i përket asaj që e ceku keq planifikim sepse të njëjtën çështje e shtroi edhe asamblisti tjetër z.Naim Çunaku, ndërsa sa i përket realizimit të tatimit në pronë zotëri Rrahmani e shikon raportin dhe po ashtu është e sakt qysh e potencoi ai në qoftë se e shikojmë si numër, mirëpo kemi një çështje ku këtu në Kuvendin e

Komunës është marrë një vendim që të falen 100€ të tatimit në pronë, do të thotë ka qenë propozim i Ekzekutivit të Komunës sepse ashtu e ka mundësuar Ligji, dhe normalisht ajo ka ndikuar që në vitin 2024 ta kemi një mbledhje të të hyrave nga tatimi në pronë sesa në vitin 2023 ta zëm, mirëpo tani në vitin 2025 sërish po kthehet krahasimisht një realizim pak më i mirë nga tatimi në pronë gjë të cilën do ta shihni në Raportin financiar të tremujorit të parë të vitit 2025.

Po ashtu edhe asamblisti z.Bashkim Syla çështje të cilën e shtroj tek shumë projekte të këtij propozim vendimi, e them se ne normalisht e kemi të drejtë të bëjmë edhe projekte të reja, mirëpo po e them se pjesa dërmuese kanë qenë obligime kontraktuale dhe të gjitha këto janë projekte të cilat i ka votuar Kuvendi i Komunës, do të thotë janë obligime kontraktuale dhe pjesë e buxhetit të viteve paraprake më sakt vitit 2024, mirëpo çështjen që e ceku edhe z.Naim Çunaku, sikur të ishte vullneti dhe nevoja ne të gjitha këto 890,000.00€ do të mund t'i bartnim në projekte të reja të cilat nuk anë qenë në vitet paraprake fare, por do të planifikoheshin projekte të reja, do të miratoheshin në Kuvendin e Komunës, shkojnë në Ministri të Financave si dhe procedurat tjera deri te investimi në ato projekte të reja, do të thotë këtu nuk fare diçka në kundërshtime me ligjin por nuk ka asgjë të keqe edhe në kuptimin e menaxhimit sepse investohet në projekte të reja nga bartja e të hyrave vetanake të këtij viti. Kështu që bëra përpjekje të bëjë disa sqarime dhe ju falënderoj për vëmendjen dhe kontributin e juaj në këtë çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtori i DBF-së i shpjegoi dhe u mundua ashtu sikurse në mbledhjen e KPF-së edhe sot këtu ta paraqes si performancë të mirë tejkalimin e mbledhjes së të hyrave vetanake, por ashtu siç ia thash në KPF po i'a them edhe sot se për performancën e Ekzekutivit të Komunës së Podujevës më së miri fol raporti i performancës dhe asnjëherë Komuna e Podujevës nuk ka arritur as t'i ofrohet asaj që të jetë përfitues për një qeverisje të mirë dhe performancë të mirë, këtu të jemi të qartë, është tejkaluar dhe në një shumë qindra mijëra euro kur tejkalohet dikujt mund të mos i tingëllojë mirë por edhe në 1 milion euro, 400 mijë euro, për mua, për mendimin tim dhe prej qasjes time, nëse është një huqje kaq e madhe është keq planifikim.

Po ashtu u tha se ne mund t'i bartim tek projektet e reja, unë e di që edhe këtu atëherë cili është qëllimi, cila është arsyeja kur për të ardhur deri te projektbuxheti i Komunës, pa daasht të hyjë në atë sepse po keni qejf shumë që ta lidhni çështjen me procedura me Ministrinë, e unë nuk po e lidhi me ministrinë sepse nuk jam i Ministrisë por jam i Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe e dimë qysh vijmë deri te një buxhet. Abc-ja e Ligjit mbi financat publike, abc-ja e një Ekzekutivi të një Komune është që ta realizoj atë që e ka marrë vendim Kuvendi, e a është ligjore apo jo ligjore unë nuk e kam atë kompetencë sikurse drejtori që e potencoj, të them po më duket ligjore e jo ligjore ngase unë nuk përfaqësoj ligjin këtu, ligjin e merre gjykata, dhe shumë çka mund të më duket mua jo ligjore e ty drejtor të duket ligjore, por verdiktin se a është ligjore apo jo ligjore është një institucion i pavarur i cili po dinë shpesh të atakohet dhe nënvlerësohet.

Edhe njëherë i nderuar drejtor i DBF-së, po foli krejt në bazë të letrave dhe ligjeve që e rregullojnë këtë fushë për veprimtarinë e një Komune, nuk mundet të ketë marrëdhënie kontraktuale me një operatorë ekonomik pa bërë shkelje ligjore nëse hynë në marrëdhënie kontraktuale pa mjete të zotuar sepse mjetet e zotuar janë ato që ta mundësojnë të hysh në marrëdhënie kontraktuale.

A është projekt dy apo tre vjeçar, për ata e kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe planifikimet për vitin paraprak, mirëpo nëse ke pasë qëllim ta sqarosh këtë Kuvend kur unë i përmenda disa rrugë që është jonormale të thuhet se shtrohen disa rrugë me 8,000.00€ unë e lexova diçka që e kam marrë nga ju, nuk shpika asgjë, ndërsa pse ti (i drejtohet drejtorit të DBF-së) nuk je në nivel të detyrës dhe nuk e futë një klauzolë që ta shpjegosh që nuk janë rrugë të reja, por thuhet për mungesë të mjeteve në një projekt të caktuar na nevojiten edhe kaq mjete t'i marrim nga këtu, por kur të thuash kaq rrugë me kaq mjete, është jo në rregull.

Edhe njëherë po e them, çka të doni, qysh të doni dhe qysh të mundeni bëjani, por mua nuk mundesh asnjëherë të më bindësh sepse unë lexoj diçka tjetër, e lexoj ligjin që nuk mund të realizosh projekte jashtë planifikimeve buxhetore për këtë vit që i kemi miratuar në muajin shtator të vitit të kaluar.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, sërish drejtori i DBF-së i iku paksa temës, këtë e lidhi me atë që kur e ceka unë që nëse paraqiten si sukses të hyrat e nivelit qendrorë që janë 562,304.00€ e që janë gjoba në trafik, të hyrat nga gjykata si dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve, e me të cilat nuk do të duhej që Ekzekutivi i Komunës së Podujevës të krenohet sepse këto janë të hyra të cilat i kthen Qeveri tek Komuna.

Kryesuesi i Kuvendi, theksoi, besoj që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i dha të gjitha sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme për çka u kërkua, pra diskutimet rreth kësaj pike u shterrën, andaj meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje përfshirë edhe dy çështje të paraqitura nga drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse të cilat kërkohet të inkorporohen në propozim vendim

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2024 në vitin 2025 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozimit të drejtorit të DBF për plotësimin e propozimit si në vijim:

-Te neni 1 i propozimit, shuma 413,539.00€ bëhet (413,539.01€)

-Para nenit 2 të propozimit, shtohet teksti si në vijim;

(Arsyetim për kategoritë: Komuna e Podujevës të gjitha të hyrat vetanake ka nevojë ti bartë në kategorinë e investimeve kapitale për arsye të obligimeve kontraktuale ne pjesën dërmuese te projekteve të cilat do të barten në këtë vendim. Në kategoritë e tjera si mallra, subvencione, komunali nuk kemi nevojë për mjete shtese ne baze te ecurive buxhetore të vitit 2025).

Sipas propozimit të Kryesuesi të Kuvendit që u mbështet në fillim të mbledhjes, Kuvendi i Komunës shkon në pauzë, dhe atë duke filluar në ora 11:25, dhe me këtë rast Kryesuesi i Kuvendit i njofton të pranishmit se për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të marrin pjesë në homazhe në fshatin Dyz, transporti është siguruar dhe menjëherë do të bëhet nisja këtu nga oborri i Komunës.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 14:20.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Donjetë Baliu.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani.

Të pavarur, Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE)

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësuesi i KFOR-LMT; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin si dhe duke i rikujtuar të pranishmit për pikat rreth rendi të ditës, përkatësisht pikat të cilat janë në vazhdim.

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për projektin e shpezëtarisë”

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim fjalën ia kalojmë drejtorit të DBF-së z.Fatlum Osmani i cili do na tregoj edhe arsyeshmërinë e këtij propozim vendimi, por që mund të arsyetoj edhe dy pikat tjera në vazhdim meqë janë të ngjashme, përveç shumave financiar dhe projekteve përkatëse.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, bëhet fjalë për projektin e shpezëtarisë që t’i shtohet projektit një vlerë prej 9,000.00€, vlera totale e këtij projekti është 30,000.00€ por dihet që në bazë të Rregullores për subvencione dhe thirrjes publike, 30% e vlerës së kontratës dhe vlerës së projektit është participim i fermerëve, andaj ne e kemi të domosdoshme në bazë të procedurës që ky shtim i buxhetit në projektin e caktuar të kalon përmes asamblesë komunale dhe ta votoj asambleja komunale. Pra bëhet fjalë vetëm për 30% të vlerës së projektit që është participim i fermerëve.

E njëjta çështje vlen edhe për projektin participim i fermerëve për pajisje për blerë (pika 4 në vazhdim e rendit të ditës) ku vlera totale e këtij projekti është 22,222.2€ kurse vlera prej 30% të këtij projekti është 6,666.66€, dhe kjo vlerë buxhetore duhet të votohet si shtim i buxhetit në këtë projekt që po e përsërisë është participim i fermerëve përfitues të këtij projekti.

Gjithashtu e njëjta çështje është edhe për projektin e pemëtarisë (pika 5 në vazhdim e rendit të ditës), ku vlera e projektit është 18,750.00€ ndërsa 5,625.00€ janë shtim i vlerës së buxhetit si participim i fermerëve në këtë projekt, andaj ju ftoj që t’i mbështesni këto 3 propozim vendime (pikat 3, 4 dhe 5 të rendit të ditës), ashtu siç e parasheh procedura e votimit një nga një, edhe pse unë e paraqita arsyetimin për të tria këto pika sepse janë të ngjashme.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, Grupi i LVV-së shpreh përkrahjen e plotë për propozim vendimin e paraqitur nga drejtori i DBF-së që ka të bëjë me shtimin e buxhetit dhe krijimin e kodit të ri buxhetor për projektin furnizim për projektin e shpezëtarisë, projekt ky i cili paraqet një hap të nevojshëm dhe të domosdoshëm për përkrahjen e fermerëve tanë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të bujqësisë. Kjo nismë është në përputhje të plotë me angazhimin tonë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritje të vetëpunësimit dhe përmirësim të kushteve të jetesës për qytetarët tanë sidomos në zonat rurale, për këtë arsye Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së do ta mbështesim këtë propozim vendim, e vetmja arsye është që t'ju dilet në ndihmë fermerëve edhe pse vlera 30% e participimit që kanë fermerët për çka drejtoresha e DBPZHR-së ka dhënë sqarime për këto projekte, por tani nuk është prezentë. Pra e përkrahim këtë propozim vendim.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrahë parimisht propozim vendimin për shtim buxheti për projektin e shpezëtarisë, por vetëm kërkojmë që të hiqet participimi prej 30% për shkak që po iu bie shumë e madhe fermerëve për pagesë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne po e mbështesim këtë propozim për shtim të buxhetit dhe t'u shtuar një kod i ri për atë vlerë të participimit prej 30% që bëhet nga ana e bujqve.

Pra të sqarohemi me parafolësen znj.Tringa Sfishta që bëri një propozim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues nuk ke çka sqarohesh, vetëm e hedh në votim propozimin e saj. Nuk je ti që duhet të sqarohesh me të.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, mos u ngutni sepse na duhet sqarimi, duhet të jetë propozimi konkret ngase unë nuk e kisha të qartë. Në rastet e dhënies së propozimeve konkrete nga dikush unë i hedh në votim, prandaj mos u ngut i nderuar zotëri Çunaku sepse nuk je ti këtu për të gjitha pyetjet, për gjithçka. Pra e nderuara zonja Tringë cili ishte propozimi juaj konkret.

znj.Tringa Sfishta e dha propozimin dhe t'i nuk je ndërmjetësues këtu.

z.Naim Çunaku, përgjigje Kryesuesit, theksoi, çfarë jam unë, që ta kërkoja fjalën dhe të tregova kur duhet ta hedhësh në votim propozimin, ti sqarohesh me të. Ti Kryesues mos u bë ndërmjetësues, sepse unë nuk jam, unë vetëm po kërkoj fjalën si anëtar i Kuvendit, kaq.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish i reagon parafolësit, theksoi, mos u ngut kështu në këtë mënyrë sepse se nuk të kapërcen koha, as ty as askujt, urdhëro fjala për ty.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues lëri këto shaka, kapërcen ose jo koha sepse s'kemi këtu as kohë e as gjë por kemi rend të fjalës dhe përfundon debati.

Tani po mundohem të të sqaroj ty zotëri Kryesues dhe mos e merr për të keq sepse s'kam tendencë por lirohu prej kompleksit për të na shpjeguar neve, unë e di që ke defekt në kuptimin që ke punuar në arsim dhe je prej atij këndit dhe e di që pa dashje e bënë, por mundohu të kurseesh sepse këtu ne i japim arsyetimet dhe jo arsyetimet, ti veç propozimet tona i hedh në votim. Krejt me dashamirësi po të them këtë gjë.

Ku ishte problemi në kuptimin e propozimit të znj.Tringa Sfishta, po mundohem me qenë i artikuluar sepse e di ti këtë qëndrim të LDK-së ngase prej kur kemi filluar me subvencione për prodhuesit bujqësor ne e kemi pas të ndërtuar qëndrimin që ne nuk jemi kundër subvencionimeve, jemi për çdo subvencionim që i bëhet bujqut e në veçanti në këtë kohë të shtrenjtimit dhe gjendjes ekonomike në të cilën jemi. E kam thënë edhe 2 ditë më parë në mbledhjen e KPF-së dhe po e përsërisë që nuk e them se këto subvencione nuk janë të mirëseardhura mirëpo një pjesë e mirë e prodhuesve bujqësor në këtë rast bujqve, me kushtëzimin 30% për participim po ua bëjnë të pa mundur edhe me pasë vullnetin për të konkurruar dhe qëllimi është t'ju jepet mundësia dhe se tani po e bëjë edhe propozimin e koleges parafolëse znj.Tringa Sfishta.

Grupi i këshilltarëve të LDK-së, i propozon këtij Kuvendi që të hiqen participimet në subvencionimin e bujqësisë, arsyeja e kësaj është që krejt ta marrin si ndihmesë subvencionin për mjetet të cilat u'a lehtësojnë si do ku do prodhimin dhe punën e tyre.

Nëse nuk kemi mjete buxhetore që këtë e kemi thënë dhe po e themi sërish si arsyetim, më mirë që të jenë në numër më të vogël përfituesit e subvencioneve në bujqësi se sa të kushtëzohen me participim në vlerë 30% për projekte të caktuara, e që mirë do ishte që drejtoresha e DBPZHR të na jep shpjegime për projektet, qëllimin e tyre, dhe sa ka arritur ta rris prodhimin bujqësor dhe sa ka arritur ta zhvilloj bujqësinë me këto subvencione, e jo të dalin siç kanë dal shumë herë duke thënë që nuk kemi mekanizëm të kontrollit, mirëpo sot e kemi veç si shtim të kodit buxhetor.

Ne kemi propozim që mos të ketë shtim të kodit buxhetor për participim mirëpo bujqit të subvencionohen në plotëni me 100% që Komuna është në gjendje t'jua ofroj.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë prita nga drejtori i DBF-së dhe prej Grupit të LVV-së që ta sqaroj këtë çështje që ky propozim vendim është ajo pjesa e participimit 30% që të shtohet në një kod buxhetor, do të thotë bujqit të japin atë 30% dhe tani Grupi i LDK-së ose duhet ta përkrah këtë ose duhet të dal me një qëndrim tjetër.

Sa i përket asaj për ta hequr këtë participim, së pari unë mendoj që këto projekte që janë bërë janë planifikuar me këtë participim nga bujqit, e që shumica e këtyre projekteve mund të dështojnë, përndryshe duhet ndryshuar Rregullorja e subvencioneve e që kjo mund të bëhet me një iniciativë për vitin tjetër, do të thotë kur të projektohet një projekt të mos parashihet participimi prej 30% nga bujqit, ndërsa për këtë kohë mendoj që kjo duhet të vazhdoj siç është edhe këtë vit, mirëpo vitin tjetër nëse dakordohemi të gjithë mund ta heqim krejt këtë participimin e bujqve.

Ne kemi pasë edhe një diskutim rreth participimin 30%, kur nuk ka participim dhe kur nuk ka për të dhënë para pastaj po ka aplikime shumë në numër të madh dhe pa pasë nevojë, andaj tani duhet të bëhemi real ngase tani ne nuk e bëjmë këtë punë për 10, 100 apo 200 vota, realitetin po e tregoj që njerëzit kur nuk japin para për projekte aplikimi është 3 ose 4 herë më i madh, këtë mund ta vërtetojnë edhe drejtorët e Drejtorive edhe të insistojnë, mirëpo nëse e bëjmë bashkërisht e bëjmë prej vitit tjetër si Rregullore që të mos participojnë fare bujqit, ta lëmë kështu qysh është këtë vit.

E nderuara Tringa, a jemi ose jo vitin tjetër ne këtu si asambleistë, e rëndësishme është që bujqit të përfitojnë, unë mendoj kështu, por tani është edhe më keq t'i lëm këto projekte pa u realizuar duke mos e votuar këtë vendim, nuk e di, ju vetë vlerësojeni por unë mendoj se kështu është më së miri.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne e kemi votuar Rregulloren dhe tani po dalim kundër vetvetes.

z.Ragip Fetahu, theksoi, edhe unë mendoj njësoj pak a shumë ashtu siç e potencoi edhe kolegu z.Bashkim Sylja, mirëpo paraprakisht mendoj që Grupi i LDK-së është mirë t'i analizoj vendimet para se t'i paraqes këtu sepse së pari ju e thatë e përkrahim vendimin kurse herën e dytë thatë duhet hequr participimin, dhe tani krejt këtu po bëhet debati dhe po na vendosni edhe neve në mjegull.

Sa i përket kësaj çështje unë mendoj që është Ministria përkatëse e cila i subvencionon bujqit konform rregulloreve në fuqi, pa asnjë kusht, pa asnjë kriter konform punës së tyre dhe tokës së tyre të punuar me kultura të ndrysmë bujqësore, kurse sa i përket çështjes së participimit 30% ne si Institucion e kemi miratuar Rregulloren që në këtë formë t'i shtyjmë qytetarët në bashkë participim që do të thotë se këto para që ne ua japim atyre, janë para të tyre, por me një bashkë participim shtesë ata kontribuojnë direkt dhe ia dinë vlerën asaj që marrin si ndihmë nga Komuna, andaj unë mendoj që kjo duhet të vazhdoj kështu edhe në të ardhmen ashtu me qëllim që këto ndihmesa për bujqit të jenë sa më efektive dhe të shkojnë në dorën e atyre që përnjëmend e meritojnë, që përnjëmend punojnë dhe e shfrytëzojnë atë subvencion në të mirë të prodhimtarisë së tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, veç një sqarim sepse jemi duke dalë prej teme, këtu kemi për ta votuar vetëm shtimin e buxhetit dhe kodin e ri buxhetor, nuk kemi të bëjmë këtu me ndarjen ose jo të subvencioneve, ta bëjmë me participim ose jo, këto janë të rregulluara me Rregulloren për subvencione që e kemi miratuar ne këtu. Pra nuk kemi temë tjetër të diskutimit, kështu që ne vetëm mund të themi dhe të votojmë se a e përkrahim ose jo këtë kod buxhetor.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues, edhe më parë edhe tash sërish po të them me dashamirësi, të na luash rolin e mentorit e kuptojmë dhe më lë të përfundoj, kjo forma shpjeguese e juaja është lëndim sa i përket kapacitetit intelektual, varet gjithkush si e kupton, për mua është lëndim dhe dhunim i intelektit të më tregosh ti çka po kërkoj në material kur unë e kam përpara atë material. Tani dua të ndërlihem me atë që e thanë dy parafolësit z.Bashkim Syla dhe z.Ragip Fetahu, ku e than se s'di çka po don LDK-ja.., unë u them që LDK-ja edhe kur është miratuar ajo Rregullore por edhe sot dhe gjithë do të jetë kundër detyrimit të participimit të qytetarëve për subvencione në bujqësi sepse mendojmë që në këtë formë nuk jemi mjaftueshëm duke e ndihmuar bujkun por në një formë edhe ata që me të vërtetë kanë nevojë shkaku i 30% e kanë të pa mundur të aplikojnë për një subvencion ngase shembull, nëse është në vlerë 3000€ e që siç e dinë të gjithë për subvencionet e mëshqerrave që kanë qenë, ata u dashtë të paguajnë 1300€ dhe në këtë kontekst nuk po e numërojmë mjaftueshëm, prandaj LDK-ja është kundër kësaj.

Pastaj kolegu z.Ragip Fetahu e ceku, pse për dhe pse kundër, mirëpo i them që jemi për subvencionimin e bujqve por jemi kundër participimit nga ana e fermerëve/bujqve, andaj dalloj këto dy gjëra, madje edhe në Rregullore kemi qenë kundër participimit dhe jemi edhe sot kundër participimit, por nuk marrim qëndrim si parti pasi nuk mundemi ta heqim participimin prej 30% dhe t'jua cungojmë të drejtën për të mos u subvencionuar fare, prandaj edhe për këtë ishte qëndrimi edhe për edhe kundër i nderuari zotëri Fetahu.

Po ashtu u përmend edhe një grusht vota, nuk e di këtë sepse të paktën ne nuk jemi në fushatë zgjedhore, dhe nëse dikush ka të drejtë të luftoj për një grusht vota me çfarë të drejte i thot tjetrit mos lufto për një grusht vota, kështu që ai kualifikimin se për çka po luftojmë duhet të mbetet individual sepse është perceptim individual ajo punë, përndryshe ai mund të mendoj se e kam për një grusht vota, ose unë ose ai tjetri ose LDK ose PDK, por është vetëm perceptim i tij sepse nuk mund ta argumentoj atë gjë.

Po e përmbylli me propozimin e koleges znj.Tringa Sfishta, që jemi për subvencionimin e bujqve në çfarë do kohe kur të mundemi dhe sa më shumë që mundemi, por jemi kundër formës së detyrimit me participim të fermerëve/bujqve, madje kolegu z.Bashkim Syla e përmendi se këto janë të projektuara me projektbuxhet, por derisa më parë që diskutonim se nuk mund të dalim jashtë projeksioneve të buxhetit e që në një formë u anashkalua ajo temë, tani po përmendet projektbuxheti, po të ishin ashtu, sepse ato kanë mund të jenë si planifikim dhe po t'i kishim ato kode të aprovuara atëherë nuk do të kishim pasë nevojë ne sot të marrim vendim fare.

z.Bashkim Syla, theksoi, me mendimin më të mirë u mundova të japë zgjidhje mirëpo tani kolegu z.Naim Çunaku u lëshua në debat më thellë e unë veç po dua t'i tregoj se prej kur është LDK-ja kundër participimit të bujqve apo bashkëpunimit të bujqve, prej cilës datë, përndryshe para 20 viteve ka funksionuar kjo kështu kurse tani këto 5 vite në opozitë ne po e bëjmë të mos participojnë bujqit. Unë e dhashë edhe mundësinë tjetër për ndërrim të Rregullores nga vitit i ardhshëm dhe unë ju mbështes, personalisht votën time e keni, prandaj urdhëro merre iniciativën për vitin tjetër dhe e bëjmë Rregulloren e re, mirëpo nuk mund të thuash vetëm tani unë jam kundër, kurse më parë kjo formë e subvencionimit ka bërë.

z.Naim Çunaku, përgjigje parafolësit, theksoi, i nderuar zotëri Sylja, çka është bërë që 20 vite ne nuk jemi këtu për storje historike se çka ka ndodh por tani flasim konkretisht, Rregullorja për participim në bujqësi është miratuar jo në këtë mandat por në mandatin tjetër kur ke qenë edhe ti (i drejtohet Bashkim Syles), në 2018 dhe këtë e them sepse ti e shtrove si pyetje prej cilës datë, pastaj e potencuat që 20 vite, kurse unë ju them nuk është 20 vite por është prej vitit 2018, praktikë e njëjta deri në këtë legjislaturë ka vazhduar e njëjta LDK e unë nuk jam këtu të jap llogari çka ka bërë dikush tjetër, por unë jam këtu për qëllimin të cilin unë votoj dhe ndihem përgjegjës për atë që unë votoj e që prej momentit që jam unë këtu në këtë mandat kam qenë kundër dhe jam edhe sot kundër, ndërsa për përgjegjësinë 20 vjeçare të një qeverisje ishte kualifikim jo i saktë sepse në atë 20 vjeçar nuk ka pas participim, ka pasë vetëm prej vitit 2017 ose 2018, mbamë për fjalë për këtë që e them dhe këto mos i harro sepse unë në atë kohë nuk kam qenë anëtar i Kuvendi Komuna por keni qenë ju z.Bashkim Sylja.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe unë ju them ju z.Naim Çunaku që ta merrni iniciativën dhe ta fusni si pikë e rendit të ditës, votën time e ke si në KPF ashtu edhe në seancën e Kuvendit për tu ndryshuar Rregullorja për subvencione.

z.Ragip Fetahu, theksoi, këtu po flasim për kategorinë më të respektuar që kemi ne në Llap që kujdeset për ushqimin tonë dhe na ndihmon që ne të ushqehemi shëndetshëm, dhe duke u bazuar në këtë fakt nuk mund ta trajtojmë këtë kategori vetëm për vota, nuk bënë t'i trajtojmë vetëm për interesa tona personale, mirëpo këtë kategori duhet ta trajtojmë ashtu siç e meritojnë dhe duhet t'ua japim atë që e meritojnë, prandaj duke u bazuar në këtë po t'i pyesim ata (fermerët dhe bujqit) pjesa më e madhe e tyre do të thonë jo sepse ne duam bashkë participim.

Në fakt unë jam që të mendohet përqindja e participimit të tyre por jo të largohet tërësisht, mirëpo jo ta mendojmë për një grusht vota, por të mendojmë për interes të tyre sepse janë kategoria më e respektuar e Llapjanëve.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, veç deshta të ndërlihem te kolegu z.Ragip Fetahu që po thotë se nuk bën të konsiderohet pjesa e fermerëve për interesa personale, prandaj ne tek që po mendojmë ta heqim participimin po punojmë për interesat e tyre.

Edhe kolegu tjetër z.Bashkim Sylja e tha që kur nuk ka participim atëherë rritet aplikimi i bujqve, kjo mua më shtynë të mendoj që aplikojnë bujqit jo që s'kanë nevojë por aplikojnë edhe ata personal që nuk kanë mundësitë për të paguar atë shumë të participimit prej 35% dhe nëse largohet ai participim mendoj që do të ketë aplikime më shumë nga ata persona që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në atë pagesë të participimit.

z.Arjant Topanica, theksoi, sa i përket kolegut parafolës se kjo po bëhet për një grusht vota, nuk është se po bëhet për një grusht vota sepse ne e deklarua se e përkrahim si do që të jetë qoftë edhe me participim prej 30%, nuk jemi ashtu që ne të ndalemi vetëm në atë që veçse të hiqet krejt participimi sepse po duam me i marrë do vota e në tjetrën anë po duam t'jua cungojmë subvencionet bujqve, pra ne jem për, kështu siç është, kaq paskemi mundësi me këtë qeverisje t'ju ndihmojmë dhe ne jemi për të mos i ndal këto subvencione.

Mirëpo propozim i yni ishte apo nënkuptonte që të rishikohet kjo ndoshta nga viti i ardhshëm të jetë participimi më i vogël ose të hiqe krejt ky participim, apo ndoshta kjo të rikthehet te ajo që thanë kolegët parafolës se më mirë është me pasë participim. Nëse bujqit e kanë keqpërdor ndonjë subvencion qoftë ai subvencion pa participim që nuk ia dinë vlerën qoftë ai subvencion me participim, është përgjegjësi e Komunës sepse kërkohet të ketë mbikëqyrje të subvencioneve.

Unë edhe në mbledhjen e kaluar iu drejtova drejtoreshës së DBPZHR-së që a ka ndonjë raport se çfarë efektesh po prodhojnë këto subvencione, a po përdoren në vendin e duhur dhe nga njerëzit e duhur, dhe nëse kemi një mbikëqyrje korrekte siç duhet në shpërndarje dhe në përdorim atëherë

edhe nëse subvencioni është pa participim ato subvencione do i shfrytëzojnë bujqit që përnjëmend e kanë rendimentin e punës së tyre në bujqësi.

Sa i përket participimit ne kemi qenë kundër edhe në qeverisjet e kaluara, subvencionimet kanë qenë pa participim, mirëpo participimin me Rregullore e ka fut në funksion ky pushtet aktual.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, një çështje është e vërteta që Rregullorja në mënyrë specifike e thotë që për subvencione duhet participim i fermerëve për 30%, edhe në të kaluarën subvencionet janë ndarë me participim, nuk kam ndonjë datë të saktë prej kur kanë filluar participimet por ne e dimë që shumë vite pas luftës nuk ka pasë participime fare për shkak normalisht të një buxheti më të vogël, por sikur ta zëm vitet 2017-2018 është bërë participimi i fermerëve për subvencionet të cilat i kanë marrë.

Rregullorja për ndarjen e subvencioneve e specifikon 30% financim, por edhe një çështje është që në të kaluarën prej vitit 2022 faktikisht Ministria e Financave për çdo projekt ku financohen fermerët që është e planifikuar në buxhet por me participim të fermerëve kur shtohet ai buxhet në kodin dhe projektin përkatës na obligon që ai vendim të kaloj përmes asamblesë komunale, e që deri në vitin 2022 këto vendime nuk kanë kaluar përmes asamblesë komunale, mirëpo tani këtë vendim ne duhet ta marrim konform Rregullores të cilën e kemi sepse DBPZHR kur e hap një thirrje për subvencionim duhet t'i referohet Rregullores të cilën e ka aprovuar kjo asamble komunale, pra kjo është sa i takon anës procedurale dhe ligjore dhe nuk mund të jetë ndryshe.

Sa i përket debatit se a duhet të ketë bashkëfinancim me fermerët kjo është një çështje tjetër, mirëpo edhe grandet që i ndan Ministria të gjitha janë me participim të fermerëve, në qoftë se dikush e merr ndonjë grand për një projekt të caktuar të bujqësisë Ministria e Bujqësisë e ka një procedurë tjetër që i bën pagesat në formë të mjeteve financiare për projektet që aplikon fermeri e ka 70% të financimit nga Ministria mirëpo pjesën tjetër e investon fermeri në fund të cilën e arsyeton me të gjitha shpenzimet që i ka bërë, kështu që ne jemi para kësaj situate që ky propozim vendim e vetmja mënyrë që të votohet është kjo formë.

Kryesuesi i Kuvendi, theksoi, vetëm po ju përkujtoj se në vitin 2008 kam qenë anëtar i KPF dhe DBPZHR nuk e ka pasë asnjë cent buxhet, dhe për herë të parë nëse nuk gaboju këtu prezent është edhe nga Zyra ligjore z.Sabedin Namani i cili ka qenë prezent dhe ka mbajtur procesverbalet, pra atëherë dhe për herë të parë në KPF kemi propozuar shumën 5,000.00€ në buxhetin e DBPZHR-së dhe prej atëherë pastaj kanë filluar ndarjet e subvencioneve sepse nuk ka pasë gjithëherë ndarje të subvencioneve, dhe tani Rregulloren e kemi aprovuar dhe në bazë të saj ne duhet të veprojmë.

Propozimet e juaja ishin shumë të mira dhe vitin e ardhshëm mund ta ndryshojmë Rregulloren nëse i kemi votat e ndryshojmë por sot ne e kemi pikë të rendit të ditës shtimin e buxhetit dhe kod të ri për projektet përkatëse, andaj kërkohet votimi i këtyre tri pikave të rendit të ditës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, pasi që po përfshihemi të gjithë në këtë debat dhe secili prej kolegëve e përmendi që kjo Rregullore po të vinte në Kuvend për plotësim ndryshim do të votonit për ndryshimin e saj me qëllim të heqjes së participim për fermerët, veç për rikujtuese kur e kemi pasë këtë Rregullore për shqyrtim në Kuvend Grupi i anëtarëve të LDK-së e ka dhënë këtë propozim dhe asnjëri nga ju nuk e ka përkrahë këtë, pra dua të them që mos thoni tani që ta sjellim ne në Kuvend dhe do ta përkrahim, kurse në situatën kur e kemi shqyrtuar e keni pasë këtë mundësi dhe nuk e keni përkrahë, kështu që ju lutem mos u thirrni kaq parimor sepse qytetarët nuk harrojnë qysh keni votuar në atë kohë.

z.Arjant Topanica, theksoi, shkurt po ndërlidhem vetëm për sqarim sepse drejtori i DBF-së mirë e tha por barra po i bie kësaj asambleje rrjedhimisht këtij pushteti që ky e ka votuar 30%-shin participim për fermerët/bujqit, do të thotë qeverisja qendrore veç ekzekuton në bazë të Rregullores tonë, kurse ne e kemi votuar me 30% dhe kur e hapin thirrjen ata e hapin përmes kësaj rruge që ne

ua kemi shtruar, ndërsa ne jemi thirr në arsyen se Podujeva njihet si vend, si trevë, si qytet ku bujqësia është sektori ndoshta më i zhvilluar i ekonomisë dhe për atë arsye do t'i shqyrtojmë mundësitë për të larguar participimin në mënyrë që për me pasë përfitime bujqit dhe të orientohen investimet e subvencioneve në këtë pjesë për arsye siç e thash merremi me kultivimin e produkteve bujqësore. Prapë po e them nuk jemi kundër qoftë edhe me këtë 30% për arsye se është ndihmesë që i bëhet bujqve tanë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë i dëgjova të gjithë, kolegu e dha përkrahjen për propozim vendimin për shtimin e buxhetit të ri dhe kodit të ri që është krejt në rregull.

Sa i përket propozimit të koleges z.Tringa Sfishta mendoj se ishte propozim korrekt por në të njëjtën kohë unë këtu nuk shohë kurrfarë politike sepse tek participimi prej 30% duhet të marrë pjesë edhe ai i LVV-së, ai i LDK-së, ai i PDK-së, dhe të të gjitha partive tjera, por edhe varianti tjetër nëse hiqet po ky 30% serish fitojnë qytetarët e partive të ndryshme.

Është e vërtetë ajo që tha kolegeja znj.Donjeta Sheqiri se ajo Rregullore është votuar këtu dhe është e vërtetë që ne e kemi votuar atë Rregullore, por tani ajo Rregullore mund të ndryshohet ashtu siç e ceku kolegu z.Bashkim Sylja, por nuk ka mundësi në këtë periudhë kaq të shkurt, në këta 4 apo 5 muaj ne nuk kemi mundësi të bëjmë plotësim ndryshim të Rregullores prandaj ne do të votojmë për këtë buxhet të kodit të ri ashtu siç e ceku kolegu z.Arjant Topanica në mënyrë që të mos bëjmë bllokimin e Kuvendit apo këtyre proceseve ngase fundja secili qytetar që participon natyrisht që ka edhe anën e vet ekonomike, financimin pastaj punësimin e të tjera, fundja fundja ndoshta burim të të ardhurave i ka këto, andaj e them që në të ardhmen është mirë të mendohet varianti më i mirë për qytetarët ngase unë vet jam pjesë e politikës dhe nuk fshihem por te këta qytetarë që marrin pjesë dhe konkurrojnë këtu nuk shohë kurrfarë politike.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pa humbur kohë më shumë rreth këtij diskutim, unë e vë në votim propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti "Furnizim për projektin e shpezëtarisë", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti "Furnizim për projektin e shpezëtarisë", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuari Kryesues përse nuk e hedh në votim propozimin tim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e nderuara zonja Tringa, ju thatë që e përkrahni shtimin e buxhetit dhe hapjen e kodit të ri por nuk e përkrahim participimin e fermerëve prej 30%, e i cili është përcaktuar në Rregullore dhe ne nuk mundemi të heqim dorë sot nga participimi prej 30%, prandaj ne propozuam që të ndryshohet Rregullorja në të ardhmen.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, atëherë i nderuar Kryesues vetëm mund ta hedhësh në votim propozimin tim, e ju pastaj votoni kundër nëse dëshironi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë po e vë në votim propozimin e znj.Tringa Sfishta që të hiqet participimi i fermerëve në shumë 30%.

Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim dhe nga 24 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, fillimisht 8 ishin Për, dhe 4 Kundër, mirëpo gjatë procesit të votimit disa prej asambleistëve kërkuar fjalën për tu sqaruar rreth këtij votimi, konkretisht këtij propozimi sepse sipas tyre ishte i paqartë, kështu që Kryesuesi i Kuvendit jua jep fjalën, dhe rrjedhimisht nuk pati ndonjë konstatim nga ana e Kryesuesit të Kuvendit rreth këtij votimi.

z.Florent Hasani, theksoi, i nderuari Kryesues nuk mund të vihesh në lajthitje për gjëra që s'kanë bazë ligjore dhe të bësh propozime të tilla përderisa shkojnë përmes ndryshimeve të Rregullores.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, i nderuari Kryesues, së pari duhet të na sqarosh a është në rregull ky propozim, a ka bazë ligjore sepse ne kemi një Rregullore me të cilën punojmë dhe së pari duam ta dimë a është ky propozim i ligjshëm apo jo, pra fillimisht këtë dilemë duhet ta heqim e pastaj është një fakt që nëse hiqet participimi prej 30% po shihet vetëm ana e mirë, por në vend se me marrë subvencion 100 bujq pastaj kanë me marrë subvencion 70 bujq, prandaj a është më mirë me marrë subvencion 100 bujq me participim apo 70 bujq pa participim.

Sqaroi këto dy gjëra i nderuari Kryesues, si dhe kisha pasë dëshirë të marrë këtë përgjigje edhe nga opozita e pastaj marrim vendim a është më mirë me marrë subvencion 100 bujq me participim apo 70 bujq pa participim, si dhe a është ligjor ky propozim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë çështje më shumë është duke u bërë politikë se sa që po i intereson dikujt për bujqit, këto projekte që ne po i diskutojmë janë dhënë dhe këto projekte s'mund t'i ndalim ne tani, mirëpo propozimi i koleges znj.Tringa Sfishta për të heq participimin ne tani nuk mund ta heqim atë participim sepse duhet ndryshuar Rregulloren përkatëse.

Një sqarim, sepse ju nuk jeni duke e lexuar Rregulloren e punës së Kuvendit dhe po thirrreni në Rregullore, mirëpo kjo Rregullorja parasheh që çdo propozim të anëtarëve të Kuvendit duhet të hedhet në votim, pastaj a voton për ose kundër është punë e juaja dhe e këtij Kuvendit, prandaj propozimi i zonjës Sfishta u vë në votim dhe ne mund ta përsërisim edhe një herë sepse këtu pati paqartësi në votim sepse pati ndërhyrje dhe nuk u la të zhvillohet procesi i votimit siç duhet, ndërsa në anën tjetër disa prej juve po thonë se po e shkel Rregulloren e punës që po e vë në votim propozimin e znj.Tringa Sfishta. Prandaj mendoj se këtu jeni duke bërë politikë, përndryshe unë e di që këto projekte kanë përfunduar dhe Rregulloren e subvencioneve nuk mund ta ndryshojmë sot.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuari Kryesues, ju lus ta hedhësh në votim edhe njëherë propozimin tim dhe po e përmbyllim këtë diskutim.

z.Haki Rudari, theksoi, të nderuar kolegë, të drejtën që e ka asamblisti atë të drejtë ia jep Rregullorja e punës e ajo e drejtë është për të gjithë, cili do asamblist nga e cila do parti politike ka të drejtë të bëjë propozime dhe ai propozim kalon ose jo me vota,. Unë vij prej Grupit të LVV-së por ne jemi të gjithë asamblistë këtu, të gjithë një pagë marrim, madje unë vet marrë 30% të pagës së asamblistit, andaj secili asamblist që është prezent e sidomos Grupi i LVV-së duhet ta përcjellë se kush çka po propozon, në fund të fundit unë nuk kam qenë në "luftë" me LDK-në pavarësisht vërejtjeve që ua kam dhënë thuajse që 20 vite, prandaj e them që secili asamblist e sidomos i Grupit të LVV-së që i drejtohem tani duhet me përcjell secilin propozim se a po del kundër Rregullores të cilën e keni votuar ose që nuk e kemi votuar, dhe të njëjtën kohë opozita i ka interesat e saj. Unë nuk kam kurrfarë problemi me propozimin e koleges znj.Tringa Sfishta, por unë kam propozim për Grupin tonë që abstenoj dhe i la hapësirë me kalu një propozimi që u bë në kundërshtim me Rregulloren të cilën e kemi votuar ne këtu, dhe nuk e di sa e keni përcjellë këtë sepse ne kemi ardhë në asamble komunale me i përcjellë diskutimet e secilit, po ju betohem se që tri mandate nuk di që kam dalë tri herë nga seanca deri sa ka përfunduar seanca, pastaj asnjë cent nuk e marrë më shumë se sa të tjerët, edhe unë mund të dalë nga mbledhja dhe të pushoj, kam probleme familjare, e kam pasë nënën në spital-intensivë dhe e din Tringa këtë dhe nuk kam dalë nga mbledhja, prandaj duhet të merret me seriozitet kjo sepse unë si shef i Grupit të LVV-së e që ju kolegët e mi nga ky subjekt e dini që kam qenë në listë i 29-ti, nuk ka qenë rastësisht ajo renditja e imja në këtë numër, i dini shumë çështje tjera që ua kam thënë në grup të kryesisë dhe po ua them sot në seancë, dhe do ua them në të ardhmen më fuqishëm.

z.Ekrem Brahmani, theksoi, për mos me zgjatë më shumë dhe mos me bë gjithë këtë zhurmë vendimi kaloj, MAPL-ja vendimet tona i shqyrton pasi këtu sekretari nuk kemi nuk është punë e juaja, MAPL-ja e kthen vendimin si të pavlefshëm nëse është i tillë dhe vazhdojmë pastaj, ti i nderuari Kryesues ke për obligim nëse është ai vendim i pa vlefshëm ta marrësh atë vlerësim dhe ta sjellësh këtu dhe t'i tregosh koleges Tringa që keni marrë vendim të pa vlefshëm dhe ne e pranojmë atë, kështu që ju them të vazhdojmë e mos të humbim më shumë kohë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, së pari propozimi është i pa qartë, kur hiqet participimi prej 30% për cilën periudhë kohore po flasim, këtë projekt ju thatë që e përkrahim me këtë participim prej 30%, kjo është totalisht e pa kuptimtë. Po na vëni në lajthitje sepse po e qitni vetë propozimin në votim që është i pa kuptimtë sepse nuk ka kurrfarë periudhe dhe nuk ceket asgjë. Propozimi është veç aty për aty momental dhe ky propozim që kaloi është absolutisht i pa vlerë sepse nuk ka asnjë lloj qartësie dhe nuk votoi diçka që është e kotë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, këtu ka një propozim vendim dhe çdo propozim vendim që kalon në procedurë të rregullt për me ardhë në asamblë komunale ndër të tjera e ka një numër të protokollit pse është votuar. Ky propozim vendim për projektin e shpeztarisë do të thotë kaloj dhe pjesë e këtij vendimi është participimi prej 30% nga fermerët në mënyrë që ky projekt të realizohet, madje edhe Plani i prokurimit sepse kur vijnë projektet jashtë planit të buxhetit procedohen në këtë rast në Plan të prokurimit dhe janë prokuruar me vlerën plus 30% të asaj që është e planifikuar me buxhet e që 30% është participim nga ana e fermerit.

Tash ky propozim vendim duhet të votohet i cili ka ardhë në procedurë të rregullt dhe ka kaluar në KPF, të votohet apo të mos votohet, është pikë e rendit të ditës në asamblë komunale, është propozuar ka dalë në votim dhe ne tani si Ekzekutiv duhet ta dim a vendimin e asamblesë komunale, hedhet poshtë ky apo kalon ky propozim vendim. Këtu një votim u bë për këtë propozim vendim dhe u votua me participimin prej 30%, ndërkohë del edhe një propozim tjetër, ndërsa kemi tri propozim vendime për tri projekte të ndryshme, andaj kërkoj nga Kryesuesi që t'i hedhë në votim këto tri propozim vendime, e them këtë sepse a e dini qysh është kjo çështje, sikurse kur të vie buxheti që është me Qarkore buxhetore ta zëmë është 34 milion euro, vie 38 milion euro, dhe pastaj të ngritët një asamblist të thotë unë propozoj që buxheti të bëhet 60 milion euro, pra i kësaj natyre është propozimi që u tha.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shikoni të nderuar, propozimi i znj.Tringa Sfishta është që në të ardhmen të hiqet partiucipimi i fermerëve, nuk është për sot sepse sot nuk mund të hiqet.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuar Kryesues ju lus të mos folesh në emrin tim sepse unë kam gojë dhe flas vet, pra e përfundova çka pata, u krye votimi dhe ditën e mirë, vazhdo tjetrën pikë.

z.Naim Çunaku, theksoi, Kryesues, pas përfundimit të votimit ti po lejon debat për pikën që kaloi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka më diskutim, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim për pemëtari"

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, para jush keni propozim vendimin përkatës, është obligim që derivon nga Rregullorja për subvencione që të votohet shtimi i buxhetit në këtë kod në mënyrë që ky projekt në mbështetje të fermerëve të realizohet.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti furnizim për pemëtari.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, sikurse në propozimin e pikës së kaluar ne e përkrahim këtë propozim vendim mirëpo të hiqet participimi prej 30%.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo pa humbur kohë më shumë e vë në votim propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për pemëtari”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 19 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 14 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim për pemëtari”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues, ju si Kryesues i Kuvendit e ke për obligim që secilin propozim ta vësh në votim, se a votojmë ne për ose kundër ai është problemi ynë, ti e ke obligim që secilin propozim me hedh në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, përfundoj kjo pikë dhe nuk ka më diskutim, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

5. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me pajisje për bletë”

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne Grup i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti furnizim me pajisje për bletë, por të lutem i nderuar Kryesues mos vazhdo kështu të herdhesh pika në votim pa diskutim, veç shkel e shko.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i’u përgjigjur parafolësit, theksoi, i nderuar njëri voton kështu, tjetri ashtu, tjetri thot propozimi im.., mirëpo ke të drejtë z.Ekrem Rrahmani sepse këtu demokraci është.

z.Bahri Blakçori, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti furnizim me pajisje për bletë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne në fillim ishim shumë të kuartë, ndoshta mund të harrojmë por u morëm vesh në një mënyrë që për të tri pikat (pika 3, 4 dhe 5) të jepet fjala hyrëse dhe të bëhet debat e pastaj secila pikë të del në votim veç e veç, edhe drejtori e dha arsyetimin shumë mirë për tri pikat e rendit të ditës, mirëpo mbeti vetëm votimi me radhë për secilën pikë të rendit të ditës, pra kështu ishte diskutimi me marrëveshje dhe kur unë fillova t’i hedh pikat në votim ju kërkuat debat, nuk është problem kjo andaj pa humbur kohë më shumë rreth këtij diskutimi e vë në votim që të miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me pajisje për bletë”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me pajisje për bletë”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

6. Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Komuna e Podujevës si organizatë buxhetore e ka për obligim ligjor që pas përfundimit të vitit fiskal të përpiloj pasqyrat e saj financiare dhe këto pasqyra financiare ti dërgoj në Ministri të Financave në mënyrë që t'i tregoj në mënyrë të specifikuar të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të cilat kanë qenë gjatë tërë periudhës fiskale të vitit 2024. Siç dihet Komuna e Podujevës për vitin 2024 ka pasë një buxhet total prej 33,439,000.00€, ku nga këto të hyra një pjesë kanë qenë nga grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake dhe natyrisht nga grandit qeveritar përbëhet grandit i përgjithshëm, grandit specifik i arsimit, grandit specifik i shëndetësisë dhe të hyrat vetanake që janë të kategorive të ndryshme, dhe nga ky buxhet prej 33,439,000.00€ totali i shpenzimeve për muajt janar - dhjetor është 33,438,931.00€, prej tyre 30,628,031.00€ janë shpenzime të grandit qeveritar dhe 2,487,002.00€ shpenzime të të hyrave vetanake. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 18,187,000.00€, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 3,413,317.00€, për shpenzime komunale janë shpenzuar 548,117.00€, për subvencione dhe transfere janë shpenzuar 1,975,239.00€.

Në pasqyrë financiare i keni të prezantuar edhe të hyrat vetanake të cilat janë realizuara, qoftë të hyra tatimore apo të hyra jo tatimore, të hyra tatimore janë 3,347,000.00€, do të thotë janë të hyra të tatimit në pronë dhe të hyra jo tatimore janë 1,000,364.00€ edhe në pasqyrën financiare vëreni që ka një ndryshim midis buxhetit fillestar dhe buxhetit përfundimtar e që ky ndryshim nga buxheti fillestar dhe ai përfundimtar vjen në kategorinë e pagave ku shuma prej 1,669,331.00€ janë mjete shtesë me vendim të qeverisë të cilat janë alokuar në kategorinë e pagave në Komunën e Podujevës dhe arsyeja pse ka ardhë deri te kjo shtesë në kategorinë e pagave të gjithë tani të jeni të informuar sepse ne e kemi diskutuar shpeshherë punën e Kontratës Kolektive ku fillimisht janë marrë me ekzekutime që janë bërë nga kjo kategori e pagave 1,669,000.00€ në mënyrë që të ekzekutohen edhe pagat e muajve nëntor dhe dhjetor. Qeveria me vendime të veçanta ka ndarë mjete pothuajse për të gjitha komunat e Kosovës në mënyrë që të paguhen shërbyesit civil por edhe shërbyesit publik të arsimit, shëndetësisë, administratave e të tjerë.

Pastaj në mallra dhe shërbime ndryshimi i buxhetit përfundimtar nga ai fillestar është 32,085.00€ dhe arsyeja e tyre është që janë bartë nga të hyrat vetanake, do të thotë me vendim të asamblesë komunale vitin e kaluar kur janë bartë të hyrat vetanake këto mjete janë bartë në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve komunale ku kemi një ndryshim nga buxheti fillestar në vlerë 40,309.00€ edhe këto janë bërë me bartjen e të hyrave vetanake të cilat janë bartë ashtu siç i bartëm sot vetëm në kategorinë e investimeve kapitale, por që në vitin e kaluar ka pasë bartje edhe në kategorinë mallra dhe shërbime dhe në investime kapitale.

I paraqita këto në formë të përmbledhur, pra disa të dhëna lidhur me të dhënat financiare të Komunës së Podujevës përgjatë vitit 2024 dhe në materialin që keni marrë që është rrjedhimisht pasqyra financiare e Komunës së Podujevës e cila është dorëzuar dhe miratuar nga ana e Ministrisë së Financave sepse aty bëhet një miratim nga Ministria e Financave ngase Ministria i kanë të gjitha të dhënat financiare që i shpenzon Komuna e Podujevës e që normalisht se gjithçka kalon përmes sistemi Free-Balance dhe i kanë të dhënat shumë të sakta si dhe është një pasqyrë financiare e cila është audituar nga Zyra Kombëtare të Auditorit-ZKA ku ne vetëm e kemi kaluar si proces edhe pse ende nuk ka ardhë raporti përfundimtar, mirëpo dihet se kjo pasqyrë financiare që ju sot e keni para vetës edhe në bazë të ZKA paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të të dhënave financiare të Komunës së Podujevës, andaj nuk po e zgjas më shumë, normalisht që jam i hapur ndaj diskutimeve, pyetjeve, sqarimeve që mund t'i kërkonit lidhur me raportin financiar për vitin 2024 dhe besoj se do të përgjigjemi për secilin një nga një për çështjet e shpenzimit të buxhetit.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në emër të grupit të LVV-së, e përkrahim raportin vjetor financiar të vitit të kaluar, një raport i cili pasqyron gjendjen reale financiare të Komunës tonë dhe gjendjen e cila reflekton pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal.

z.Arjant Topanica, theksoi, po ndërlidhem me parafolesin i cili tha se e përkrahim këtë raport financiar, raporti financiar nuk përkrahet sepse është vetëm pasqyrë e rrjedhjes së parasë për vitin paraprak e në këtë rast e kemi për vitin 2024. Mandej nëse ndërlidhemi te baza ligjore, që në fillim kemi shkelje në paraqitjen e këtij raporti para Kuvendit sepse sot është data 18.04.2025 dhe të paraqitet raporti financiar për vitin fiskal paraprak në këtë datë, është një shkelje ligjore për arsye se raporti financiar i vitit paraprak duhet të paraqitet para Kuvendit më së largu deri më 31 mars të vitit pasues.

Për të hyrë tutje në detaje të këtij raporti, fillimisht nëse e marrim raportin dhe e shohim si strukturë dhe si përmbajtje mirëpo e vërejmë një jo seriozitet, do të thotë ata që janë marrë me të nuk e kanë marrë mundin që të paktën nga kuptimi i paraqitjes së tij dhe nga kuptimi i përmbajtjes së tij teknike të japin sinjal se është marrë dikush seriozisht me të. Kemi tabela pa ndarje të vijave dhe nuk dihet cila shumë përkon me cilën shumë në anën tjetër të tabelës, mandej përmbajtjet e tij dhe strukturimi i tij është mjaftë i thjeshtë dhe vërtetë shihet një jo seriozitet së paku në gjërat elementare të përpilimit të këtij raporti, por vlen të theksohet sepse gjërat e mëdha dhe të rëndësishme identifikohen nga detajet dhe për atë arsye këto nuk janë detaje por janë gjëra që duhet të merremi seriozisht kur përpilohet një pasqyrë kaq e rëndësishme financiare siç është raporti financiar që tregon rrjedhën e parasë publike për një vit fiskal.

Për të hyrë në detaje tutje, çka kemi vërejtur si defekte në këtë raport që kemi, te shpenzimet furnizim me ushqim në vlerë 2,500.00€ nga buxheti i Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” që është një keq menaxhim i parasë publike sepse nuk dihet çka është paguar nga buxheti i shkollës dhe a është në dijeni drejtori i shkollës dhe a janë në njohuri përgjegjësit për buxhetin e tyre apo ky buxhet është marrë nga kodi i tyre pa dijeninë e tyre dhe është bërë një keq menaxhim dhe keq planifikim i këtyre mjeteve. Pagesa në shumën 5,000.00€ në emër të bartjes së nxënësve për arsimin para fillor, pra për çerdhe, sa e dimë ne fëmijët që shkojnë në Çerdhe nuk kanë transport prandaj dua sqarim për këtë se në emër të kujt është bërë kjo pagesë prej 5,000.00€ në emër të bartjes së nxënësve për arsimin para fillor-Çerdhe. Pastaj te pagesat për bursa vërejmë se përshtkrimi është bërë pagesa për institucione jo publike, do të doja një sqarim pse të figurojë kjo pagesë kështu, dhe kemi vërejtur se te këto pagesa kemi tri pagesa nga 300€, një pagesë 400€, dhe një pagesë 157€. Po ashtu dua një sqarim shtesë nga drejtori i Drejtorisë përkatëse se pse te përfituesit e këtyre bursave figuron pagesa me nga 300€ person fizikë me emër dhe mbiemër të njëjtë e që për hire të privatësisë nuk po e përmendi.

Projekti asfaltim i disa rrugëve në fshatin Penuhë, kemi pagesa për dy operatorë të ndryshëm ku përshtkrimi është asfaltim i disa rrugëve në fshatin Penuhë, në një kod është vetëm në fshatin Penuhë, kurse në kodin tjetër është operatori tjetër për një grumbull të fshatrave ku ndër to është edhe fshati Penuhë. Mandej projekti asfaltim i disa rrugëve në fshatin Letanc, ku për ato rrugë është bërë pagesë në emër të disa operatorëve, në shumë 90,648.00€ në emër të projektit ndërtim i objektit të ri të shkollës fillore në qendër të qytetit, ne e dimë që në qendër të qytetit shkolla e mesme ekonomike është duke u ndërtuar dhe janë duke u rinovuar disa shkolla fillore por për ndërtim i objektit të ri të shkollës fillore në qytet, për këtë do të doja sqarim sepse është në pyetje shuma 90,648.00€ dhe nuk e dimë, apo ndokush nga ne nuk e din se është duke u ndërtuar një shkollë fillore në hapësirën e qytetit.

Po ashtu në Drejtorinë e Arsimit, në shumë raste kemi keq planifikim dhe keq menaxhim të parasë publike ku shumica e pagesave nuk gjenden në projektin dhe në kodin e duhur, e që këto nuk ish dashtë as të kalojnë si vërejtje sot por janë edhe rast për hetime të mëtutjeshme edhe gjyqësore.

Pagesa në emër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në vlerë 579€, për kontroll sanitar për Çerdhe publike, do të thotë nga kodi i DSHMS-së është paguar për shërbime të sanitarisë në Çerdhe publike.

Pra këto janë disa nga gjetjet si më kryesore që i kemi ngritë dhe pa dashtë t’jua marrë kohën për diskutim edhe kolegëve tjerë që bashkërisht e kemi analizuar këtë raport dhe i kemi gjetur ato vërejtje dhe komente mbi këtë raport financiar që gjithsesi janë në të mirë të qytetarit, mirëpo kërkojmë edhe një herë vendosmëri dhe seriozitet sepse kemi të bëjmë me menaxhimin e parasë publike, parasë së qytetarëve tanë, andaj të paktën duhet të merret me seriozitet dhe të ulet shkalla e keq planifikimit dhe keq menaxhimit. Disa arsye i dimë edhe ne që e nxisin këtë raport që të jetë i tillë mirëpo të paktën të merret me seriozitet dhe të hartohet raporti ashtu siç duhet e mos të na dalin këto keq planifikime e keq menaxhime që lënë vend edhe për hetime të mëtutjeshme.

z.Bashkim Sylja, theksoi, raporti është obligim ligjor që së paku deri më 31.03.2025 të diskutohet në asamble. Buxheti fillestar i Komunës së Podujevës për vitin 2024 ishte 31,268,000.00€, si dhe shtesa nga qeveria për paga 1,669,000.00€, pastaj të hyrat vetanake të bartura nga viti 2023 ishin 1,104,000.00€, donacione 499,000.00€, kështu që buxheti final i Komunës së Podujevës ishte 34,540,000.00€. Buxheti përfundimtar për paga 18,187,000.00€, nga ky buxhet 1,673,000.00€ janë pagesa për vendime gjyqësore që janë marrë nga ky kod buxhetor. Buxheti përfundimtar për mallra dhe shërbime 3,624,000.00€, pagesa për vendime gjyqësore 368,000.00€ nga ky kod buxhetor, pastaj buxheti përfundimtar për shpenzime komunale 553,000.00€, pagesa për vendime gjyqësore 28,000.00€, buxheti përfundimtar për investimet kapitale 9,931,301.00€ ku janë shpenzuar 9,314,637.00€ dhe po nga kjo shumë pagesa për vendime gjyqësore 1,791,596.00€, investime kapitale në Komunën e Podujevës për vitin 2024. Sa ishin të planifikuara nga 9,314,637.00€ janë shpenzuar 7,523,000.00€ ose 2,408,000.00€ më pak se sa janë planifikuar.

Prej të gjitha këtyre kodeve buxhetore i kam mbledh këto pagesa për vendime gjyqësore ku përafërsisht janë 3,998,000.00€.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, është viti i tretë që ndërlidhem te pjesa e raporteve financiare dhe e jap si koment qysh këto raporte financiare lënë për të dëshiruar, është një raport vështirë i kuptueshëm madje edhe nëse je i fushës së ekonomisë e lëre më nëse nuk je. E di që raportet përmbajnë terma teknik por mendoj që një raport financiar nuk duhet të jetë me përmbajtje thjesht përmbledhje të numrave por duhet të jetë raport i qartë që tregon gjendjen ekonomike të Komunës tonë në mënyrë që ta kuptojmë të gjithë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, së pari kam një pyetje për drejtorin e DBF-së z.Fatlum Osmani, se di a i ka treguar Kryetarit të Komunës a jo që ligji mbi menaxhimin e financave e jep datën e fundit për raport 31 marsin, ligjin nuk po ia lexoj sepse këtë ky e din më mirë se unë, por po i them a është shkel ligji pasi ka kaluar data 31 mars dhe nuk është sjellë raporti financiar deri më sot kur është data 18.04.2025, por prapë më mirë të sjellët vonë se sa hiç.

Unë si zakonisht kam qejf t’i përmendi disa pagesa që nuk i kuptoj dhe disa pagesa të luksit që në raporte që po na sjellën ju duhet t’i shikoni në raport të Free Balance sepse këto pagesa është problem të gjenden në këtë raport.

Së pari kam një pyetje për një pagesë prej kodit kanalizimi prej fshatit Lluzhan-Lupç, por fatura i është bërë Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi”, do të thotë shuma 60,000.00€ drejtori e din që kod të veçantë ka kanalizimi, kod tjetër të veçantë ka ujësjellësi dhe nuk e di përse e ka bërë

këtë pagesë kështu. Tjetër pagesë është renovimi i objekteve shëndetësore në shumë 90,000.00€ dhe do të kisha dëshirë të di cili objekt është duke u rinovuar e që paska këtë kosto.

Pastaj pagesa tjetër prej Teatrit “Avdush Hasani” i është bërë Bashkësisë Islame për shpenzimet e varrimit e që kjo pagesë prej Teatrit në shpenzime të varrimit goxha pa lidhje i bie. Mandej pagesë tjetër është, drejtoresha e DKRS-së për momentin nuk qenka këtu, mirëpo pata pyetje për terrenet sportive që janë 128,936.00€, nuk po e them për të gjitha por prej këtyre terreneve sportive që kanë qenë në kontratë për tu përfunduar e që goxha shpesh kaloj pran tyre, por terreni i fushës sportive në fshatin Sibofc nuk është i përfunduar, dhe tani që drejtoresha është prezentë po e përsërisë, edhe pse e di që kjo nuk ka qenë drejtoreshë e DKRS-së kur janë kontraktuar këto terrene sportive por nuk do të thotë që nuk je përgjegjëse tani që këto punime nuk përfundojnë më shpejtë, pra për terrene sportive është pagesa 128,396.00€, ku janë bërë e ato punime sepse nuk kanë përfunduar, madje terreni sportiv në fshatin Peran dihet në çfarë gjendje është sepse e kam vizituar dhe nuk i plotëson kushtet e një terreni sportiv as për nga madhësia, as sipas standardeve por edhe bari i fushës nuk është në nivel dhe aty ke një shportë të mbeturinave që e kanë sjellë disa shkolla të futbollit prej vullnetit të tyre.

Kemi asfaltimin e disa rrugëve në qytet ku jenë bërë tri pagesa në shumë 99,787.00€, pastaj u çudita nga pagesat e shumta për mirëmbajtje të kamerave dhe vazhdimisht çdo raport tre mujor që kam pasë dokumente në dorë kam has në mirëmbajtje të kamerave, prandaj besoj që në këto shuma që janë paguar për mirëmbajtje të kamerave edhe po të bliheshin të reja dhe të instaloheshin ato kamera në vendet e caktuara nuk do të bëhet ajo shumë e cekur që është për mirëmbajtjen e tyre, pra është pagesë që i kanë vendos kamerat e është shkruar kodi për mirëmbajtje.

Pastaj kemi mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore që ishin disa pagesa 9000€ dhe 6800€ e që pyes cilën ngrohje qendrore e mirëmban dikush me këtë shumë kaq të shtrenjtë.

Tash po i ceku pagesat e “sefasë” ushqim dhe pije ku i pash 22,163.00€, madje e pash këtu një pagesë në një lokal këtu në qytet më 03.09.2024 pije 723€ dhe po ashtu më 04.09.2024 pije 723€, do të thotë njëra faturë është në emër të lokalit kurse tjetra faturë është në emër të pronarit të atij lokali, pyes si keni pasë mundësi që këto dy shuma nga 723€ t’i fusni në dy data 3 dhe 4 shtator 2024, do të thotë dy pagesa të njëjta për pije, kjo më bëri goxha përshtypje.

Mandej dhe te kjo kafeja këtu afër që është këtu shkruan akomodim, rregullojeni atë kod ju lutem, çfarë akomodimi në atë kafe siç e kemi po ashtu akomodin te “Sefa”, akomodim në kafe të “Ramishit”, akomodim këtu në kafe, i bie shumë pa lidhje kur shihen këto pagesa për akomodim sepse të gjithë ne e dimë që në këtë kafën afër këtu s’mund të flejë sepse nuk është hotele por është kafene, e as në të tjerat që i ceka që janë të ngjashme.

Te subvencionet, e kam përmend dhe po e them sërish sepse mua më dhembë, qendra sportive dhe rekreative “Kroni” 5,000.00€ e që kisha pasë qejf të di çka ka bërë ai që i ka marrë 5,000.00€, pastaj çka ka bërë ende më shumë kjo OJQ “Kthesa” që i ka marrë 8,000.00€ si dhe OJQ “Për Mjedis dhe Turizëm të Qëndrueshëm” e që ai “jarani” atje arsimtari i gjeografisë në Pejë i merr 15,000.00€, a ka mundësi ta dim ky bash çka ka bërë për t’i marrë 15,000.00€ këtu, ndërsa atij i qoftë hallall që ka arrit deri te Kryetari i Komunës së Podujevës me i marrë gjithë ato para veç ashtu, përndryshe ne kemi OJQ këtu sa të doni dhe ka këtu këso klube sportive që ka mundësi t’ju jepen para, por jo atij nga Peja gjithë atë shumë 15,000.00€.

Te pagesa për naftë janë mbi 52,000.00€ ku shumica e pagesave është bërë për vetura edhe pse kishte pagesa edhe për ngrohje, por pjesa më e madhe e pagesave ishte për vetura.

Po e përfundoj me kaq por nëse ka diçka gjatë diskutimeve e them sërish.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, unë kam vetëm një pyetje për drejtorin e DBF, tek ndërhyrja te të arkëtueshmet, ndërhyrja me merimangë tri vite radhazi 2,936.00€ a është ndonjë kontratë apo diçka tjetër, që ka mundësi na e shpjegon këtë se është shumë fikse e njëjtë e që nuk e kam ndonjë informacion për tu informuar rreth kësaj çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur t'i përsërisë ato që thanë parafolësit sepse sigurisht të njëjtin material e kanë përpunuar nga këndi i tyre por kam një vërejtje ashtu siç e tha kolegu z.Arjant Topanica që një raporti financiar komponentë kryesore ka të jetë i sqaruar dhe i kuptueshëm për atë që i paraqitet, e them këtë kur ke parasysh që një pjesë e mirë e anëtarëve të Kuvendit e njëri nga ta edhe unë e dimë që jemi zgjedhë nga qytetarët e jo me konkurs dhe mund të mos jemi profesionist të fushës, andaj edhe ligjërish komponenta kryesore e një raporti të raportuar para atyre të cilëve ligjërish duhet të raportohet duhet ta përmbajë në vete komponentën e të qenit i kuptueshëm dhe i sqarueshëm. Po i përmendi vetëm shkurtesat në këtë raport që nuk shihet as faqja dhe nuk e di kush ka punuar në këtë raport por të paktën në fillim të kësaj faqeje duhet të jenë të sqarueshme kur përdoren terma të caktuar për të sqaruar diçka në raport dhe në këtë faqe që kam para vetes, pra shkurtesat që keni përdor janë, fh, fhzhm, gq, t, h,v thd, gpd, dhe të gjitha këto nuk e kanë një faqe për t'i sqaruar se çka janë si një prej komponentëve për të qenë raport sqarues.

Se çka ka ndodh dhe si është menaxhuar ky buxhet që e keni thënë me plot gojën buxheti më i madh historik mbi 30 milion euro, dhe kur vij puna për të raportuar nuk mund ta kuptosh ose shumë pak si është menaxhuar, a është menaxhuar drejtë dhe sa me nikoqirllëk është shpenzuar ky buxhet, e që e vetmja formë për ta kuptuar është nëse bëhen kërkesa individuale përmes thesarit për t'i parë pagesat, përndryshe është i pa kuptueshëm ky raport.

Kolegu z.Ekrem Rrahmani foli për shpenzimet për mallra e shërbime, dhe për ato subvencione por një kategori tjetër që s'është përmend e që ligjërish është e obligueshme që të thuhet këtu, para se të citoj ligjin e menaxhimit të financave publike, dhe jo pse unë po dua. Të dhënat e investimeve kapitale nga ato projekte që i kemi miratuar në shtator, çka na pasqyrohet sot, cilat janë realizuar, cilat janë përmbyllë, cilat janë në fazën e realizimit, sa ka kushtuar secili prej atyre projekteve, sa mjete kanë tepruar dhe sa s'ka pasë mjete, ashtu siç biseduam më parë për disa kontrata që bëhen pa zotim të mjeteve. Pra të bëhet një përmbledhje e statusit të të gjitha investimeve kapitale se ku janë, çfarë gjendje janë, sa është realizimi, sa janë finalizuar, prandaj e them se Kuvendi i Komunës është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të komunës, ndërsa Kryetari i Komunës mbikëqyrë dhe administron atë që e ka vendos Kuvendi dhe normalisht pastaj paraqet raporte periodike dhe raporte vjetore.

Nuk po dua të zgjati debatin, por një vërejtje që deri në pikën tjetër shumë kush mori fjalën që këtu po bëhet politikë që nga Kryesuesi i Kuvendit e te poshtë dhe nëse ishte fjala për politikë pyes partinë që është në pushtet, gjegjësisht që qeverisë me Komunën e Podujevës, qasja e këtij raporti financiar në këtë mbledhje, sa numra (asambleistë prezent) i ka këtu dhe në anën tjetër ne detyrohemi si opozitë në rolin tonë t'ia mundësojmë të vazhdojë kjo seancë vetëm kur është prezenca jonë, do të thotë serioziteti se si i qasen kësaj tematike kur është puna për të raportuar për ato që i kanë harxhuar dhe si janë harxhuar pa dashur të hyjë në banalitete qysh janë të pa kuptueshme për mua ashtu siç i përmendi kolegu Ekremi, akomodimet këtu e aty, kemi projekte kapitale që janë me vite e vite të tëra e sot nuk dihet as sa kanë kushtuar, as a janë finalizuar, as sa janë përruruar, a janë gjysmake, shpallet kontratë tjetër për me përmbushë projektin bazik qysh ka qenë në fillim e qysh e kemi projektin për gjelbërim e të tjera.

Po e përmbylli, askush nuk mund ta përmirësoj askënd deri sa ai vet nuk don të përmirësohet ose nëse nuk ka masa ndëshkimore për shkeljet që i ka bërë dhe vullnetin që ka mbet këtu nuk po shohë që jemi në rrugë të mirë, nuk po shohë që po i ofrohemi ose të paktën e kemi ndërdijën tonë

t'i ofrohemi një qeverisje të mirë dhe një menaxhimi të suksesshëm të buxhetit që vërtetë e përmendi z.Ragip Fetahu se kish qenë dashur të ndikojë në mirëqenien, zhvillimin, pa dyshim nuk po them që s'ka sepse 30,000,000.00€ t'i shpenzosh sigurisht që diku shihen por ato që diku shihen duhet të pasqyrohen ashtu siç është obligim ligjor e në këtë rast si shkallë e parë përgjegjësi i jep Kuvendit të Komunës si monitorues i parë pastaj e dimë edhe fazën tjetër të Auditorit të jashtëm edhe opinionit publik, por para nesh keni paraqitur një raport jo sqarues dhe jo të kuptueshëm.

Po ta marrësh prej fillimit deri në fund raportin tre mujor dhe raportin një vjeçar, as kategoritë kryesore sa është suficiti, sa është kjo e ajo, janë fsheh me disa germa sikur të ketë atë para ndjenjën, që s'duhet me qenë, sa më i hijezuar aq më i mirë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, pa dashur të përfshihem në diskutimet e mëparshme se sa i koklavitur dhe sa i pa kuptueshëm është ky raport, po dua ta japë një pamje se si ka ardhë ky raport financiar. Kështu siç po e shihni ky raport financiar ka ardhë kështu, tani a po ju dhimbset toneri i ngjyrës apo çka është kjo me korniza kështu, por t'i specifikoni. Nuk po ndalem më shumë te kjo mirëpo me çfarë qëllimi po bëhet fshehja e emrit, andaj pyes drejtorin e DBF-së, te një pagesë që është bërë riparimi i kioskave dhe amfiteatrit është bërë pagesë në shumë 5,000.00€, a mund ta dimë cilat kioska janë riparuar, pastaj edhe te një pagesë që është bërë ngritja e infrastrukturës së turizmit për çka është një pagesë 48,000.00€, dua ta di a ka përfunduar ky projekt.

z.Haki Rudari, theksoi, të drejtën për me qenë prezent në sallë krahas asamblistëve e kanë edhe Ekzekutivi i Komunës, e sidomos në rastet kur ka të bëj me raport vjetor që i përfshin të gjitha Drejtoritë e që konsideroj se do të ishte shumë e arsyeshme, nuk do të thoja të jetë e obligueshme të jetë prezent në radhë të parë të gjithë drejtorët e Drejtorive por të gjithë asamblistët që kanë marrë votat e qytetarëve dhe natyrisht në fund të muajit paguhen për ardhjen në seancë dhe një pjesë e madhe prej nesh po e shohim qysh po shkon, kjo është e para për arsye se po shohë që prezent janë vetëm katër drejtor të cilët prej fillimit që kur ka filluar seanca janë prezent.

Ne kemi një buxhet 33,438,931.00€ dhe ajo që unë do ta përmendi është një shpenzim kapital në shumë 9,314,637.00€, por një çështje që më ka ra në sy e që realisht po bartet do të thoja në formë shakaje “si lloj gripi apo flake që na e ka lënë LDK-ja dhe partitë tjera në pushtet” me Kontratë Kolektive dhe atë grip nuk po mundemi fortë as ne ta heqim për arsye se kjo bartje tash po na përcillet edhe neve nëpër Kuvende Komunal e sigurisht edhe në Komunën tonë. Pra kemi një shumë të madhe të pagesave nga proceset gjyqësore dhe konsideroj se kjo po ndikon nëpër projekte por megjithatë ky është një problem qendror, një problem që është nënshkruar në vitin 2017, por thënë të drejtën fortë zgjidhje nuk i kemi jep edhe ne që jemi ardhë dhe sigurisht që kjo do të vazhdojë edhe më tutje.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kur flasim për raportin financiar të vitit të kaluar dhe kur flasim për gabime teknike pajtohem plotësisht që Komuna e Podujevës duhet të ketë një lektor i cili do të merrej me dokumentet zyrtare dhe gabimet eventuale teknike t'i përmirësoj në mënyrë që mos të na dalin në publik dokumentet me gabime të ndryshme gjuhësore dhe teknike.

Sa i përket raportit financiar unë mendoj që buxheti i vitit të kaluar ka sjellë zhvillim në Komunën tonë në disa drejtime, pra në aspektin ekonomik ky buxhet i vitit që lamë pasë ka sjellë një zhvillim ekonomik, ka sjellë interesim shumë të madh të bizneseve të njerëzve të cilët duan të investojnë në Komunën tonë, ka sjellë një interesim shumë të madh në aplikim për ndërtimin e objekteve kolektive që kjo nënkupton që është një zhvillim për Komunën dhe është një mundësi që gjeneron vende të reja të punës dhe zvogëlon shkallën e pa punësisë, pastaj në aspektin kulturor mendoj që ka sjellë një pozitivitet mirëpo duhet të bëhet shumë më tepër në këtë aspekt sepse ta zëmë stadiumin në fshatin Peran që e përmendi kolegu Ekremi, madje unë takoj shumë ekipe që luaj aty dhe është ngjallë ai vend mirëpo natyrisht se ka nevojë për investime shtesë në atë fushë.

Në aspektin e menaxhimit dhe keq menaxhimit që u potencua këtu dhënia e disa kontratave për investim në disa rrugë të caktuara mendoj që ne jemi anëtar të Kuvendit dhe kemi të drejtën ligjore që të qasemi në dokumente zyrtare dhe secili nga ne në qoftë se kemi interes natyrisht se mund të shikojmë edhe të shikojmë se për çka bëhet fjalë konkretisht dhe si janë duke u ndërtuar ato rrugë, nga kush dhe për cilat projekte bëhet fjalë.

z.Arjant Topanica, theksoi, kam një pyetje rreth suficitit buxhetor që të specifikohet dhe të shohim apo e paraqitni të duhurin dhe atë çka tregon raporti, pra të na njoftoni për suficitin buxhetor në detaje, prandaj i nderuar drejtor i DBF-së është i parashikuar dhe i paraparë kjo mirëpo deshta ta dëgjoj prej teje dhe atë sipas kategorive, atë të përgjithshmin si dhe nga donatorët se qysh e kemi suficitin buxhetor.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, po ndërlidhem te tri çështje, së pari sa i përket kolegut që tha e ka lënë LDK-ja si flamë Kontratën Kolektive, deshta të sqaroj që LDK nuk e ka lënë Kontratën Kolektive si flamë por e ka lënë PDK-ja atë Kontratë prej të cilës edhe ti përfiton i nderuar koleg. Së dyti deshta të ndërlidhem se si po na servohet raporti financiar neve dhe në çfarë gjendje si dhe seriozisht e them nëse kish qenë qoftë ndonjë biznes individual do ishte tmerr e lëre më nga Komuna, e them këtë ngase, shembull kemi kod buxhetor që është shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale, aty merreni dikë e le t'ua bënë raportin që të paktën të duket bukur.

Sa i përket asaj që e ceku kolegu z.Ekrem Rrahmani përfitimin e një OJQ-je që ka përfituar 15,000.00€, kisha pritë së paku prej kolegut z.Ragip Fetahu që merret me këtë çështje të reagoj sepse shumë prej 15,000.00€ me ia jep një OJQ në Podujevë kishit bërë më mirë se sa atij tipit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit zonja Arnisa që na e përmende PDK-në, po PDK e ka bërë atë Ligj/Kontratë shumë të mirë, por të tjerët nuk e kanë realizuar, mirëpo me qenë gabim që e ka bërë PDK-ja sigurisht që Gjykata nuk i kthen pozitive vendimet dhe krejt punëtorët janë duke i fituar lëndët, kjo do të thotë nuk e ka shkel asnjë ligj të Republikës së Kosovës edhe Gjykata është e Kosovës siç është edhe PDK-ja e Kosovës, madje asnjë punëtor që i'u kanë dhënë ato shpërblime nuk ka dalë ta kundërshtoj, as s'ka dalë z.Haki Rudari, as unë e askush, që do të thotë është një vendim shumë i mirë që e ka marrë qeveria dhe nuk e kundërshtoj asnjëherë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për diskutimet dhe çështjet që i ngritët, ne shpesh kemi diskutuar për raportin financiar por është ky viti që ne bashkërisht i diskutojmë çështjet e raportit financiar dhe këtu shumë u diskutua madje znj.Arnisa Sylejmani e krahasoj me një biznes individual, por zonja Arnisa dhe të gjithë të tjerët që e ngritët çështjen e raportimit financiar ju them se kjo është pasqyrë financiare, çdo vit Ministria e Financave për çdo vit me radhë e publikon formatin e raportimit financiar të çdo organizate buxhetore në këtë rast edhe të Komunës së Podujevës, kjo që keni para jush është formati i Ministrisë së Financave e ne si organizatë buxhetore nuk kemi të drejtë t'i shmangemi këtij formati të pasqyrës financiare, përndryshe ne mund të paraqesim një raport tjetër ashtu siç e kemi diskutimin që të jetë më sqarues meqenëse bëhet fjalë për shumë persona të cilët normalisht që nuk janë të fushës, por edhe për ata që nuk janë të fushës këto terma i kuptojmë të gjithë, madje z.Ekrem Rrahmani mund ta sqaroj edhe pse nuk është i fushës por po i sqaron të gjitha sepse është raport financiar i Komunës dhe i kuptueshëm. Pra po e përsërisë, është formati i Ministrisë së Financave dhe kjo pasqyrë financiare në bazë të Ligjit të financave publike e ka për obligim deri më 31 janar të hartohet dhe të dërgohet në Ministrinë e Financave e cila ka të gjitha të dhënat e shpenzimeve të çdo organizate buxhetore.

Çdo shpenzim nga planifikimi buxhetor kalon përmes një sistemi të integruar të financave të menaxhimit të financave publike SIMFK dhe Ministria shohin çdo shpenzim.

Kjo si procedurë shkon në Ministri dhe është miratuar në Ministri të Financave si një pasqyrë financiare që paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve, buxhetit, të hyrave

financiare, buxhetit fillestar, ndryshimet e buxhetit fillestar, dhe atë pse ka ndryshuar, për çka ka ndryshuar dhe komplet çështjet tjera.

Përveç kësaj, një pasqyrë financiare edhe auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit-ZKA e që raport përfundimtar i ZKA-së ende nuk është sjellë e që sigurisht që ka të gjetura sepse është e pa mundshme të mos ketë të gjetura, mirëpo një çështje është që përveç pasqyrës financiare nuk ka asnjë vërejtje sa i takon prezantimit të të dhënave në pasqyrë financiare, do të thotë nuk ka vërejtje, normale të çështjet e keq klasifikimit të cilat kanë të bëjnë me Kontratën Kolektive edhe të gjeturat tjera, mirëpo për këtë çështje nuk ka vërejtje.

Dy ose tre asamblistë përfshirë edhe z.Arjant Topanica e paraqiten çështjen e jo seriozitetit lidhur me raportin financiar, mirëpo e përsërisë se ky raport do të thotë është bërë sipas formatit të Ministrisë së Financave. Lidhur me shpenzimet që i ceku z.Arjant Topanica konkretisht një pagesë 5,000.00€ furnizim me ushqim, ju them se Komuna e Podujevës në këtë periudhë i ka shpenzimet e ushqimit që i furnizon nxënësit e shkollës fillore 1-5 me ushqim dhe kjo pagesë i takon asaj, pastaj përmendi që është bërë pagesë nga kodi i Gjimnazit, po ashtu është por tani kemi një grand të arsimit që është për shpenzime të ushqimit, dhe ka vetëm një buxhet që rrjedh nga grandit specifik i arsimit dhe procesi i shpenzimeve në sistemin SIMFK kalon përmes procesit të nën alokimeve. Po më bie të përmend sërish jo për arsye time por seriozisht Kontrata Kolektive i ka shkaktuar këto çështje dhe tek ne ka qenë kjo për arsim dhe e kemi bërë pagesën vetëm prej arsimit të mesëm, do të thotë nuk ka asnjë çështje tjetër rreth kësaj meqë u përmend edhe çështja e informimit të drejtorit i shkollës, mirëpo ju them se drejtori i shkollës nuk është bartës i buxhetit, nuk nënshkruan pagesë, do të thotë buxheti kalon nëpër sistem tjetër të pagesave ku është e rregulluar siç janë shpenzim, certifikim, pranim, dhe është prej arsimit të mesëm për shkak që në një periudhë të caktuar ka munguar buxheti në arsimin fillor dhe këtë pagesë ZKA nuk e klasifikon as keq klasifikim sepse është prej kategorisë së mallrave, pra çështje tjetër është prej kodit ekonomik përkatës, çështja tjetër është prej programit të arsimit që është me grand specifik të arsimit dhe çështjet tjera që këtu s'ka kurrfarë problemi.

E njëjta logjikë është edhe të çështja e transportit ku bëhet fjalë për disa kontrata që ka Komuna e Podujevës por me operator ekonomikë të cilët e bëjnë bartjen e nxënësve në shkolla të ndryshme dhe dihet se në bazë të rregullores kanë mbi 4 km edhe janë kontrata të nënshkruara përmes zyrës së prokurimit dhe për obligime të cilat derivojnë prej atyre kontratave e që në bazë të raportit të pranimit është bërë pagesa.

Çështja e bursave, u cek pagesa për entitete jo publike, tani në planin kontabël meqë u përmenden edhe disa elemente të cilat kanë të bëjnë me çështjen e planit kontabël, në këtë plan janë kodet ekonomike dhe këtë plan e miraton Ministria e Financave, ne jo vetëm në kuptimin procedural e ligjor që kemi obligim t'i përmbahemi atij plani kontabël mirëpo as teknikisht kur te marrim për ta proceduar një pagesë që fillon nga zotimi i mjeteve aty është një kod ekonomik dhe nëse nuk shkruhet ai kod ekonomik i cili është brenda planit kontabël teknikisht nuk mund ta kalosh pagesën, do të thotë aty janë dy kode subvencione për entitete publike dhe subvencione për entitete jo publike. Në këtë rast studentët të cilët procedohet me një pagesë janë entitete jo publike dhe pagesa është bërë prej këtij kodi ekonomik, të gjitha bursat e që teknikisht nuk po hy në krejt shpjegimet teknike, çështja e bursave kur procedohet bëhet pagesa përmes listës matëse, dërgohen, zotohen dhe bëhet ekzekutimi sepse ka tepër shumë studentë, rreth 300, dhe për të mos proceduar me 300 pagesa, shkohet me një pagesë që është me listë dhe është mundësi teknike përmes Ministrisë së Financave të cilët i ekzekutojnë.

Asfaltimi i rrugëve në Penuhë, Letanc dhe asfaltimi i rrugëve në qytet që u përmenden si dhe pagesat e disa operatorëve ekonomik, ka qenë një kontratë që ka qenë për një grumbull të fshatrave

Penuhë, Lluzhan dhe është një kontratë e vetme prej të njëjtit kod ekonomik aty kanë qenë dy kontrata të operatorëve të ndryshëm dhe është paguar prej këtij projekti është fjala që sërish po them është në rregull.

Çështja tjetër, sa i përket çështjes së transportit për Çerdhet publike do të thotë është për kontrolle sanitar nëpër Çerdhe publike, kontrolli sanitar i paguhet Institutit të Shëndetit Publik i cili bën kontrollin sanitar të disa punonjësve shëndetësor dhe arsimor e që është ekzekutuar pagesa prej fushës së shëndetësisë.

Disa çështje të përgjithshme që i paraqiti z.Bashkim Sylja që kanë të bëjnë me raportin financiar dhe me formën e këtij raportimi, mirëpo e sqarova çështjen e raportimit financiar. Po ashtu z.Naim Çunaku i pati disa çështje por ndoshta nuk ishte prezent këtu sepse e sqarova kuptueshmërinë e raportit financiar dhe e sqarova që ky raport financiar është në bazë të formatit të Ministrisë së Financave ku ne si raport financiar jemi të obliguar që këtë para se të vije në asamble komunale, më largu deri më 31 janar jemi të obliguar ta dorëzojmë në Ministri të Financave dhe ky i njëjti i dorëzohet edhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Sa i përket listës së investimeve kapitale, do të thotë këto janë çështje ku edhe në pasqyrë financiare i keni të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me kapitalet ku përfshihen ndërtimi i rrugëve lokale, kanalizimeve si kategori që është marrë, ndërtesa arsimore, ndërtesa shëndetësore dhe gjitha të tjerat. znj.Donjeta Sheqiri shtroi dy çështje që patën të bëjnë me riparimin e kioskave dhe amfiteatrit, bëhet fjalë për një pagesë të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik që ka qenë për rregullimin e një amfiteatri që ka qenë te parku i paqes si dhe këtyre kioskave që janë në shesh e ndoshta tani po bëhet viti i pestë që ato kioska janë aktive dhe për shkak të lëvizjes së tyre janë dëmtuar, andaj normalisht edhe është zhvilluar procedura e prokurimit, është kontrata, është procedura e prokurimit që normalisht në bazë të punëve të kryera është kryer pagesa.

Çështje tjetër kemi atë që ngriti znj.Arnisa Sylejmani lidhur me çështjet e raportit financiar si dhe një çështje që e shtroi z.Arjant Topanica për çështjen e suficitit buxhetor, si dhe për individ të njëjtë, ju sqaroj se mund të ndodh që kanë emrin dhe mbiemrin e njëjtë por numrin e letërnjoftimit e kanë të ndryshëm, ndoshta nuk është mirë këtu të bëhet publike por edhe nëse bëhet nuk është ndonjë çështje, mirëpo aty është lista e pagesave dhe ne mund ta sqarojmë por lirshëm edhe kërkon qasje në dokumente zyrtar, madje mjafton ta shkruash vetëm një e-mail, e që z.Ekrem Rrahmani shkruan shpesh thuajse çdo 2 ose 3 muaj dhe çdo gjë që kërkon i ofrojmë qasje, kështu që edhe ti zotëri Topanica mund të kërkojë qasje dhe ne ju dërgojmë listën e përfituesve, pra aty mund të jetë emri i njëjtë sepse janë më tepër se 300 studentë dhe mund të jetë aty, çka mund të jetë një çështje te këto dy nga 300€, ka raste të caktuara kur Ministria e Financave ekzekuton ndonjë pagesë dhe për arsye të ndonjë gabimi e kthen e që ne pastaj duhet ta procedojmë sërish, por te personi i njëjtë me numër të letërnjoftimit të njëjtë nuk ka mundësi ekzekutimi për emrin e njëjtë, mirëpo lirshëm kërko qasje në dokumente zyrtare dhe ne jua ofrojmë këtë, sepse kur është puna te qasja në dokumente zyrtare unë ju kam thënë edhe në të kaluarën dhe atë jo vetëm sa për t'ju thënë, por po ju them sërish e kemi për obligim edhe kur është puna për qasje në dokumente zyrtare përveç raportit që mund t'ju dërgojmë shumë shpejt prej Free Balance që është lista e shpenzimeve për çdo faturë, lirshëm ne çdo pagesë të cilën e kryejmë në Drejtori flas me kompetencë morale dhe profesionale, që ndiqen të gjitha procedurat, kalon minimalisht nëpër 5 zyrtar të ndryshëm financiar teknikisht duke filluar prej zotuesit, shpenzuesit, urdhërblerjes së prokurimit, zyrtarit të pranimit, certifikuesit, dhe të gjitha këto pasi që të përfundon edhe për arsye praktike që kemi përmes Zyrës Kombëtare të Auditimit por edhe për çështje praktike tonat, çdo pagesë e skanojmë pasi që të nënshkruhet prej të gjithëve si nga ana ime ashtu edhe prej zyrtarëve tjerë duke përfshirë këtu edhe dokumentacione tjera që janë të menaxherëve të kontratave,

drejtorëve të Drejtorive përkatëse, pra i skanojmë të gjitha këto dhe kur të doni me një e-mail të shkurtër mund të kërkonti të gjitha pagesat e skanuara të cilat janë proceduar në vitin 2024 nga ana e DBF-së sepse normalisht çdo pagesë ekzekutohet në këtë Drejtori, pra si ta shkruani ju atë e-mail pas 10 minutave mund të vini tek ne vetëm me një USB dhe jua japim të gjitha, më transparent se kaq nuk ka mundësi të jem, do të thotë se mund ta shihni çdo pagesë kush e ka nënshkruar, kush ka qenë menaxher i kontratës, raportin e pranimi, kohën kur është bërë raporti i pranimi, kohën kur është proceduar pagesa si dhe gjitha çështjet tjera.

Sa i përket suficitit që e ceku z.Arjant Topanica, sot patëm edhe bartjen e buxhetit nga të hyrat vetanake të cilat dihet se nuk janë shpenzuar që është shuma rreth 800,000.00€, mirëpo nga buxheti fillestar nuk janë shpenzuar 467,000.00€ do të thotë kjo është diferenca sepse 413,000.00€ është tejkalim, po ashtu është edhe shpenzimi nga grandit qeveritar, por i kemi këtu edhe nga kategoritë e ndryshme ku thuajse është 99.6% e buxhetit që është i shpenzuar. Në kategorinë e pagave kemi tejkalim të shpenzimeve ashtu siç e ceku dhe që është cekur edhe në raport financiar që janë diku rreth 1,600,000.00€ pa hy t'i them me centë, po si vlera janë më shumë të shpenzuara për arsye se Ministria me vendim të veçantë ka ndarë mjete financiare në kategorinë e pagave dhe atë jo vetëm për Komunën e Podujevës, përndryshe sikur të mos ndante mjete me vendime të veçanta, në muajt nëntor dhe dhjetor, ne që kërkojmë marrim pagat përmes këtij buxheti nuk do kishim pasë mundësi t'i marrim pagat për muajt nëntor dhe dhjetor shkak i kësaj është Kontrata kolektive nga e cila na janë marrë afër 4,000,000.00€, dhe normalisht që kur të planifikohet buxheti bëhet në bazë të numrit të punonjësve dhe në bazë të Qarkores Buxhetore dhe në bazë të shpenzimeve strikte të cilat janë përgjatë vitit dhe tani në momentin kur është prekur ajo vlerë buxhetore absolutisht mbetemi mangu me buxhet, do të thotë edhe kjo çështje kështu është.

Besoj që në formë të përmbledhur e bëra maksimumin t'ju përgjigjem.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, po i nderuar drejtor, aq sa pate mundësi u tregove transparent por një pyetje mbete borxh, te ngritja e infrastrukturës së turizmit një pagesë rreth 50,000.00€, a ka përfunduar. Po ashtu pikës kryesore nuk i'u përgjigje pse e ke shkel secilin afat ligjor për me sjellë raportin në Kuvend, për çfarë arsye është vonuar ky raport.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, te çështja e ngritjes së infrastrukturës së turizmit, po janë rreth 48,000.00€ të paguara, do të thotë në vitin 2023 është nënshkruar një kontratë për 250,000.00€ për investim në infrastrukturën e turizmit që ka pasë të bëjë me investime në pjesën e fshatit Lluzhan konkretisht në Shakovicë dhe te pishat e Kërprimihut 200,000.00€ që janë shpenzuar në vitin 2023, kurse 48,500.00€ është pagesë e cila është ekzekutuar në fillimin e vitit 2024, pra si kontratë e vitit 2023, kjo ishte për çështjen e pagesës së turizmit.

Për çështjen e raportit financiar është e vërtetë që në asamble komunale duhet të dorëzohet deri më 31 mars, ne kemi qenë të gatshëm dhe e them që këtë raport financiar e kemi të gatshëm sepse më 31 janar domosdoshmërisht duhet ta dërgojmë në Ministrinë e Financave dhe me pa tjetër edhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit, madje kjo Zyrë e ka kryer procesin e auditimit më shumë se një muaj ditë në Komunën e Podujevës, dhe këtë çështje nëse nuk gaboj për disa ditë e kemi dorëzuar, pra si çështje e organizimit të seancës për bartjet buxhetore, por pa u sjellë nga Ministria e Financave dhe pa e bërë ata raportin financiar sepse ata e kryejnë më 31 mars e që duhet barazuar me centë, shembull siç ishte diferenca që patëm 890,001.09€, pra kjo duhet të përputhet me centë, me raportin e Ministrisë së Financave. Prandaj ata nuk kanë arrit ta bëjnë dhe deri më 3 prill nuk e kanë publikuar, pastaj më 3 prill, momentin kur e kanë publikuar ne e kemi përgatitur këtë pikë dhe derisa kanë ardhë materialet për këtë seancë që është sot më 18 prill.

Pra nuk bëhet fjalë për fshehje sepse nuk ka çka të fshehët ngase auditohet nga 4 auditor të Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët për një muaj qëndrojnë në Komunën e Podujevës ku kryesisht auditojnë financat. Besoj mjaftueshëm u kuptua kjo vonesë e vogël dhe arsyeja e kësaj vonese.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam menduar se e kam goxha mik drejtorin e DBF-së por në lidhje me raportin mua nuk mu përgjigj fare ose harroi ose ndoshta që ka zgjatë seanca dhe nuk e mora përgjigje, mirëpo po ndërldhem me dy - tri çështje dhe nuk po e zgjati shumë, shembull amfiteatri te pishat të cilin po e marrë si të mirëqen që është rregulluar, por ato kioskat që kanë qenë këtu nuk i ka prek askush, kurse që janë marrë paratë dhe është bërë pagesë 5,000.00€ aty në rregull është, pra këtu thotë riparimi i kioskave dhe amfiteatrit, por e përsërisë që ato kioska nuk i ka prek askush sepse ka kohë që i kam parë.

Te çështja që u përmend raporti i auditorit, shpresoj që jo, por unë në bazë të këtyre pagesave aaë kam parë raporti i auditorit do të del i kualifikuar ose për ta shpjeguar pak më shqip që ta kuptojnë të gjithë i bie raport i zi e i keq, unë kështu mendoj duke marrë për bazë të pagesat.

Unë kuptohem shumë mirë me drejtorin z.Fatlum Osmani dhe sa herë i kërkoj diçka nuk e lë pa më dhënë përgjigje, edhe pse ndonjë gjë ka mundur të harroj ndoshta, pra kur e tha që unë i dërgoj e-maile e materiale, vërtetë është i gatshëm gjithherë qoftë në mënyrë elektronike qoftë në fizike, jam i vetëdijshëm për atë pjesë, mirëpo edhe për pageat që i ceke ti drejtor e din por edhe në raportin e auditorit thuhet që në vitin e kaluar disa kompanive iu kanë vonuar më shumë se tre muaj pagesat, pra nuk është krejt ashtu siç e thua ti, madje bash që je ti unë pres të jesh pak më korrekt dhe të mos vonosh raportin financiar, të mos vonosh pagesat nëpër kode, por të jesh pak më mirë në këto dhe çështje tjera.

Unë pash disa pagesa që janë bërë, shembull për shumë projekte të cilat veç sa kanë filluar për çka nuk e di çfarë raporti të punës sjellin ata, siç janë tek rruga "Vëllezërit Frashëri", pastaj te rr. "Xhemajl Mustafa", për shkollën në fshatin Shajkoc e cila nuk ka përfunduar, për shkollën "Isa Boletini" dhe plotë projekte tjera.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, vërtetë paskan harruar t'i përgjigjem z.Ekrem Rrahmanit, qoftë lidhur me raportin e auditorit qoftë për pagesat që i kemi bërë.

Në bazë të pagesave të cilat i ka ekzekutuar thesari sipas Kontratës Kolektive raporti ka dalë i kualifikuar për këto vite dhe kjo është e vërtetë, mirëpo asnjë komunë e as Komuna e Podujevës e jo veç ne si DBF, por asnjë komunë nuk mund të fajësohet për këto sepse nuk janë në Kontratë të cilën e kanë nënshkruar e as nuk kanë mundësi ligjore e as financiare t'i përmbahen asaj Kontrate.

Te çështjet tjera që mbetëm pa u përgjigj siç janë pagesat të cilat janë kryer për kanalizim dhe ujësjellës, ka qenë një Marrëveshje Bashkëfinancimi midis Komunës së Podujevës, Ujësjellësit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe vlera e atij projekti është diku rreth 276,000.00€, shembull e kemi z.Naim Çunakun i cili është bërë me ujësjellës, pastaj fshati Bellopoj dhe të tjerë në emër të asaj Marrëveshje e cila është sjellë në muajin mars ose prill, dhe neve nuk na ka lejuar Ministria e Financave të fusim mjete buxhetore për çështjen e ujësjellësit, pra ka qenë një projekt i dobishëm për qytetarët dhe ne si Komunë nuk kemi mund të lejojmë që të na kaloj ajo Marrëveshje Bashkëfinancimi në të cilën ne kemi dhënë mjete financiare afër 20% të vlerës së projektit dhe thjeshtë nuk kemi dashtë të humbim diku rreth 220,000.00€ financim që është bërë, natyrisht për qytetarët e Komunës së Podujevës edhe pse është për ujësjellës.

Renovimi i objekteve shëndetësore, kanë qenë 90,000.00€ dhe janë rinovuar objektet shëndetësore siç është edhe QKMF - pjesa e brendshme dhe është në renovim si dhe kanë qenë disa obligime të vogla rreth 7000€ - 8000€ që kanë mbetur nga viti 2023.

Për Terrene sportive është një kontratë në vlerë 450,000.00€ dhe është e vërtetë që ka ngecje në realizmin e këtyre projekteve mirëpo kjo pagesë është kryer gjatë vitit 2024, pra e kemi pasë

raportin e punëve të kryera, dhe nuk do të thotë që është raport përfundimtar i punëve të kryera por në bazë të situacioneve ju e dini qysh shkon pagesa me situacione besoj.

Sa i përket mirëmbajtjes së kamerave që u përmend edhe kodi ekonomik, bëhet fjalë për kontratën që është mirëmbajtje dhe furnizim me kamera, do të thotë në kuadër të kësaj kontrate edhe ka furnizim të kamerave edhe ka mirëmbajtje të sistemit të kamerave ekzistuese.

Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore, vitin e kaluar ka qenë e kontraktuar një kompani private për mirëmbajtjen e ngrohjeve qendrore që janë mirëmbajtur në objektet shëndetësore, arsimore dhe objekte komunale, kurse tani është një çështje po e quaj shumë pozitive që në vitin 2025 për mirëmbajtjen e ngrohjeve qendrore dhe mirëmbajtjen e elektrikes, ne e dimë që si Kuvend komunal keni marrë vendim për themelimin e një Ndërmarrje Publike që është NPL “Eko Llapi” dhe tani për kontrata kemi marrëveshje, do të thotë quhet kontratë në shtëpi që quhen furnitorë “Eko Llapi” e cila kryen edhe mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore edhe mirëmbajtjen e elektrikes.

Sa i përket çështjes e kafes që u përmend si kod ekonomik, unë e sqarova në fillim që plani kontabël nuk e bënë Komuna por e bënë Ministria e Financave, madje unë këtu pajtohem me atë që e kanë heq kodin ekonomik për pije dhe dreka zyrtare, tash numri i kodit ekonomik është ai i njëjti që ka qenë 13131 mirëpo tani quhet akomodim brenda vendit e që në njëfarë mënyre është i pa kuptimtë sepse nuk bëhet fjalë për akomodim, por ne atë nuk mundem ta ndërrojmë teknikisht.

Te furnizimi me naftë u përmenden 53,000.00€, ka të bëjë me naftën për ngrohje qendrore ku komuna ngrohet me naftë, por janë edhe dy-tri objekte shëndetësore të cilat ngrohen me naftë dhe normalisht shpenzimet e naftës që janë edhe të sektorit të shëndetësisë dhe të shërbimeve publike, zjarrfikësit dhe të administratës që janë këto në shuma 52,000.00€ që është një shumë normale për funksionimin e krejt këtij sistemi dhe logjistikën e institucioneve publike.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, vetëm në kuptimin e sqarimit por nuk kam qëllim polemike, të paktën nuk dua të kuptohem ashtu por si do që të jetë kur thash një raport jo sqarues para asamblesë dhe tregova që përbërja e asamblesë nuk do të thotë që janë ekspert të fushave të ekonomisë, përgjigjja juaj ishte që një kësi raporti mund të bëhet edhe me ato germa që i përmende por t’ia sqarosh Kuvendit një diçka që është obligim ligjor, në atë kontest e pata fjalën sepse ka qenë dashtë të jetë një raport më i shkoqitur dhe asgjë nuk ka pasë të keqe që këtij raporti ashtu qysh e shprehe që je i hapur dhe me kolegun zotëri Rrahmani që ka kërkuar dhe ka marrë materialet e kërkuara, ndoshta është e pa nevojshme të vijmë gjithë ne anëtarët e Kuvendit për t’i marrë ato materiale ose petty-cash-in qysh është bërë, dhe shtrohet pyetja nëse ka qenë e nevojshme për asambleistët ajo punë përse nuk është dërguar si material shtesë ose në CD që asambleistët ta kenë një pasqyrë më reale sa i përket harxhimit të buxhetit, pa të bërë telashe ty me ardhë dhe me të kërkuar ose jo materiale. Fundja nëse duhet me qenë për të plotësuar dhe sqaruar raportin financiar përse në një formë CD-je nuk janë furnizuar gjithë anëtarët e Kuvendit sepse fundja këtu ashtu punohet raporti.

Kur e përmenda që raporti nuk është aq sqarues nuk e thash përmendsh, të jesh i bindur që nuk e kam konsultuar ligjin, por nëse don që t’i citoj nenet dhe ta përshkruaj se çka duhet të përmbaj një raport atij që i referohesh, prandaj këto ishin në kuptimin sqarues, përndryshe për ty drejtor mund të jetë krejt në rregull edhe LH, HM dhe inicialet/termet tjera siç ishin, pra për ty janë normale sikur ta pyesësh një profesor të gjuhës angleze për fjalë anglisht, por ta pyesësh dikë tjetër që nuk ka njohuri të gjuhës angleze për ato fjalë anglisht edhe ky gjuhen e ka njëjtë, ky fakultet të gjuhës ai fakultet të gjuhës veç se ai e ka angleze, dhe kështu nuk mund të merren vesh, prandaj në këtë kontekst e pata që ka qenë dashtë ky raport të jetë më sqarues e në veçanti te projektet kapitale sepse fundja ato janë që e ndryshojnë cilësinë e jetës ngase pagat e mëditjet deshëm ose jo shkojnë rrugës së vet, grandit specifik i arsimit ashtu, grandit specifik i shëndetësisë ashtu.

Sa i përket ujësjellësit, më bëri të marrë fjalën që u cek emri im, është e vërtetë që ujësjellësi ka qenë në fshatin Lluga, për sqarim të kolegëve, fshati Lluga është i furnizuar me ujë të pijshëm prej rrjetit të ujësjellësit regional KRU “Prishtina” që prej vitit 2002 ku nga ai vit gjithë banorët e fshatit Lluga janë furnizuar me ujë të pijshëm dhe atë rrjet të ujësjellësit e kanë ndërtuar me vetë kontribut pa asnjë cent nga Komuna e Podujevës, mirëpo sigurisht e keni pasë fjalën për dy lagje që është ndërruar gypi dhe unë kam menduar që ai është obligim dhe është dashtë të jetë ai obligim i KRU “Prishtina” që ta ndërroj gypin e ujësjellësit e jo komuna, prandaj kam menduar që është një donacion i KRU “Prishtina” për ta zëvendësuar atë gyp në dy lagjet, lagja “Curri” dhe lagja “Bulliçi”. Vërtetë është i mirëseardhur ai projekt sepse ka pasë defekte në atë gyp dhe si i tillë sigurisht ka lehtësuar furnizimin me ujë, por dua të them një tjetër gjë unë si Naim, po aty është bërë, dhe KRU “Prishtina” e ka obligim kanalizimin dhe ujësjellësin që t’i mirëmbajë, pra KRU “Prishtina” e ka obligim ta mirëmbajë edhe kanalizimin edhe ujësjellësin, kështu e ka në specifikë të punëve të veta dhe tani prej cilit kod e ka marrë kjo është çështje e tyre, por unë kam menduar që ata janë donatorët kurse ne kemi mundur që vetëm ndonjë participim ta bëjmë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës diskutimi mbaroj, po shohë që shumica e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent janë të disponimit të shkohet në një pauzë të shkurtër, kështu që nëse jeni të pajtimit mund të jap pauzë prej 15 minutave.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

Mbështetet propozimi për pauzë rreth 15 minuta, dhe atë duke filluar nga ora 16;30

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 16;50, nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit z.Hilmi Hoxha

Prezent ishin anëtarët e Kuvendit, dhe atë:

Nga LVV, Florent Hasani; Sebastina Vokri; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Donjetë Baliu.

Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.

Nga Ekzekutivi i Komunës ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh.

7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2025 është 33,459,115.00€, prej tyre mbi 17 milion euro për paga dhe mëditje, mbi 4 milion euro mallëra dhe shërbime, mbi 633,000.00€ shpenzime komunale, pastaj mbi 1 milion e 800,000.00€ për subvencione dhe transfere, mbi 9 milion euro për shpenzime kapitale. Prej shumë totale të buxhetit ashtu siç është prezantuar edhe në këtë raport janë shpenzuar në këtë tremujor mbi 4,663,000.00€ në paga dhe mëditje, rreth 943,000.00€ për mallra dhe shërbime, rreth 177,000.00€ për shpenzime komunale, mandej rreth 282,000.00€ në subvencione dhe transfere si dhe për investime kapitale janë shpenzuar rreth 2 milion e 42,000.00€, e që totali i shpenzimeve është 8,109,000.00€.

Gjithashtu në këtë raport tremujor të vitit 2025 janë paraqitur edhe të hyrat vetanake në këtë tremujor ku gjatë kësaj periudhe kohore janar-mars 2025 janë mbledhur 314,314.00€ të hyra vetanake të realizuara.

Po ashtu në këtë raport është prezantuar edhe lista e shpenzimeve në bazë të kodeve ekonomike të cilat janë shpenzuar dhe atë duke filluar prej pagave dhe mëditjeve si dhe gjitha kategorive tjera si dhe çështje të tjera me rëndësi sa i përket raportit financiar për këtë tremujor, si dhe po ashtu krahasimin e shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kështu që materiali ju është dërguar me kohë dhe sigurisht e keni analizuar dhe nuk po i përsëris, por çka do që keni jemi të gatshëm t'i sqarojmë dhe të japim përgjigje.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të LVV e vlerësojmë pozitiv këtë raport duke parë edhe investimet kapitale në të gjitha sferat e ndryshme siç janë arsimiti, shëndetësia dhe të tjerat.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i kam disa pyetje lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-mars ngase në raportin në fjalë që na vije si material nuk janë të pasqyruar disa gjëra me të cilat kam probleme. Në Raportin e free-balance shkruan kafe pije kurse në raportin e dërguar figuron zero euro, po ashtu pash edhe disa kode në këtë raport që na është dërguar, shembull, mirëmbajtja e rrugëve lokale në shumë 276,694.00€ për këtë tremujor e që unë nuk e di që ka pasë dimër të fortë për të mirëmbajtur kaq shumë, megjithëse edhe kompania që e ka fituar tenderin është duke dalë me një fshesë në qytet e që vetëm po bënë pluhur asgjë tjetër.

Kodi tjetër ka të bëjë me naftë edhe këtu shuma është madhe afër 45,000.00€ për këta tre muaj, pastaj kemi rrjetet e kanalizimit e që unë besoj që ky kod ka të bëjë me kolektorin në fshatin Lupç, mirëpo shuma prej 385,333.00€ për vetëm këta tre muaj është shumë e madhe.

Pajisje mjekësore, në këtë temë nuk dua të hyjë shumë por megjithatë kemi rastin ku janë shpenzuar, shembull, 80,336.00€ andaj a ka mundësi të na tregoni se çfarë pajisje mjekësore është kjo sepse unë shoh që Zyra e prokurimit ka shumë tenderë që lidhen me shëndetësinë mirëpo ka shuma tepër të mëdha e që ose ne po dëshirojmë t'i ikim paksa temës sepse është kategori e ndjeshme, por pajisje mjekësore në vlerë mbi 80,000.00€ për mua është shumë interesante.

Rasti tjetër kemi të bëjmë me shenjëzime horizontale dhe vertikale, edhe për këta tre muaj kemi një pagesë më 05.02.2025 në shumë 123,432.00€.

Pastaj kemi pagesën tjetër që për është dreka zyrtare për këtë periudhë janar- mars në shumë 19,775.00€ e që bëhet fjalë për një darkë për të cilin mendimi im është se është shpenzim i madh, bëhet fjalë për ndejnë e fund vitit në shumë 8,425.00€ ku ne si anëtar të Kuvendit nuk kemi qenë të ftuar fare dhe nëse e bëjmë një llogari se sa punëtor i ka Komuna atëherë kemi të bëjmë me një shifër interesante dhe për këtë arsyeje e thash që për mua është shumë e madhe kjo pagesë andaj edhe do të doja një sqarim nga drejtori lidhur me këtë pagesë.

Te mirëmbajtja e mobileve, që është si kategori këtu ku një shumë është mbi 7,000.00€ e që edhe ky shpenzim është shumë e madhe për këta tre muaj.

Po ashtu e kam edhe një pyetje që paksa ndoshta është jashtë teme për drejtorin e DBF-së, por ka të bëjë me shtesat për neve anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa që jemi e që nuk jemi duke i marrë shtesat dhe nuk jemi në dijeni a është problem prej që jam unë bërë anëtar i këtij Komiteti e mos rastësisht po bëhem problem edhe për anëtarët tjerë apo çka është problemi, e them këtë sepse unë e shikova që ka pagesë në 2023 në muajin mars që nuk është bërë, pastaj në vitin 2024 në muajin dhjetor as këtu nuk është bërë pagesa, si dhe dy tre muaj në 2025, prandaj dua të di a është problemi tek ju apo ku qëndron nëse ka mundësi me na sqaruar këtë çështje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, edhe unë i kam disa pyetje për drejtorin e DBF-së, meqë jemi te krahasimet për vitin 2024 dhe 2025, është një kod buxhetor, info publike, dhe nga ky kod në vitin 2024 janë paguar 2,051.00€, pra dua të si dhe për çfarë info publike është bërë kjo pagesë dhe çfarë janë këto.

Pyetja tjetër ka të bëjë me shtesat tranzitore, në vitin 2024 nga ky kod janë paguar 2,300.00€, ndërsa tani shuma është 628.00€, pra dua të di se për çfarë shtesash bëhet fjalë dhe çka paguhet me këto shtesa. Te kodi 13132 akomodim për udhëtime zyrtare brenda vendit, në vitin 2024 kanë qenë 10,440.00€ ndërsa tani janë 16,000.00€ e që është një diferencë shumë e madhe kur kemi të bëjmë vetëm për 3 muaj, meqë drejtori përkatës më herët e theksoi që është për dreka zyrtare dhe jo akomodim, i bie që për pije dhe dreka zyrtare në këtë tre mujor i keni shpenzuar dhe paguar 16,000.00€. Mandej te shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale për këtë tre mujor është bërë pagesë 1,250.00€ andaj a ka mundësi ta dim për çfarë këshille keni paguar këtë shumë.

Gjithashtu për pajisje tjera, në vitin 2024 është bërë pagesë 1,357.00€ ndërsa për këtë tremujor të vitit 2025 është bërë pagesë 26,614.00€, andaj edhe për këtë a ka mundësi të dimë për cilat pajisje tjera dhe pse është paguar kjo shumë kaq e madhe.

znj.Sebastina Vokri, theksoi, kam pyetje lidhur me rrjetet e kanalizimet ku shuma është 385,333.00€, pra kjo shumë a ka të bëjë me shtrirje të rrjetit të kanalizimit apo për mirëmbajtje.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, meqenëse për shumicën e kodeve veç janë bërë pyetjet, unë kam pyetje lidhur me shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale, pastaj kemi edhe shërbimet e veçanta konsulente dhe kontraktor individual, pra dua që ta di dallimin në mes tyre ngase meqë në tremujorin e njëjtë të vitit 2024 me mujorin e vitit 2025 ka shumë dallim sa i përket këtij kodi.

Po ashtu kam edhe një pyetje sa i përket qirasë për tokë-kodi 14120, e që kemi një dallim shumë të madh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, faleminderit edhe njëherë për çështjet të cilat i shtruat dhe po bëjë përpjekje t'i sqaroj të gjitha këto çështje të cilat i parashtruat.

z.Ekrem Rrahmani, e theksoi çështjen e kafes, pra pijeve dhe çështja është se kodi ekonomik është akomodimi brenda vendit, pra ashtu është siç e sqaruam edhe më herët se bëhet fjalë për drekë kafe dhe pije për takime zyrtare dhe çështje të tjera, ndërkohë ky si kod ekonomik është kështu sepse nuk ka kod ekonomik tjetër dhe unë pajtohem sikurse ju ngase është ky plan kontabël i Ministrisë së Financave dhe ne nuk mund ta ndryshojmë, pra e kanë heqë këtë çështje dhe normalisht e kemi detyrim që t'i përmbahem kësaj.

Dua që ta bëjë një sqarim të përgjithshëm para se t'i jap sqarimet specifike për çështjet të cilat u shtruan, te disa dallime të cilat janë me vitin 2024 dhe po është e vërtetë që krahasimi është tre mujori i parë i vitit 2024 me tre mujorin e parë të vitit 2025 dhe pjesën tjetër e keni edhe krahasimin, ku do që i shihni disa dallime të mëdha siç është puna të nafta, të mirëmbajtja e rrugëve lokale, të furnizimi me ushqim ku është një dallim i theksuar, pra këtu bëhet fjalë për një çështje ku gjatë fundit të vitit 2024 kemi mbetur siç edhe e tregon raporti financiar në obligime të cilat janë krijuar edhe për shkak të mungesës së buxhetit por edhe për shkak të Kontratës Kolektive që na ka marr rreth 4,000,000.00€ dhe na ka lënë pa buxhet në shumë projekte e që pagesat për këto çështje janë kryer në fillim të vitit 2025, pra e njëjta është të shpenzimet e naftës siç keni mundur t'i shihni se janë 35,000.00€ si shpenzim i naftës ku pjesa dërmuese e tyre janë obligimet të cilat janë krijuar gjatë fundit të vitit 2024 dhe me hapjen e buxhetit që ka ndodhur në muajin shkurt është bërë pagesa e naftës e cila është shpenzuar në vitin 2023. E njëjta gjë është edhe të çështjet e ushqimit e cila ka ndodhur, përveç kësaj edhe të çështjet e akomodimit të kodi ekonomik për udhëtime zyrtare është e njëjta çështje ku kemi mbetur në disa obligime në fund të vitit 2024.

Çështje tjetër cila u shtrua është shtrirja e rrjetit të kanalizimit pagesa prej 385,333.00€, ku këtë pyetje e ngritën dy anëtarë të Kuvendit znj. Sebastina Vokri dhe z. Ekrem Rrahmani, pra këtu bëhet fjalë për një kontratë që e ka të lidhur Komuna e Podujevës mbi 3,000,000.00€ për rrjetin e kanalizimit, pra konkretisht bëhet fjalë për kolektorin e ujërave të zeza që shtrihet nga fshati Lluzhan, Lupç deri te pjesa e Gerdocit, dhe kjo pagesë ka ardhur gjatë muajit mars ku edhe është bërë ekzekutimi i kësaj pagese për disa punë të kryera gjatë viteve 2024-2025 ku është sjell fatura dhe është bërë pagesa në bazë të kësaj kontrate.

Te pajisjet mjekësore të cilën e ceku po ashtu z. Ekrem Rrahmani në vlerë 80,000.00€ specifikisht ka qenë një kontratë e cila është nënshkruar dhe është iniciuar si procedurë e prokurimit për arsyeje se ka qenë situata urgjente për çështjen e rentgenit në QKMF dhe është blerë ky rentgen dhe ka ardhur gjatë muajit janar ku është bërë ekzekutimi i pagesës për këtë çështje.

Gjithashtu u përmend në mënyrë specifike shenjëzimet horizontale dhe vertikale, kjo pagesë është bërë në muajin shkurt, mirëpo bëhet fjalë për një faturë e cila na ka mbetur në detyrim sepse nuk kemi pasur mundësi financiare ta përfundojmë në vitin 2024 dhe e kemi ekzekutuar në fillimin e vitit 2025. Çështja e mirëmbajtës së mobileve dhe pajisjeve, edhe këtu është një kod ekonomik, te mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore është një kod ekonomik dhe janë pajisje dhe mirëmbajtja e tyre, edhe mirëmbajtja që u diskutua më herët te kamerat dhe çështjet e tjera në këtë kod ekonomik dhe paguhet mbi bazën e këtij kodi ekonomik, normalisht janë buxhete të ndara mirëpo si kod është ky kod ekonomik.

Jashtë raportit financiar, por një çështje që i takon financave u përmenda çështja e pagesave të KPF-së, zotëri Rrahmani e din që nuk ka të bëjë vetëm me të sepse paguhet të gjithë, mirëpo jeni të informuar që Komuna i dërgon në Ministrinë e Financave listën e pagave dhe formularët për ndryshim, edhe Kryesuesi është i informuar, pra ne si Komuna e kemi dërguar, por ata nuk i kanë ekzekutuar, ne i kemi dërguar sërish dhe për çdo rast mundeni me ardhë dhe t'i shihni formularët ose edhe mund t'ju sjell këtu në mënyrë që t'i shihni se janë dërguar për ekzekutim, shpresojmë që do të rregullohet kjo çështje përndryshe do të na duhet të bëjmë ndryshime buxhetore ose ndonjë gjë tjetër që ato pagesa që ekzekutohen.

znj. Donjetë Sheqiri shtroj disa çështje lidhur me shtesat tranzitore, me ligjin e pagave kur është miratuar pjesës dërmuese të zyrtarëve ju është rritur paga, mirëpo ka disa zyrtar që me Ligjin e ri të pagave koeficientin e kanë me të vogël sesa me ligjin që ka qenë, mirëpo Ligji i ri i pagave e thekson që asnjë zyrtari nuk guxon t'i zvogëlohet paga, tani gjatë kësaj periudhe deri sa të përputhet paga me të cilën e ka me ligj të pagave, me pagën aktuale duhet të paguajmë këtë shtesë tranzitore, pra deri sa të barazohen këto të dyja. Tani në këtë vit këto pagesa janë marr më të vogla për arsyeje se është rritur paga e rregullt, pra që është rrit koeficienti për 55 euro dhe mund ndodh deri në muajin korrik do të bëhet barazimi i këtij koeficienti dhe normalisht që nuk paguhet pastaj shtesa tranzitore. Ndërsa sa i përket shërbimeve këshillëdhënëse dhe profesionale, në Komunën e Podujevës momentalisht është vetëm një zyrtar që është i kontraktuar përmes shërbimit këshillëdhënëses dhe profesional, pra në bazë të Ligjit të prokurimit është i angazhuar dhe normalisht për shërbimet e kryera bëhet pagesa për çdo muaj në bazë të raportit të cilin e bënë ai zyrtar i cili është Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje së Mjedisit për çka edhe paguhet shërbimet për atë zyrtar.

Çështja tjetër që u shtrua është për pajisjet tjera, më herët u diskutua që pajisjet mjekësore e kanë kodin e veçantë ekonomik, mirëpo ka shumë pajisje të cilët blihen të cilët nuk e kanë një kod të veçantë ekonomik, shembull blihen pajisje për kabinete shkollore të fushave të ndryshme, dhe me patjetër duhet që të bëjmë përshkrimin e kodit ekonomik e që është pajisje të tjera që janë pajisje të llojeve të ndryshme qoftë në institucione shëndetësore, ato arsimore apo edhe në administratë.

znj. Arnisa Sylejmani e përmendi çështjen e shërbimeve kontraktuese dhe individuale, edhe kjo është e ngjashme ku është paguar për të njëjtën gjë, vetëm që është paguar dy herë me kod të ndryshëm ekonomik. Po ashtu edhe te qiraja për tokë e kemi diskutuar që shuma 4,000€ dhe tani e keni parasysh Parkun e Pagues ku pjesa në fillim është pronë e Infrakosit dhe për atë pronë është dashtë që të lidhet një Marrëveshje me Infrakos-in dhe duhet t'i paguajmë qira, pra i kemi mbetur detyrim edhe në vitin e kaluar dhe tani në muajin prill duhet t'i paguajmë disa detyrime në mungesë të financave.

Shërbimet për informatë publike, kjo çështje ka mundur të jetë çështja për ndonjë publikim i cili është kryer, shembull TV Llapi që e kemi këtu, pra shërbimet e informimit i paguajmë përmes kësaj mirëpo pagesa për publikimet dhe të tjera që bëhen që kanë ndodhë është bërë nga kodet e ndryshme ekonomike, kurse në këtë vit nuk kemi pagesë për shërbimet të cilat i marrim.

z. Ekrem Rrahmani, theksoi, te energjia elektrike nga viti i kaluar deri tani, nga 91,000.00€ në 161,000.00€ është dallim i madh me rreth 77,000.00€, andaj dua të di se a është paguar realisht rrymë apo është paguar diçka tjetër me këtë kod të energjisë elektrike.

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF, vazhdoi, bëhet fjalë për pagesën e shpenzimeve të rrymës, mirëpo është për të njëjtën arsye, faturat e muajit dhjetor dhe një pjesë të nëntorit të vitit 2024 kur janë shpenzimet në pikun e tyre, nuk kemi arritur t'i paguajmë si rezultat i mungesës së mjeteve financiar dhe tani së bashku me faturat e muajve janar, shkurt dhe mars 2025 janë paguar të gjitha dhe kjo është arsyeja se pse është kjo diferencë.

znj. Donjetë Sheqiri, theksoi, kjo që po e potencon drejtori i DBF, a nënkupton kjo që do të kemi mungesë të mjeteve në fund të këtij viti e që nuk i ke të planifikuara.

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, nuk e besoj që do të ketë mungesë të mjeteve në këtë vit ashtu siç e ceku parafolësja.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron të marrë fjalën, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës sepse ky është Raport dhe nuk votohet, andaj kalojmë në pikat e radhës sipas rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

8. Propozim vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një pronë komunale e cila është në procedurë për këmbimin me një pronë private të një banori të fshatit Llugë me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e trotuarit në atë fshat, kështu që prezent kemi drejtorin e Drejtorisë përkatëse i cili mund të na informoj më gjerësisht.

z. Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sa i përket kësaj pike mendoj që ju veç keni njohuri për këtë çështje sepse parimisht është votuar në këtë Kuvend që ka qenë fillimi apo inicimi i procedurave për këmbimin e kësaj prone në fshatin Llugë që është në pronësi të Ismet Bulliqit dhe aty afër është një pronë publike ku ne si DSHPMSH kemi bërë kërkesë te Drejtoria e kadastrit apo edhe te Kryetari i Komunës që të bëhet këmbimi i pronës publike me atë private me qëllim të ndërtimit të trotuarit, në pamundësi për ta ndërtuar atë trotuar meqë rruga ku ne kemi dashtë ta ndëtojmë trotuarin ka qenë e ngushtë dhe nuk ka pasë hapësirë të mjaftueshme për ta ekzekutuar ndërtimin e këtij trotuari kurse kërkesa ka qenë shumë e madhe por

ne kemi vlerësuar që është shumë e arsyeshme dhe shumë e nevojshme që të bëhet ky trotuar me qëllim të ofrimit të një sigurie sa më të madhe të kalimtarëve të disa lagjeve të asaj pjese por kryesisht nxënësve të fshatit Llugë.

Janë kryer të gjitha procedurat sa i përket këmbimit të kësaj prone, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e ka dërguar materialin në fjalë në Ministrinë e Financave me që rast është bërë edhe vlerësimi i pronave të cilat kanë për këmbim, vlerësim i cili është kthyer nga Ministria e cekur dhe tani vetëm pritet marrja e vendimit nga ky Kuvend.

Duhet cekur se ndërtimet e trotuareve paraqesin goxha shumë vështirësi edhe pse janë shumë të nevojshme dhe që ka shumë kërkesa të mëdha, por pikërisht mungesës së hapësirave të mjaftueshme në shtratin e rrugëve, është hera e parë që ne e bëjmë një kërkesë të tillë mirëpo këtu në këtë rast nuk ka pasë kurrfarë mundësie tjetër sepse kemi raste të ndryshme ku në disa rrugë kërkohet pak zgjerim por që aty me bashkëpunim dhe me pak mirëkuptim të banorëve apo qytetarëve arrijmë që ta përmbyllim projektin sepse ka të atillë të cilët e lirojnë një hapësirë të caktuar për ndërtimin e trotuareve e që sigurisht që ajo bëhet për të mirën e tyre, për sigurinë dhe interesin e qytetarëve, prandaj edhe në këtë rastin në fjalë ku ne kemi kërkuar këmbim nuk ka pasë aspak hapësirë mirëpo duhet theksuar se në disa pjesë të tjera përgjatë atij trotuari është bërë lirimi i hapësirës nga dy familje të asaj pjese të cilat tani po i përmendi edhe me emra edhe pse njëri prej tyre është këtu kolegë i juaji asambleist që e kanë liruar hapësirën, fjala është për z.Naim Çunakun të cilin po e përmendi me emër dhe po e falënderoj publikisht i cili edhe e ka rrënuar rrethojën e oborrit me qëllim që të zgjerohet ai trotuar në mënyrë që të mos mbetet keq dhe që të ofrohet një siguri sa më e madhe për nxënësit e atyre lagjeve, por është e familja e Shaban Bulliqit të cilën po ashtu e falënderojmë për ofrimin e mundësisë që të ekzekutohet ai trotuar, dhe tani ka mbet vetëm pjesa ku ne nuk kemi pas kurrfarë mundësie e që ka gjete si trotuare i shkëputur, mirëpo fatmirësisht të gjitha procedurat kanë përfunduar ashtu qysh kemi dashtë ne dhe qysh kemi kërkuar dhe që tani jemi në fazën edhe të një vendimi këtu në Kuvend Komunal për çka ju ftoj të gjithave ta votojmë në mënyrë që ta shtyjmë tutje si procedurë.

z.Haki Rudari, theksoi, e dëgjuam arsyetimin e drejtorit parafolës të DSHPMSH rreth kësaj pike të rendit të ditës dhe si Grup i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe konsiderojmë se është në interes të qytetarëve në radhë të parë, prindërve e mbi të gjitha në interes të nxënësve ngase trotuari sot është bërë një nga problemet kryesore atje ku ka mungesë kështu që ne në emër të Grupit të LVV-ës e përkrahim.

Thënë të drejtën nga ai fshat vie Kryetari i Komunës, pastaj kolegu asambleist z.Naim Çunaku, aty i kam miqtë dhe nuk kam si të veproj ndryshe.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë kur kemi të bëjmë me këtë pikë të rendit të ditës, gjegjësisht me vendimmarrjen për ndërrimin e pronës komunale me pronë private në fshatin prej nga vije unë, po e shoh të arsyeshme për ju kolegë të nderuar se gjatë gjithë kësaj kohe, për ata që nuk e njohin territorin e fshatit Lluga e që është normale dhe që nuk janë banorë të këtij fshati apo e as që i kanë miqtë në këtë fshat, kështu që vërtetë fshati Lluga ka mbi 200 shtëpi, mbi 2000 banorë, ka një shkollë me 350 nxënës, dhe vërtetë kanë qenë në një situatë jo të mirë sa i përket mundësisë së lëvizjes së lirë të nxënësve dhe qytetarëve andej, dhe në vazhden e përpjekjeve për të bërë një zgjidhje ç'është e vërteta kemi biseduar edhe me Kryetarin e Komunës, edhe me drejtorin e DSHPMSH por edhe me atë zotëriun që tani është palë në këmbimin e pronës dhe kemi arritur një marrëveshje që të bëhet nderimi i një prone e që për shpjegimin e juaj ajo pronë e atij personi me pronën komunale vetëm një mexhë i ndan, do të thotë nuk ka as ndryshim të kualitetit, as në kuptimin e efektit të vlerës nominale të saj, janë dy prona e që edhe ministria e ka vlerësuar ashtu, janë të njëjta për nga vlera, ndërsa nuk ka qenë e njëjtë për nga vlera për banorët e fshatit Llugë

sepse nderimi i kesaj prone i'a ka mundesuar fshatit Llugë ta ndërtoj një trotuar dhe të kontribuojë në sigurinë dhe lëvizjen e nxënësve dhe qytetarëve të saj e që mendoj se është një prej projekteve vërtetë të mira që po realizohet në të mirën e qytetarëve të fshatit Lluga.

Jeni në dijeni se Komuna e Podujevës një pjesë të mirë të buxhetit me vite të tëra e ka investuar në trotuare dhe vërtetë fshati Llugë duke pasë parasysh nëse hyjmë në përbërjen apo banueshmërinë në Komunën e Podujevës po ju jap edhe një informatë që fshati Lluga hyn në 10 fshatrat që ka dendësinë më të madhe dhe të qytetarëve dhe nuk ka pasë asnjë metër trotuar brenda, jo pse ka munguar vullneti por pse nuk kemi pasë interes derisa e kemi gjete këtë solucion për këmbimin e pronës publike me atë private, dhe mua nuk më mbetet tjetër vetëm se të shprehë kënaqësinë për realizimin e këtij projekti dhe mbështetjen time të pa rezervë me urimin që të vazhdoj ndërtimi i trotuarit edhe në pjesët tjera.

Sa i përket këtyre dy familjeve që u përmenden nga drejtori parafolës, pa të keqe dhe krejt me qëllim që gjatë rrugëtimit gjegjësisht gjatë vazhdimit të trotuarit do të hasen edhe në pjesë tjera të dy lagjeve tjera që mund ta kemi të njëjtin problem dhe kemi konsideruar si një shembull i mirë dhe një vullnet i mirë i qytetarëve për të mirën e përgjithshme, andaj uroj që ky projekt të zbatohet ashtu siç është menduar prej fillimit deri në fund për të mirën e qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po besoj që ky propozim vendim është shumë me vend dhe është i pranueshëm për të gjithë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, duke uruar që drejtori i DSHPMSH ta kryen punës sa më shpejt të jetë e mundur ngase siç po vërehet ky propozim do të miratohet unanimisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismet (Muharrem) Bulliqi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (emërimi i anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me propozimin për plotësimin dhe ndryshimin e përbërjes së KPF-së, për çka jemi në dijeni se znj.Drita Pajaziti është zgjedhë Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe para disa ditëve ka dhënë dorëheqje si anëtare e Kuvendit të Komunës së Podujevës rrjedhimisht edhe nga të gjitha funksionet që rrjedhin nga Kuvendi i Komunës, ndaj tani LVV-së i takon që ta propozoj një anëtar/e në vend të ish anëtares në KPF znj.Drita Pajaziti, andaj ftoj përfaqësuesin e kësaj partie që ta propozoj emrin për anëtarë në KPF.

z.Haki Rudari, theksoi, në zgjedhjet e fundit parlamentare në mesin e kandidatëve për deputet ishte edhe znj.Drita Pajazit kolege e jona apo ish kolege në këtë Kuvend Komunal e cila arriti të bëhet edhe Deputete dhe në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e falënderoj atë për korrektësinë, bashkëpunimin dhe seriozitetin e treguar në raport me Grupin e LVV-së, në raport me Ekzekutivin, në raport me subjektin dhe mbi të gjitha në raport me qytetarët me të cilët e ka treguar bashkëpunimin. Në të njëjtën kohë shfrytëzoj rastin ta uroj edhe kelegen nga LDK znj.Arjeta Abazi për zgjedhjen po ashtu Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket plotësim ndryshimi të përbërjes së KPF-së, unë nga radhët e Grupit të LVV-ës e propozoj z.Xhevdet Malokun.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues ne në sallë për momentin jemi 18 anëtar/e të Kuvendit dhe nëse kolegu që u propozua i bie të dal nga salla, nuk e di qysh mund ë veprimi sepse jemi në një situatë të paqartë ku mund të mbesim pa kuorum në këtë votim.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, i nderuar zotëri Rrahmani, nuk kemi të bëjmë me konflikt të interesit në këtë rast. Kuorum ka sepse jemi 18 anëtar/e të Kuvendit prezent në sallë. Madje për të qen pak më i qartë edhe unë si kryesues i Kuvendit kam pas të drejtë ta votoj veten dhe e kam votuar, si dhe edhe ju e keni votuar veten kur keni hyrë anëtar/e të KPF-së, prandaj konsideroj se kjo nuk paraqet kurrfarë konflikti të interesit, përndryshe nëse ndodh që eventualisht të ketë sigurisht që Ministria do të na jap vërejtje, por në bazë të asaj që unë e kam analizuar nuk ka konflikt.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, gjithashtu edhe një çështje tjetër i nderuar Kryesues, kemi të bëjmë me rastin ku është heq nga KPF një femër dhe tani po zëvendësohet me mashkull, a e prek interesin e Komitetit, a ka barazi gjinore apo jo, a jeni konsultuar me ndokënd për këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, i nderuar zotëri Rrahmani, kjo është një e drejtë që të propozoi partia të cilës i është liruar një vend në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Jemi në dijeni se ka qenë një femër znj.Drita Pajazit e cila ka shkuar prej këtij Komiteti kurse këta kanë shprehë dëshirën e tyre sa i përket propozimit dhe në qoftë se nuk kemi barazi gjinore atëherë Ministria mund të na e kthej vendimin si të paligjshëm, mirëpo unë nuk mund të përziehem në subjektin politik sepse këta e propozojnë kandidatin e tyre, andaj nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën unë e hedh në votim këtë propozim vendim, përkatësisht propozimin që anëtar i KPF-së të emërohet z.Xhevdet Maloku.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 anëtar/e të Kuvendit sa i shih në sallë, me 10 vota Për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht z.Xhevdet Maloku emërohet anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, në kuptimin e mos interferimit tonë tek Grupi i këshilltarëve të LVV-së ne zgjedhëm këtë mënyrë sa i përket votimit, sepse është e drejtë e tyre dhe për atë nuk dëshiroam të interferojmë asgjë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ashtu edhe unë duke mos dashtë të interferojë asgjë tek Grupi i LVV vendosa të votoj Për, është zgjedhje e këtij Grupi dhe nuk po e zgjatim më shumë sepse kjo pikë veç se kaloj dhe përfundoj, është vullnet i Grupit të LVV-së dhe nuk kemi çfarë të ndërhyjmë.

10. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” Sh.A. në Podujevë

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj pike kemi të bëjmë me një parking në qytet që gjendet tek ish drejtoria a atëherëshme e ndërmarrjes tregtare Llapi, pronë e cila tani pas luftës kryesisht është shfrytëzuar si parking ku për disa vite e ka pasë klubi i futbollit Llapi, tani nuk e di kujt i është dhënë, mirëpo tani Komuna ka marrë një vendim dhe i është propozuar Kuvendit, për më shumë fjalën për sqarime nga Ekzekutivi i Komunës drejtori i DBF.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, bëhet fjalë për propozim vendimin përkatës që ka hyrë si pikë shtesë nga mbledhja e KPF-së. Materialin e këtij propozim vendimi e keni të gjithë sepse ju është dërguar me konstatimet e KPF-së.

Pra është propozim vendimi për dhënin e pronës me sipërfaqe prej 3802 m² ne numëron kadastral 71712062-2871-0 Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” për shfrytëzim afatshkurtër (ku edhe tani në 1 i propozimit korrigjohet kjo nga afatgjatë bëhet afatshkurtër), pra meqë është për 10 vite atëherë nënkuptohet që duhet të jetë për shfrytëzim afatshkurtër, kështu që ju ftojme ta mbështetni këtë pikë të rendit të ditës për të cilën mendojmë se është e rëndësishme që kjo pronë t’i jepet në shfrytëzim një Ndërmarrje Publike e cila është në pronësi lokale “Eko Llapi”.

z.Naim Çunaku, theksoi, me këtë pikë apo gjegjësisht me materialin për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” në Podujevë dhe materialin që e kemi këtu para neve e kemi konsultuar këtë material dhe i kemi disa shqetësime rreth pronës, rreth dokumenteve që na janë prezantuar dhe po mundohem të shfaqë ato që ne mendojmë që do të duhej të paktën të marrin shpjegim prej drejtoreshës së Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Në parcelën e propozuar P-71712062-2871-0 bazuar në Kopjen e Planit që ne e kemi në këtë material figurojnë 38 ari, dhe në realitet në bazë të fotove që janë bërë dhe në bazë të Kopjes së Planit aty del që në këtë 38 ari ka banesa ku banojnë qytetarët, ka objekte afariste dhe ka një objekt i pashfrytëzuar. Pastaj kur të hysh në Certifikatën e pronësisë që na është prezantuar dhe që e kemi në material, te lloji i pronës figuron që kjo pronë është Pronë Shoqërore, andaj a janë mjaftueshëm këto që na bëjnë të mendojmë se dihet e drejta e Komunës për vendimmarrje për Pronën Shoqërore, e Pronën Shoqërore nëse nuk kemi arritur ta shpallim ose ta kalojmë në pronë komunale mund ta marrim një vendim për një diçka që nuk jemi kompetent.

Te kërkesa që i është drejtuar Ndërmarrja “Eko Llapi” Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, në kërkesën përkatëse në asnjë rresht nuk e ka parë të arsyeshme të tregoj qëllimin për çka i nevojitet ajo pronë për ta marrë në shfrytëzim, por vetëm që të kaloj në shfrytëzim të asaj Ndërmarrje, dhe kjo duke i anashkaluar procedurat për dhënien e një prone komunale në shfrytëzim. Krejt tjetër që na del nga kjo, jeni në dijeni se në fund vit Komuna e harton një Listë të pronave të cilat mendon që gjatë vitit i ofron për dhëni në shfrytëzim publik dhe kjo pronë nuk figuron në atë Listë të miratuar nga Kuvendi i Komunës për dhëni në shfrytëzim publik.

Duke marrë parasysh që Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko Llapi” e kemi themeluar me vota unanime nga ky Kuvend i Komunës duke menduar që do të jetë ndihmesë shumë e madhe në kuptimin e kryerjes së punëve (sikur të jetë servis i dorës së parë i punëve komunale), ne e kemi mbështetur edhe formimin e saj, edhe ndarjen e lokacionit në qendër të qytetit konkretisht në Sheshin “Zahir Pajaziti” - ndërtesa lokal për objekt të zyrave, kemi ndarë mjete financiare, pastaj pa të keqe e them se siç e kemi parë edhe këtu afër në Shesh e që nuk e di me lejen e kujt por që shohim se kjo Ndërmarrje ka bërë edhe rezervim të parkingjeve në pronë publike pa vendim të Kuvendit, ndërsa tani po kërkohet një sipërfaqe prej 38 ari, pa e ditë qëllimin e destinimit e saj dhe

pa e pas qartësinë e bazës ligjore e që përafriht një formë të tillë e kemi edhe tek 7 hektarshi atje poshtë që nuk po dua t'ia përmend emrin, andaj nëse vazhdojmë kështu t'i favorizojmë Ndërmarrjet pa e dhënë ato asnjë mjet për shfrytëzimin e pronës komunale, nuk e di se ku do të përfundojmë. Pra dua të them se për këtë Ndërmarrje kemi dhënë financa, kemi dhënë objekte, kemi dhënë pronë, andaj në një formë do të doja që të ishte këtu prezentë drejtoresha e DPKGJ, mirëpo një dilemë tjetër që e ngrisim tani është se në bazë të Ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim, nuk e di sakt sepse nuk e kam konsultuar në detaje atë material, por a kemi të drejtë ne që pronën publike si një e mirë e qytetarëve, t'ia ofrojmë një Ndërmarrje Publike që është fitimprurëse, për të krijuar benefite prej asaj prone.

Kështu që duke u bazuar në gjithë këto dilema që i kemi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së, në këtë formë ka dy propozime i nderuar Kryesues i Kuvendit, dhe atë:

1-propozimi i parë është që mendojmë se është mirë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës dhe të pajisemi me dokumente dhe me kërkesën se çfarë mendohet të bëhet në atë parcelë.

2-Nëse kjo e para nuk ndodh atëherë ne detyrohemi si Grup që të marrim pjesë në këtë vendimmarrje me të vetmen arsye që mendojmë se nuk është e pastër baza ligjore dhe pa hyrë në historikun e asaj prone qysh shfrytëzohet, që sa shfrytëzohet, nga kush shfrytëzohet, çfarë të hyrash ka inkasuar Komuna prej asaj prone, e duke i anashkaluar të gjitha këto, e vetëm në segmentin që pa bazë të kjo ligjore nuk duam të jemi pjesë e kësaj vendimmarrje.

Për fund edhe njëherë i nderuar Kryesues, ne kemi propozim që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër dhe të kompletohet dokumentacioni komplet, me vërtetim të pronësisë, me kërkesën për çka mendon NPL "Eko Llapi" ta shfrytëzoj atë pronë, dhe fundja ta ketë edhe një pagesë simbolike por që për këtë mund të diskutojmë mandej këtu ngase nuk mund t'i marrësh falas 38 ari midis qendrës së Podujevës dhe në anën tjetër të thuash po operoj ekonomikisht për favore të Ndërmarrjes.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, besoj se shumë i kjo ishte kolegu parafolës por unë deshta t'i potencoj edhe dy pika kurse të tjera nuk po dëshiroj t'i përsëris.

Është edhe një vendim i fundit i gjykatës që e ka pas Komuna me Agjencionin Kadastral, vendim i cili neve si anëtar të Kuvendit nuk na është prezantuar dhe nuk e dim fundin e saj.

Pastaj në atë parcelë figurojnë 38 ari e 2 metra, dhe tani i bie që nëse e merr në shfrytëzim për dhjetë vite "Eko Llapi" mund t'i kërkoj qira edhe atyre që janë në banesa ngase në atë parcelë ishin të gjitha komplet banesat, lokalet që janë privatizuar prej AKP-së edhe toka, prandaj mendoj se ose duhet të ndahen parcelat dhe të lihet vetëm hapësira që është pa ndërtim që të jepet në shfrytëzim.

Po ashtu është e sakt ajo që e potencoj parafolësi kolegu z.Naim Çunaku që ne duhet ta dimë se çka marrim ne si Komunës prej Ndërmarrjes "Eko Llapi" nëse i'a japim në shfrytëzim, çfarë shërbimi kryen ajo Ndërmarrje për qytetarët përveç se t'jua marrë paratë nga parkimi i veturave, çfarë të mire shohim ne si Komunë nga ajo Ndërmarrje, a e kryen ajo ndonjë punë që e merr parkingun në shfrytëzim, shembull ndonjë dezinfektim, ndonjë pastrim të ndonjë rruge apo çfarë bënë ajo që i merr ato para nga parkingu i automjeteve nga ana e qytetarëve.

Gjithashtu do të ishte mirë të sillej ndonjë raport se a ka pas ndonjë kontratë aty për shfrytëzim me ndokënd dhe ne tani nuk duhet ta njoftojmë atë që aktualisht është aty se duhet ta lë parkingun, pra i bie se ai peron nuk është në dijeni, prandaj pyes a ka ndonjë kontratë aty ose a mund ta dim se kujt ka qenë duke i'a paguar qiran e atij parkingu.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, mu ka mbush në mendje që t'ia dërgojmë një e-mail Kryetarit të Komunës duke i kërkuar që z.Fatlum Osmanin ta bënë drejtor të të gjitha Drejtorive sepse vetëm nga ky po marrim përgjigje e që nuk po më duket normal kjo gjë.

Në mbledhjen e KPF-ës kur drejtoresha e DPKGJ e propozoj këtë pikë të rendit të ditës nuk na u dha mundësia që të hapim debat dhe të parashtrojmë pyetjet sepse ti Kryesues e potencove në KPF se kur të vie rendi kësaj pike të rendit të ditës pastaj diskutojmë kurse kur i erdhi rendi nuk ishte prezentë në mbledhje drejtoresha e DPKGJ. Po ashtu edhe sot nuk është prezentë drejtoresha në fjalë andaj qysh me i marrë ne përgjigjet dhe qysh të votojmë bllanko ne sot.

Nëse drejtori i DBF-së e merr pozitën për të gjitha Drejtoritë normal që do ta pranoja, ndërsa kështu qysh po ndodh nuk më duket as normale përderisa as pagën nuk e merr ky për atë Drejtori.

z.Ragip Fetahu, theksoi, siç jemi në dijeni ne kemi themeluar një Ndërmarrje të re e cila është duke e mbajtur qytetin shumë pastër dhe është duke ndihmuar shumë në mirëmbajtjen e hapësirave publike, edhe kjo ka shumë rëndësi por vlen të theksohet fakti që ne tani jemi një prej komunave më të pastërta në nivel Kosove sepse nëse i shikojmë komunat tjera dhe dalim i vizitojmë arrijmë të gjithë në një mendim pavarësisht mendimeve politike se jemi një prej komunave më të pastërta në mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Është shumë e rëndësishme që kjo Ndërmarrje të ndihmohet në këtë aspekt, mirëpo edhe unë pajtohem me mendimin e kolegut parafolës z.Naim Çunaku që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, me sqarimet e kërkuara nga zotëri Çunaku, dhe mendoj se kjo çështje do të zgjidhet qysh është më së miri meqë deri tani kjo pronë deri tani është shfrytëzuar pa asnjë përfitim nga ana e Komunës prej individëve të caktuar, kurse ne duke pasë parasysh që direkt apo indirekt do të kenë përfitime së pari qytetarët Llapjan nga ky propozim vendim, mendoj që në seancën e radhës do të sqarohen të gjitha ato paqartësi dhe të kaloj në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për ta larguar si pikë të rendit të ditës është dashtë të bëhet në fillim të mbledhjes, z.Naim Çunaku por edhe z.Ragip Fetahu propozuan që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës apo të shtyhet mirëpo ju e dini që për situata e propozime të tilla duhet që në fillim të mbledhjes të ndodh pa u miratuar rendi i ditës e që unë në fakt në fillim ju kam ftuar që kushdo që dëshiron fjalën rreth rendit të ditës mund ta merr fjalën por askush nuk u lajmërua për këtë pikë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuari Kryesues propozimi ynë nuk ishte për ta heq nga rendi i ditës por vetëm për ta shtyrë për një mbledhje të radhës, e që nuk është hera e parë sepse ka pas praktika të tilla kur ky Kuvend ka shtyrë pika të caktuara për mbledhjet e radhës edhe pse i ka votuar në fillim si pika të rendit të ditës.

Prandaj mund ta shtyjmë për mbledhjen e radhës, e marrim materialin e kompletuar dhe pastaj mund ta marrim një vendim të plotë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, parafolësi z.Naim Çunaku i shtroj disa çështje lidhur me bazën gjinore të këtij propozim vendimi, mirëpo ky Kuvend Komunal e ka marrë edhe një vendim tjetër për dhënien e pronës komunal në shfrytëzim të njëjtës Ndërmarrje, pra prona e cila gjendet aty ku e ka ushtruar funksionin Kompania "Pastrimi", vendim i cili është konstatuar i ligjshëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, prandaj edhe ky propozim vendim për të cilin po diskutojmë sot e ka të njëjtën bazë ligjore dhe pa asnjë dyshim është i ligjshëm.

z.Ekrem Rrahmani, nga vendi ndërhyr duke potencuar se prona për të cilën po fol drejtori parafolës ka qenë pronë komunale.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, vazhdoi, edhe kjo pronë për të cilën po diskutojmë sot është pronë komunale sepse ashtu shkruan në fletën poseduese, por është e vërtetë se në disa fleta poseduese figuron pronë shoqërore Komuna e Podujevës, andaj aty ku figuron titullarë Komuna e Podujevës është pronë komunale dhe kjo pronë pa asnjë dyshim është pronë komunale e cila

proponohet t'i jepet në shfrytëzim NPL "Eko Llapi" për një periudhë 10 vjeçare, mirëpo këtu në propozim vendim e keni edhe një nen tjetër ku është futur edhe mundësia e shpërndarjes për ndonjë qëllim specifik, shembull në rast se aty do të bëhet muzeu sepse në atë hapësirë është edhe një objekt i cili në fakt ai është pronë shoqërore por që për të cilin jemi në procedurë të shpronësimit dhe ky Kuvend i Komunës e ka shpallë atë si interes i përgjithshëm me qëllim që në atë pronë të themelohet muzeu i qytetit në Komunën e Podujevës, kështu që këtu gjithçka është e qartë dhe kërkesa është që t'i jepet në shfrytëzim që ai parking të menaxhohet nga Ndërmarrja "Eko Llapi" deri në një shfrytëzim tjetër, ndërmarrje e cila është 100% në pronë të Komunës së Podujevës e cila është themeluar nga kjo asamble komunale dhe është duke e kryer një funksion shumë të mirë. Pra ky propozim vendim i cila ka kaluar në KPF mendoj që duhet të kalojë në votim edhe sot në këtë mbledhje dhe të marrë vullnetin e asamblesë komunale se qysh po vendos kjo asamble e që do të ishte mirë që sa më herët të kalojë në votim dhe të merret ai vendim aq më mirë do të ishte që të kalojë në menaxhim të kësaj Ndërmarrje ngase pronësia është e Komunës së Podujevës, edhe NPL "Eko Llapi" është në pronësi të Komunës së Podujevës, kështu që atë pronë vetëm e marrë në menaxhim kjo Ndërmarrje.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë e kam marrë fjalën dhe dua të përfundoj e ti kolegë i nderuar z.Ragip Fetahu pasi ta përfundoj unë mund t'i kërkoj Kryesuesit që ta mbyllë seancën apo çfarëdo mund të thuash se nuk është duke më bërë përshtypje ajo.

Edhe një diçka që dua ta vë në spikam është se asnjëherë nuk kam qenë kundër dhënies së pronave komunale në shfrytëzim, përkundrazi gjithherë kam qenë pro mirëpo kur krijohen dilemat e bazës ligjore, që z.Arnisa Sylejmani e tha një fjalë i nderuar drejtor i DBF që të kisha bërë për të gjitha Drejtoritë drejtor, por nuk mund të të bëjë gjykatës as nuk mund të të bëjë interpretues të ligjeve sepse duhet edhe pakt të shkosh edhe në një segment tjetër dhe pastaj të konsiderojmë ashtu.

Çka keni parë ju unë nuk e di, por unë i'u referova letrave që na janë dorëzuar neve dhe skam tjetër informacion, pra në letrat që ne i kemi 38 ari janë krejt ato ndërtesa që i përmenda më parë, madje madje po të ishte pak qysh duhet nuk do të guxonte as qysh tani. Kam qejf ajo të shihet diçka mirë dhe jam për tu parë mirë qoftë edhe parking, të paktën një parking i rregulluar dhe fare nuk i kam ato dilema ashtu qysh nuk e kam dilemën që duhet të shfrytëzohet prona komunale pa kontroll qysh shfrytëzohen gjithandëj qysh nga rruga kryesore e këndeje e që nuk po dëshiroj të përmend emra sot e që jam ithtarë që ato të kthehen në sistem dhe menaxhim të Komunës dhe të participohet gjegjësisht të krijohen të hyra për Komunën, andaj të mos ngatërrohem kinse jam kundër dhe nuk është Grupi i LDK-së kundër, mirëpo me një bazë ligjore çfarë na është prezantuar dhe me një kërkesë çfarë na është prezantuar na krijojnë dilema që jemi duke marrë një vendim të rregullt, prandaj në asnjë mënyrë nuk dëshiroj të involvohet Grupi i këshilltarëve të LDK-së në një votim të tillë sepse është e drejtë e jona se cilën formë të votimit e zgjedhim ne.

Ti drejtor i DBF-së e përmende se ajo pronë do të shfrytëzohet si parking, por unë pyes përse nuk ka figuruar në kërkesën zyrtare të Ndërmarrjes "Eko Llapi" kjo çështje. Në kërkesën zyrtare të kësaj Ndërmarrje shkruan diçka tjetër, prandaj e them që në mbledhjen tjetër të radhës mund t'i bëjë kërkesat me destinim të qartë se për çka po don ta shfrytëzojë atë pronë Ndërmarrja "Eko Llapi" por jo në këtë formë siç shkruan këtu, "në kuadër kërkojmë miratimin për dhënie në shfrytëzim të pronës të mësipërme e cila do të na mundësojë realizimin e planifikimeve të reja në rritjen e kapaciteteve të Ndërmarrjes" kështu e përcakton ajo se si do ta shfrytëzojë atë pronë, jo parking.

I nderuar drejtor i DBF-së, unë në fjalimin e parë për këtë pikë i bëra disa pyetje e që ti nuk mu përgjigje, një të tillë po e shtroj sërish, në bazë të ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim, a ke të drejtë që të japësh prona pa pagesë, madje 38 ari në mes të qytetit.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, duke i reaguar parafolësit theksoi se ka shumë vendime që 20 vite që i janë dhënë prona në shfrytëzim KEDS-it pa pagesë, për dallim nga kjo e fundit që ishte para disa muajve që i është dhënë me pagesë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, lëreni 20 vjeçar in ju sepse nuk ka të bëjë me këtë, por nëse mendoni që me këtë bazë ligjore dhe me këto shkresa që na janë dërguar, mendoni ju që jeni në rregull me vendimmarrje unë nuk përzihem se qysh votojnë Grupet tjera të këtij Kuvendi, ata të veprojnë si të dëshirojnë, mirëpo nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së ishte propozimi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një seancë të radhës, të sqarohen këto dilema të cilat për ne Grupin e LDK-së nuk janë të sqaruara, e që për Grupet tjera mund të jenë të sqaruara, përndryshe cilësime që po bëhen nga vendi për ne si Grup ato janë paragjyktime të juaja.

Pra nëse ju mendoni se jeni në rregull atëherë votojeni, nëse mendoni se duhet të përkrahet propozimi im që ka për qëllim një vendimmarrje të drejtë mund ta përkrahni, jo për diçka tjetër sepse për një seancë / rreth 1 muaj po bëhet fjalë, mirëpo nëse mendoni që nuk duhet të përkrahni propozimin tim urdhëroni veproni, ne mund edhe ta lirojmë sallën dhe ju vazhdoni dhe vendosni pastaj qysh do që dëshironi.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori i DBF-së po këmbëngul duke thënë që dihet kërkesa por që ky ndoshta e din sakt sepse i ka treguar ai për çka, por këtu në dokumentacion po thuhet për zgjerimin e veprimtarive të reja, dhe nëse i kujtohet ndokujt këtu kur e kemi dhënë një pronë tjetër asaj Ndërmarrje për zyrë ku aktualisht është një barnatore në Sheshin e qytetit unë që atëherë e kam thënë që ne do ta votojmë për interes publik që ta heqim nga AKP dhe ta kthejmë në pronë komunale dhe t'ia japim për zyrë kësaj Ndërmarrje por ka zyra mjaft në objektin e vjetër të Komunës, por që sot e asaj dite ne atë vendim e kemi marrë këtu në Kuvend por aj lokal nuk shfrytëzohet nga NPL "Eko Llapi" por e shfrytëzon një person militant i LVV-së i cili e ka barnatore dhe vazhdon ashtu kurse ne e kemi votuar për zyra të NPL "Eko Llapi", prandaj edhe kjo që po diskutojmë ne sot krijon dilema se për çfarë po votojmë ne t'ia japim për 10 vite dhe pastaj a do ta shfrytëzoj kjo Ndërmarrje apo në emër të kësaj do ta shfrytëzoj dikush tjetër dhe për çka.

Është mirë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës dhe të mos na detyroni të dalim nga salla sepse edhe kështu në sallë jemi fiks 18 anëtar/e të Kuvendit e që mund ta përdorim këtë variant por që nuk duket e mirë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, nëse po flitet këtu që dokumentacioni i kësaj pike nuk është në rregull dhe nuk është bindës mjaftueshëm për ta votuar mund të them se ka plotë raste të tjera që janë marrë vendime të njëjta. Por po flasim për një pronë publike të cilën kemi propozuar t'ia japin në shfrytëzim një Ndërmarrje Publike, përkundër asaj që unë e ceka më herët që janë dhënë prona publike Ndërmarrjeve private për interes të qytetarëve, dhe tani nëse veç pak është e kuptueshme ajo që shkruan aty për rritur paksa kapacitetet, unë nuk e besoj që është pak e kuptueshme sepse kapacitetet rriten në forma të ndryshme, përndryshe nëse tani e cekim në vija të holla secilin aktivitet ose kapacitet që don ta rritë Ndërmarrja, ajo do të rritet edhe me staf, edhe me makineri sepse është Ndërmarrje që është në formim e sipër e cila është formuar tash së voni dhe që po kërkon rritje sa më të madhe e që normale se do t'i duhet hapësira sa më të mëdha, e them këtë sepse po t'i shohim Ndërmarrjet tjera të komunave tjera se çfarë hapësirash kanë kjo e jona mbetet që nuk ka hapësirë fare, kjo Ndërmarrje tani për tani funksionon në një gjendje shumë të vështirë, prandaj nëse po e themi që materiali nuk është i kuptueshëm mjaftueshëm dhe nuk është i plotësuar mjaftueshëm atëherë votojeni kundër, mirëpo unë nuk po e kuptoj qartë këtë kur në një formë po veprohet në këtë mënyrë që po e hedhim ne në votim dhe nëse votohet kundër jemi në rregull por nëse votohet për po dalim jashtë, kështu pak a shumë po i bie kjo, ju (i drejtohet asambleistëve të LDK) këtë po e thoni, ne këtu jemi dhe po ju dëgjojmë, ju po thoni le të hedhet në

votim propozim për shtyrje të kësaj pike, nëse votohet jemi në rregull por nëse nuk votohet ai propozimi ne pastaj po dalim jashtë po e lëshojmë sallën, pra kështu ishte ajo që theksuat ju.

Nuk po bëjë propagandë sepse e dëgjova shumë mirë ngase këtu prezent isha, kështu e potencoj asambleisti z.Ekrem Rrahmani kur e tha ose po e shtyjme ose po detyrohemi të dalim jashtë e që ashtu siç e ceka unë nënkuptohet kjo çështje.

Nëse dëshironi material plotësues është çështje tjetër por kjo nuk po kuptohet që ju nuk e keni të kuptueshëm materialin por po kuptohet që nuk po doni ta votoni, shkurt.

Po thoni që ka dilema, në rregull por për ato dilema unë po ju them që ka të bëjë me rritjen e kapaciteteve ku shkruan aty shumë qartë dhe me çfarë kapacitetesh e shfrytëzon ajo pastaj atë hapësirë publike fundja është çështje e asaj Ndërmarrje, mirëpo ne duhet t'ia mundësojmë që ajo Ndërmarrje t'i rritë kapacitetet por ne nuk po duam t'ia mundësojmë në këtë rast, nuk është ndryshe sepse është çështje e Ndërmarrjes se qysh i rritë kapacitetet e veta, ne nuk e dim a ka nevojë për personel, për makineri, apo për diçka tjetër, ne nuk e dim, nëse për makineri normale se diku duhet t'i lë ato makineri sepse fundja në Shesh na duhen.

Pra ta shohim se qysh po veproni tani ju por me rëndësi është që ne po e dim tash.

z.Ekrem Rrahmani, duke i'u drejtuar drejtorit parafolës të DSHPMSH, theksoi, nëse t'i i dëgjove ato që i potencova pak më parë, përse nuk e dëgjove kur ta kërkonte vendimin e gjykatës që jeni në gjyq me Agjencionin Kadastral, sjelle vendimin e gjykatës pastaj e shqyrtojmë këtë, ende nuk është 100% se a është ajo pronë komunale apo nuk është pronë komunale sepse diku thuhet pronë shoqërore e diku pronë komunale, andaj qysh ju propozoni t'i jepni në shfrytëzim 38 ari kur në ata 38 ari është galeria, është ndërtesa banesore, janë lokalet që disa janë fotokopje e disa kafiteri e të ngjashme, madje është kompletë banesa në atë 38 ari.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, prona është komplet pronë komunale kurse objekti nuk është por edhe ai është në fazën e shpronësimit për tu bërë i joni dhe do të bëhet së shpejti edhe ai objekt, pra prona është pronë komunale dhe ne po flasim për pronë e jo për objekte në këtë rast sepse për objektin do të diskutojmë më vonë kur të sjellët shpronësimi i atij objekti.

z.Ekrem Rrahmani, vazhdoj, a keni qenë si Komunë në gjykatë për këtë objekt.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, përgjigje duke thënë se nuk e di që kemi qenë ndokush në gjykatë për atë objekt apo pronë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSH, atë ditë që Komuna ka gatishmëri, vullnet dhe mundësi për ta blerë një pronë dhe atë ta kthej në pronë komunale, këtu tani ta premtoj se e ke votën e Grupit të LDK-së, nuk po e them që nuk janë blerë deri tani, por edhe ajo pronë kur të vije këtu në Kuvend ta jua premtoj tani që votën e Grupit të LDK-së do ta keni, mirëpo nuk po e di çfarë ka të keqe nëse kërkohet 1 muaj ose në seancën e radhës të kompletohet dokumenti dhe të sillet sërish për shqyrtim dhe votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për momentin kuorum nuk ka për vazhduar me mbledhjes sepse jemi vetëm 17 anëtar/e të Kuvendit prezent në sallë, mirëpo meqë kolegu z.Fatmir Gashi e ka kërkuar fjalën qysh më herët nuk mund tani mos t'ia jap sepse ai ju dëgjoj të gjithëve dhe pati durim, andaj ta dëgjojmë edhe ne atë.

z.Fatmir Gashi, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës dëgjuam qëndrimet e të gjithëve qoftë Grupit të LDK-së qoftë Ekzekutivit të Komunës qoftë edhe këshilltarëve të tjerë, mendoj se nuk ke çka tutje i nderuar Kryesues, nëse nuk ka dikush çka të debatoj të mos i përsëritim të njëjtat gjëra disa herë por hedhi në votim sipas Rregullore së punës së Kuvendit dhe ta shohim pastaj rezultatin e votimit se a kalon apo jo. Në rast se nuk kemi kuorum nuk kemi çka tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani për momentin nuk ka as kuorum për të vazhduar me mbledhjen kështu që nuk mund të vazhdojmë me procedurën e votimit, andaj kjo mbledhje ndërpritet për shkak të kuorumit ngase nga 35 asamblesitë/e të Kuvendit prezent në këtë pjesë pothuajse vazhdimisht ishin 18 mirëpo tani jemi vetëm 17 dhe nuk mund të vazhdojmë tutje.

Nga ju disa po kërkohet që të mos e ndërpres mbledhjen sepse asambleisti z.Ragip Fetahu është këtu diku por që mund të ketë dalë për ndonjë nevojë të tijë, dhe ai do të kthehet, mirëpo ne jemi duke pritë që një kohë kolegun në fjalë por si duket ka shkuar sepse nuk po hyn në sallë, kështu që unë tani jam në një situatë ku as nuk mund ta vazhdoj mbledhjen me 17 anëtarë/e të Kuvendit prezent e as të hedh në votim asgjë, përveç siç e potencova që ta ndërpresë tani dhe e ndërpresë për shkak të kuorumit.

Meqë nuk pati kuorum për të vazhduar mbledhjen ngase vetëm 17 anëtarë/e të Kuvendit ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Kuvendit theksoi se kjo pikë e rendit të ditës për të cilën shqyrtimi ishte në përfundim e sipër, si dhe pika në vijim (Të ndryshme) nuk mund të shqyrtohet kështu që në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, e ndërpre në këtë mbledhje me konstatimin se e njëjta do të vazhdohet pas konsultimeve si dhe po sa të krijohen kushtet përkatëse, për çka do të bëhet njoftimi të gjithëve përmes e-mailit.

Konstatim:

Mbledhja ndërpritet në orën 18:00 (18.05.2025), për të vazhduar sipas deklarimit të mësipërm të Kryesuesit të Kuvendit

Vazhdimi i mbledhjes, më 28 maj 2025

Vazhdimi i mbledhjes filloi në orën 10:30 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës, dhe u kryesua nga z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/te e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; Donjetë Balii..

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi; kurse mungoi Qendresa Haliti.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani, Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri; Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;)

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin edhe media lokale dhe disa zyrtar komunal.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi vazhdimin e seancës, theksoi, ashtu siç jeni informuar lidhur me vazhdimin e seancës ku kemi mbetur te pika e rendit të ditës Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” Sh.A. në Podujevë, sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF-së dhe dërguar si pjesë përbërëse e Konstatimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 16 prill 2025, lidhur me këtë fjalën ia kaloj drejtoreshës së DPKGJ znj.Saranda Stublla.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, në propozim vendim e kemi parcelën 2871-0, me sipërfaqe 38 ari e 2 metra në Zonën Kadastrale Podujevë. Në këtë parcelë më duhet të japë një sqarim lidhur me objektet të cilat janë të vendosura në këtë parcelë ku janë disa objekte përreth të cilat objekte private për shkak se kanë qenë në pronësi të Agjencionit Kosovar të Privatizimit AKP-së dhe kjo Agjenci i ka privatizuar. Procedurat e privatizimit kanë filluar në vitet 2013-2014. Pastaj në atë hapësirë kemi edhe objektin e vjetër të ish një Ndërmarrjeje për të cilin kanë filluar procedurat e shpronësimit dhe pritët të kthehet në pronësi të Komunës si objekt në mënyrë që pastaj Komuna të zhvilloj procedurat për zhvillimin si Muze i Komunës.

Sipërfaqja tjetër që është e lirë, qëllimi është t'i jepet në shfrytëzim afatshkurtër Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” dhe pres ta mbështetni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, kemi një propozim vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrje Publike Lokale “Eko Llapi”, propozim të cilin e kemi nga seanca e kaluar e cila natyrisht siç e tha Kryesuesi i Kuvendit që në mungesë të kuorumit është ndërprerë kjo mbledhje dhe që tani po vazhdohet.

Grupi i këshilltarëve të LVV-së e kemi analizuar këtë pikë të rendit të ditës dhe kemi ardh në përfundim që kjo formë e dhënies është në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, po ashtu ligji parasheh kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, duke filluar nga parimi i ligjshmërisë pastaj parimi i efikasitetit dhe parimi i të hyrave vetanake.

NPL “Eko Llapi” është lokale dhe konsiderojmë që dhënia në shfrytëzim e kësaj prone kësaj Ndërmarrje ka efekte pozitiv për arsye se ajo gjeneron të hyra dhe në të njëjtën mënyrë afati kohor i dhënies në shfrytëzim është afatshkurtër 10 vite, këtë e thotë edhe pika 4 e propozim vendimit, andaj në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim dhe i japim mbështetje të plotë.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot kemi vazhdimin e seancës me pikat e mbetura nga seanca e kaluar që kanë mbetur shkaku i kuorumit, pra kemi dy pika të rendit të ditës pikën e parë që tani po e trajtojmë, vendimmarrja për dhënie në shfrytëzim të një prone komunale dhe pika tjetër Të Ndryshme. Tani po mundohem ta përsërisë atë që kemi thënë në mbledhjen e kaluar lidhur me formën se si duhet me dhënë një pronë në shfrytëzim dhe këtu i përmendi parafolësi z.Haki Rudari parimet se si duhet me dhënë një pronë komunale në shfrytëzim, theksoi nga normativat apo rregulloret në fuqi për dhënien e një prone në shfrytëzim duke filluar nga Ligj, Udhëzimi Administrativ, Qarkoren e Ministrisë e të tjera, dhe që në fillim e përmendi parimin e ligjshmërisë, tani unë pa dashur t’i përmend edhe parimet tjera, shembull, parimin e efikasitetit, parimin e trajtimit të barabartë të palëve që duan të marrin pronën në shfrytëzim, parimin e transparencës, parimin e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik që kjo është më e rëndësishmja, parimin e ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale, parimin e ruajtjes së karakteristikave të vlerës unike të pronës, parimin e ruajtjes së mjedisit dhe parimet dhe kriteret tjera që duhet t’i përmbushim po flasim te kriteri i ligjshmërisë.

Për të dhënë një pronë në shfrytëzim ligjet në fuqi e kanë paraparë një procedurë e cila duhet të ndiqet dhe të gjithë ne këtu jemi dëshmitar që në fund të vitit 2024 të gjitha pronat komunale që komuna mendon t’i japë në shfrytëzim që mos të mbesin si aset i fjetur i Komunës, mirëpo ato të jepen në shfrytëzim për zhvillim ekonomik për ngritje të mirëqenies për punësim, dhe ajo listë e pronave miratohet më së largu deri më 31 dhjetor të vitit paraprak, tani lind pyetja vetvetiu, këtë pronë që ne sot po mendojmë ta japim në shfrytëzim a është pjesë e asaj liste, në rend të parë kjo pronë nuk është pjesë e asaj liste. Kur kemi kërkuar ta shtyjmë për një seancë tjetër këtë pikë të rendit të ditës kemi thënë që ajo parcelë që po figuron në bazë të kopjes së planit 38 ari, ajo është vetëm në kopje të planit 38 ari sepse në realitet në atë parcelë prej 38 ari qysh e përmendi edhe drejtoresha e DPKGJ kemi ndërtim të banesave kolektive, kemi ndërtim të një shtëpie që është nën përkujdesjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe disa lokale afariste aty afër.

Sot derisa ato janë aty dhe nuk mund të zhvendosen sepse janë objekte, as nuk mund t’i shtyjmë, qysh mund të flasim për 38 ari, pra nuk mund të flasim për 38 ari dhe për këtë edhe në mbledhjen e kaluar e kemi shfaq mendimin që të plotësohet dhe të matet saktësisht se cilat pjesë nga ajo parcelë prej 38 ari mund t’i jepet në shfrytëzim dikujt.

Tani kur jemi te procedurat e dhënies në shfrytëzim se çka duhet të përmban një pretendent për marrjen e pronës në shfrytëzim, pyes a kemi një biznes-plan apo një destinim të asaj prone, a kemi diçka para Kuvendit se çka do të bëhet me atë pronë, e kemi një kërkesë të Ndërmarrjes “Eko Llapi” e që në fakt e kemi por që e cila me dy fjalë e përmbyll “për zgjerimin e kapaciteteve”, dhe tani te zgjerimi i kapaciteteve duke pasë parasysh fushëveprimin e NPL “Eko Llapi” në fushëveprim mund të hyjnë të gjitha ato që janë regjistruar në specifikat e veprimtarisë së saj, dhe ne sot nuk e dimë, të paktën nuk kemi letra apo kërkesë apo biznes-plan se për çfarë qëllimi do të shfrytëzohet ajo pronë. Prona tani siç është duke u menaxhuar vërtetë ndoshta dikush nga Ekzekutivi është dashtë të jep sqarim qysh shfrytëzohet ajo pronë, qe sa kohë shfrytëzohet, pse

shfrytëzohet, ku inkasohen të hyrat dhe ato të hyra ku përfundojnë, e them këtë sepse sigurisht që çdo njëri prej nesh kemi paguar në atë parking dhe asnjëri prej nesh nuk e din rrugën se ku kanë përfunduar ato mjete që inkasohen nga një pronë që është pronë komunale dhe nuk është e vetmja pronë komunale që na ndodh kështu ngase kemi edhe prona tjera, por për të mos e zgjatë shumë po e përmbylli këtë, mirëpo me këtë formë qysh na është prezantuar ne Grupi i LDK-së nuk duam prej një shfrytëzimi të pa rregullt që nuk mund ta quaj ndryshe deri sa nuk ka diçka të na tregoj që është në rregull, ta shndërrojmë tani në një dhënie në shfrytëzim tjetër të parregullt dhe krejt e keqja e kësaj më e madhe është që të paragjykohe tani e 10 vite, do të thotë sot qytetarit të Komunës së Podujevës me këtë vendimmarrje që po bëjmë i tregojmë që edhe 10 vite po i japim dikujt dhe ajo pjesë e qytetit do të mbetet ashtu siç është edhe për 10 vite.

E di që ndoshta dikush prej Ekzekutivit, ndoshta drejtoresha e DPKGJ do të thotë që e kemi një pasues në kontratë që mund t'ia shkëpusim kontratën kurdo që dëshirojmë, por me vetë faktin që votojmë që ajo pamje e qytetit dhe ai frekuentim dhe ai zhvillim në atë pjesë të qytetit do të mbetet sepse nëse sot votohet Për, po bëhemi pjesë që t'i japim në shfrytëzim pronën dikujt tjetër.

Te NPL “Eko Llapi” kam edhe dy fjalë, nëse ju kujtohet, nuk e di në cilën seancë, unë këtu po në këtë foltore të Kuvendit e kam thënë se çka po ndodh me parkingun që e kemi para ish objektit të vjetër të Komunës, aty është një parcelë përafërsisht e madhe që shfrytëzohet si parking, aty është shfrytëzuar ajo pjesë dhe janë mbledhë taksa gjegjësisht janë mbledhë pagesa për parking ndërsa sot aty nuk është askush dhe ato taksa që janë mbledhë, e di që ka qenë një marrëveshje për të kaluar te Stacioni i Autobusëve, e di që ky Stacion nuk ka pasë gjyrollogari dhe në mënyrë të rregullt nuk kanë mund të barten ato mjete. Shtrohet pyetje nëse Ndërmarrjes “Eko Llapi” duhet t'i ndihmohet, unë mendoj që atyre t'ju ndihmohet në veprimtari të tyre që të rrisin kapacitetet duke iu dhënë punë shtesë që janë në natyrën e kësaj Kompanie, ndërsa t'i japim prona në menaxhim e të bëjmë një lloj tregtimi sepse unë edhe sot nuk e di se për çka do shfrytëzohet dhe do të ishte mirë që Kryesuesi i Kuvendit të na tregoj destinimin e asaj prone pasi t'ia japim Ndërmarrjes “Eko Llapi” në shfrytëzim, se çfarë elaborati apo çfarë plan-biznesi ka si dhe çka parashihet të bëhet aty.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sot po diskutojmë për dhënie në shfrytëzim të pronës apo parkingut që e njohim ne, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi”, në fakt drejtoresha e DPKGJ na sqaroi disa çështje rreth asaj prone dhe do ishte mirë të na tregoj se nga kush është shfrytëzuar kjo pronë deri më sot dhe a ka pasë Komuna inkasim të të hyrave nga ajo pronë.

Kam pritur që do të na sjellët një sqarim i detajuar për këtë propozim vendim, mirëpo unë mendoj që më mirë është t'i jepet në shfrytëzim kjo pronë Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” se sa të shfrytëzohet në mënyrë të pa ligjshme apo të mbetet në pozicionin të cilin është.

Te çështja e NPL “Eko Llapi” do të doja ta di a ka bërë ndonjë plan siç e ceku kolegu parafolës z.Naim Çunaku, se si do të veprojnë Ndërmarrja “Eko Llapi” dhe a do të investojë në atë pronë.

Përveç këtyre dy sqarimeve, unë mendoj që më mirë është kjo pronë t'i jepet në shfrytëzim Ndërmarrjes “Eko Llapi” se sa të mbetet ashtu siç është. Ndërsa sa i përket parcelës, u sqarua që aty janë disa prona të shitura nga AKP-ja, por kjo pjesa që i jepet Ndërmarrjes “Eko Llapi” sa është parcela dhe sa ka vlerë aty.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës edhe pse shumica e gjërave u përmenden në pika të shkurtra unë po them nëse që kjo pikë kalon do t'i drejtohem Ministrisë së linjës ngas kjo është e paligjshme dhe në bazë të konsultimit të ligjit këtu të gjithë e dimë që shkojnë disa procedura, por nëse duam veç ta votojmë dhe t'ia bëjmë qejfin dikujt është diçka tjetër. Së pari, e ngriti kolegu parafolës z.Naim Çunaku si dilemë është lista e pronave për tu dhënë në shfrytëzim në vitin 2025 të cilën e kemi votuar në vitin 2024, e që njëra prej kërkesave apo kushteve për të dhënë në shfrytëzim prona publike duhet të jetë në listë, kurse kjo pronë nuk

është në listë për dhënie në shfrytëzim, së dyti, shumë mirë e specifikon ligji se kërkesa e NPL “Eko Llapi” duhet të jetë e qartë se për çka, ne në fakt mund t’i besojmë drejtorit ose jo këtu që e potencon se është për parking, por në kërkesë të Ndërmarrjes nuk shkruan që do të përdoret ajo pronë për parking, pastaj së treti, mendoj se drejtoresha e DPKGJ ra në kundërshtim me fjalët e saj sepse nëse këtu shkruan që ne t’ia japim në shfrytëzim 38 ari, kurse aty ka lokale, pastaj është ajo shtëpia/objekti për të cilën u tha se është në procedura që të bëhet pronë e Komunës, mirëpo ato mbesin veç fjalë përderisa të bëhet me vendim ajo pronë komunale.

Pastaj në atë hapësirë janë ndërtesat aty, është edhe galeria, andaj nuk e di pse po ju vie aq zor ta ndani hapësirën përkatëse që nuk ka objekte dhe të na e sjellëni këtu, e jo siç është sjellë me 38 ari që i bie ta qesim nga aty edhe galerinë pastaj, si dhe çka ndodh nëse aty ku janë ndërtesat nesër iu kërkohet qira nga NPL “Eko Llapi” në momentin që atë parcelë e qet në emrin e vet si shfrytëzuese. Prandaj mua më duket e pa logjikshme kjo punë. Përse Komuna meqë ka gjeometër dhe i ka krejt kapacitete nuk shkon ta ndaj atë parcelë dhe NPL “Eko Llapi” pastaj të na e sjellë kërkesën më të qartë ku do të cekej edhe arsyeja, shembull për parking, e jo veç për zgjerim të ndërmarrjes siç është thënë, pa dhënë ndonjë specifikim të arsyeshëm dhe të saktë, e që bazuar në ligj, së pari kërkesa duhet të jetë e saktë, po ashtu prona duhet të jetë në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim e që ajo pronë nuk është në listë sepse e kam hulumtuar listën që ne e kemi votuar dhe nuk është aty, mirëpo që dëshironi ju të japni atë pronë në shfrytëzim jashtë ligjshëm na thoni dhe në rregull jemi, mirëpo unë do t’i drejtohem Ministrisë për këtë çështje.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket listës së veçantë të pronave është e vërtetë se nuk është në listë të veçantë, mirëpo me ligj parashihet që në mes institucioneve pa qenë në listë të veçantë me procedurë të jashtëzakonshme mund ta japin në shfrytëzim. Ndërsa sa i përket pyetjeve të parafolësit z.Bashkim Sylja, përgjigja ime është se nuk ka kontratë, kam hulumtuar në arkivat e pronës dhe nuk ka kontratë që e është dhënë në shfrytëzim ajo pronë, përndryshe zakonisht kur jepet prona në shfrytëzim, në kadastrë vendoset një vërejtje në fletën poseduese me numrin e kontratës që është e dhënë në shfrytëzim, mirëpo edhe në arkivë kemi kërkuar ndonjë dokument por nuk kemi gjetur diçka. Pastaj lidhur me pyetjen që u potencua që përse nuk është ndarë parcela, DPKGJ nuk e ndan parcelën pa një vendim të asamblesë komunale ose të ndonjë Drejtorie që paraqesin kërkesë që do të zhvillohet ndonjë projekt aty.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderuar drejtoreshë e DPKGJ, mos e kupto si polemikë këtë por kuptoj si shqetësim që po e ngriti sepse për mua është shqetësim ajo që e potencove se ne nuk bëjmë ndarje të parcelave pa kërkesë qoftë të Kuvendit qoftë të Drejtorive. Disi po ju tingëllon ajo që përafërsisht e potencoi parafolësi z.Ekrem Rrahmani, si mund të japim ne në shfrytëzim hapësirën diku dhe ata banor që janë aty më nuk kalojnë për pronë publike por kalojnë për një pronë që dikush e ka marrë në shfrytëzim, dhe qysh mund të ndërtojmë mirëbesim me qytetarët, apo me këtë vendim apo shkaktojmë telashe mes atyre banorëve që sot e shfrytëzojnë një pjesë të asaj prone, nëse është dashur vendimi i Kuvendit ne në mbledhjen e kaluar patëm propozim dhe a kemi ne sot propozim që t’i kërkohet Kuvendit të bëhet ndarja e parcelës dhe të parashihet një hapësirë minimale për ata banorë që janë në mënyrë që pastaj pjesa e lirë e asaj prone, kushtimisht po e them që mbetet pas reduktimit 5 apo 10 ari, të jepet në shfrytëzim. Pra pyes a ju duke kjo që jepen 38 ari në shfrytëzim komplet parcela dhe ndoshta do të shkaktojmë probleme, habi ose telashe edhe atyre banorëve si shfrytëzues të rregullt të asaj prone. Pra nëse është dashtë të merret vendim në Kuvend, është dashtë të sjellët si pikë e rendit të ditës që t’i propozohet Kuvendit ndarja e asaj parcele dhe ta dimë çka po japim në shfrytëzim.

Pastaj u potencua edhe objekti ose shtëpia që është e ndërtuar aty dhe në shfrytëzim, por ajo tani është trashëgimi kulturore dhe as Komuna dhe askush tjetër nuk mund të ndërhyjë sepse ajo duhet

të mbetet aty në atë hapësirë, kurse ne kalkulojmë se cili është përfitimi i Komunës në këtë rast, nuk ka diçka që Komuna jep në shfrytëzim dhe e nuk duhet të ketë sepse nuk jepet në shfrytëzim një pronë pa pas marrëveshje dhe benefit, e pyetja është çka kemi ne, çka përfitojmë ne, apo prej një parregullsie po bëjmë një parregullsi tjetër ashtu qysh e thashë më parë.

Të mos harrojmë edhe një gjë që ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim, besoj drejtoresha e DPKGJ dhe një pjesë e mirë e këshilltarëve e dinë që në përfundim të mandatit, e që ne i jemi afruar datës kur do vijë zgjedhjet e reja lokale, dhe posa të hyjmë në këtë fazë Kuvendit i Komunës i cungohet e drejta për të dhënë prona në shfrytëzim, kjo ngase hartuesi i ligjit sigurisht e ka paraparë që ka interesa edhe elektorale nëse ndodh një gjë e tillë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj që diskutimet përfunduan dhe pa humbur kohë më shumë e vë në votim propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” Sh.A. në Podujevë, sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF-së të mbajtur më 16 prill 2025 dhe dërguar si pjesë përbërëse e konstatimeve të rekomanduara.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 20 vota Për, 11 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (një nuk votoi), miratohet propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” Sh.A. në Podujevë, sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF-së dhe dërguar si pjesë përbërëse e Konstatimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 16 prill 2025.

11. Të Ndryshme

z.Arjant Topanica, theksoi, do t’i ngris dy shqetësime të banorëve të fshatit Sfeçël, dhe atë; njëri ka të bëjë me mbeturinat që është pjesa e shkolla por që tani ka filluar edhe një deponi të bëhet në rrugën e ashtuquajtur rruga e “Polonicave” besoj e din edhe drejtori i DSHPMSh se ku është apo thënë ndryshe rruga e hekurudha që lidhet me rrugën e Mullirit në afërsi të ish “Hotel Besiana”, pra aty është bërë një grumbull apo deponi e mbeturinave. Unë drejtorit të DSHPMSh do t’ia dërgoi lokacionin, fotografitë dhe videot por dhe kërkoj që të ketë vullnet për largimin e asaj deponie si dhe të ketë një kujdes më të madh sepse po rrezikohen edhe fëmijët që kalojnë andej. Gjithashtu po e ri-përsëris edhe një shqetësim tjetër për mburojat e urës te pjesa e ashtuquajtur ura e “Vokrollëve” atje është një mburojë që është thyer nga një aksident më parë dhe janë bërë dy ose tri vite që mungon ajo rrethojë dhe paraqet rrezik për fëmijët që kalojnë andej për të shkuar në shkollë, por edhe për qytetarët tjerë për arsye se komplet pjesa e rrethojave të hekurit nga njëra anë është e hequr dhe nuk ka muroja fare.

z.Naim Çunaku, theksoi, pasi patëm një diskutim për pronat komunale pak më parë, unë i drejtohem me një pyetje drejtoreshës së DKRS-së, te çështja e shfrytëzimit të stadiumit të Llapit a mund të na tregoj për sa vite është dhe ato objekte aty që janë të ndërtuara a janë dhënë në shfrytëzim apo si është gjendja e tyre, statusi i tyre, si shfrytëzohen, a ka ndonjë vendim, kontratë apo ndonjë sqarim juridik për këtë veprimtari që e ushtrojnë ata.

z.Kasib Bashota, theksoi, prej banorëve të Llapashticës e kemi një kërkesë për ndërtimin e një Çerdhe publike në një zonë të përshtatshme në mes dy fshatrave që mund të gjendet, sepse me të vërtetë ka nevojë për ndërtimin e saj.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë kam një shqetësim pasi është prezent këtu edhe drejtori i DSHPMSh z.Bahri Selimi, a ka mundësi këtë mirëmbajtjen e ndriçimit publik ta bëni pak më mirë sepse ka shumë vende ku shumë drita fiken e ndezën si të jenë blic bëhen, madje çfarë më ka rënë në sy shumë është se ka një vit rresht që në Orllan është një dritë e cila fiket e ndezët si të jetë blic

i policisë si dhe që e ka aq dritën e fortë, përse nuk e dërgoni dikë dhe ta rregulloni atë dritë ngase jeni në dijeni sa është pengesë për shoferët ajo dritë, andaj nuk dua shpjegime këtu por nëse ka mundësi të shkoni dhe ta rregulloni atë dritë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, kam një pyetje meqë drejtori i DSHPMSh z.Bahri Selimi është deklaruar kur është shtruar rruga në drejtim të SHFMU “Enver Maloku”, ka thënë që nuk do të vendosen pjesë të pengesave mirëpo jemi dëshmitar që së fundmi janë vendos 2 të tilla në atë rrugë dhe sa e kam parë një postim ka qenë se është vendosur njëra pengesë nga banorët e asaj lagjeje, andaj a mund të na informosh drejtor më shumë rreth kësaj qasje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, kam një kërkesë prej banorëve të fshatit Majac për një rrugë lidhëse në rrugën kryesore “Ramadan Berisha” e cila është e pa kalueshme dhe ka goxha banor aty, unë kam edhe foto të asaj rruge siç mund t’i shihni.., kjo është momentalisht gjendja e rrugës nëpër të cilën kalojnë fëmijët përgjatë saj, andaj kërkoj nga Drejtoria përkatëse të intervenoj menjëherë dhe ta rregulloj atë rrugë.

Meqë drejtori i DKA-së është prezent këtu, kam bërë kërkesë disa herë dhe sërish po e vazhdoj kërkesën e njëjtë që 4 vite që të na informoj më shumë për fushën sportive në SHFMU “Lasgush Poradeci” në fshatin Dumnice, por nuk kemi marrë përgjigje edhe pse drejtori në fjalë ka thënë shumë herë që kjo fushë do të rregullohet shumë shpejtë mirëpo kanë kaluar 4 vite dhe kjo nuk është rregulluar, andaj për këtë do të doja të marrë një përgjigje prej drejtorit.

z.Valon Demolli, theksoi, desha të ngrisë një shqetësim të banorëve të Sekiraçës, Sibocit, Gllamnikut, për shkak se një banor ndoshta po e quaj ashtu “i pa ndërgjegjshëm” fermer aty që ka një stallë, gjithë kanalizimin po e liron në lumin Llap dhe aty bëhet kundërmim i tmerrshëm për çka banorët kanë paraqitur ankesat e tyre për shkak të erërave të rënda që kalojnë përgjatë lumit, besoj drejtori i DI edhe pse nuk qenka prezent, është në dijeni për cilin rast po flas.

Kam edhe një pyetje, te lagja “Sogojeva” në fshatin Bajçinë si ka mundësi që ndriçimin publik dikush nga Komuna e ka heq të gjithin, aty ndriçimi ka qenë por tani i tëri është heq në atë lagje.

z.Naim Çunaku, theksoi, me pyetjen tjetër që mendoj që është dashur të jetë shqetësuese po i drejtohem drejtorit të DKA-së që të paktën të na sqaron brenda mundësive dhe kapaciteteve të tij, e kam fjalën për mësimin jo formal që është duke u organizua në institucionet fetare.

Me ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm, çdo institucion që organizon mësim qoftë formal ose jo formal duhet të jetë i licencuar apo i akredituar nga Institucionet e Republikës së Kosovës për të ushtruar veprimtari të edukimit nëpër format që ata i mendojnë që mund të organizohen, andaj Duke pas parasysh që nëpër institucionet tona fetare janë duke u organizuar mësim jo formale dhe atë ngjitur me shkollën, pyetja për drejtorin është, cila është kompetenca e Komunës, gjegjësisht e DKA-së të merret me këtë problematikë ose të paktën të inspektohen se a është duke u zhvilluar mësimi konform rregullativës ligjore në Republikën e Kosovës, nëse jo cilat masa duhet të merren që ushtrimi i atyre veprimtarive të bëhet konform rregullativës ligjore.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, kam një pyetje rreth projektit të varrezave të qytetit, që një kohë e dimë që këtë projekt veç se e kemi reklamuar goxha shumë që do të bëhet, mirëpo ende nuk është bërë ndonjë zhvillim, e them këtë ngase rrezikojmë shumë shpejtë, në qoftë se nuk merret diçka, të përfundojmë me njerëzit që nuk do të kenë ku të varrosen.

Për këtë çështje kam parë edhe kalkulime që janë bërë edhe nga opozita, por do të thoja që është një projekt që duhet të përfundoj sepse nuk kemi kohë.

znj.Edona Shabani, theksoi, dua t’i them drejtorit të DKA-së, nëse ka mundësi të na jap një zotim tani këtu që të më lejoj t’i ndihmoj fëmijët me nevoja të veçanta sepse nga një Organizatë kemi fituar një donacion, andaj publikisht kërkoj prej drejtorit me na jep leje për të shkuar dhe ndihmuar ata fëmijë me nevoja të veçanta se ka kohë që nuk na ka lejuar të hyjmë në atë shkollë.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket pyetjes së z.Naim Çunaku që e bëri lidhur me parcelën e stadiumit të qytetit, përgjigja është se stadiumi i qytetit nuk ka ndonjë kontratë që i është dhënë në shfrytëzim KF Llapit ose personave tjerë të cilët nuk kanë ndonjë vendim. Është e vërtetë që ne i kemi përfshi në listë të veçantë lokalet për t'i dhënë në shfrytëzim, mirëpo përse nuk kanë dalë është se nuk dihet saktë statusi i asaj prone për shkak se në fletën poseduese ka një vërejtje që i është vendos më përpara, mirëpo ne kemi iniciuar padi në gjykatë për të definuar saktë se ku qëndron problemi dhe besoj që gjykata do ta zgjidh këtë çështje.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, këto pak pyetje që dolën prej jush këtu po mundohem t'i përgjigjem secilës veç e veç sepse mbajta shënime këtu vazhdimisht, sa i përket pyetjeve për mbeturinat, e them se është një shqetësim shumë me vend dhe që tashmë e kemi të gjithë sepse po e vuajmë të gjithë. Të them të drejtën para se të mendohet se qysh të largohen mbeturinat shtrohet pyetja se kush po i hedh ato, pra ne vetë po hedhim ato mbeturina dhe është goxha problematike këto deponitë e egra ilegale t'i largojmë. Ne çdo vit kemi zhvilluar procedura të tenderimit për largimin e deponive të egra ilegale, por për çdo vit janë hedh në po të njëjtat vende ku është vazhduar sërish me hedhjen e mbeturinave, ky është një shqetësim bukur i madh për neve sepse përnjëmend nuk po dimë si të veprojmë, argumente për t'i gjobitur nuk ka dhe përderisa nuk ka argument nuk mundemi të shqiptojmë gjobë, në të kundërtën të gjitha deponitë që janë të evidentuara ku janë diku rreth 84 deponi në territorin e Komunës së Podujevës, pra deponitë e egra ilegale dhe të gjitha që janë të njëjta ne i largojmë këtë vit, kurse vitin tjetër duhet sërish të shpenzojmë buxhet si Komunë për t'i larguar të njëjtat që i kemi larguar në vitin paraprak, prandaj për këtë vit po ju tregoj që nuk kemi kontratë për largim të deponive ilegale, por po mundohemi që të bëjmë diçka së bashku me kompaninë regjionale "Pastrimi" dhe me Ndërmarrjen tonë komunale "Eko Llapi" me aq kapacitete sa kanë dhe kjo besoj që është arsyeja dhe qëllimi më i madh i joni që ta rrisim dhe t'i ngrisim kapacitetet e NPL "Eko Llapi" në mënyrë që të kursejmë edhe buxhetin i cili për çdo vit shkon për të njëjtën punë. Të gjitha deponitë e di ku janë sepse i kemi të identifikuar që janë 84, por mundësia për t'i larguar tani nuk është sepse kapacitetet janë të vogla, mirëpo shpresoj që së shpejti do të reagojmë dhe do i largojmë ato deponi.

Sa i përket rrethojës te ura në fshatin Sfeqël që u ngrit si shqetësim, ne kemi vendosur rrethoja në të gjitha urat që i kemi pas të lajmëruara që i'u mungojnë mbrojtëset dhe për këtë po ju them që kemi kontratë dhe menjëherë do të veprojmë sepse kjo është një gjë që veç nuk e kemi ditë sepse sigurisht keni pasë mundësi të vëreni se në shumë ura ka pas mungesë të mbrojtësve dhe ne i kemi vendos e që nëse nuk gaboju 10 sosh dhe do e rregullojmë edhe këtë që u cek sepse kemi kontratë aktive që po punojmë për këtë punë.

Te mirëmbajtja e ndriçimit publik, e kemi biseduar shumë herë këtu se tani më lehtë është bërë zgjerimi i ndriçimit publik se sa mirëmbajtja ngase është bërë një numër i madh i dritave që janë vendosur në Komunën tonë dhe ju e dini që kemi biseduar këtu ku tashmë me këtë kontratën e fundit mbërrin dikund rreth 300 km vija gjatësore e ndriçimit publik.

Te mirëmbajtja sigurisht që e rritë koston, andaj ne këtu për ta zvogëluar koston, e që më erdhi mirë që u përmend edhe prej juve fuqizimi i NPL "Eko Llapi" e cila fatmirësisht po kryen shumë punë dhe po na ndihmon shumë në secilin projekt të mirëmbajtjeve, dhe ne tani po mundohemi që në bazë të kapaciteteve që i ka kjo Ndërmarrje t'ia kalojmë kësaj për çka jemi në prag të lidhjes së një marrëveshje/kontrate me NPL "Eko Llapi" që po duam t'ia kalojmë komplet kësaj Ndërmarrje. Pra meqë tani po kemi shumë probleme me operatorët privat për mirëmbajtje të ndriçimit publik po duam që ndriçimin publik ta mirëmbajmë vet dhe kjo do të bëhet së shpejti, nga Ndërmarrja "Eko Llapi", janë shpallë procedurat e pajisjes me material dhe presim të lidhet kontrata në mes Komunës dhe kësaj Ndërmarrje e cila pastaj të filloj me mirëmbajtjen e ndriçimit publik, e që

besoj se përveç që është më mirë është kontratë që quhet Kontratë në Shtëpi, përndryshe me NPL “Eko Llapi” është një kontratë dhe nuk do të kemi më kontrata tjera për mirëmbajtjen e ndriçimit.

Sa i përket asaj dritës që u përmend në Orllan mund të them se është i njëjti problem sikurse me gjithë mirëmbajtjen e ndriçimit publik edhe në pjesët tjera.

Te kanalizimi që asambleisti z.Valon Demolli parashtroj pyetje, tek feramat ka disa që janë të lidhura në kanalizime fekale por ka edhe disa që kalojnë drejtpërdrejtë në Llap, vërtetë ne ligjërisht kemi intervenuar në shumë vende ku feramat janë të lidhura në kanalizim fekal sepse ligjërisht është e ndaluar dhe nuk lejohet, madje nuk lejohet as kanalizimi atmosferik të lidhet në atë fekal e lëre më kanalizimi i një ferme, është e njëjta gjë edhe derdhja në lum, ne i kemi dërguar shumë herë inspektorët dhe janë marrë me këtë çështje dhe tani mundeni me marrë me mend se është goxha problematike si çështje nëse po shqipton gjobë e po i zhvillon të gjitha procedurat dhe sërish problemet po vazhdojnë të jenë të njëjtat, përndryshe veç po t’i lëmë inspektorët në atë vend sepse nuk po gjejmë ndonjë formë çka të veprojmë më shumë se sa ta gjobitim me inspektor ngase fundja kjo është punë e inspektoratit, jo e shërbimeve publike.

Sa i përket pengesave në rr.”Hakif Zejnullahu”, kur e kemi rregulluar këtë rrugë e kemi pas një lloj marrëveshje verbale me banorët e kësaj pjese që të mos vendosen pengesa për shkak se pengesat na kanë krijuar shumë probleme, dhe ne në bazë të kërkesës së banorëve të atyre lagjeve që janë aty kemi vendos të vendosim pengesa në rrugë, mirëpo pastaj kur e kanë parë se vozitja është goxha e shpejtë sepse rruga është rregulluar dhe është bërë një rrugë lehtë e qarkullueshme dhe e bukur por që lëvizja e automjeteve është shumë e madhe, atëherë vetë ata banorë që fillimisht na kanë thënë të mos vendosim pengesa kanë ardhur dhe na kanë kërkuar t’i vendosim. Për ta vendosur një pengesë në rrugë nuk vendosim ne si Drejtori aty ku duam ne dhe ku na pëlqen neve sepse kemi një komision të caktuar prej inxhinierëve të komunikacionit të cilët fillimisht e shqyrtojnë kërkesën dhe pastaj ata marrin vendim a është e lejueshme apo jo për t’u vendosë pengesë në atë vend. Është e vërtetë që ai komision ka ardhë në përfundim që në atë rrugë duhet të jenë 3 pengesa, pra komisioni e ka vlerësuar këtë kërkesë, mirëpo ne kemi pasë mundësi të vendosim fillimisht në bazë të kontratës aktive që ka qenë për vetëm një pengesë dhe atë pengesë e kemi vendos afër shkollës sepse e kemi vlerësuar se është më e rëndësishmja, kurse pengesa e dytë që është e vërtetë se është vendosur nga qytetarët, mirëpo është vendosur në vendin e duhur aty ku komisioni e ka paraparë dhe nuk kemi intervenuar por e kemi lënë ashtu edhe pse ne tani duhet të vazhdojmë edhe me një pengesë të tretë në atë rrugë ashtu siç e ka paraparë komisioni përkatës.

Sa i përket varrezave të qytetit, e dini se është bërë një projekt për ndërtimin e varrezave të mëdha mirëpo t’ju them të drejtën procedurat janë duke u zhvilluar dhe atë në zyre të prokurimit ku ne i kemi dërguar për t’u lidhë kontrata për çka jemi në pritje për të vazhduar pastaj me rregullimin e varrezave të reja të qytetit ku do të ketë vend të mjaftueshëm.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendimi im është që varrezat e qytetit të mos i sjellëni në Obrançë qysh po mendohet të bëhet, por secili le t’i varros të afërmit e tij në fshatrat e tyre prej kah kanë ardhë, edhe shkojnë i vizitojnë nganjëherë.

z.Naim Çunaku, theksoi, ku ishte ti zotëri Kryesues kur ka vendosur ky Kuvend që ato varreza të kalojnë atje, atëherë s’të pengonte që janë në Obrançë, çka ndodhi tani që është fundi i mandatit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ky Kuvend nuk ka vendos, këtu gabim e ke zotëri Çunaku, drejtorët janë prezent mund t’i pyesësh.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, lidhur me pyetjen që e parashtrori asamblisti z.Kasib Bashota për çerdhe ishte pyetje shumë e drejtë, ne në disa lokalitete ku hapësirat brenda shkollës mund të adaptohen në çerdhe do të bëhet adoptimi i tyre.

Në fshatrat Llapashticë e Poshtme dhe Llapashticë e Epërme siç jeni në dijeni është në procedurë zgjerimi i hapësirës së shkollës në fshatit Llapashticë e Epërme e që sigurisht se pastaj e mundëson edhe adoptimin e çerdhes brenda objektit shkollor. Kësaj çështje i ka parapri edhe kuzhina qendrore që do t'i furnizon të gjitha çerdhet dhe do të na mundëson jo vetëm në këto dy lokalitete por edhe në shumë lokalitete tjera që të adoptohen çerdhet aty ku është e mundshme.

Sa i përket mësimi jo formal që u përmend, përveç dy shkollave të mesme ajo “Isa Boletini” dhe shkolla ekomomike që organizojnë mësim jo formal për të rritur siç i kemi informacionet, kurse për të tjerat do të interesohemi i nderuari asamblist z.Naim Çunaku dhe do të japë informacion nëse ka diçka të tillë.

Sa i përket fushës së sportit te shkolla “Lasgush Poradeci”, jemi në dijeni që në të gjitha shkollat për shkak të kushteve klimatike nuk është që po shfrytëzohen mjaftueshëm fushat e hapura të sportit dhe jemi të interesuar ta ndërtojmë një sallë sportive te ajo shkollë në mënyrë që të jetë një zgjidhje më afatgjate për këtë çështje.

Sa i përket lejes për t'i vizituar shkollat dhe për të dhënë donacione, do të ishte mirë e nderuara bashkëvendëse (i drejtohet znj.Edonë Shabani) të dihen donatorët prej nga janë sepse ndonjëherë po ndodh që një donatorë me një shumë ndoshta krejt simbolike po i publikon 100 foto dhe po bëhet jo mirë kjo çështje në një formë prandaj duhet të dihet a përfshihen të gjithë fëmijët apo një pjesë e fëmijëve e që mandej pjesa tjetër mund të lakmojnë për ato dhurata, mirëpo duhet të dihet qartë për çka po bëhet fjalë.

Për fund, unë nuk e di që e kam ndaluar dikë për t'i dhënë dhurata dikujt, mirëpo po çuditë përse tash në këtë vit zgjedhor të fillohet me dhurata të tilla, kështu që është mirë ta përkufizoni qartë për çka duhet të bëhet ajo në mënyrë që jo unë t'ju përcjellë por ju përcjellin zyrtarët dhe mund ta kryeni atë aktivitet pa asnjë problem.

z.Ragip Fetahu, theksoi, po e ngrisë një kërkesë që e kam nga disa të rinjë banorë të Sekiraçës të cilët kanë një kërkesë imediate për ndërtimin e një fushe të futbollit. Ffshati Sekiraçë siç e dimë është një prej fshatrave më kontribut dhënës në Komunën tonë dhe jo vetëm, dhe nga të rinjtë e kësaj lagjeje siç po thotë edhe Nënkrjetarja se nuk është fshat, kam një kërkesë që të ndërtohet një fushë e futbollit ku si lokacion i mundshëm do të ishte aty ku është shkolla e Sekiraçës.

Mendoj se do ishte mirë që në KAB të hyj ky si projekt dhe njëkohësisht gjithë së bashku të punojmë që vitin e ardhshëm të bëhet kjo fushë dhe të realizohen kërkesat e atyre të rinjve që është shumë e drejtë dhe shumë reale.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kur drejtori i DSHPMSh u përgjigj që nuk kemi çka t'i bëjmë stallës/fermës, nuk mendoj se është ashtu ngase aty jepet një leje, bëhen kontrollet a i ka rezervuarët e të tjera, andaj nëse iu ka dhënë leja atij të veprojnë aty dhe i është ndaluar hedhja e plehrave në lumin Llap, është dashtë të dilet në kontrolle dhe të shikohet a e ka gropën skeptike nëse po a është funksionale ose jo. Pra nuk është ashtu siç u tha, vetëm të shkohet të dënohet me gjobë nëse ai vepron, por duhet të shkohet me kontrolle se a po i përdor ose jo ato gropat skeptike dhe t'i ndalohet hedhja e plehrave në lumin Llap sepse vërtetë na telashe.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, meqenëse drejtori i DKA disi aludoi në punën e asaj Organizatës për fëmijët me nevoja të veçanta, s'po dua të bëjë polemika e as ta quaj vit zgjedhor ashtu siç e përmendi ai, por edhe përmes grave asambleiste të LVV-së keni qenë në dijeni që ky është një projekt që 4 vite radhazi ne i përcjellim me një organizatë nga diaspora që është nga të gjitha

partitë politike por që fatkeqësisht prej Kuvendit përveç asambleistes që tani më ka shkuar në nivel qendror zonjës Drita Pajaziti nuk ka pasë tjera gra përfaqësuese të LVV-së në atë organizatë.

Kemi aplikuar për t'i fituar disa mjete të cilat do t'i sjellim në Podujevë për blerjen e mjeteve ndihmëse didake për të mësuar ata fëmijë, pra nuk është çështje e vitit zgjedhor, nuk është asnjë tjetër çështje veç se në bashkëpunim me Komunën, dhe absolutisht jo ne por askush tjetër këtë kategori nuk guxon ta përdor për vit zgjedhor. Kështu që së bashku me ty dhe Komunën është diçka e mirë që do të vije për Komunën tonë dhe po mendoj që është një kosto jo e vogël të cilën e kanë fituar ky grup i grave asambleiste të Kuvendit të Komunës, e që nëse dëshironi mund t'i përmendi me emra cilat kanë qenë.

Sa i përket koleges zonjës Edonë Shabani që e përmende si bashkëvendëse, ne të gjithë e dimë se në Kuvend dikush ka fol për 4 vite radhazi për fëmijët me nevoja të veçanta e ai person ka qenë znj.Edona Shabani, kështu që nuk e ka shfrytëzuar vetëm për vit elektoral siç u tha.

z.Arjant Topanica, theksoi, lidhur me atë që drejtori i DSHPMSH e tha që nuk e di që u ngritë shqetësimi i urës në fshatin Sfeqël, unë e di që atë shqetësim e kam ngritë këtu dhe është fjalë publike, madje drejtori në fjalë më ka thënë që nëse është aksident nuk mund të ndërhyjnë deri sa të jepet raporti i Policisë mbi dëmtimin e asaj rrethoje, si dhe po ashtu edhe dy herë tjera e kam ngritë këtë shqetësim, kurse sot është hera e tretë që e ngrisë këtë shqetësim ndërsa drejtori sot e tha që nuk e di që është ngritë ky shqetësim, prandaj vetëm deshta t'i përgjigjem.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, i nderuari z.Ragip Fetahu, sa i përket fushës së sportit në Sekiraçë afër shkollës, dua të them se në koordinim me DKRS-në kanë filluar të hartohen specifikat për atë fushë sportive. Është e vërtetë që ai komunitet aty ka kontribuar edhe për shkollë edhe për oborrin, madje një bashkëvendës aty ka vendos të zgjeroj hapësirën në mënyrë që fusha sportive të jetë sa më funksionale.

Në të njëjtën kohë i falënderoj asamblistet e LDK-së për sqarimet e nevojshme rreth donacionit ngase fillimisht ishte fjala vetëm për donacion por pa e ditë arsyen për çka dhe normale është që mund të vazhdoni pa mua, si do që e vlerësoni ju.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pas gjithë këtyre diskutimeve dhe përfundimit të pikave të mbledhjes së datës 18.04.2025, atëherë këtë mbledhje e shpallim të mbyllur / përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25 më datë (28.05.2025)

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0022111/25

Podujevë,

18 prill 2025, e vazhduar dhe përfunduar më 28 maj 2025

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LIII-të (pesëdhjetetë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 28 maj 2025.

Mbledhja filloi në orën 13:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Donjetë Baliui; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Ardi Hasani; Lirika Maliqi.

Nga LDK, Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi, Valon Demolli; kurse munguan; Ilir Koprani; ; Qendresa Haliti

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Burim Hasani; Arbnor Fazliu, kurse mungoi Mrika Thaçi

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli., kurse mungoi Adnan Zymeri,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla – Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR); Vigan Salihu – Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE; ndërsa mungoi Shuajb Blakçori – Drejtorja e Inspeksionit –DI; Fatlum Osmani – Drejtorja e Buxhetit dhe Financave -DBF

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; Samir Calakovic Caleb Waugh përfaqësues të OSBE, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar të pranishmëve punë të mbarë, konstatoi kuorumin, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës. **znj.Saranda Stublla**, drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, para se të miratohet rendi i ditës për këtë seancë unë po e paraqes edhe një propozim vendim për shpallje në interes të përgjithshëm të disa parcelave që gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, këtë propozim nuk e kemi paraqitur dje në mbledhjen e KPF-së pasi që kërkesa e AKP-së ka ardhë pasi që ka përfunduar seanca dhe nga ana e Komunës kanë kërkuar që asambleja komunale të nxjerrë një vendim të shpalljes në interes të përgjithshëm deri më datë 23.06.2025. Besoj që administrata do të shpërndaj materialin të cilin mund ta shqyrtoni e pastaj do vazhdojmë tutje lidhur me këtë propozim vendim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, materiali është duke u shpërndarë të cilin mund ta shfletojmë dhe të shohim se a është i arsyeshëm ky propozim të hyjë pikë shtesë e rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, të gjithë e dimë se është mirë të kthehen këto prona në interes publik dhe të hiqen nga procedura e shitjes sepse qysh shiten ato ajo procedurë është katastrofë, por këtu arsyetimi qenka për zhvillim ekonomik lokal, ndoshta është dashur të precizohet ky arsyetim dhe të dihet për çka po shpallet në interes publik kjo pronë, pra ta dimë saktë për çka po votojmë. Nuk e di a do pranohet kjo kështu të votojmë ne pa e ditur qëllimin e shfrytëzimit dhe shpresojmë që MAPL të mos me na e kthej këtë vendim për këtë pikë edhe pse është një shpjegim për zhvillim ekonomik lokal për komunitetin e asaj zone në Komunën e Podujevës, përndryshe unë jam për që ky propozim të votohet dhe ato prona të bëhen prona komunale.

z.Florent Hasani, theksoi, duke e ditur që është në interes të Komunës që këto prona të jepen në shfrytëzim, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë nismë që ky propozim vendim të jetë pikë e rendit të ditës.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, edhe ne Grup i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim që të jetë si pikë e rendit të ditës që këto 5 prona të kthehen në pronësi të Komunës. Neni 2 e paraqet që është interes i përgjithshëm që këto 5 prona të kthehen në pronësi të Komunës me qëllimin e vetëm të realizohen projektet në të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sipas deklarimeve të gjitha grupeve po shihet që interesi i të gjithëve është të përkrahet ky propozim vendim që të jetë pikë e rendit të ditës, andaj pa humbur kohë e vë në votim Propozim vendimin që të shpallen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, e evidentuar si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore-Kërpimëh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, Njëzëri me 28 vota Për, mbështetet të përfshihet pikë shtesë në rendin e ditës të kësaj mbledhje duke e renditur sipas radhës së pikave të rendit të ditës Propozim vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, të evidentuara si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e vë në votim rendin e ditës së bashku me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikën shtesë të propozuar nga drejtoresha e DPKGJ e cila u mbështetë paraprakisht dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, Njëzëri me 28 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikat shtesë të rekomanduara nga KPF si dhe pikën e mbështetur në fillim të kësaj mbledhje që ishte; Propozim Vendimin që të shpallen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, e evidentuar si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Rendi i miratua i ditës:

1. Draft rregullore për transparencë e komunës së Podujevës

1.1.Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

-Raporti për ecurinë e konsultimit publik për Draft Rregullore për Transparencë e Komunës së Podujevës dhe draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029.

2. Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtor[ve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës.

3. Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

4. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me vendimin e kuvendit të komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhejtor 2024 dhe atë; e dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të listës, komnketish periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ku thuhet njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, ri formulohet si vijon; Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

5. Propozim Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës-Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m2, zona kadastrale Lupç i Poshtëm.

- Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone.

6 Propozim Vendimin për shpallje në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, e evidentuar si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

7. Të Ndryshme.

1. Draft rregullore për transparencë e komunës së Podujevës

1.1.Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këto janë dy dokumente që i kemi përfshi në një pikë për shkak se në diskutim publik këto dy pika kanë qenë bashkërisht, raporti është i përbashkët, kështu që kjo është arsyeja, mirëpo do t'i votojmë veç e veç, fjalën hyrëse ia kalojmë Nënkryetares së Komunës. **znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës**, theksoi, sipas rregullativës ligjore në fuqi parashihet që komuna të hartojnë dhe miratojnë dokumente të politikave të cilat ndërlidhen me transparencë në institucionet lokale me theks të veçantë Rregulloren për transparencë dhe Planin e veprimit për transparencë. Në kuadër të kësaj dhe në respektim të akteve ligjore Komuna e Podujevës ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe në këtë aspekt ka ngritur Grupin punues për përgatitjen e dokumenteve të cekura, Grup punues i cili ka zhvilluar procedurat e nevojshme sa i përket përgatitjes së draft akteve në fjalë duke përfshirë këtu edhe procesin e konsultimeve publike ashtu siç parashihet me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, si dhe në fund ka hartuar edhe raportin për këtë proces të përgatitjes së drafteve të cekura si drafte finale për procedim për këtë seancë të Kuvendit.

Draft Rregullorja për transparencë komunale dhe draft Planit i veprimit për transparencë, janë dokumente të cilat si modele janë hartuar nga MAPL-ja dhe janë dokumente unike për gjitha Komuna e Kosovës por që mund të bëhen disa ndryshime të vogla aty ku komunat i kanë parë të përshtatshme, kështu që unë kërkoj nga ju që të votohen këto dy draft dokumente.

z.Haki Rudari, theksoi, draft Rregullorja për transparencë përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të rregullt të organeve komunale, Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, trupave të Kuvendit dhe mekanizmave tjerë ligjor, dhe në anën tjetër rregullat parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Thjeshtë është një Rregullore e cila është në interes të të gjithëve duke filluar nga qytetarët e deri te organet e Komunës siç është Kuvendi dhe Ekzekutivi. Theks i veçantë në këtë Rregullore i dedikohet transparencës e cila është një veprimtari e hapur e organeve të Komunës që siguron një publikim, informim dhe qasje në dokumente publike si dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe punës së organeve komunale. Një çështje shumë me rëndësi që theksohet dhe i jepet hapësirë në këtë Rregullore është edhe llogaridhënia e cila nënkupton një proces ku institucionet komunale japin një përgjegjësi për ushtrimin e kompetencave të tyre. Kur jemi te transparenca natyrisht duhet të kemi transparencë për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit, transparencë për mbledhjet e Ekzekutivit, transparencë për publikimin e dokumenteve zyrtare, pastaj pjesëmarrjes së qytetarëve, transparencë në menaxhimin e pronës komunale dhe të tjera.

Në të njëjtën kohë po e shfrytëzoj rastin, edhe pse unë kam menduar se këto dy pika do të jenë si të veçanta e jo të përbashkëta, megjithatë më lejoni te transparenca apo Plani i veprimit për transparencë në Komunë. Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit synojnë që mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve të jenë sa më afër organeve të ndryshme dhe në këtë kuptim mendoj, e tha edhe Nënkryetaria e Komunës, që është ngritë Grupi punues nga sektorët e ndryshëm dhe e gjithë kjo mendoj që është në interes të qytetarëve për arsye se sa do pak ofrohet një informim i qytetarëve lidhur me zhvillimet në komunë, planet e ndryshme, investimet, rregulloret e ndryshme, pjesëmarrja e qytetarëve në draft buxhet, në KAB dhe shumë të tjera.

Për fund, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim draft Rregullore për transparencë e Komunës së Podujevës dhe draft Planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, draft Rregullorja për transparencën e komunës, edhe pse paksa parafolësi i përmendi si dëgjimet publike dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, unë mendoj që këto mungojnë dhe raporti i KAB-it tregon që Komuna e Podujevës ka rënë dhe s'ka përfituar asnjë grand qeveritar për performancë, edhe ato që bëhen ashtu, nuk di si i ka marrë ato pikë kështu.

Shembull, ne jemi dëshmitar të projekteve qysh proklamohen kur të dalin, mirëpo transparencë është të dilet edhe kur dështon projekti dhe të tregohen arsyet, e jo të bëhen lajme e video me dron për projekt duke thënë u krye duke mashtruar qytetarët, e pastaj të mbetet në mëshirën e fatit nëse ndokush dëshiron që përmes postimeve të tregoj që nuk është mirë. Nuk e di çfarë transparence është nëse rr."Skenderbeu" ose rr."Xhemajl Mustafa" ose rr."Vëllezërit Frashëri" vonohen kontratat dy ose tri vite, dhe askush nuk del të jap përgjegjësi ose transparencë duke treguar arsyet përse kanë dështuar, e që një gjë e tillë nuk është marre. E them këtë sepse nëse e proklamoni dhe thua kanë me u krye krejt projektet, ndërsa jo që vonohen me një ose dy muaj e që do të ishte e arsyeshme sepse mund të ketë fatkeqësi natyrore ose bllokim trafiku që duhet liruar, mirëpo rr."Xhemajl Mustafa" ka pas të përfundoj më 1 shtator të vitit të kaluar kurse ajo rrugë nuk ka përfunduar ende, atëherë çfarë transparence është kjo.

Te konsultimet publike, kush i pyet qytetarët këtu..., ne e dimë në vitin e kaluar qysh janë mbajtur konsultimet publike. E kemi miratuar buxhetin dhe tani shkohet nëpër fshatra duke i'u thënë çka po doni buxhet ju vetëm tregoni, e që nuk do të duhet t'ju thuhet ashtu pasi që është miratuar buxheti sepse kjo formë është veç se mashtrim. Shembull, vie në Gllamnik dhe thotë çka po doni kurse i ka ndarë për Sibofc 40,000.00€, për Gllamnik 70,000.00€, pra pasi është miratuar buxheti ju thuhet çka po doni ju, pastaj ju thuhet edhe që do ta rishikojmë buxhetin edhe një herë, prandaj e them se kjo nuk bëhet kështu sepse nuk preket buxheti, duhet miratim me vendim të Kuvendit, pra

unë për këto arsye mendoj që këto më shumë janë mashtrime, përndryshe po t'i shikosh këto dokumente i kanë goxha disa pika interesante po që se i përmbahemi, kurse unë nuk kam parë në shumë raste që është përmbajtur, shembull, njëra prej pikave thotë konsultim publik e që nënkupton përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e konsultave para vendimmarrjes, kurse tek ne nuk ndodh asnjëherë kjo gjë, pastaj njëra prej pikave ishte llogaridhënia që nënkupton procesin ku institucionet komunale japin përgjegjësi për ushtrimi e kompetencave të tyre, shtrohet pyetja, kush kujt i jep përgjegjësi këtu, unë nuk kam parë ndonjë dhënie e përgjegjësisë, pastaj këtu tregohet që edhe Kryetari i Komunës duhet të japë raport në Kuvendin e Komunës dy herë në vit, e që po ashtu te ne nuk ndodh kjo, një herë po, a dy herë jo, ndërsa drejtorë të Drejtorive të mos flasim, përjashtoj këtu dy drejtoresha që vijnë nga dy herë në vit dhe e bëjnë njëfarë raportimi, kurse të tjerët nuk e di ku raportojnë, pra ka shumë pika që duhet t'i përmbahemi këtij dokumenti, por unë mendoj se bëhen.

Sigurisht se do t'i miratojmë këto dy drafte, mirëpo gjithashtu nuk është transparencë shembull vetëm të caktohet një person zyrtar për t'i publikuar disa gjëra në ueb faqe të Komunës, besoj që komuna jonë ka pasë kapacitete më shumë që këto gjëra t'i bëjë më mirë dhe të filloj ndonjë grand e mos të del kështu.

Po ashtu njëra prej pikave në këtë draft Rregullore ishte edhe transparenca e Ndërmarrjeve Publike, ne kolegë i kemi këtu në asamble por ka aksionar që nuk kanë ardhë të raportojnë fare dhe të na tregojnë ku janë ato Ndërmarrje, çka punojnë dhe deri ku kanë arritur apo kanë ngecë krejt.

Shpresoj që t'i përmbaheni kësaj Rregulloreje.

z.Bashkim Sylja, theksoi, siç e dimë, në shumë çështje sa i përket transparencës janë pasqyruar dhe janë rregulluar me ligje, me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për dokumente zyrtare e shumë ligje tjera, mirëpo çdo dokument çdo draft rregullore që e ngritë cilësinë e transparencës në komunë normalisht që ne jemi për dhe e përkrahim.

Pajtohem me një pjesë të fjalimit të parafolësit z.Ekrem Rrahmani që transparenca në zbatim të këtij dokumenti është me rendësi, nëse e miratojmë ne si dokument e mbetet vetëm në letër edhe pse shumica e gjërave janë çështje që duhet të raportohen dhe të jepen sqarime në Kuvend, mirëpo kjo është një bazament që merret veç me Komunë, pra është draft rregullore që merret vetëm me çështjet e Komunës dhe do ishte mirë të zbatohet sa më shumë që është e mundur, përndryshe edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë dhe çdo dokument që e ngritë transparencën në komunë.

z.Naim Çunaku, theksoi, të flasësh për transparencën vërtetë ke fol për shtyllën kryesore të një qeverisje të mirë gjegjësisht edhe për afrimin e qytetarëve në vendimmarrje. Se ku qëndrojmë ne si komunë me transparencë më së miri e tregon një institut i pavarur kredibil që ka dhënë verdiktin e tij se ku qëndron komuna jonë, do të thotë kemi regres, kemi kthim mbrapa sa i përket transparencës, andaj si mund të cilësohet ndryshe kjo kur ne nga ky Kuvend këtu, nga kolegët e mi, nga Kryesuesi i Kuvendit është votuar kundër Planit të punës së Kuvendit që e ka miratuar vetë, pastaj ky Kuvend dhe këta koleg që i përmenda janë ata që kanë votuar kundër edhe transmetimit të seancave drejtpërdrejtë, do të thotë që prej këtyre ulëseve e tutje kemi punuar jo për transparencën por për kundër transparencës. Kur e përmendi kolegu parafolës z.Haki Rudari me të drejtë që këtu kemi të bëjmë me dy dokumente, draft Rregulloren për transparencë dhe draft Planin e veprimit për transparencë.

Sa i përket Rregullores edhe dje në KPF por edhe sot këtu po e paraqes një shqetësim timin që procedurat për hartimin e një Rregulloreje në rend të parë i përcakton Ligji për vetëqeverisjen lokale, pastaj Statuti i Komunës, Rregullorja e punës së Kuvendit, Udhëzimi Administrativ mbi standardet minimale të konsultimit publik dhe Udhëzimi Administrativ për hartimin dhe publikimin e dokumenteve zyrtare të komunës, ndërsa sot neve po na paraqitet vetëm një Udhëzim

Administrativ për qeverisje të hapur, nëse shkojmë kështu do të thotë që i kemi dhënë rëndësi një Udhëzimi Administrativ për qeverisje të hapur, dhe kemi dalë në kundërshtim me bazën e qeverisjes lokale. Pa dashtë të zgjasë më shumë sespe sigurisht që çdo planifikim, çdo draft dhe çdo rregullore që ngritë transparencën dhe me transparencën sigurisht vjen edhe llogaridhënia, unë mendoj dhe sigurisht që do ta ketë mbështetjen tonë sepse është një kontribut drejt qeverisjes së mirë lokale, por me faktin që pesë muaj para zgjedhjeve të reja lokale po miratojmë një Plan të veprimit për transparencë, me vetë faktin që po miratojmë një Rregullore vetëm pesë ose gjashtë muaj që na ndajnë nga zgjedhjet, flet më së miri sa seriozisht i është qas ky Kuvend dhe ky Ekzekutiv llogaridhënies dhe transparencës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kolegu parafolës z.Bashkim Syla e përmendi qasjen në dokumente zyrtar që është njëra prej pikave që unë kam pasë shumë problem në Komunën tonë, për shumë gjëra unë vazhdimisht kërkoj qasje në dokumente zyrtare dhe kalon afati e unë nuk marrë përgjigje ku pastaj më duhet t'i drejtohem Agjencisë për Privatësi dhe Informim. Kam e-maile plot, shtyju me Ekzekutivin e Komunës së Podujevës, shtyju me Agjencinë, i jepet edhe në afat Komunës, lejon qasje të shohë ose jo. Ta zëmë shembull, nëse unë tash si anëtar i këtij Kuvendi nuk kam qasje në dokumente zyrtare, atëherë sa e marrin për bazë një qytetar që është i punësuar diku tjetër dhe nuk merret me këtë punë, nëse dëshiron ta shohë një dokument, këtu në këtë draft Rregullore ish përfshi edhe kjo që e ceka. Pastaj ishin edhe pikat e prokurimit që në fillim të vitit duhet të votohen siç është Plani i prokurimit dhe në fund Raporti i prokurimit, e që këto nuk kanë ndodh kurrë në Komunën e Podujevës por që shpresoj se pasi të votohet kjo draft Rregullore në të ardhmen të ketë më shumë transparencë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, po i ceku tri çështje bazike të cilat dëshmojnë që kjo qeverisje veç transparente nuk është, dëshmon se ka çka fsheh prej qytetarëve dhe nuk është llogaridhënëse para qytetarëve, shpresoj t'i përmbahemi kësaj Rregulloreje e jo veç të votohet sepse si dokument është i mirë nëse i përmbahemi por me këto tri pika bazike nuk e besoj që ky Ekzekutiv as që iu ka përafruar përmbajtjes së tyre.

Së pari, po ndalem te Plani i punës së Kuvendit që e kam cek edhe para tri seancave e që e ceku edhe kolegu z.Naim Çunaku që ju vet si Ekzekutiv dhe asamblistët e pushtetit kanë votuar kundër atij Plani, kundër llogaridhënies që drejtorët e Drejtorive duhet të japin para qytetarëve, me përjashtim të disa drejtoreshave që kanë raportuar, madje ka drejtor Drejtorie që thonë ne veç Kryetarit të Komunës i japim llogari, askujt tjetër sepse ai na ka emëruar, e që këtë së pari nuk e shohë që është transparente.

Së dyti, është mos publikimi i listës së të gjitha pronave të Komunës dhe gjendjes së tyre, kërkesë kjo e cila është prej vitit 2021 që ne e kemi paraqitur, kurse një listë e tillë nuk është publikuar kurrë e që edhe kjo tregon sa është transparente Komuna jonë.

Së treti, është raporti i performancës ku Komuna e Podujevës as që është afruar për së afërmi garës për përfitim të grandit për performancë komunale, madje është tentuar që ky raport të mbahet fshehtë prej qytetarëve, dhe edhe kjo tregon se sa transparente është Komuna e Podujevës.

z.Fatmir Gashi, theksoi, disa prej kolegëve më herët folën sa i përket këtyre dy parimeve themelore siç janë transparenca dhe llogaridhënia, meqë janë dy parime themelore të çdo qeverisje të mirë mendoj që e kemi edhe vlerësimin paraprak të organit kompetent për vlerësime të transparencës ku megjithatë ka regres, andaj nga ana juaj kërkoj që mbetet sfida edhe më tutje transparenca dhe llogaridhënia edhe për Komunën tonë në mënyrë që të bëjmë gjithçka që t'i përmirësojmë këto dy çështje themelore për një qeverisje të mirë.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, faleminderit shumë të gjithëve për këto vërejtje dhe komente të cilat i konsideroj si produktive sa i përket transparencës. Deri tani nuk kemi pasë Rregullore të tillë por me transparencë nuk është se jemi keq, jemi një ndër komunat e para sa i përket nivelit të transparencës. Ekziston një dallim mes grandit të performancës, dhe për ta fituar grandin e performancës janë dy kritere të cilat janë eliminuar, njëra prej tyre është edhe raporti i kualifikuar i Auditorit ku në rast se raporti i Auditorit është i kualifikuar nuk mund ta përfitosh grandin e performancës po që se edhe nëse krejt indikatorët që lidhen me performancë i ke 100%, kështu që fatkeqësisht Komuna e Podujevës në dy vitet e fundit veç e ka pasë një raport të kualifikuar të Auditorit gjë që na e ka pamundësuar edhe të jemi përfitues në grandin e performancës, kurse arsyet pse raportet Auditorit Gjeneral kanë qenë kualifikuar i dimë, kështu që vetëm deshta të jap këto sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës debati përfundoj, andaj fillimisht e vë në votim Draft Rregullore për transparencë e komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, Njëzëri me 27 vota Për, miratohet Rregullorja për Transparencë e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim Draft Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, Njëzëri me 27 vota Për, miratohet Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, dihet që për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore formohet komision, tani është edhe konkursi i shpallur. Këtu prezent e kemi edhe drejtorin e DKA-së z.Avni Fetahu i cili do na i jap sqarimet e nevojshme për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, para vetes keni një propozim vendim për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës.

Edhe dje në mbledhjen e Komitet për Politikë dhe Financa u kërkua një sqarim për të cilin u zotova se do ua sjellë sot, bëhet fjalë për Rregulloren nr.19/2024, që është votuar vitin e kaluar ku neni 14 te përbërja e komisionit përzgjedhës paragrafi 8.1 thotë qartë që dy anëtar të Komunës të cilët propozohen nga DKA-ja dhe miratohen nga kuvendi komunal. Anëtar i parë është i punësuar në Drejtorinë e Arsimit ndërsa anëtar i dytë i propozuar nga DKA-ja mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e arsimit, pra ky anëtar i komisionit shkon përtej i punësuar në DKA dhe njëherit është edhe kryetar i komisionit.

Pra Rregullore zbatohet në të gjitha komunat, andaj kërkohet mbështetja juaj.

z.Bahri Blakçori, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, e përkrahim këtë propozim vendim për të cilin drejtori i DKA-së z.Avni Fetahu i dha sqarimet në detaje.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, siç e thash edhe dje në mbledhje të KPF-së, unë nuk përkrahi komision që nuk më jep llogari mua në Kuvend. Nenin të cilin e shpjegoi drejtori i DKA-së unë e kam të shtypur këtu, dhe ai e lexoi ku thotë njëri prej drejtorëve duhet të jetë drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, e unë i nderuar drejtor e kam parë drejtoreshën që e ke përcaktuar ti dhe na trego ti performancën e saj, përndryshe në nuk mendoj që është me performancë të lartë, ne të gjithë këtu jetojmë dhe e dimë, por nëse drejtori e ka zgjedh komisionin që i përgjigjet personalisht këtij dhe i bën përzgjedhjet ashtu siç e dimë ne që i bën përzgjedhjet këtu, votat i ka dhe le te votojnë, kurse ne jemi kundër.

Unë nuk votoj kësi komisioni të cilit i thotë z.Avni Fetahu, këtë e atë ke për ta zgjedh drejtor, pra që i përgjigjet këtij. Ne po e dimë sa është degraduar arsimi dhe çfarë drejtorësh në shkolla kemi, unë i përkas gjeneratës së mesme dhe me drejtorët e shkollave që i kam pasë edhe kur takohem në qytet skuqem prej tyre dhe me kokën ulur iu flas, e jo tani siç janë dy ose tre drejtorë që i njohë më shumë, po çfarë drejtori është ai i shkollës teknike, ai është edhe servil i asambleistit z.Kasib Bashotës (mbytet duke i bërë like e komente), çfarë drejtori është ai, përndryshe nuk do e kisha lënë drejtor kurrë, hajde po të jetë servil i drejtorit të DKA dhe i Kryetarit të Komunës, por edhe i asambleistit z.Kasib Bashota, ku kemi shkuar ne medet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Ekrem, nuk do të doja me ra në atë nivel dhe të merremi me atë temë asnjëri prej nesh se kush kujt ia bën like ose komenton.

z.Burim Hasani, theksoi, edhe ne si pjesë e Grupit të AAK-së e përkrahim propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me këtë pikë, nga parafolësi drejtori i DKA-së u thirr në një Rregullore për përbërjen e komisionit dhe u komentua në një formë njëherë nga drejtori që u lexua neni 8 pika 1 dhe njëherë nga asambleisti z.Ekrem Rrahmani, po i njëjti nen u citua, dhe në një formë atë që dëgjova prej drejtorit të DKA është e vërtetë që ashtu shkruan dhe të jemi të qartë për opinionin se me këtë nen parashihen tri mundësi dhe njëra prej mundësive që na është propozuar neve të zgjedhet drejtori i institucionit arsimor me performancë të lartë, e që në rastin tonë konkret është vepruar kështu, mirëpo ky nen i parasheh edhe dy mundësi tjera që janë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim ekspert në fushën e arsimit dhe ekspert i pavarur. Në dy rastet kemi anëtar të komisionit individ për të cilët pa dashtë të hyjë në kualitete personale të tyre sepse nuk është çështje e imja ajo, që të dytë janë llogaridhënës të DKA-së, dhe me vetë faktin që ata janë llogaridhënës para DKA-së i zbehë kredencialet e tyre që të jenë të pavarur në vendimmarrje.

Edhe dje në KPF, edhe sot në këtë mbledhje por edhe në vitin e kaluar kur e kemi pasë këtë temë unë mendoj që derisa në pikën paraprake të gjithë e patëm fjalën qeverisje të mirë dhe për një qeverisje të mirë, transparente e llogaridhënëse, mendoj që njëri prej anëtarëve të komisionit të jetë jo në vijë të drejtpërdrejtë të llogaridhënies së DKA-së, e që këtë mundësi ligjore kjo Drejtori e ka sepse i është mundësuar me ligji e që jemi në rregull, mirëpo unë atë e fola që përse po i anashkalojmë edhe dy mundësi tjera që i ka paraparë Rregullorja, mirëpo sigurisht këtu vendimmarrës është drejtori i DKA-së, ai e ka paraparë kështu kurse në dorën tonë është ta mbështesim këtë vijë të tij apo ta kundërshtojmë.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku mirë e sqaruat por të keni parasysh faktin që edhe në vitin e kaluar e kemi propozuar Kryetarin e Këshillit të Prindërve dhe nuk e keni votuar, madje e pata përmend atë fjalimin e famshëm që edhe Bill Gates me sjellë ju

nuk e votoni, kurse tani e kemi propozuar një drejtoreshë që ka një performancë të mirë për ne, ka një përvojë të gjatë mbi 20 vjeçare në fushën e arsimit, dhe konsideroj që edhe në vitet e ardhshme do e provojmë edhe këtë ekspertin e pavarur se qysh janë duke shkuar punët mirë jemi duke shkuar dhe vitin e ardhshëm e provojmë edhe këtë e që do shohim a do ta votoni.

Ndërsa e ndjej obligim për herë të parë të flas për një drejtor që është drejtori më i përgjegjshëm në punën e vet, drejtori i shkollës teknike, andaj nuk është mirë të njollosen emra i nderuar z.Ekrem Rrahmani për arsye se është një nga drejtorët që ka performuar më së miri, ndërsa aktivitetin e lirë në Facebook e ka secili dhe nuk i'a ndalon as Mark Zucenberg, e kur ai nuk i'a ndalon, nuk mund t'i'a ndalosh as ti.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta nuk e merr drejtori i cekur si çështje personale këtë farë pune. Pastaj ta marrim shembull atë që drejtori i DKA-së e tha që këtë ekspertin e pavarur nuk mund ta emërosh më në komision, është sepse në vitin e kaluar e ke qitë në komision, të ka dëgjuar dhe ia ke dhënë orët duke e rehatuar menjëherë, e din ti drejtor ku e ke dërguar. Prandaj ti drejtor e dinë edhe atë që krejt këto unë i di sepse jam njëfarë “SHIKU”.

Kam një pyetje, pse drejtorët që t'i nuk i ke në qejf ata nuk guxojnë gjatë orarit të punës të bëjnë as like diku sepse ua kontrollon ti liket kurse e atij që të përgjigjet dhe të shkon për “tehu” ty nuk do të thotë që është i mirë për të gjithë. Sa i përket drejtoreshës në fjalë që e çekët, unë nuk e kontestova asgjë, vetëm thash na e sjell rezultatin e performancës së saj dhe sërish po të them sille rezultatin dhe thuaj është me performancë të larët nuk kam asgjë kundër dhe jemi në rregull.

Unë nuk e njeh atë as emrin nuk i'a di dhe as nuk dua t'i'a di, por unë dyshoj dhe e di që ashtu ndodh që nuk guxojnë ata me zgjedhë askënd drejtor të shkollës pa ju thënë ti drejtor i DKA-së ose Kryetari i Komunës, e dimë ku po jetojmë ne, ka ndodh edhe më parë kjo, është ka ndodh edhe tani, mirëpo nuk është mirë të politizohen shkollat sepse po shohim edhe rezultatin e Pisa tani çfarë po del, qoftë për neve që tani kemi këtu fëmijë në Komunën e Podujevës por edhe për gjeneratat e ardhshme që vijnë, andaj nuk është mirë as LDK, as LVV dhe as askush t'i politizojnë por tua lënë duart e lira. Lidhur me këtë po dua të marrë një shembull edhe pse ndoshta ndokush nuk dëshiron të përmendi, unë shkollën fillore e kam kryer në fshatin Gllamnik dhe a e din çfarë drejtorësh zotërinj ka pasë shkolla e Gllamnikut dhe në kënd ka ra tani, ka pasë me emra dhe ka pasë gjenerata në shkollë të Gllamnikut që janë dalë doktor shkence dhe nuk ka pasë shkollë më të mirë në Komunë të Podujevës, kurse tani në atë shkollë ka ardhë një drejtor që më mirë mos me fol për të hiq, krejt partiak, andaj mua nuk më pëlqen kjo farë pune, madje edhe në shtëpi po të fillon të qes diktaturë unë dal e rrebelohem sepse vet jam i asaj natyre.

Ti drejtor ndoshta po e merre si personale por unë nuk e kam personale. Unë e kam djalin në shkollë - në klasën e IX, planifikoj të regjistrohet në shkollën teknike dhe nuk dua unë që djalin tim të ma ndjekë ndokush ose një drejtor shkolle politikisht veç pse unë jam në tjetër parti, e them këtë sepse më ka ndodh një gjë e tillë me vajzën që ka qenë në Gjimnaz, edhe pse nuk më ka treguar derisa e ka përfunduar shkollën kur është regjistruar në fakultetin e mjekësisë nuk më ka treguar. Pra të ndodh që një nxënës t'i ketë të gjitha notat 5-she nga klasa e I-rë kurse në klasën e XI t'i'a lë dikush notën IV në lëndën e edukatës fizike, kjo po më dhemb, edhe pse ta zëmë nuk ka mund ta ndalë asgjë sepse është regjistruar dhe është në vitin e dytë në fakultetin e mjekësisë, por ka tjerë që nuk ia dalin dhe mbeten pa u regjistruar, prandaj duhet ta heqim politikën prej shkollave sepse nuk na duhet asgjë ajo farë pune.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sërish e them se nuk kisha dashtë të lëshohemi në emra se edhe ata drejtor kanë integritet, unë shumë prej këtyre drejtorëve i kam pasë nxënës dhe sidomos drejtori i shkollës teknikës është një drejtor shumë i mirë, besoni që nuk e di as në cilën parti është, por ai është një djalë i mirë dhe shkollën teknike e ka kthyer mbarë për këto vite sa është drejtor.

Ju them kushdo që përmendet në Kuvend të jemi të kujdesshëm se ata njerëz nuk na kanë borxh asgjë, edhe nëse janë të ndonjë partie tjetër ajo është e drejtë e tyre dhe këtu ne po flasim që 25 vite drejtorët kanë qenë partiak, unë kam punuar 37 vite në Gjimnaz dhe krejt drejtorët kanë qenë partiak, prandaj pse po flasim sot e po e bëjmë aq të madhe, është dashtë të ndalet më herët dhe shtrohet pyetja përse nuk e keni ndalë ju LDK-ja, por ju e keni mbështet dhe ata drejtor që kanë qenë me LDK-në sot janë bërë me LVV-në dhe janë drejtorë sërish.

Arsimin më mirë e njohë unë se sa drejtori i DKA-së, këtu u plaka në arsim dhe e di qysh shkon prandaj unë kisha dashtë që asnjë drejtor të mos jetë i përfshirë në parti politike, drejtori duhet me ardhë në DKA me jep përgjegjësi vetëm për punën e tij e jo për punën partiake, por për punën që e kryen në shkollë.

z.Naim Çunaku, theksoi, prej kur jam në këto ulëse as nuk kisha dashtë e as nuk jam lëshuar në emra të përveçëm në kuptimin për mua që diçka s'është e vlefshme që është relative që për tjetrin mundet me qenë e vlefshme dhe në këtë segment nuk e pranoj kritikën që po ia jep një epiteti se nuk jepet ajo kritikë. Mundohem fortë të kursehem dhe të mos përmend emra sepse fundja përshtrohet, emrin e kuptojmë që të gjithë mirëpo pasi dy emra i përmendi drejtori i DKA-së dhe ata s'janë shqiptar e që s'ju mbetet hatri që si përmendi unë, Mark Zucembergun themeluesin e Facebook-ut dhe Bill Gatesin themeluesin e Microsoft-it, i nderuar drejtor i DKA-së që dy herë i përmend por hiç nuk ke pasë nevojë të shkosh aq larg sepse po të na provonit neve se a do t'i votonim apo jo, vetëm po të ishte më dorëlibër që ta dëgjoje edhe zërin e opozitës.

A të ka shkuar mendja i nderuar drejtor i DKA-së që kandidatin e parë dhe të dytë e propozon ti, ndërsa për kandidatin e tretë që kemi mundësi ta pyesim opozitën a e votoni Mark Zucembergun apo kemi ndonjë ekspert tjetër, e po që se ne nuk do ta bënim këtë atëherë do t'u jepte e drejta ty të thoni që ne nuk jemi bashkëpunues.

Sa i përket anës së rregullatives ligjore e thash edhe më herët dhe po e përmbyll tash se jemi plotësisht në rregull, kurse a është në rregull ashtu siç e keni paraparë ose jo nuk jemi kompetent për të fol ne, por jemi në rregull se Mark Zucembergun dhe Bill Gatesin ne do t'i votonim.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk desha të flasë për arsye se kolegu e tha në emër të Grupit tonë, por meqë janë 35 vite që vijë nga fusha e arsimit megjithatë po e ndjej obligim të flas.

Pajohem plotësisht me parafolësin që tha është mirë të rezervohemi te emrat për arsye se arsimit nuk është veç kur është LVV-ja në pushtet, arsimit daton edhe kur LDK-ja ishte në pushtet dhe e dimë mirë qysh LDK-ja i ka caktuar dhe emëruar drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e që unë jam kundër asaj forme. Unë me kolegun z.Ekrem Rrahmani njihemi moti për arsye se e kam pasë nxënës por drejtori i shkollës teknike vërtetë ka bërë ndryshime dhe për këtë po nisem nga nxënësit që janë shumë të interesuar, sot ka nxënës në shkollën teknike me të gjitha notat pesëshe dhe se kanë problem të regjistrohen sepse ai ka bërë ndryshim dhe transformim të asaj shkolle dhe unë jam ithtar i këtyre ndryshimeve në arsim për arsye se arsimin askush nuk e mer për ta dërguar në shtëpi por arsimit është i të gjithëve, nëse arsimimi shkon mirë përfitojmë të gjithë sepse shumica sigurisht kemi fëmijë nëpër shkolla fillore dhe të mesme.

Po ndalem tani te pika që është për ngritjen e këtij komisioni, është në të gjitha komunat e Kosovës, unë e kam edhe ligjin për arsimin parauniversitar nr.04/L-032, në të njëjtën kohë e lexoi edhe drejtori i DKA-së, unë po e lexoj edhe këtë ku thuhet komisioni i kryen punët dhe detyrat në pajtim me dispozitat e ligjit për arsimin në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, prandaj ky komision nuk mund të ndryshohet sepse anëtari i tretë caktohet prej MASHT-it, e MASHT-in nuk e udhëheqë LDK-ja, përndryshe ai anëtar do të vinte prej LDK-së dhe ne nuk kishim pasë problem për arsye se e parashih aspekti ligjor po ta kishte MASHT-in LDK-ja, pra anëtarin e tretë të komisionit e kish bë MASHT-i dhe nuk kishim pasë mundësi të bëjmë ndryshime.

Prandaj ato që janë në raport me aspektet ligjore është mirë të përkrahen nga të gjithë dhe natyrisht vërejtjet që kemi ose performancën që e ceku dikush ju them se performanca bëhet nga degët që vijnë, nga drejtoria e shkollës, DKA-ja, inspektorët e të tjerë dhe vie ajo që bëhet performanca e një mësimdhënësi ose mësimdhënësve në përgjithësi.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, i nderuari koleg z.Haki Rudari, nëse nuk ke mund ta kuptosh kolegun z.Naim Çunakun i cili nuk e tha që anëtar i tretë të komisionit që ta përzgjedhim ne, por e tha për anëtarin e dytë të komisionit. Edhe dje me drejtorin e DKA-së në mbledhje të KPF-së e kemi thënë se nuk kemi probleme me emra të përveçëm që janë pjesë e komisionit, edhe dje i thash drejtorit të DKA, edhe sot po e përsërisë që po bie në kundërshtim me kolegun zotëri Naim që nëse edhe Bill Gates propozohet me një vend që nuk duhet me qenë, nuk duhet të votohet pavarësisht kush është.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pa humbur kohë më shumë rreth diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës, e vë në votim këtë Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, sipas propozimit të Drejtorisë që e keni në materialin përkatës që anëtarë të komisionit të jenë z.Blerim Vllasa dhe znj.Bahrie Talla, kurse anëtar i tretë propozohet nga MASHT.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 25 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, me 15 vota Për, 10 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, miratohet vendimi për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendësdrejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës, sipas propozimit të drejtorisë që e keni në materialin përkatës që anëtarë të komisionit të jenë z.Blerim Vllasa dhe znj.Bahrie Talla kurse anëtar i tretë propozohet nga MASHT

3. Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

znj.Adelinë Stublla drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, këtu para jush do të shpалosim informatën për Shëndetësi që është sipas Planit të punës së Kuvendit ku për t'ju respektuar juve si këshilltar të Kuvendit komunal dhe për t'i njoftuar qytetarët mundohem të jem korrekte sipas Planit të punës së Kuvendit.

Dua të filloj me një falënderim të sinqertë për të gjithë stafin e QKMF-së, shërbimeve dhe njërive tjera përcjellëse, pastaj DSHMS-në dhe QPS-në të cilat së bashku po bëjnë një punë jashtëzakonisht të madhe ku falë përkushtimit dhe angazhimit të tyre po arrihen rezultate të jashtëzakonshme e që nga shërbimet që i marrin qytetarët ne pothuajse çdo ditë marrim mesazhe falënderuese nga ata që i marrin shërbimet dhe kjo është një dëshmi e suksesit që kemi arritur së bashku. Pra kjo pikë e rendit të ditës është një përmbledhje e punës së QKMF-së, urgjencës, radiologjisë, shërbimit shtëpiak, shërbimit për nënat lehona dhe fëmijët deri në tri vjet, mjekësinë familjare si dhe njësitet përcjellëse, puna në ambulanta e fshatrave dhe shërbimet e tjera përkatëse. Po ashtu janë përfshirë edhe punët që kryhen në sektorët e mirëqenies sociale, QPS dhe DSHMS, ku iniciohen projekte dhe kontrata të ndryshme me qëllim të përmirësimit të kushteve të shërbimeve shëndetësore, dhe pa dashur t'ju marrë shumë kohë po ndalem në disa projekte që janë iniciuar e disa të tjera që janë në fazën e inicimit.

Është realizuar projekti furnizim me rëntgen të shërbimeve radiologjike, është realizuar projekti furnizim me bombola të oksigjenit për nevoja të shërbimit të urgjencës, është realizuar projekti për

furnizim me dokumente mjekësore, është realizuar servisimi i pajisjeve laboratorike, është bërë furnizim me inventar nga kontrata e AQP-së, është bërë përgatitja e dhomës këshillimore për të sëmurët me sëmundje kronike, projekt ky nga Ministria e Shëndetësisë, pastaj është bërë inventarizimi i dhomës për edukimi dhe promovimin e shërbimeve shëndetësore në maternitet, është iniciuar projekti i renovimit të hapësirave të reja për sallën e infuzioneve. Është duke u punuar me intensitet të lartë Qendra rezidenciale për qëndrim ditor për të moshuarit, janë duke u rregulluar disa adaptime të dhomave për hemodializë ku janë blerë pajisjet dhe pritjet së shpejti të hapet Poliklinika Specialistike, është vu gurthemeli për Banimin e përballueshëm për raste sociale dhe për çifte të reja, projekt ky i mirëpritur nga qytetarët, mandej së shpejti do të fillojmë edhe me shërbimin e ri për edukimin dhe promovimin shëndetësor për prindërit e ri që besoj se do të mirëpritet nga qytetarët e sidomos nga çiftet e reja.

Pra në fund pres nga ju pyetje, vërejtjet dhe sugjerime, për të arritur sa më shumë përmirësime dhe avancime në shëndetësi dhe mirëqenie sociale për të mirën e qytetarëve të Komunës së Podujevës.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, kanë kaluar më shumë se një vit kur Spitali i Podujevës me vendime skandaloze u zëvendësua me një Poliklinikë Specialistike duke shkelur kështu premtimet publike në dy palë zgjedhjet lokale nga Kryeministri Kurti dhe Kryetari i Komunës që Podujeva do të bëhet me spital. Kur u mor vendimi për themelimin e Poliklinikës u paraqit këtu në Kuvend si nevojë urgjente por në realitet me tempon të cilën ju e jepet për funksionalizmin e saj po shihet që nuk paska qenë urgjente, por urgjente paska qenë mbulimi i dështimit të Spitalit.

Sot një vit pas themelimit të poliklinikës ndonëse objekti i ndarë për këtë qëllim që ekziston nga viti 2020 ende nuk ka një datë kur do të funksionalizohet kjo poliklinikë kur do të filloj dhënia e shërbimeve për qytetarët, a do të ketë staf specialistik, mjek specialistik, për shërbimet e premtuara pasi që siç dihet Kosova ka suficit të resurseve humane edhe si zakonisht që bëni ju e keni lënë në kohë fushatë të bëni filma siç e keni zakon pasi që për shëndetin e qytetarëve Llapjan nuk jeni duke u mërzhitur sepse po të ishit mërzhitë ajo do të funksionalizohej siç keni premtuar brenda dy ose katër muajve. Në fakt kështu i keni pasë fjalët ne si opozitë vitin e kaluar, saktësisht një vit më parë ku unë personalisht kam pasqyruar gjendjen shumë të rëndë të shumë Ambulantave të Mjekësisë Familjare nëpër disa fshatra të Podujevës që vërtetë ishin në gjendje të rëndë të mbyllura, të demoluara andaj besoj se në këtë informatë drejtoresha e DSHMS është dashur të na informoj në këtë Kuvend për gjendjen e tyre, a janë funksionale dhe a ofrojnë shërbime për qytetarët, është fjala për ambulancat në fshatrat Pollatë, Halabak, Herticë, Dobërdol.

Përndryshe unë personale nuk kam asgjë personale me drejtoreshën e DSHMS, mirëpo kjo pati me na dhënë informatë për shëndetësinë, e në fakt bëri veç falënderime.

z.Ragip Fetahu, theksoi, fjalimi i parafolësës ishte shumë i mirë dhe shumë mirë i shkruar, i lumtë atij që ta ka shkruar. Unë falënderoj publikisht drejtoreshën e DSHMS për bashkëpunimin me Kuvendin e Komunës, transparencën e saj dhe të gjitha informatat që jep para Kuvendit për punën që është bërë deri më tani. DSHMS me të vërtetë është duke bërë një punë të mirë, janë disa elemente kryesore të cilat më parë s'kanë qenë, e para është kujdesi paliativ si dhe kujdesi për gratë shtatzëna dhe fëmijët prej 0-3 vjeç për çka bëhet kujdesi shtëpiak e që është një risi.

Kur është fjala te Spitali apo Poliklinika, ju e dini që spitali është diçka imagjinate që është filluar në fushatë zgjedhore në periudhat e më hershme kurse Poliklinika është diçka reale që ka ndodh dhe së shpejti do të filloj punën ashtu siç i ka hije dhe ata njerëz të cilët kanë nevojë për të kryer shërbime natyrisht se ato shërbime do i marrin aty.

edhe një herë informata e drejtoreshës është informatë gjithëpërfshirëse, informatë reale duke u bazuar në kushtet dhe rrethanat në të cilat gjendemi ne.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, kam një pyetje për para folësin. kur pritjet të hapet Poliklinika.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuar Kryesues, unë e ceka edhe pak më par që me drejtoreshën e DSHMS nuk kam asgjë personale dhe e kam mike sepse jemi njohur kohë më parë dhe mendoj që të dyja ne jemi për të mirën e qytetarëve dhe që po mundohemi për të mirën e qytetarëve, mirëpo këtë herë debatin e kam me kolegun parafolës z.Ragip Fetahu për të cilin unë do të bëjë kërkesë personale te Kryetari i Komunës që në vend të znj.Adelinë Stublla të emëroj zotëri Fetahun drejtor të DSHMS-së.

E dyta, i them zotëri Fetahut, ulu burrë aty te drejtorët se ti po fol e këta veç po rrinë, madje ti fol e na jep përgjigje.

Së treti, nuk dua të hyjmë në personale me ty i nderuar kolegë, sepse ti e din shumë mirë se ne njihemi mirë, andaj mos ma luaj ti rolin e avokatit, a je infermier, a je doktor. Ka kush jep raportime mjekësore, nuk je personi adekuat ti i nderuar, ashtu siç nuk jam unë dhe qysh veproj kur ti del flet për sociologjinë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, unë thjeshtë veç e falënderoj parafolësen kolege zonjën Tringa për vlerësimin që po ma bën.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Ragip nuk kemi nevojë t'i kthejmë gjërat në personale sepse siç po e shohë unë debati po donë të kaloj në debat shakaje, e nëse doni të bëni shaka mund të bëni pas mbledhjes ku mund të dilni për kafe sepse po silleni si në kafe.

z.Ragip Fetahu, theksoi, vetëm një sqarim i nderuar Kryesues, unë nuk jam duke bërë shaka dhe atë që e them e them me shumë seriozitet dhe bazohem në fakte dhe argumente, andaj ju kisha lutë Kryesues që herëve tjera mos tentoni me ma ulë nivelin e diskutimit që e bëj.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, nuk e ulëm ne nivelin e diskutimit i nderuar Kryesues, por kolegu zotëri Fetahu ia filloj diskutimit duke më thënë, kush ta ka shkruar fjalimin, e andej, kënde, e që mendoj ky krejt rolet po i merr, krejt epitetet, pastaj po i vie inat kur po ia cekim disa gjëra, kaq.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pasi që nuk jam i fushës dhe veç se foli parafolësja kolege e imja në emër të Grupit, unë drejtoreshën e DSHMS-së e përgëzoj që vjen dhe e bënë mundin dy herë në vit dhe e sjell raportin këtu në Kuvend edhe pse kolegët e saj, përjashtoj drejtoreshën e DBPZHR-së, të tjerë nuk vijnë të raportojnë asnjëherë në Kuvend.

Janë disa pika që unë kisha dasht pak më gjerësisht t'i shpjegoj në lidhje me disa tender goxha të mëdhenj që i kam parë edhe në raport të free-balancit, 80,000.00€ për radiologji, ose janë aparatura shumë të shtrenjta ose diçka tjetër sepse ka plotë që kanë thënë se në radiologji mungojnë gjërat elementare dhe janë disa mirëmbajtje të klimave dhe nxemjeve qendrore, por që te ana profesionale nuk do të hyja.

Kolegu z.Ragip Fetahu i përmendi dy çështje, njërën e ceku se Spitali ka qenë imagjinar, nëse ky e ka dëgjuar mirë, e që unë e kam këtu edhe video incizimin që Kryetari i Komunës ku ka thënë në të gjitha studiot dhe programet televizive që menjëherë brenda 6 muajve do ta bëjë Spitalin, e ashtu siç është imagjinar është dashtë atëherë t'i thuash atij publikisht, e besoj se ky e ka dëgjuar incizimin, nëse jo mund t'ia lëshoj nuk ka problem.

Po ashtu u cek edhe kujdesi paliativ për të cilin tha, është e vërtetë që tani është një risi e re në shëndetësi, mirëpo nuk është veç në Komunën e Podujevës, është në gjithë Kosovën tash, përndryshe drejtoreshën e falënderoj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit zotëri Ekrem, edhe një herë po ju them s'kisha dashur ta kthejmë debatin në personale. E unë e falënderoj drejtoreshën e DSHMS e cila prej krejt stafit të Ekzekutivit është më e rregullta, tani sa jeni të kënaqur me raportin e saj disa i shprehët.

znj.Adelinë Stublla drejtoreshë e DSHMS, theksoi, faleminderit i nderuar Kryesues, faleminderit prej të gjithë atyre që më lavdëruan dhe atyre që më kritikuan, i marrë për bazë të gjitha dhe më

vjen mirë prej disave që na bëtë me qeshë pasi që po kalon një periudhë kohore goxha e gjatë e pastaj po kalon në monotoni, por si do që të jetë faleminderit prej të gjithëve.

Sa i përket asambleistes zonjës Tringa që i ceku disa problematika në shëndetësi e që ajo mendon se ato janë, ne i marrim ato për bazë e besoj që zgjidhen. Te çështja Spitalit u tha jo u bë, jo s'u bë, por ju jeni dëshmitarë të kohës së mëhershme që i keni prerë shiritat me vite të tëra në kohë të fushatës kurse tani Spitali që është në oborrin e QKMF-së, ne tashmë e kemi në shfrytëzim për specialistikë, për radiologji dhe për nevojat tjera, administratë dhe shërbime tjera përcjellëse, kështu që ne atij Spitali që veç po e quani kështu, nuk ia kemi pre shiritin por pritet së shpejti për me ia pre shiritin Poliklinikës, e besoi që brenda muajit do të hapet, janë në procedurë të adaptimit disa pajisje dhe disa pengesa teknike që operatorët kompetent nuk i kanë rregulluar, kështu që tash ne vetë po duhet t'i rregullojmë ato adoptime të dhomave të dializës, kurse ti e nderuar je daktreshë dhe e dinë se si shkojnë ato pajisje dhe ato adoptime.

Po ashtu sa i përket ambulantave që the se janë në gjendje të tmerrshme, kisha pasë shumë qejf të ma dëshmoni këtë çështje, ambulanta e Pollatës punon dhe aty është motra medicinale, pra punon rregullt, kurse mjeku shkon dy herë në javë, mandej në Herticë gjithashtu, kurse në Halabak pati bërë goxha do buja mediatike por realisht ajo është e mbyllur për shkak se e përmendëm edhe çështjen e shërbimit të palativ i cili punon deri në ora 23:00 dhe po bënë një gjithë përfshirje jashtëzakonisht të madhe të të gjithë banorët e Komunës së Podujevës dhe kështu edhe ajo pjesë e komunitetit nuk po qëndron larg kontroleve mjekësore.

Sa i përket asamblistit z.Ragip Fetahu, faleminderit zotëri Ragip që i the gjitha ato sa i përket shëndetësisë. Po ashtu zonja Arnisa bëri pyetje kur hapet Poliklinika e që veç se e ceka, ndërsa të falënderoj zotëri Ekrem Rrahmani të vlerësimin tuaj, e vlerësoj shumë atë që e ceke, por për pyetjet e tuaja sa i përket çështjes së kontratave që i ceke për punën e radiologjisë e kemi blerë aparatet sepse ka qenë i stërvjetruarë dhe tash veç se e kemi aparatet e ri, kurse për mirëmbajtjen e klimave realisht ato në momentin që blihen, normalisht që dëmtohen, prishen dhe nevojitet servisimi i tyre, ndërsa për punën e shërbimit palativ nuk qëndron fakti që është në të gjitha komunat e Kosovës, është një shërbim që ne vetëm e themi por realisht qytetarët po na falënderojnë që po ju kryen punë për çdo ditë ai staf i mrekullueshëm që është.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e falënderoj Drejtoreshën e DSHMS e cila besoj ishte shumë e qartë dhe i bëri përgjigjet për të cilat besoj që të gjithë pajtoheni. Raporti s'ka nevojë të votohet andaj vetëm ju falënderoj.

z.Valon Demolli, theksoi, veç desha ta ngrisë një shqetësim ngase ky djali (fjala është për drejtorin e DPUMM) nuk e di kush është, a është në cilësinë e qytetarit që po hyn e po del, unë nuk po e njoh këtë djalë që ishte këtu, andaj kisha dashtë me ditë kush ke ky. Shumë seriozisht e kam, nëse është qytetar i Komunës së Podujevës le të del në fund atje sepse atje në cilësinë e qytetarit duhet të ulet, e jo këtu. Unë nuk jam duke e njohur.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sqarim Valonit, i nderuar ky është drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe nuk kemi çka diskutojmë më shumë për këtë.

z.Valon Demolli, theksoi, për besë i nderuar Kryesues mendova që është qytetar dhe pata për qëllim t'i tregoj që duhet të ulet në fund në cilësinë e qytetarit, e jo këtu.

Kryesuesi i Kuvendit e Konstaton të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

4. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024 dhe atë; e dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, ri formulohet si vijon; Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ky është propozim i cili ka hyrë si pikë shtesë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF, andaj i'a kalojmë fjalën hyrëse drejtoreshës e DPKGJ.

znj.Saranda Stublla, drejtoreshë DPKGJ, theksoi, i nderuar Kryesues ju e prezantua këtë propozim vendimin, por kam vetëm një sqarim se nuk kemi të bëjmë me ndryshimin e Listës komplet por vetëm të parcelës të cilën e kemi si propozim për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim që periudha kohore ku shkruan afatshkurtër të bëhet afatgjatë, pra është parcela 202-3 me sipërfaqe prej 13 hektar e 71 ari e 57 metra që është në Zonën Kadastrale Lupç i Poshtëm.

Ky ndryshim që ka ardhë është në konsultim edhe me zyrën ligjore, pra do të thotë që të jepet me një periudhë më të gjatë kohore, vitin e kaluar ka qenë me periudhë më të shkurtër mirëpo nuk ka arritur të jepet në shfrytëzim. Ky ndryshim plotësim po bëhet se ne kemi menduar ta vendosim edhe në Listën e veçantë para se të miratohet mirëpo na ka ikë si detaj, prandaj kjo është perse tani po bëhet ndryshimi.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të L:VV-së e përkrahim këtë propozim vendim për arsye se konsiderojmë se është në interes të qytetarëve çdo investim që bëhet në Komunë dhe mendoj që ka efekte pozitive, prandaj në emër të Grupit i japim përkrahje këtij propozim vendimi për ndryshimin e afatit kohor për dhënie në shfrytëzim nga ai afatshkurtër në atë afatgjatë, dhe në të njëjtën kohë do të kalojmë në propozim që parashihet të formohet një komision në fund.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne edhe dje në KPF kur e trajtuam këtë pikë e shfaqëm qëndrimin e Grupit të LDK-së dhe edhe sot mendojmë që nuk mundemi tani të revidojmë një diçka që Kuvendi ka marrë vendim në muajin dhjetor të vitit të kaluar, aq më keq kur përmendëm kriteret për dhënien e një prone në shfrytëzim dhe u nisëm prej kriterit të ligjshmërisë, interesit publik e një kallaballëk kriteresh që i përmban, dhe sot në një formë deri sa kemi hasë konkretisht në një pronë e cila ka qenë e paraparë të jepet në shfrytëzim për dhjetë vite dhe sot tentohet dhe provohet që t'i shtohet afati i dhënies në shfrytëzim afatgjatë që nënkupton deri në 99 vite, sot mendoj që kemi informacione të përgjysmuara që nuk na qartëson se si të vendosim, gjegjësisht si të votojmë.

Pa dashtë të përsërisë atë që në vazhdimësi po e citon shefi i Grupit të LVV-së, edhe ne kurrë dhe asnjëherë nuk kemi qenë kundër interesit publik dhe thash që në fillim të seancës që jemi ata që asetet e fjetura nuk e kemi komoditetin t'i mbajmë ne si Komunë, andaj atyre aseteve duhet t'i jepen mundësi të zhvillimit ekonomik, mirëqenies sociale, punësimit, ruajtjes së vlerës së tregut të pronës, mirëpo dilemat i kemi në atë pse u dashka t'i shtohet afati i dhënies në shfrytëzim nga ai afatshkurtër në afatgjatë, nuk kemi informacion, a kemi ndonjë të interesuar potencial, pastaj në fillim të seancës e patëm fjalën që kur pronat të shpallen për dhënie në shfrytëzim që të gjitha duhet ta ngërthejnë në vete një sqarim se për çfarë qëllimi jepen, kurse sot ne për një pronë që po bisedojmë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite, po bisedojmë për një pronë që na ndajnë vetëm edhe 10 ditë prej datës kur shkurtohet e drejta për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, me gjithë këto dilema ne na bënë që mos të marrim pjesë në këtë votim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, realisht t'i jepet dikujt prona në shfrytëzim për 99 vite është sikur t'i falet për 99 vite, i bie që jo fëmijët tanë por nipërit me ditë çka është bërë me atë tokë.

Gjithashtu nuk kemi as 5 muaj që kemi votuar që këtë pronë ta japim në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite dhe përse atëherë nuk është veçuar për me hedh në votim për me dhënë në shfrytëzim afatgjatë por tani, a mos ndoshta ka ardhë dikush e ka thënë për me marrë këtë pronë në shfrytëzim zgjateni afatin, apo ka ndonjë arsye konkrete sepse nëse ka dalë katër ose pesë vitet e fundit me radhë për dhënie në shfrytëzim në afat kohor për dhjetë vite dhe nuk e ka marrë askush në shfrytëzim, atëherë është dashtë të bëhet një analizë dhe të sjellët dhe votohet në vitin paraprak në Listë të veçantë për vitin 2025. Pra është dashtë të bëhet një analizë që të dihet pse nuk po merret në shfrytëzim ajo pronë ngase aty janë mbi 13 hektar dhe prona gjendet në vendin e quajtur Bugurdoll dhe atje nuk ka as rrugë të konvencionale, prandaj afati prej 99 viteve është shumë, kështu që unë jam kundër.

(Grupi i LDK-së, lëshon sallën me arsyetimin se nuk ka arsyeshmëri pse duhet të shtohet afati i dhënies në shfrytëzim nga ai afatshkurtër në atë afatgjatë prej 99 vite, si dhe nuk ka ndonjë sqarim a ka ndonjë palë të interesuar ta marrë atë pronë shfrytëzim si dhe për çfarë qëllimi do jepet prona në shfrytëzim).

z.Haki Rudari, theksoi, për momentin kemi mungesë të kuorumit dhe në të njëjtën kohë vendimet nuk janë në harmoni me ligjin, propozoi një pauzë prej 10 minutave e pastaj besoi që do të krijohet kuorum për vazhdimin e seancës.

Në mungesë të kuorumit, dhe në propozim të z.Haki Rudari, shkohet në pauzë të shkurtër rreth 10 minuta.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 15:00. Prezent ishin, si në vijim:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Donjetë Baliu; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

Nga PDK, Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Burim Hasani; Arbnor Fazliu; Mrika Thaçi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Po ashtu në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës; Saranda Stublla-Drejtoria e pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR.

Të pranishëm po ashtu ishin edhe media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e seancës, theksoi, kuorumi për punë dhe vendimmarrje tani ekziston andaj po vazhdojmë aty ku kemi mbetur. Për këtë pikë të rendit të ditës u diskutua mjaftë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim propozim vendimin përkatës sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga të gjithë anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Vendim për ndryshim plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024 dhe atë; e dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, ri formulohet si vijon; Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

5. Propozim Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona kadastrale Lupç i Poshtëm.

- Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës besoj që debati përfundoj, andaj së pari e vë në votim Propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga të gjithë anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani kalojmë duke e hedh në votim nënpikën e radhës Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone sipas kësaj pike të rendit të ditës, komision i cili përbëhet prej pesë anëtarëve, dy anëtarë vijnë nga përbërja e Kuvendit, dy anëtarë vijnë nga radhët e Ekzekutivit dhe një anëtarë nga Shoqëria Civile.

znj.Saranda Stublla drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, nga radhët e Ekzekutivit propozoj që anëtar të këtij komisioni të jenë z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh dhe znj.Adelinë Stublla, drejtoreshë e DSHMS, ndërsa sa i përket Shoqërisë Civile ne kemi bërë thirrje publike për aplikim dhe është sjellë një aplikim që është z.Shqipdon Rushiti.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, nga radhët e Grupit të LVV-së, përfaqësues në këtë komision e propozojmë z.Haki Rudari.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, nga radhët e Grupit të AAK-së, përfaqësues në këtë komision e propozojmë z.Burim Hasani.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë propozimet u dhanë dhe nuk ka të lajmëuar tjerë për të marrë fjalën, e vë në votim Propozim vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës-Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas propozimeve të lartcekura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga të gjithë anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës dhe propozimeve të lartcekura, dhe atë;

z.Haki Rudari, anëtar i komisionit, nga radhët e Kuvendit të Komunës

z.Burim Hasani, anëtar i komisionit, nga radhët e Kuvendit të Komunës

z.Bahri Selimi, anëtar i komisionit, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës

znj.Adelinë Stublla, anëtare e komisionit, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës

z.Shqipdon Rushiti, anëtar i komisionit, nga radhët e Sektorit jo-qeveritar lokal

6. Propozim Vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, të evidentuara si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimeh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

znj.Saranda Stublla drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, si propozim vendim e kemi edhe shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, të evidentuara si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimeh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Është një shkresë e AKP-së që ka ardhë dje pasdite dhe ka kërkuar që deri më datën 23 qershot t'ua dërgojmë një vendim nga asambleja komunale për shpallje në interes të përgjithshëm për t'i larguar këto prona nga privatizimi, andaj kërkoj mbështetjen tuaj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këto prona janë në interes të qytetarëve, banorëve të asaj zone por edhe në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, është një prej vendimeve më të mira që ka marrë Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi për shpalljen e këtyre pronave në interes publik sepse është kërkesë e kamotshme e qytetarëve për pastrimin e disa zonave, disa gërmadhve që janë në Kërpimeh, dhe me këtë vendim do të mundësohet pastrimi dhe mundësimi i komunitetit për shfrytëzimin e atyre pronave në interes të tyre e sidomos një prej modeleve që është Turniri i Futbollit për nderë të Dëshmorëve që organizohet çdo vit. Përse të mos shfrytëzohet për ndërtimin e një fushe më të madhe dhe më të përshtatshme për futboll e cila do të ndihmonte edhe komunitetin lokal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e vë në votim këtë Propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga të gjithë anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet Vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Pakashticë e Poshtme, të evidentuara si Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimeh, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

7. Të Ndryshme.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;
Enis Sheholli
Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0029231/25
Podujevë,
28 maj 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LV-të (pesëdhjetepesë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 26 qershor 2025.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; Donjetë Baliu, ndërsa mungoi Sebastina Vokrri.

Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Qëndresë Haliti; Fatmir Gashi; kurse munguan Arjant Topanica; Ilir Koprani; Tringa Sfishta.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; kurse munguan Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Adnan Zymeri; kurse mungoi Demokrat Hodolli

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMH; Shuajb Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR – LMT, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, para se të fillojmë me mbledhjes së pari konstatojmë kuorumin, për momentin të pranishëm janë 21 anëtar të Kuvendit që do të thotë është një numër i madh i anëtarëve të Kuvendit që mungojnë dhe arsyeja e mungesave po më duket se janë bërë shumë të padisiplinuar kohëve të fundit ngase 14 anëtar të Kuvendit të mungojnë është shumë, pra për momentin mungojnë; Fitim Muçolli, Artrit Mulliqi, Sebastinë Vokrri, Lirika Maliqi, Arjant Topanica, Donjetë Sheqiri, Ilir Koprani, Tringa Sfishta, Endritë Murati, Burim Hasani, Arbnor Fazliu, Gazmend Islami, Demokrat Hodolli.

Urdhëroni nëse dëshiron fjalën ndokush lidhur me rendin e ditës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, kam një propozim për shtimin e një pike të re në rend të ditës për shpallje në interes publik të disa pronave dhe këtë pikë po e paraqesim si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e seancës për arsye se me datë 26 qershor ka ardhë një shpresë nga ana e Agjencionit Kosovar të Privatizimit ku nga Komuna ka kërkuar që të tregoj se a është e interesuar

që këto prona t'i shpronësoj dhe në rast se Komuna dhe Kuvendi komunal nuk i shpallë në interes të përgjithshëm atëherë AKP-ja, këto prona i qet në shitje.

Me qëllim që këto prona të mos privatizohen por të mbesin prona komunale ku ka një interes të Komunës që këto i paguajnë vetëm me 20% të vlerës së tyre dhe të përdoren të interesit publik kërkojmë që ky propozim të inkuadrohet si pikë e rendit të ditës dhe këto prona të shpallen në interes të përgjithshëm në mënyrë që këto prona të kthehen në prona komunale dhe të shfrytëzohen për interes publik.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me propozimin e bërë nga drejtori i DBF-së, në emër të Grupit duke pasë parasysh urgjencën e vendimmarrjes dhe duke pasë parasysh interesin e Komunës dhe interesin qytetar që sa më shumë prona t'i kthejmë në pronësi të Komunës, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështet këtë propozim duke e arsyetuar edhe urgjencën e tij.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim që të futet si pikë e rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht si Grup LVV-së u nisëm nga parimi që propozimi i drejtorit të DBF-së duhet të vihet në votim dhe të mos ketë debat, përkundrazi s'jam kundër kësaj dhe në emër të Grupit e mbështesim këtë propozim vendim që të hyjë si pikë e rendit të ditës, natyrisht pasi të vihet në votim nga ana juaj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e vë në votim këtë propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik-pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështetet propozimi i paraqitur nga drejtori i DBF, për përfshirje edhe të një pike shtesë në kuadër të rendit të ditës, dhe atë:

Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi,

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit Konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas Thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për politikë dhe Financa, si dhe pika shtesë e mbështetur në fillim të kësaj mbledhje sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në fillim, dhe atë:

- Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

Rendi i miratuar i ditës:

- 1.Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2026/2028.
- 2.Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.
- 3.Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti Furnizim me mekanizëm bujqësorë.
- 4.Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri Në Bashkësi-KKSB për vitin 2024.
- 5.Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 datë 18.04.2025 për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Kërkesa e MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025.
6. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024
-Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
7. Të ndryshme

1. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2026/2028

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, një Komunë e zhvilluar në aspektin ekonomik dhe shoqëror është synimi jonë dhe korniza afatmesme buxhetore, financimet e planifikuara në këtë dokument buxhetor janë në funksion të realizimit të këtyre qëllimeve. Në këtë KAB janë të planifikuara investime në çdo sektor dhe në çdo lokalitet të Komunës së Podujevës, bazuar në Qarkoren Buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave, Komuna e Podujevës i ka këto limite buxhetore, pra për vitin 2026 ka një buxhet në vlerë 34,778,954.00€, për vitin 2027 ka buxhet në vlerë 36,640,812.00€, për vitin 2028 ka një buxhet në vlerë 38,453,975.00€. Pra në qoftë se e shohim në bazë të këtyre numrave kjo shihet që kemi një rritje progresive për çdo vit buxhetor në bazë të Qarkores së parë buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave.

Kjo Kornizë ka të planifikuar financimin e projekteve prioritare dhe të sektorit proritar të sektorit të Komunës së Podujevës, sektorë të cilët kanë rritje të ndjeshme të buxheti në rast se i krahasojmë me vitet e kaluara janë arsimit, shëndetësia, ekonomia, kultura, projektet infrastrukturore etj.

Në sektorin e arsimit në këtë kornizë buxhetore janë të planifikuara vetëm në investime kapitale mbi 7,000,000.00€ për tri vite, rritje e buxhetit në kategorinë e mallrave ku janë të planifikuara 3,500,000.00€ për tri vite, subvencione që janë bursa për studentë.

Në sektorin e arsimit janë të planifikuara shumë projekte me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe realizimit të mësimin në një ndërrim në gjithë territorin e Komunës së Podujevës dhe mësim gjithë ditor. Për këto normalisht që nevojiten shumë investime në shumë objekte arsimore dhe në këtë kornizë buxhetore janë të planifikuara këto projekte, vazhdimi i ndërtimit të shkollës së mesme teknike në kampusin e shkollave të mesme, ndërtimi i aneksit në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”, ndërtimi i aneksit të SHFMU “Enver Maloku”, ndërtimi i aneksit të SHFMU “Xheladin Rekalu”, ku për këto tri anekse ne si Komunë vetëm me bartjen buxhetore të cilën e kemi pasë nga të hyrat vetanake ku kemi planifikuar një buxhet fillestar dhe që vetëm kanë filluar procedurat e prokurimit mirëpo normalisht është e nevojshme të planifikohet buxhet në vitin 2026 për arsye se janë projekte që për me u përmbyll financiarisht duhet buxhet përtej asaj që është planifikuar për vitin 2025.

Investime në digjitalizimin e institucioneve arsimore ku janë planifikuar blerja e tabelave digjitale, renovimin e institucioneve arsimore, vazhdimi i ndërtimit të SHFMU “Nuhi Gashi” në fshatin Bradash dhe SHMU “Jetullah Gashi” në fshatin Dobërdol, anekse të shkollave në fshatrat Sfeçël, Kërpimeh, ndërtimin e shkollës në fshatin Lluzhan, aneksin në shkollën “Dëshmorët e Kombit”, anekse të shkollës në fshatrat, Sibofc, Gllamnik edhe ndërtimin e sallës së edukatës fizike në fshatrat Orllan, Kërpimeh, pastaj vazhdimin e ndërtimit të Kuzhinës Qendrore etj.

Shëndetësia si sektor jetik në kuadër të kompetencave komunale që ne menaxhojmë me sektorin primar shëndetësor i është kushtuar një vëmendje e veçantë, në fushën e shëndetësisë kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm për mallra dhe shërbime në mënyrë që ky sektor jetik të ketë të gjitha furnizimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve për qytetar, gjithashtu është planifikuar buxhet për renovimin e objekteve shëndetësore si dhe furnizim me pajisje mjekësore. Normalisht nuk kemi planifikuar buxhet për ndërtimin e objekteve sepse kemi konsideruar se ndërtimi i objekteve është rumbullaksuar gjatë këtyre viteve me ndërtimin e objekteve shëndetësore duke përfshirë këtu edhe Urgjencën e qytetit.

Në fushën e ekonomisë janë planifikuar projekte me rëndësi për zhvillimin ekonomik si fonde për ndërtimin e Zonës Industriale ku tani jemi në procedurë të prokurimit e besojmë që së shpejti do të fillon ndërtimi, pastaj Parku Teknologjik që prapë është një projeksion dhe një investim shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës, tregu i kafshëve, investimi për përmirësimin e infrastrukturës. Gjithashtu janë të planifikuara edhe subvencione 300,000.00€ për vitin 2026 me qëllim për rritjen të vazhdueshme të subvencioneve për bizneset prodhuese.

Në fushën e kulturës janë të planifikuara investime, ndërtimi i terreneve të reja sportive i dhe investimet në trashëgiminë kulturore, gjithashtu edhe subvencione për sport dhe kulturë.

Në bujqësi janë të planifikuara 700,000.00€ për subvencione dhe ndoshta për herë të parë kemi planifikuar buxhet për investime kapitale në fushën e bujqësisë ku në këtë Kornizë Buxhetore është planifikuar ndërtimi i parkut bujqësor industrial në fshatin Sfeçël si dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokës bujqësore ku kemi ndarë mjete të konsiderueshme buxhetore gjatë tri viteve 2026-2027 dhe vitin 2028.

Në fushën e infrastrukturës janë të planifikuara shumë projekte të rëndësishme si ndërtimi i rrugës nga Stacioni i autobusëve deri në rrugën e re lidhëse, ndërtimi i rrugës nga magjistrallja deri në rr.”Bedri Ahmeti”, ndërtimi i rrugëve; “Bajram Krasniqi”, “Besnik Restelica”, “Bedri Bajrami”, ndërtimi i unazës së qytetit, ndërtimi i rr.”28 Nëntori”, ndërtimi i kanalizimeve ku kemi fonde të konsiderueshme për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtimin e trotuareve, ndërtimin e infrastrukturës së varrezave. Po ashtu është planifikuar buxhet për ndërtimin e rrugëve në çdo fshat të Komunës së Podujevës ku çdo fshat është edhe në projeksionet e vitit 2026 dhe viteve vijuese, pra çdo fshat është i prekur në infrastrukturën rrugore.

Të nderuar, kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është në funksion të zhvillimit të projekteve zhvillimore dhe të investimeve në gjithë sektorët dhe në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, andaj ju ftoj që ta mbështesni.

z.Haki Rudari, theksoi, KAB paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion së bashku me prioritetet e komunës, ne si grup mendojmë që të gjitha këto projekte që janë në KAB, konsiderojmë që janë të rëndësishme dhe në të njëjtën kohë këto janë në interes të qytetarëve. KAB për vitet 2026-2028, së bashku me miratimin e buxhetit që do të bëhet në vitet që do vijmë në vazhdim arrihen edhe këto objektiva, përmirësimi i infrastrukturës në qytet dhe fshatra, krijimi i një qyteti me plan urbanistik, ngritjen e nivelit të arsimit përmes investimeve në arsim, zhvillimi i shëndetësisë së paku duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët, rritje e mirëqenies sociale, zhvillimi i kulturës, rinisë dhe sportit, përkrahje e

bizneseve të vogla përmes subvencioneve të ndryshme, zhvillimi i bujqësisë, të gjitha këto konsiderojmë që janë në interes të qytetarëve.

Nëse e përcjellim dhe e shohim tabelën e buxhetit të Komunës që pas Qarkores së vitit 2026/01, te të hyrat vetanake kemi një rritje nga viti aktual 1,986,336.00€ në vitin 2025, kemi të hyrat të cilat planifikohen 2,527,090.00€, po ashtu nëse e shohim totalin e buxhetit nga viti aktual nga shuma 33,459,115.00€, në vitin 2028 ky buxhet sipas KAB do të kalojë në 38,453,975.00€, prandaj po vërehet që është edhe ngritje e buxhetit.

Të nderuar koleg, nëse po ashtu po i shohim edhe prioritetet nëpër drejtori që janë në KAB 2026-2028 po ashtu kemi investime të shumta nëpër drejtori apo sektor të ndryshëm, Nëse e marrim Drejtorinë e Urbanizmit, kemi diku 50 vendbanime apo fshatra në Komunën tonë ku parashihet të ketë investime të ndryshme nëpër fshatra të ndryshëm. Natyrisht kërkesat ende janë të mëdha nga qytetarët por konsiderojmë se në këtë KAB i kemi 57 vendbanime të cilat parashihen investime, gjithashtu investime parashihen edhe nëpër Drejtorinë e tjera. Prandaj krejt në fund duke i parë të gjitha këto ne Grupi i LVV-së sigurisht që do t'i japim përkrahje dhe mbështetje të fuqishme kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot kur po e trajtojmë KAB-in sigurisht që kemi parasysh vizioni se ku do ta shohim komunën tonë për vitet 2026-2028, nga ato parafolësit që i vunë në spikamë investimet dhe objektivat e komunës vërtetë është e këndshme me dëgjua e në veçanti kur drejtori i DBF-së e përmend çështjen e arsimit, organizimin e arsimit gjithë ditë dhe sektorin e shëndetësisë diçka që vërej një mangësi në këtë KAB që i paraprinë buxhetit për vitin e ardhshëm po të hysh në përmbajtje sheh që shumë nga projeksionet janë vetëm të kopjuara apo copy paste e Kornizës Afatmesme Buxhetore e vitit të kaluar e në veçanti një problem shumë i madh në Komunën tonë, të paktën për ambientin nuk shohë diçka edhe pse është përmend planifikimi i infrastrukturës së shërbimeve publike, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit do të thotë diçka të përsëritur vazhdimisht e në veçanti e dini që në këtë kuvend më së shumë se një herë është diskutuar për çështjen e rregullimit të shtretërve të lumenjve në kuptimin e mirëmbajtjes së tyre dhe rrezikut potencial për vërshime. Mirëpo pa hy në detaje për çdo drejtori pasi dy parafolësit e shteruan atë çështjen e këtij KAB-i, mua si kryefjalë e gjithë diskutimeve gjer më tani ishte interesi i qytetarit dhe po të qasësh nga interesi i qytetarit automatikisht lind pyetja sa ka pasë qytetari qasje në përgatitjen e KAB-it, kur them se sa ka pasë qasje e dini se të gjithë jeni dëshmitar që komuna jonë ka parapa katër dëgjime publike në periferi dhe dy dëgjime publike këtu në sallën e këtij kuvendi dhe jemi dëshmitar të gjithë se çfarë pjesëmarrje të qytetarëve ka pasë dhe është për keqardhje dëgjimi i atij zëri i qytetarit se demokraci e ofruar nënkupton ofrimin e qytetarit në vendimmarrje.

Unë e di që posa ta mbaroj fjalën, dikush do të thotë që qytetarët s'po vijnë në takime publike por për me ardhë në takime duhet me bë atraktive pjesëmarrjen e tyre. Po e citoj një dokument një Udhëzim Administrativ mbi standardet minimale të konsultimit publik që në një formë ka qenë edhe i konsultuar kur e kemi pasë edhe Rregulloren për transparencë dhe këto elemente i kam parë aty dhe sa jemi me këtë në rregull dhe një prej dokumenteve që gjithqysh prioritet do ta kishte zërin e qytetarëve gjegjësisht kërkesat, ankesat dhe prioritetet që qytetari dëshiron t'i realizoj është si dokument që i paraprinë buxhetit është KAB dhe në një lokalitet si komuna jonë që kemi 78 fshatra dhe qytetin e të organizohen vetëm katër diskutime publike në rend të parë këtu mendoj që qytetari s'është ai që iu ka marrë mendimi.

Për mos me zgjatë shumë po e citoj vetëm një nen të këtij Udhëzimi Administrativ, neni 20 thotë mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik, Kryetari i Komunës siguron projekt propozimet e dorëzuara për aprovim Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës duhet t'i sheh të përmbushura standardet minimale të konsultimit publik, Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin nëse projekt

propozimet me rastet kur nuk janë përmbush standardet minimale të konsultimit publik dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

Nisur nga kjo duke pasë parasysh që mund të përmirësohet në kuptimin e buxhetit mendojmë që afatet ligjore që kemi deri më datë 30 qershor që do të miratohet kjo, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk do të jemi pro KAB me arsyetimin që një prej segmenteve kryesore ajo që e përmenda më shumë se një herë kryefjala për qytetarin ndërsa qytetari askund.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sot po diskutojmë për KAB 2026-2028, në KAB paraqiten shpjegime për politika dhe prioritetet që ka qeverisja komunale në shumicën e KAB-ve të miratuara edhe më herët prioritet iu ka dhënë infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, kulturës, problemi është sa janë realizuar projektet dhe prioritetet e KAB të miratuar në vitin 2023-2025 dhe a është bërë ndonjë analizë ku është bërë ngecje dhe cilat janë arsyet e mos përmbushjes së atyre projeksioneve dhe prioritetëve që i ka vënë qeveria. Kjo Kornizë është edhe para prirje e buxhetit e vitit 2026 dhe sipas qarkores buxhetore 2026, te grandit i përgjithshëm ishte shuma e njëjtë si në vitin 2025.

Më bëri përshtypje si nuk kish ndryshuar së paku një shumë qoftë edhe 10€ më shumë te grandit i arsimit ishin paraparë më shumë mjete se në vitin 2025 dhe kjo tregon që iu ka dhënë përparësi, edhe në shëndetësi patë më shumë mjete ndërsa projeksionet e buxhetit për vitin 2026 i kemi 34,778,954.00€, do të thotë është buxhet më i lartë se në vitin 2025 për 1,319,839.00€.

Unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam pasë një kërkesë dhe absolutisht pajtoj që KAB ka projekte të mira shumë të rëndësishme për qytetarët e komunës së Podujevës, por unë kam pasë një kërkesë për trajtimin e rr."Ulpiana 41", gjë që sot kam prit prej drejtorit të DBF që do të reflektoj mirëpo së paku nuk mund ta mohoj që në këtë KAB ka projekte të mira dhe ka projekte në të mirë të qytetarëve të komunës tonë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ato që i cekën kolegët nuk po i përmendi por më bënë përshtypje qysh janë caktuar prioritetet drejtor, edhe një fjalë që e keni pasë ju sa ishit në opozitë që e keni përmend më së shumti duke thënë pse po i fshihni projektet nuk po i tregoni ku janë emrat e rrugëve e që ekzistojnë, s'ka asnjë rrugë pa emërtim, shembull në fshatin Sibofc që po thotë 30,000.00€ për vitin 2026, këtë nuk e din askush kah shkojnë këto mjete por i zgjidhni ju votuesit e juaj e pastaj ua shtroni asfaltin deri te dera, nëse nuk është ashtu më trego cilat janë këto prioritetet në fshatin Sibofc.

Drejtori i përmendi edhe terrenet sportive, ne e dimë që ka qenë një kontratë dy vjeçare dhe si kanë shkuar punimet ne e dimë dhe ndoshta si deri më tani më nuk investoni, një fushë 40 metra gjerësi me 60 metra gjatësi me u bë tri vite e ajo fushë mos të ndërtohet në kurrfarë mënyre dhe tepër keq kjo veç te ne ndodh. E përmendi edhe te subvencionet që tha shtim të buxhetit edhe këtu kush i këqyr se kush po përfiton prej klubeve dhe prej OJQ-ve, është shumë katastrofë dhe tepër keq, kemi një shembull kur z.Faton Blakçorit ia jepni subvencionin në vlerë 5,000.00€ kurse këndej ia lëshoni lejen për ndërtim ndërtesa 17 katëshe, ai del për qytet dhe rrah gjoksin se kontribuova diçka kurse këndej subvencionet i merr e nuk ia len disa OJQ-ve që mezi mbijetojnë ose bëjnë diçka për qytet. Mos t'i përmendi të gjithë me emra se janë dy persona babë e djalë që s'ka vit që s'përfitojnë nga dy herë prej këtyre sendeve, ti rriti këto shuma për subvencionim veç pak me këqyr se kujt po ia japim këto subvencione a ça po bëjmë. Njëherë nuk e pashë ndoshta më ka ik se këtu nuk e pash dhe nuk nguli këmbë por para një viti unë e pata përmend që janë ndarë 200,000.00€ për vazhdimin e katit të tretë të objektit të komunës për një sallë të Kuvendit që e patëm përmend, ne nuk e dimë mandatin tjetër kush është këtu e kush nuk është, por mendoj që Podujeva e meriton me pasë një sallë të Kuvendit më të mirë se kjo, një mysafir me pasë kjo si plotëson kushtet sepse dikush me u ngritë në këtë sallë me dalë jashtë atëherë tre persona tjerë duhet të ngritën e t'ia lirojnë atij hapësirën për me dalë jashtë, madje e patëm rastin për ditën e

çlirimit ku nuk e dijmë se ku do të ulemi e për fat këta gjysma e anëtarëve të kuvendit s'janë të interesuar për me ardhë në atë mbledhje dhe po të vinin edhe këta atëherë ish dashur ata amerikanët t'i lenim përjashta, prandaj mendoj se do ishte mirë të parashihet ndërtimi i një sale të mirë të Kuvendit, s'ka lidhje kush është e kush jo por ne që jemi këtu me ia mundësuar atyre që vijnë më vonë me i pasë kushtet më të mira, me pasë një hapësirë pak më të mirë, ndoshta me marrë një model diku si ai në Shkodër që kemi qenë në vizitë ne dhe e kemi parë se çfarë kushtesh kanë në Kuvend, si zyra ligjore, sekretaria, kryesuesi dhe anëtarët e kuvendit, ka pika që mund t'i përmirësojmë por ka edhe mangësi.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, sot jemi përballë një dokumenti të rëndësishëm për zhvillimin e komunës pra KAB 2026-2028, ky dokument nuk është vetëm një planifikim financiar, ai është një reflektim i prioriteteve tona për vitet e ardhshme. KAB për komunën e Podujevës paraqet një dokument strategjik dhe udhëzues të rëndësishëm për planifikimin dhe menaxhimin e financave publike komunale në afat të mesëm, KAB bazohet në buxhetin e programeve dhe reflekton misionet dhe objektivat e secilës Drejtori komunale ku ndër objektivat janë zhvillimi i infrastrukturës urbane dhe rurale, hartimi dhe zbatimi i planit urbanistik, përmirësimi i arsimit, zhvillimi i sektorit të shëndetësisë etj.

Kemi pa shumë projekte siç janë zona industriale, zona bujqësore në fshatin Sfeçël, po ashtu në KAB në komunën e Podujevës është përfshirë një ndër projektet shumë të rëndësishme dhe të mirëpritura për komunitetin e fshatit Lluzhan dhe fshatrave përreth që është ndërtimi i shkollës së re të fshatit, një kërkesë dhe nevojë e kahershme tashmë është vendosur në agjendën zyrtare të investimeve komunale, ky investim madhor për arsimin do të nis në vitin 2027 me ndarjen e mjeteve në shumë 300,000.00€ dhe në vitin 2028 do të vazhdoj me një shumë tjetër prej 501,000.00€ duke e bërë të mundur realizimin e plotë të këtij projekti kaq të nevojshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit tanë. Ky projekt nuk është vetëm një ndërtesë e re por ai është një hap drejt përmirësimit të kushteve të mësimi si një garancë e ardhme e fëmijëve tanë dhe një dëshmi e qartë që edhe vendbanimet si Lluzhani janë pjesë e planeve zhvillimore dhe vizionit zhvillimor të komunës së Podujevës. E gjithë kjo ka pasur angazhim, përkushtim që zëri i Lluzhanit të dëgjohet aty ku duhet dhe është kënaqësi e madhe të shohësh që ky angazhim po i jep frytet e veta.

Faleminderit të gjithëve që kanë kontribuar dhe kontribuojnë në përfshirjen e këtij projekti në KAB e posaçërisht për mbështetjen dhe vullnetin e treguar nga Kryetari i Komunës dhe drejtori i DKA-së për ta bërë këtë projekt prioritet.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, elaborimin e KAB-it mendoj që në mënyrë të plotë e bëri drejtori i DBF-së, por unë më tepër po ndalem te disa vërejtje ose sugjerime që u drejtuan nga ana e asamblistëve e që lidhen duke filluar me vizionin e Komunës tonë për të ardhëm dhe mendoj që krejt ajo punë dhe angazhim që është bërë në këtë aspekt është që të shtyhen përpara ato projekte prioritare të cilat mendojmë që janë të nevojshme për Komunën e Podujevës në këtë periudhë kohore.

Nëse ndalemi dhe analizojmë mirë komplet këtë Kornizë, shohim që janë të mbuluara mirë thuajse të gjitha fushat e funksionimit të Komunës dhe sigurisht ka fusha që është fokusuar prioriteti paksa më i lartë gjë të cilën e potencoj edhe drejtori i DBF-së që kemi një synim që të avancojmë në veçanti në fushën e arsimit për të mund të krijojmë kushte të përshtatshme që në periudhën e ardhshme afatshkurtër të kalohet në mësimin tërë ditë në shkollë, gjë që kemi filluar edhe më herët dhe po besoj që viti në vijim do të jetë vit i cili do të përmbyll komplet këtë proces në mënyrë që të mos futemi e të bëjmë eksperimente të ndryshme e që kemi shembuj të cilat kanë ndodhë deri tani.

Shëndetësia mendoj se është relativisht mirë e mbyllur, te pjesa dërmuese e investimeve kapitale në infrastrukturë po mendojmë se qëndrojmë mirë dhe normalisht duhet të avancohen shërbimet dhe të fokusohemi te koncentrimi i një buxheti më të madh për rritjen e këtyre shërbimeve.

U përmend ambienti, faktikisht vitet në vijim do të jenë vite të rëndësishme qoftë në përmbylljen e kolektorit të ujërave të zeza që është njëri prej projekteve më kapitale e që besoj se në këtë aspekt do ta kemi përkrahjen edhe të qeverisë në realizimin e projektit të impiantit të ujërave të zeza, fabrikës për përpunimin e ujërave të zeza që besoj se është një prej projekteve shumë të rëndësishme që do të realizohet në të ardhmen. Sigurisht nuk do të mungojnë edhe investimet që do të bëhen qoftë prej Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorisë së Shërbimeve publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në zgjerimin e hapësirave publike gjelbëruese të cilat i kemi vazhduar dhe në këto vite edhe i kemi kaluar.

Sa i përket qasjes së qytetarëve në debatet publike, nuk është praktikë e tanishme, është një praktikë e mëhershme që na ka shoqëruar gjatë gjithë këtyre viteve, po them që ndoshta qasja nuk është krejt në mënyrën më të mirë të qasshme dhe ndoshta ka vend për të punuar ende, por mendoj që në këtë aspekt e kemi një detyrim të përbashkët qoftë pozitiv - opozitiv për të mund të siguroar përfaqësim më të mirë të qytetarëve e do të ishim shumë të kënaqur edhe ne që të kemi përfaqësim më të mirë sepse fundja për qytetarët po bëhen ato takime, për qytetarët po afrohemi tani në ato pikat të cilat janë planifikuar më afër qytetarëve për të mos i maltretuar ata të vijnë këtu, por ne po e shohim që edhe këtu në qytet kur po mbahen takimet nuk është që ka një pjesëmarrje shumë të madhe, mirëpo është shumë e rëndësishme që kontakti me qytetarë është shumë i mirë, thuajse është i përditshëm në baza ditore, zyra ime asnjëherë nuk është e mbyllur për qytetarët dhe në baza ditore edhe drejtorët e Drejtorive por edhe unë si Kryetar i Komunës po bëjmë përpjekje të jemi sa më afër qytetarëve dhe t'i marrim kërkesat e tyre, prandaj kërkesat dhe nevojat e qytetarëve po janë të përditshme dhe nuk është që ka mungesë të informacionit sa i përket përfaqësimit.

U përmend çështja e rrugës në fshatin Gllamnik konkretisht zgjerimi i asaj rruge, ne kemi një buxhet të caktuar për lokalitetin e Gllamnikut dhe besoj që ajo rrugë do zgjerohet me këtë buxhet, pra nuk do të ketë telashe dhe e kemi parasysh zgjerimin e asaj rruge dhe do ta bëjmë, përveç kësaj ju po e shihni që për çdo vit po kemi dhjetëra miliona euro me Memorandume që po i nënshkruajmë me Ministrinë e Infrastrukturës për këto qëllime, dhe disa donacione tjera, andaj rregullimin e asaj rruge unë e marrë përsipër i nderuar asamblist (z.Bashkim Sylja).

Pati disa vërejtje te subvencionet, tani subvencionet dhe këto ndihmat që po bëhen janë për klubet e Komunës së Podujevës, nuk ndajmë subvencionime për klube jashtë komunës së Podujevës apo për OJQ të cilat funksionojnë jashtë Komunës së Podujevës, mirëpo tani cilat klube marrin subvencione më shumë e cilat më pak varet si vlerësohen prej anës së komisionit dhe prej rëndësisë së projekteve që i ofrojnë ata.

Sa i përket sallës së Kuvendit të Komunës, është e vërtetë që kjo sallë as për së afërmi nuk i plotëson kushtet, por ne tashmë e kemi në proces të prokurimit dhe nuk e di sakt nëse janë iniciuar ende procedurat apo jo për fillimin e punëve për ngritjen edhe për një kat këtë objekt në mënyrë që të krijohen mundësi për zgjidhjen e këtij problemi sa i përket kësaj sale të Kuvendit sepse e përsëris se është e vërtetë që kjo sallë as për së afërmi nuk i plotëson kriteret, por duhet të keni para sysh edhe një fakt që edhe fillimi i punimeve në këtë renovim ose zgjerim të këtyre kapaciteteve brenda këtij objekti është goxha me rreziqe sepse me largimin e komplet kulmit në rast se do të ketë reshje atmosferike në atë periudhë kohore kur munden të fillojnë punimet, është rreziku shumë i madh pastaj të dëmtohen katet tjera sepse e dimë që shumica e këtij objekti është e ndërtuar me rigipspllakë në pjesën e sipërme dhe kontakti i këtyre pllakave me ujin paraqet rreziqe të mëdha, prandaj do na duhet një periudhë kohore e përshtatshme kur nuk mundemi ta rrezikojmë

komplet objektin sepse në rast se do të na paraqiten reshje atmosferike në atë periudhë të caktuar kohore kur fillon ndërtimi në këtë objekt, rrezikohet komplet edhe pjesët tjera të këtij objekti.

Unë ju lus që nëse keni ndonjë propozim konkret, apo ndonjë mangësi që mund të ketë kjo Kornizë sepse nuk e përjashtoj mundësinë që në ndonjë fushë mund të ketë ndonjë mangësi të caktuar, dhe ju si asamblast nëse keni ndonjë propozim konkret do të ishte mirë ta diskutojmë bashkërisht këtu, të gjejmë hapësirë dhe ta fusim brenda KAB-it si pastaj ta shtyjmë përpara si proces në mënyrë që t'i hapim rrugë procesit të shtatorit ku do ta kemi projektbuxhetin e ardhshëm të Komunës së Podujevës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, për vitin 2026 në fshatin Gllamnik janë ndarë 35,000.00€ për infrastrukturë e që nuk mjaftojnë për zgjerimin e asaj rruge, unë prita që po e ndani një shumë të mjeteve për atë rrugë, tjetër kërkesë nuk pata, nuk e bëra si propozim për ta vë në votim për shkak se besoj që kjo mund të rregullohet edhe me buxhet, kurse premtimi i Kryetarit ishte që ajo rrugë do të rregullohet, mirëpo me këto mjete ajo rrugë nuk mund të rregullohet. Tash ato mjete në cilin kod buxhetor i merrni dhe bartni kur dihet që ajo rrugë është shumë e ngushtë e cila është ndërtuar në vitet 2022-2023 nga Komuna në bashkëfinancim me qytetarë, rrugë e cila është shqetësim dhe paraqet rrezik për banorët dhe nxënësit e atij lokaliteti, prandaj nga ana juaj prita që po e ndani një shumë të buxhetit për atë rrugë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kjo Kornizë u lëvdua shumë që në fillim mirëpo unë u mundova në aspektin kritik me qëllimin e përmirësimit të KAB-it dhe në fjalën e Kryetarit dëgjuam nëse ka propozime konkret dhe që në fillim te qasja pozitive opozitive për dëgjimet publike me qytetarë shembullin më të mirë besoj që e kemi dhënë unë dhe kolegu z.Xhevdet Maloku se të dytë kemi qenë pjesëmarrës në dëgjim publik në lokalitetin nga vijmë ne dhe e kam përcjellë dëgjimin publik këtu dhe në të dy takimet tjera e që vetëm keqardhje ke mund të dëgjosh.

Tani shtrohet pyetja pse qytetarët po mungojnë në debate, unë para vetës pata një Udhëzim Administrativ sepse ky tregon rrugën që duhet ndjekur për të qenë një dëgjim me qytetar i suksesshëm, pra këtu janë 10 pika dhe nëse doni mund t'i lexoj, nëse veç paraprakisht dihet që për një dëgjim publik po e lexoj shpejt. Format dhe teknikat e një konsultimi publik përfshijnë dhe përkufizohen, takimet publike konsultative, konsultimet me shkrim dhe elektronike, publikimin në ueb faqen e komunës, publikimin në platformën e konsultimeve publike të qeverisjes së integruar si vegëz në ueb faqen e komunës, publikimi i platformës elektronike shtesë nëse janë aktive në komunë, konferencat, këshillat me grupe të caktuara të interesit, intervistat, hulumtimet e opinionit, panelet me qytetar, tendat në rrugë, takimet me këshillat e fshatrave që e dimë në çfarë gjendje e kemi, takimi me qytetarë lagje për lagje dhe konsultimet me shkrim dhe elektronik.

Pra do të thotë se nuk mund të shkojmë ne në një konsultim publik ku ka ardhë ai qytetarë që ka ardhë, del një X zyrtar i komunës dhe thotë buxheti kështu e ashtu, pa e pasë mundësinë ai qytetarë që ta ketë në dorën e tij paraprakisht një draft të atij dokumenti që të ketë mundësi pastaj të jap sugjerimet e tij, e që çfarë do që propozon ai qytetar sipas Udhëzimit në fjalë ai duhet të marrë përgjigje, e unë pyes kush merr përgjigje për atë gjë, e që mendoj se kjo ka bërë që qytetari të mos ketë interesim për pjesëmarrje në këto dëgjime publike.

Sigurisht që një projekt buxhet i tillë dhe mjetet e tilla, projeksionet për tri vite s'kanë se si mos ta ndryshojnë dhe si mos të kenë rritje se fundja çdo gjë e kemi thënë disa herë shkon në rritje dhe rritet edhe buxheti por formula për investime nëpër komuna nuk ka ndryshuar është e njëjta formulë, mirëpo unë kisha dashur që në këtë KAB të paktën edhe kësaj radhe mos të jetë zona industriale, parku i teknologjisë, e dini pse sepse i kemi më së paku qe 10 vite nëpër çdo KAB dhe hyni në 10 vjeçarin e fundit që keni me pasë planifikim këtë, kurse të mendojmë a ka një përfundim në mënyrë që të shkojmë me një projekt tjetër.

Këto ishin jo në kuptimin që ka munguar se kur kemi konsultim me qytetar s'ka pozitë opozitë dhe këtu prezent është drejtori i DBF-së, që kemi qenë dëshmitar që aq është larguar qytetari nga thënia e fjalës së vet që në takimin ku ishim ne së bashku dhe për atë pyeta edhe drejtorin e DBF-së edhe kolegun z.Xhevdet Maloku, ngase ata qytetarë kishin menduar që është takim i partive politike dhe thoshin çka i them unë votuesit kur del për këtë projeksion që s'është realizuar dhe si kemi votat ose i kemi votat. Unë them aq i kemi larguar në kuptimin që as qëllimin e takimit nuk e kanë kuptuar një pjesë e qytetarëve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Kryetari e tha se është infrastruktura e mirë, shpresoj unë me i pas sytë e këqinjë të magjistarëve po sytë e mi nuk shohin ashtu se infrastrukturë të mirë nuk ka, këto kompani që po i kryejnë këto punë të rrugëve sidomos janë shumë për keqardhje.

E përmendi edhe përfaqësimin e qytetarëve, qytetarëve duhet me ju shku zëri ose me u ec ndonjë projekt për me pasë ndonjë arsye për pjesëmarrje në takim ai qytetar, se përndryshe ai nuk vjen aty veç për pjesëmarrje me bë më kallaballëk e në fund mos me pyet askush asgjë nuk vjen. Unë në këto dëgjimet publike jam muduar të shkoj nga pak së fundi ishte dëgjimi në kuvend ishim vetëm tre vetë dhe atë dëgjim publik nuk e mbajtëm hiç vetëm ecëm. Te subvencionimi kryetari tha nuk janë nda subvencione jashtë qytetit të Podujevës, un i kam dokumentet, vjet dy shumat më të mëdhaja që janë shkuar, kanë shkuar jashtë Podujevës, njëra shumë ka qenë 15,000.00€, ka shkuar në Pejë dhe shuma tjetër prej 8,000.00€ ka shkuar në Prishtinë tjerat s'po i përmendi, nuk është që s'po shkojnë edhe te klubet që thatë i plotësojnë kushtet, i plotësojnë por tri vite radhazi një klubi me i dhënë 500€, e me i thënë ta kam jep një subvencion e tjetrit klub me ia jep 5000.00€, është njëfar dallimi. E di që krejt të barabartë nuk janë por mundesh një klubi me ia nda subvencion 1,500.00€, e të tjerëve nga 2,000.00€ ose 2,500.00€ e jo një ekipi 5,000.00€ tri vite radhazi e tjetrit 500€. Te propozimet që i përmendi në fund, ne e kemi përmend që për momentin ndoshta puna kryesore që duhet me u bë është zgjerimi i shtretërve të lumenjve, u bë një tentim shembull kemi lumin Dumnica ku deri në Sibofc janë bë punime kurse ka raste kur del një banorë i ndonjë fshati ju thotë mos ma prishni arëne mbjellur me misër këta i lënë punimet e këtu besopj që komuna duhet me pasë ndonjë mekanizëm mos me lënë as Ekremi me i pengu punimet nëse edhe murin e kam të ndërtuar në lum komuna duhet ta rrënoj e jo me lënë ashtu e pastaj ai lum me vërshu në dëm të qytetarëve për shkak të Ekremit që e ka vendos murin në lum ky ishte shembull, është dashur të ndahen mjete më shumë për zgjerimin e lumenjve dhe mirëmbajtjen e tyre.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, unë sa i përket KAB-it, nuk kam pyetje meqenëse kryetari tha nëse keni ndonjë propozim meqenëse është fundi i mandatit, nëse e kish bë këtë pyetje në fillim të mandatit i kisha propozuat të vijë më shpesh në mbledhje si tash nëç fund se po na merr malli me i pa drejtorët, meqenëse erdhe ti sot thuajse të gjithë kanë ardhë në mbledhje.

z.Ragip Fetahu, theksoi, më lejoni që së pari të kyçem dhe të jap opinionin tim në lidhje me dëgjimet publike pse qytetarët s'po marrin pjesë në to, nuk është përgjegjësi ose obligim i kryetarit, drejtorit apo personit kompetent ta sjellë dikë me zor ose ta shtyjë atë për pjesëmarrje, arsyeja pse qytetarët nuk marrin pjesë në takime publike përnjëmend dera e ekzekutivit është e hapur për të gjithë qytetarët çdo ditë prej orës 08:00-16:00, ku secili qytetar ka të drejtë t'i paraqes problemet, mendimet e tij se çka e preukupon atë. Ndoshta këto dëgjimet publike që po mbahen formalisht prej ekzekutivit mendoj që ne duhet të mendojmë mënyrën për t'i ndryshuar ato, njëri prej elementeve që mendoj t'i promovojmë është intelegjenca artificiale ku secili banor i një zone të caktuar mund ta pyes inteligjencën artificiale duke ia dhënë karakteristikat e fshatit të tij dhe ta merr një definim apo ide se si do duhej të dukej vendbanimi i tij dhe çka i mungon vendbanimit të tij dhe në këtë mënyrë do ta ndihmonte vetën, vendbanimin dhe ekzekutivin. Më lejoni që të fokusohemi në dy elemente, elementi i parë është zhvillimi i turizmit, është shumë pozitive që

potencohet zhvillimi i turizmit në komunën e Podujevës, ne e dimë që në të kaluarën kishim shumë probleme se po të na vinte ndonjë mysafir nga jashtë ne nuk dimë çka t'ju ofrojmë atyre. Prandaj na takon neve si ekzekutiv dhe si anëtar të kuvendit të identifikojmë objekte tradicionale shtëpi tradicionale të zonave, vendeve, vendbanimeve prej nga ne vijmë dhe t'i paraqesim ato në këtë mënyrë që drejtorja e linjës në bashkëpunim me ministrinë e linjës të fokusohen në investime në këtë drejtim, pra meremetimi i shtëpive, odave, mullinjve, objekteve të përgjithshme tradicionale. Elementi i dytë është digjitalizimi ky është një term i ri dhe është shumë pozitiv sidomos digjitalizimi i shkollave, sa pash në KAB është parapa një shumë prej 50,000.00€, në digjitalizim mirëpo mendoj që kjo nuk mjafton duke pasë parasysh zhvillimet digjitale që i kemi dhe orientimin e të rinjve që të fokusohen drejt digjitalizimit. Të mendojmë që të gjitha shkollat t'i pajisim me tabela të mençura tabela të cilat do të ndihmonin shumë si mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit. Po e them edhe këtë që KAB është veç një orientim, është mirë që ne të gjithë së bashku t'i japim orientim e ta përkrahim KAB-in dhe të votojmë për interes të përgjithshëm të komunës tonë në mënyrë që në shtator t'i japim mundësi vetës secili nga ne që me propozimet tona t'i inkorporojmë në buxhet të vitit të ardhshëm në mënyrë që ta lehtësojmë jetën e atyre personave që ne i përfaqësojmë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket subvencioneve, edhe njëherë po ju them se është një komision i cili i vlerëson se ku duhet të orientohen subvencionet dhe sa duhet të jenë përafërsisht shumat, ndoshta ka edhe klube të tilla që u përmenden me shuma 500€ por ata sigurisht pak a shumë e vlerësojnë edhe gjendjen financiare të tyre e që ndoshta dikush mund të jetë më i fortë financiarisht dhe ka nevojë të përkrahet më pak e dikush mund të jetë më i dobët financiarisht dhe ka nevojë për mbështetje më të madhe.

Sa i përket zgjerimit të shtretërve të lumenjve, ne tashmë jemi duke e hartuar një projekt dhe presim një investim për vitin e ardhshëm ndoshta në shumë 5,000,000.00€ që do të financohet komplet zgjerimi i shtretërve të lumenjve, pra jemi në hartim të një projekti por që vazhdimisht jemi në proces të prokurimit për shkak të ankesave të operatorëve e që ka kohë që ky projekt është në proces të prokurimit dhe nuk po ec si projekt sepse OSHP i jep të drejtën një konkurrenti që ka aplikuar me 50,000.00€, ne e kemi vlerësuar një operator që ka qenë me 19,000.00€ për atë projekt dhe këto pra janë ngecjet për shkak të operatorëve të cilët janë duke u shtyrë mes veti por që këtu pastaj fatkeqësisht është involvuar edhe OSHP-ja.

Disa herë u përmend çështja e një OJQ-je të Pejës, unë këtë vetëm po ua sqaroj juve si asamblistë por edhe qytetarëve, është e vërtetë që është financuar ai projekt mirëpo për herë të parë Komuna e Podujevës e ka në dorë një raport lidhur me projektet e gjeotrashëgimisë në nivel komunal, janë mbi 100 objekte të reja të gjeotrashëgimisë të cilat janë evidentuar, qoftë mullinj të vjetër, qoftë burime të caktuara, oda të vjetra, kulla të vjetra e të ngjashme, të cilat janë digjitalizuar dhe sot ne e kemi atë dokument dhe do të kërkohet nga Ministria e Kulturës Rinisë e Sportit që në të ardhmen të investoj në ruajtjen e këtyre monumenteve të gjeotrashëgimisë të Komunës tonë, prandaj ai projekt është hartuar prej një eksperti dhe nuk e di a keni informacion apo jo por është i vetmi ekspert në fushën përkatëse që ka punuar në hartimin e këtij projekti, projekt të cilin tani e kemi në dorë si institucion komunal, prandaj mos u mërzi tani sepse nuk kanë shkuar huç ato para dhe nuk janë keqpërdor por mendoj që është bërë një punë e jashtëzakonshme dhe sot e kemi një pasqyrë reale të objekteve të trashëgimisë në nivel të Komunës së Podujevës.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bënë përshtypje sugjerimet që z.Ragip Fetahu dha në kuptimin e ngritjes së vetëdijes qytetare, deri aty shkoj sa që na tregoi që përmes platformës së inteligjencës artificiale të kemi këtu konsultime por unë i them z.Ragip Fetahu për me përdor inteligjencën artificiale të paktën duhet me pasë atë natyrale që duhet me qenë i vetëdijësuar me qenë i ngritur

në atë nivel që me përdor atë inteligjencë dhe krejt në fund dua t'i tregoj z.Fetahu që në një seancë më parë që kemi pasë në këtë kuvend ka qenë njëri prej më të zëshmeve dhe ka pasë përkrahjen time kur ka qenë puna të konstituimi i këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe hapi i parë se komuna me banorët e vet duhet të ndërtoj komunikim vertikal se fundja edhe ligji mbi vetëqeverisjen lokale e parasheh që kompetencë e komunës është organizimi i nivelit lokal. Unë kisha pas dëshirë por me intelegjencë artificiale mund të merren nipat e mi por jo gjeneratat tona.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, kam edhe një pyetje qoftë për kryetarin apo drejtorin e DBF-së, u poencua edhe më herët mungesa e emrave të rrugëve të cilat planifikohen të shtrohen gjatë kësaj periudhe kohore po ashtu kërkova që specifikisht kemi me pasë kërkesat tona, kryetar, Arnisa pak më herët e përmendi që shumicën e kohës drejtorët nuk janë këtu prezent, ne në secilën seancë japim era rrugësh, kërkesa të qytetarëve dhe asnjëherë nuk marrim përgjigje qoftë verbalisht e as me shkrim. Këto projekte që janë për asfaltim që janë projekte bazë që qytetarët kanë nevojë e keni fut a jo ato projekte në KAB përndryshe nuk e di pse duhet me qenë në Dumnicë asfaltimi i disa rrugëve, pse mos me ditë edhe qytetarët se cila rrugë pritet të asfaltohet, pse të asfaltohet dhe ku ka nevojë më shumë, kështu që edhe ne po japim propozimet tona por nuk po e dimë se a po merren parasysh kërkesat tona.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ç'është e vërteta ndoshta edhe keni të drejtë ë këtë çështje, unë vetëm po ju tregoj një fakt që është në zyrën time ku e kam një listë që është përpiluar për ndryshim të emrave të këtyre rrugëve e sigurisht në atë listë janë mbi 600 kërkesa të cilat janë duke u trajtuar, disa janë aprovuar si mundësi për t'i sjellë në seancë të Kuvendit e që është një situatë kaotike në terren dhe fatkeqësisht të tillë e kemi gjetur dhe nuk kemi mund ende ta shtyjme përpara sepse në atë moment që vie kjo çështje në Kuvend me 600 propozime të ndryshme për ndryshim të emrave të rrugëve nëpër lokalitete ku shumë prej tyre kanë mbetur pa u krye si projekt sepse shumë prej atyre tabelave janë mbet në oborr të Komunës ku në fakt i kemi gjet këtu dhe vazhdojnë të mbesin këtu. Ju e dini se shumë prej tyre nuk i kanë pranuar qytetarët fare sepse ju janë imponuar prej Komune ose prej Kuvendi apo prej individëve të caktuar që nuk e di sakt dhe tani këtu kemi jashtëzakonisht shumë probleme në shumë lokalitete sa i përket emrave të rrugëve, prandaj puna e parë që duhet të bëhet për t'i hapë rrugë këtij procesi i cili do të ishte shumë i rëndësishëm për të gjithë ne është zgjidhja e problemit të emërimit të këtyre rrugëve sepse ka shumë probleme dhe për çdo ditë të Zotit ka shumë kërkesa për ndërrim të emrave të rrugëve. Projekti që ka qenë i lidhur mes Komunës dhe operatorit i cili nuk e di se kush ka qenë ai operator por që ka pasë për obligim vendosjen e tabelave të rrugëve, pra ka qenë projekt i përgjysmuar që kurrë njëherë nuk është kryer, të tillë e kemi gjet dhe i tillë ka mbet, prandaj do të ishte mirë të determinohen në teren cilat janë rrugët, por kemi shumë rrugë të cilat ende nuk kanë emër dhe nuk pastaj nuk ke si ta determinosh ose të determinohet me tjetër emër sepse tani qytetarët sjellin kërkesa për rrugë krejt me tjetër emër, por ka raste ku qytetarët e kanë tërheq krejt atë emër që i është vendos asaj rruge.

Janë shumë rrugë të shkurtra që kanë mbet sepse rrugët e gjata shumica thuajse kanë mbaruar si projekte, tani ta zëmë një rrugë është shtruar 300 metra dhe pastaj në atë rrugë janë shtuar edhe 4 apo 5 shtëpi të reja e që duhet ta përsërisim sërish emrin e të njëjtës rrugë që është zgjatur sepse kemi shumë raste të tilla në praktikë, prandaj ajo që është shumë e rëndësishme rrugët që po hyjnë në pozicionin rrugë, janë kërkesa të qytetarëve që po i bëjnë sepse qytetarët për çdo ditë drejtohen qoftë në DSHPMSh për rrugët çka lidhen me kocka, qoftë në DPUMM për asfaltime që vijë me kërkesa qoftë të lagjeve apo në raste të caktuara me kërkesa individuale, prandaj ato kërkesa po merren prej atyre qytetarëve dhe ata e mbajnë kontaktin drejtpërsëdrejti me drejtorët e Drejtorive për ato kërkesa të cilat normalisht se shikohen prej Drejtorive e ajo që po shikohet prej neve si

Komunë është numri i shtëpive, kjo ngase kemi kërkesë për rrugë ku janë 7 shtëpi, dhe kërkesë për rrugë me 2 shtëpi e që normalisht po mundohemi t'i japim prioritet asaj kërkesë që janë 7 shtëpi, pra ju e dini shumë mirë që nuk jemi duke i shikuar politikisht, dhe për këtë keni shumë shembuj të gjithë ju si asambleist por besoj që edhe të tjerët që kanë përfituar gjatë këtij procesi sepse nuk e kemi politizuar çështjen e rrugëve, nuk e kemi politizuar çështjen e infrastrukturës rrugore dhe fatmirësisht po përmbyllen rrugët, në fakt rrugët nuk përmbyllen asnjëherë sepse gjithmonë ka ndërtime të reja, ka kërkesa të reja, por nuk ka shumë të tilla që t'i politizojmë dhe të bëhen ndasi politike qysh e dimë fatkeqësisht që ka pasë në të kaluarën, por ndasitë e tilla nuk kanë qenë në këtë mandat tonin dhe nuk janë duke ndodh në këtë mandat, mirëpo me prioritet po mundohemi t'i bëjmë duke marrë parasysh faktin nëse është numri më i madh i shtëpive në lagje t'iu japim përparësi atyre në raport me ndonjë që mund të jetë edhe kërkesë individuale.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, u përmenden shenjat dhe emërtimet e rrugëve ndoshta ka qenë pak si kaos por në këtë mandat u bë pak më shumë kaos se jam në ngjarjeje dikush brenda këtu që e kanë atë përgjegjësi ju ka thënë njerëzve sillni nënshkrimet këtu dhe ka hy në gjeoportale e i ka ndërruar emrat e rrugëve, kur qytetarët tjerë i kanë pa këto ndërrime të emrave në gjeoportale ata janë shkuar e kanë heq atë shenjë dhe u bë kaos dhe nëse ka tjera propozime janë procedurat me i sjellë në kuvend me bë komisionin e me i ndjek procedurat qysh shkojnë ato me nënshkrime të shtëpive dhe me bë prej gjitha subjekteve politike komisionin e mos me i thënë dikujt kështu e dikujt ashtu se duhet me mbyll këtë çështje. Unë kam thënë këtu në kuvend po pak jam injoruar shembull kemi lumin Dumnica u hi dikush aty në gjeoportale dhe ia ka shkruar emrin lumi Lluga, tash kah po shkoj Lluga po më del, Naimi Lluga, kryetari Lluga, dikush ka hy e i ka ndërruar këto emërtime, këto janë bë në vitin 2025 do të thotë në këtë fillim vit se më herët këto nuk kanë qenë të ndërruara se aq sa mbaj mend unë lumi jonë është quajtur lumi Dumnica e tash në gjeoportale shkruan Lluga sinqerisht po them dhe aty pranë shtëpisë time ku kalon lumi aty shkruan lumi Lluga. Sa i përket rrugëve që thatë nuk i shikojmë politikisht nuk është ashtu që don ai me lënë ashtu është diçka tjetër por nuk është ashtu shembull ke tenderin e parë para një viti kur ka qenë shtrimi i disa rrugëve me kubëza ato i kam fotografuar që janë nëpër shtëpia të njerëzve ose militantëve të LVV-së, e kanë mashtruar aty këtu ndonjë të LDK-së që mos me bë ankese për ata të tjerët se e dimë ne. Ndoshta është keq me përmend por një axhë i imi ka ndërruar jetë i ndjeri sa ishte në karrocë kam bë disa herë kërkesë për rregullimi e një rrugica me gjatësi 50m dhe më kanë thënë po, po por ajo asnjëherë s'është shtruar, nuk është ashtu që janë plotësuar gjitha kërkesat e asambleistëve, nuk është ashtu, që doni me lënë ashtu e lëmë po nuk është ashtu.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë e di që parafolësi Ekremi gjithëherë ka paksa qejf të "fërkohet" me mua në diskutime, ne jemi të një ana/lokaliteti por nëse unë dhe asambleisti tjetër zotëri Naimi e paskemi atë potencial që t'i ndërrojmë emrin lumit të cekur atëherë ju e dini që unë jam pak profesionist i kësaj fushe dhe rrjedha ujore e merr emrin zakonisht aty ku e ka burimin andaj nuk ka logjikë t'i vendoset lumit Dumnica emri i ri siç u tha "Lumi Lluga" kur ai lumë veç kalon përmes fshatit Llugë dhe nëse ju mendoni që ne e kemi atë potencial, unë dhe Naimi që jemi nga fshati Llugë të kem mundësi të futemi në gjeoportale e të ndërrojmë emra të lumenjve ose vendbanimeve gabim e keni sepse gjeoportalin nuk e mbajmë ne, ne nuk kemi qasje në gjeoportale ashtu siç nuk keni qasje as ju, Komuna nuk e ndërron gjeoportalin dhe nuk ka shanse të ndërroj emra të fshatrave, rrugëve ose vendbanimeve në gjeoportale sepse sigurisht që ju e dini që është një softuer në nivelin qendror në Agjencinë Kadastrale dhe kjo nuk është në kompetencën tonë dhe askush legalisht prej këtij institucioni të cilin unë e udhëheqë nuk guxon të dërgoj diçka jo legjitime qoftë edhe një kërkesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për të bërë ndryshime të tilla, por nëse ndokush në këtë Agjencion e ka pasë atë guxim që t'ia ndërroj emrin e lumit nga

Lumi Dumnica në Lumin Lluga, atëherë unë nuk japë përgjegjësi për atë punë sepse nuk është në kompetencën tonën dhe nëse është ashtu siç u tha është mirë të denoncohet si rast sepse sa di unë gjeoportali nuk preket dhe qasja në të është e limituar, dihet në çfarë forme mund të bëhet një ndryshim qoftë i emrit të rrugës ose emrit të lumit apo cilit do objekt tjetër të rëndësisë së veçantë. Ndërsa politikisht, edhe njëherë po ju them shumë sinqerisht, unë mendoj që këtë më së miri e thotë opinioni publik në terren, nuk kemi të paktën një rast në publik që unë e di që politikisht me një arsye të caktuar ndokujt nuk i është bërë rruga ose kanalizimi pse ka qenë në këtë ose atë subjekt politikë, a e dini pse, sepse unë po luftoj t'i marrë edhe ata që edhe nëse nuk kanë qenë me mua, pra jam duke luftuar për me pasë mundësi me i kthye edhe ata dhe t'iu tregoj që unë punoj mbarë dhe është mirë me më përkrahë mua e mos me i përkrahë ata të tjerët që kanë punuar mbrapsht. Prandaj nëse dikush ka bërë gabime më herët, nuk jam shumë i interesuar t'i përsërisë të njëjtat gabime që i keni bërë ju më herët, kështu që këtë duhet pasur parasysh, pra lufta dhe puna ime është t'i bindë ata që nuk më kanë përkrahë, këta që më kanë përkrahë i kam pasë, dhe interesi im është me rritë dhe me zgjeru rrethin tonë të përkrahjes edhe si institucione komunale edhe si subjekt politik, prandaj unë nuk kam arsye t'i diferencoj njerëzit në kuptimin politik sepse fundja këto para të të gjithë qytetarëve të Podujevës dhe të gjithë e kanë të drejtën e barabartë të qasen e t'i shfrytëzojnë këto para.

Unë kam shumë kundërshtar politik që më kanë luftuar me çdo mjet dhe formë, por sot i keni investitor të mëdhenj që janë ardhë sepse i'u kam thënë, një muaj ju kam pasë kundërshtar, u kryen zgjedhjet, i kam fituar, ju kam mund dhe më nuk merrem me juve, andaj ejani punoni, punoni në interes të qytetarit, punoni në interes të Komunës sepse interesi im është kjo Komunë të zhvillohet. Kështu që kemi shumë shembuj që mund t'ua demantoj atë që po e thoni, për arsye se sërish po përsërisë që gabimet të cilat janë bërë më herët nuk dua t'i përsërisë, nuk po them që nuk gaboј sepse edhe unë mund të gaboј dhe të gjithë ne mund të gaboјmë, por jo të bëjmë gabime të qëllimshme për ta dëmtuar vetveten.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk fola rastësisht pa ditë se edhe Agjencioni Kadastral i ka pasë do punëtor këtu lartë dhe nuk e di qysh janë ardhë dhe unë s'dua t'i përmend me emra të rrugëve se i kam 3 ose 4 raste që emrat u janë ndërruar në gjeoportali, unë se di a ka të drejtë e si ka hy e ei ka ndërruar ata emra, unë këtë nuk e di dhe një gjë që se di s'merrem me atë por një gjë e di që emrat janë ndërruar dhe është bërë njëfarë kaosi, duke ju thënë sillni nënshkrimet dhe ata emra janë ndërruar e pastaj janë heq gjatë këtyre 4 ose 5 muajve kjo ka ndodhe dhe pas ankesave ato emërtime janë heq dhe i kanë lënë ato rrugë pa emërtime qoftë me emrat e vjetër apo të rinjtë e ka këso rrugësh plot se këto raste i di se i kam hulumtuar vetë. Për sa i përket asaj që thoni ua marrë votuesit e juaj, ruaj ata votues që i ke se mos po të ikin se nganjëherë duke tentuar të marrësh diçka të huajën e juaja ec se nuk janë të betonuar këta se krejt këta që janë në LVV, k[ta kanë ik prej dikujt e kanë ardhë në LVV por edhe kur të shohin ty që je duke punuar mbrapsht ikin këta se janë disa në LVV që kanë parime, njohë unë prej ditëve të para që kanë gjuajtur gurë e kanë bërë protesta e tash vijnë te ne plotë njohë edhe që më thërrasin por njerëzit bëjnë lëvizje, a po qeverisë mirë ose jo këtu ka shumë pikëpyetje. Nuk dua unë të hyj në disa sende por tregojnë rastet më vonë a po qeverise a jo se goxha njëfarë milioneri je bërë shpejt ti.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Ekrem jashtë temës nuk kemi nevojë të dalim. Tani po flas unë sa i përket emërtimeve të rrugëve, këtë e them me përgjegjësi sepse kam qenë anëtarë i komisionit së bashku me z.Naim Çunaku dhe z.Bahri Selimi.

Unë mendoj që emërtimi i rrugëve është bërë në mënyrë shumë të drejtë sepse komisioni ka shkuar në çdo fshat, ka pasë tubime në çdo fshat e jo takime si sot me nga 10 veta por ka pasë me qindra njerëz, këtu prezent janë z.Bahri Selimi dhe z.Naim Çunaku madje edhe z.Bashkim Sylja që ka

qenë në takim në fshatin Gllamnik ku hapësira e shkollës si ka zënë qytetarët të cilët i kanë bërë propozimet e tyre, aty ato propozime janë votuar dhe pastaj u janë vendosur emrat rrugëve.

Për rrugët e reja kanë qenë emrat në listën rezervë të cilët kanë mbet që në qoftë se bëhen rrugë të reja por nuk është punuar në atë drejtim, ata emra nuk janë shfrytëzuar dhe sot po çuditem që prej 1600 propozimeve kemi 600 propozime të reja dhe atë tani veç me nënshkrime e si t'iu besohet këtyre që kanë të drejtë, pra këtyre nuk mund t'ju besojmë që kanë të drejtë sepse atëherë në tubime ndoshta nuk kanë qenë prezent dhe tani ndoshta janë organizuar dhe kanë pasë përçarje brenda familjeve. Unë kam rast që më është thënë pse rruga është emërtuar me emrin e djalit të axhës e nuk është emërtuar rruga me emrin e djalit tim, rasti është për një rrugë në fshatin Gllamnik e që ata janë aq të afërt, por ndoshta sot njerëzit i kanë parë interesat e tyre të ngushta familjare personale dhe kjo na ka prurë në këtë gjendje që sot kanë mbledh nënshkrime dhe ato nënshkrime duhet t'i shikojmë kah kanë ardhë sepse nuk janë të asaj lagjeje, nuk janë ata persona që jetojnë aty, unë plotë nënshkrime kam parë që s'janë banorë të atyre lagjeve fare, ashtu qysh i kam parë nënshkrimet për një objekt tjetër në fshatin Obrançë që kanë nënshkruar njerëz që s'jetojnë në Obrançë fare, gjysma e tyre kanë nënshkruar mirëpo nuk jetojnë në fshatin Obrançë, prandaj duhet të nënshkruajnë ata të cilin e kanë problemin e tyre, e jo ata tjerët.

Ai komision i Komunës le t'i shikon pak më mirë kërkesat sepse unë nuk mendoj që 600 gabime i kemi bërë, përndryshe le ta demanton ndokush se është ashtu. Unë mund të flas më shumë se ka çfarë të bisedohet por po dalim prej temës pastaj, mirëpo vetëm desha t'ju japë një përgjigje sepse Kryetari nuk ka qenë atëherë në rrjedha të këtij procesi dhe tani mund ta informojnë gabimisht.

z.Naim Çunaku, theksoi, në kuptimin e emërimit të rrugëve, lagjeve dhe shesheve ka qenë një procedurë, një udhëzim administrativ që ka qenë i inkuadruar edhe Agjencioni dhe është bërë një punë goxha e madhe 6 mujore dhe për fatin e mirë qenkemi të pozicioneve të ndryshme politike mirëpo nuk po e shohë të arsyeshme të bisedojmë për këtë se jemi duke biseduar për KAB-in, por është e vërtetë e madhe që për ta ndryshuar një emër të rrugës që e ka emëruar kuvendoi duhet çdo njëri prej zyrtarëve të komunës që sot janë aty mos me ia bë rrafsh se dihet procedura si duhet të veprohet për emërtimin e një rruge, afatet kohore kanë qenë deri sa ka ardhë në kuvend.

Vendimin e Kuvendit kurrfarë komisioni i komunës nuk mund ta ndryshoj, duhet me ju tregu qytetarëve shumë qartë nuk ka dikush autoritet tjetër në shërbimin civil të Komunës së Podujevës që mund ta ndryshoj vendimin e Kuvendit komunal dhe ai vendim i Kuvendit komunal është votuar me vota unanime të gjitha subjekteve politike që kanë marrë pjesë dhe të anëtarëve të komisionit, nuk po them që është i pa prekshëm, nuk po them që s'ka pasë ndonjë ndryshim mirëpo llogariteni që në atë kohë më tepër se 1300 emra të rrugëve janë emërtuar dhe dihet procedura se si mundet me ardhë e të atakohet se nuk është ajo fontanë dëshirash se po ia vendosim emrin kështu ose ashtu, a ka pasë lëshime, ka pasë lëshime, sigurisht ndoshta nuk janë ardhë ata më meritoret por ai komision ka arrit që në mënyrë unanime t'i sjellë ato në kuvend dhe ky kuvend jo në këtë përbërje por ata që kemi qenë në atë përbërje me vota unanime të të gjitha subjekteve politike janë bë emërimet dhe nuk kemi aty interesa personale të individëve aty që mund t'i bëjmë, mund ta bëj dikush që konkretisht e sjellë në Kuvend si propozim ndërrimin e emrit të një rruge që u përmendke një rrugë me emrin Haki Rudari e ajo rrugë s'ka qenë hiq dhe qohet dikush propozon heqjen e emrit të rrugs së kolegut Haki Rudari ta zëm, e propozon në Kuvend dhe Kuvendi vendos që të hiqet ai emërtim dhe në vend të atij mund të bëhet diçka tjetër por nuk shkon procedura ndryshe qysh po thuhet me komisione e tabela sepse është keq që janë mbet tabelat aty.

I nderuar Kryetar, aty ka qenë organizata e GIZ-it në implementimin e saj dhe sa di unë ke zyrtar ende që janë duke u paguar prej atij Agjencioni, mirëpo kemi rrëshqit nga tema, ajo temë don një

pikë të veçantë të rendit të ditës dhe mendoj që duhet të trajtohet me arsyeshmëri e jo në këtë formën, bëri ky e bëri ai, sepse gjithmonë do të kem këso temash.

Po e përmbylli, në një shtet normal s'kish dashtë as në një legjislaturë që respektohet, askush t'i fus duart, dhe unë nuk mund të besoj sepse ato bëhen përmes Shtetit të Kosovës dhe ato emërtime edhe ndërkombëtarisht njihen, pra nuk besoj që mundet dikush të bëjë gjëra të tilla, por nëse ka arrit të bëjë atë atëherë ka bërë falsifikim sikur të bëhet falsifikim me monedhën 500€ e me hedh në treg, pra ka bërë vepër penale.

z.Haki Rudari, theksoi, kam qenë pjesë e atij intervali kohor 2013-2017, nuk e di a ka qenë viti 2014 apo 2015 kur është bërë një komision prej partive të ndryshme dhe nga radhët e LVV anëtar i komisionit ka qenë z.Bahri Selimi, ka qenë një punë e lodhshme e mundimshme jo e lehtë ka pas takime të shumta nëpër çdo fshat ku ka pasë kërkesa të shumta në çdo fshat dhe lagje, është përfunduar në mënyrë unanime, është votuar në Kuvend të komunës në vitin 2016 nëse nuk gabo. Tani te kërkesat e reja natyrisht që ka rrugë e shtëpi të reja por nuk mund të ndërrohet emri vetëm pse shkojnë disa nënshkrime e kam fjalën për ato emërtime që janë bërë me vendim të Kuvendit, ne jemi në përfundim të mandatit dhe nuk kemi kohë edhe nëse kemi dëshirë të merremi me këtë çështje tani, përbërja e re e Kuvendit sigurisht se do të merret me këtë çështje e tha edhe Kryetari sepse tani ka kërkesa të shumta për emërtime të reja por nëse ka ndonjë ankesë ai komision që do të formohet nga subjektet politike në fund do të votohet në Kuvend dhe mendoj që kjo është rruga ligjore, mirëpo po ashtu mendoj se nuk është mirë të dalim nga tema sepse në diskutimin kemi KAB-in, si dhe krejt në fund, këshilltari ka të drejtë për të njëjtën pikë të diskutoj dy herë dhe unë për herën e dytë diskutova.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj që debati u shter për këtë pikë të rendit të ditës, andaj e vë në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 të Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, 6 vota të Përmbajtura, miratohet me vendim Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas kërkesave nga disa prej anëtarëve të Kuvendit që të shkohet në një pauzë, Kryesuesi i Kuvendit i njofton të pranishmit se Kuvendi shkon në pauzë për 1 orë, dhe atë duke filluar nga tani në ora 11:45

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:20.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; Donjetë Baliu.

Nga LDK, Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Sylja.

Nga AAK, Mrika Thaçi.

Të pavarur, Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)

Të pranishëm ishin edhe media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin si dhe duke i rikujtuar të pranishmit për pikat rreth rendi të ditës, përkatësisht pikat të cilat janë në vazhdim, theksoi, kam një propozim që pika që hyri si pikë e re shtesë në rend të ditës në këtë mbledhje, a mund të rendit në vazhdim si pikë e 2-të e rendit të ditës ngase është pikë me rëndësi si dhe administrata duhet ta përgatis paksa me prioritet për ta dërguar sa më shpejtë Ministri, andaj nëse e përkrahni këtë propozim mund edhe të votojmë për procedurë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, mund ta përkrahim këtë meqë është propozim me rëndësi dhe në interes të përgjithshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë arsyet e jepen dhe mund ta hedhim në votim, për procedurë, që kjo pika e cila hyri shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik pronat përkatëse nën menaxhimin e AKP-së në Zonat Kadastrale Metehi dhe Stedim, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes.

Pas votimit, Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishim prezent për momentin në sallë, mbështetet propozimi procedural që pika shtesë e cila hyri në rend të ditës në këtë mbledhje, të rendit si pikë e dytë e rendit të ditës, me arsyetimin që si çështje është me prioritet dhe interes i përgjithshëm për Komunën dhe qytetarët nevojitet që sa më shpejt të jetë e mundur të përgatitet vendimi final dhe të dërgohet në Ministri dhe AKP.

2. Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, j falënderoj pr mirëkuptimin e juaj që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet tani si pikë e dytë në mënyrë që të kaloj si propozim vendim. Ashtu siç e sqarova edhe në fillim të mbledhjes duke e paraqitur edhe arsyeshmërin e futjes së kësaj ike si pikë e jashtëzakonshme në kuadër të rendit të ditës që ka të bëjë me shpalljen në interes të përgjithshëm publik, fjala është sepse shkresa prej AKP-së ka ardhur më 23.06.2025 dhe aty ka një afat kohor që ne duhet t'i përgjigjemi AKP-së që këto prona janë shpallur interes i përgjithshëm publik dhe që nuk duhet të hyjë në valët e privatizimit, përndryshe në rast se nuk e dërgojmë këtë vendim që këto prona janë shpallur interes i përgjithshëm publik për interesa publike të Komunës së Podujevës, atëherë këto kalojnë në privatizim dhe pastaj është e pamundshme të kthehet prapa dhe ne të paguajmë 20% të vlerës, mirëpo nëse pastaj hyjmë në proces të shpronësimit duhet të paguhet 100% të vlerës së pronës, kështu që edhe kërkoj ta mbështetni këtë propozim vendim sipas materialit përkatës.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupi të LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim edhe pse materiali i kësaj ike erdhi si vonë në fillim të mbledhjes dhe nuk patëm shumë mundësi të shikojmë dhe analizojmë e që nuk pata mundësinë të shohë se a janë destinuar këto prona për ndonjë projekt apo vetëm duhet ne ta mbështesim si shpallje interes publik.

Pra a është paraparë diçka në ato prona sepse sa jam në dijeni është edhe si obligim ligjor që Ekzekutivi ta parashihë çka do të bëhet në ato prona, përndryshe ne e mbështesim kështu siç është.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo si procedurë nuk e di a kemi të drejtë kështu në mes të seancës ta ndërrojmë rendin e ditës, përkatësisht renditjen e pikave në këtë formë kështu ku një pikë e rendit të ditës nga fundi të del e dyta ose e treta, pra mos po është pengesë kjo për shkak të kësaj çështje, përndryshe ne e mbështesim kështu siç është.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, i nderuar Bashkim, kjo pikë e rendit të ditës hyri si pikë shtesë por që nuk u caktua në fillim se në cilën pikë renditet. Pra ne vetëm votuam të hyjë si pikë shtesë në rend të ditës, kjo ishte pra.

z.Bashkim Sylja, sërish theksoi, kur e cekta këtë çështje e mendova që vetëm të mos ketë ndonjë problem apo pengesë meqë është afati shumë i shkurtër për ta dërguar këtë vendim në institucionet përkatëse të nivelit qendrorë. Përndryshe unë jam Për ashtu siç kam qenë gjithëherë që pronat që kanë qenë të Komunës së Podujevës dhe që tani menaxhohen nga AKP t'i kthehen Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë ju falënderoj dhe sa po vërej nuk të interesuar të tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, e hedh në votim këtë propozim vendim për shpallje në interes të përgjithshëm publik këto tri prona sipas propozim vendimit dhe materialit përkatës ku njëra është në sipërfaqe prej 8827m², tjetra është 1865m² dhe e treta është 7298 m², andaj e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 20 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - pronat e paluajtshme në Zonat Kadastrale Metehi dhe Shtedim, të evidentuar Pronë Shoqërore Kooperativa Bujqësore Kërpimëh, që janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të kësaj mbledhje.

3. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri

-Projekti "Furnizim me mekanizëm Bujqësorë"

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këto propozim vendime për shtim të buxhetit dhe kod të ri na janë bërë rutinë pothuajse sepse gati për çdo mbledhje po kemi propozime të tilla, për më shumë rreth kësaj na informon drejtori i DBF-së.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në bazë të Rregullores për subvencione, konkretisht subvencionimin e bujqve, do të thotë participimi i fermerëve që është në vlerën 30% atëherë mjetet që mblidhen nga ata fermer përfitues patjetër nevojitet vendimi i Kuvendit të Komunës në mënyrë që Ministria e Financave të na e mundësoj alokimin e mjeteve nga participimi i fermerëve në mënyrë që të realizohet projekti i cili ka të bëjë me mekanizëm bujqësorë në këtë rast, kështu që ju ftoj ta mbështetni këtë propozim.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe ne LDK thuajse nga fillimi i mandatit gjithherë i kemi përkrahur këto iniciativa për ndihmë fermerëve Llapjan, mirëpo kërkesa jonë që gjithherë e kemi cekur ka qenë që të hiqet participimi i fermerëve, përndryshe ne i kemi përkrahur këto iniciativa gjithherë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e përmenda edhe dje në mbledhjen e KPF-së dhe patjetër më duhet të përmend edhe sot sepse në KPF jemi pak anëtarë të Kuvendit dhe nga Ekzekutivi.

E kam parë mekanizmin që është blerë, dhe në një formë më erdhi mirë që ishte "Made in Serbia" sepse na patën lodhë duke thënë duaje tënden dhe duke vendosur në zemër aty, duaje tënden, duaje tënden, por që këta është dasht ta dinë në fillim e jo ta përdorin politikisht sepse Ligji i prokurimit e njuh operatorin i cili plotëson kushtet, del më i ri dhe pa qare duhet t'i jepet tenderi/kontrata.

Prandaj tani duhet ta marrin vesh edhe këta që edhe ai pse i ka sjellë "Made in Leskovc" të Serbisë nuk ka pasë qare pa i sjellë, por më herët e kanë përdorë politikisht, duaje tënden, dhe tani nuk e di a bënë pjesë edhe kjo "Made in Serbia" duaje tënden.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për shtimin e kodit të ri buxhetor edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim edhe pse realisht në të kaluarën këto propozime të tilla nuk kanë ardhë nëpërmes Kuvendit, andaj tani nuk e di përse Ministria e Financave e ka bërë të obligueshme për shkak të shumës së mjeteve nga participimi i fermerëve. Përndryshe edhe unë jam Për që të behet një rregullore me të cilën do të zvogëlohet participimi i bujqve sepse 30% është shumë, kështu që do të ishte mirë që kjo të kryhet dhe në seancën e radhës të vie në Kuvend për miratim nga një komision i cili do të vlerësonte profesionalisht këtë participim për të cilin mendoj se është shumë 30% e vlerës së subvencionit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim me mekanizëm Bujqësorë", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB për vitin 2024

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj informate, theksoi, me pëlqim të Kryetarit të Komunës po e pasqyroj një informatë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe duke marrë parasysh edhe numrin e madh të pikave që keni paravetës dhe duke marrë parasysh që paraprakisht ne e kemi sjellë një informatë të detajizuar e që ka qenë kërkesë e juaja që informata e tillë të jetë më e përmbledhur për këto gjashtë takime që kemi mbajtur në vitin e kaluar dhe ato gjashtë takime i keni të përmbledhura në këtë informatë, andaj sigurisht që do të ketë diskutim dhe mund të keni ndonjë sugjerim, plotësim apo vërejtje.

z.Ragip Fetahu, theksoi, e falënderoj drejtorin parafolës të DKA-së për informatën e dhënë lidhur me tematikën. Informata në fjalë është një bazë gjithëpërfshirëse e të dhënave se çka është bërë në KKSBB në vitin 2024. Njëkohësisht shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe Policinë e Kosovës për bashkëpunimin qoftë me neve anëtarët e Kuvendit po ashtu edhe me institucionet tjera në përgjithësi në mënyrë që të gjithë së bashku të punojmë për parandalimin e fenomeneve negative me të cilat ne si Komunë dhe si qytetarë ballafaqohemi e që bazuar në këtë është shumë pozitive që ne tani kemi një rënie të lehtë të fenomeneve negative sidomos të dhunës nëpër shkolla, konflikteve, sjelljeve delikuede e të tjera e që janë rezultat i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit institucional dhe mendoj se kjo është një gjë shumë pozitive falë bashkëpunimit edhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës përfshirë këtu pozitë opozitë duke u bazuar në rekomandimet dhe vendimet tona të cilat i kemi marrë qoftë edhe si Ekzekutiv i Komunës së bashku me organet tjera kanë bërë një punë shumë të mirë dhe kanë arritur me sukses që të zvogëlojnë fenomenet negative në Komunën tonë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk e shohë bash krejt sikurse parafolësi z.Ragip Fetahu.

Ka shumë pika të cilat kanë qenë në Plan por që këtu nuk ka informatë, shembull njëra prej pikave që ka qenë është zbatimi i planit për parandalimin e ekstremizmit, pikë për të cilën nuk raportim dhe u e dim çka është bërë me këtë pikë, pastaj kemi pikën tjetër ku thuhet tryezë pune me akterë DKA me KBI, OSHC e që do të thotë se nuk është mbajtur ajo tryezë, nëse po drejtori i DKA-së është prezent dhe mund të na njoftoj, mandej po ashtu kemi pikën tjetër masat parandaluese ndaj zjarreve dhe vërshimeve, por që në raport nuk figuron kjo dhe nuk jemi të informuar ne se çfarë masash janë marrë e që ndoshta edhe janë marrë por që në këtë informatë nuk figuron. Po ashtu njëra prej pikave ishte edhe siguria në komunikacion dhe nga qentë endacak e që po ashtu edhe për këtë nuk pash diçka që është thënë në këtë informatë se çfarë është ndërmarrë për këtë pjesë.

Pati edhe disa pika tjera por që këto që i ceka ishin paksa më të rëndësishme e që nëse ka mundësi të na jepni sqarime përse mungojnë informatat për këto.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa për sqarim, për shkak se ka qenë edhe kërkesë e juaja që të shkoqitet raporti e i cili ka diku 92 faqe por që në atë ekzistojnë të gjitha ato takime dhe ato aktivitete që i potencoj asambleisti parafolës. Sigurisht që pas kësaj informate që ofrohet këtu në Kuvend mendoj se duhet të publikohet në faqen zyrtare të Komunës edhe versioni i zgjeruar por edhe ky version që e kemi sot paravajtës në mënyrë që të shihet se janë realizuar edhe ato aktivitete që u ceken.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk po vërej që ka të interesuar të tjerë për të marrë fjalën, andaj kjo është një Informatë dhe nuk ka nevojë të hedhet në votim por vetëm e konstatojmë të përfunduar diskutimin për këtë si pikë e rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës

5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 datë 18.04.2025 për ndryshim dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa - Kërkesa e MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një Kërkesë të MAPL-së e cila na është dërguar më 30.05.2025 dhe në atë kërkesë për rishqyrtim arsyeja është shumë e thjeshtë, në vend të ish anëtares së KPF-së zonjës Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga Kuvendi i Komunës pasi është zgjedh Deputete në nivel qendrorë, kështu që ne kemi marrë vendim duke e emëruar anëtar të KPF-së një anëtar të Kuvendit të gjinisë mashkullore kurse MAPL ka kërkuar që të plotësohet kuota gjinore duke u emëruar një anëtare e gjinisë femërore, andaj ftoj Grupin e LVV-së që të jep një propozim për anëtar në kuadër të përbërjes së KPF-së.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e propozojmë kolegën zonja Lirika Maliqi që të jetë anëtare e KPF-së.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë do të votoj Për, edhe në mbledhjen e kaluar kam votuar Për, mirëpo edhe këtu publikisht ju kam thënë që nuk kemi të drejtë ligjore të emërojmë anëtar të gjinisë mashkullore sepse nuk e lejon kuota gjinore, por Kryesuesi i Kuvendit e tha që ne po e votojmë kështu dhe po e dërgojmë në MAPL kështu. Do të thotë është keq për neve si Kuvend sepse MAPL këto raste nuk i lëshon. Unë pra sërish do të votoj Për.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë siç u cek kemi të bëjmë me rishqyrtimin e vendimit të mbledhjes së kaluar sipas Kërkesë MAPL-së, andaj pa humbur kohë e hedh në votim propozimin që znj.Lirika Maliqi të emërohet anëtare e KPF-së në vend të ish anëtares znj.Drita Pajaziti.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht znj.Lirika Maliqi emërohet anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vend të znj.Drita Pajaziti e cila ka dhënë dorëheqje nga funksioni anëtare e Kuvendit të Komunës.

6. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, raporti i auditorit për komunën e Podujevës normalisht është një proces që përcaktohet me ligj dhe normalisht Zyra Kombëtare e Auditimit çdo vit bën auditimin e të hyrave financiare të çdo organizate buxhetore duke përfshirë normalisht këtu edhe komunën e Podujevës si organizatë buxhetore që funksionon në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike. Raporti i auditorit për vitin 2024, ju materialin e keni marrë me kohë mirëpo raporti i auditimit është i paraqitur edhe në faqen zyrtare të Zyrës Kombëtare të Auditimit mirëpo normalisht ne si institucion jemi të obliguar që të përgatisim edhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ky raport i auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Podujevës, në raportin e auditimit është opinion i kualifikuar për arsye të cilat do i diskutojmë tash mirëpo e konstatojmë që pasqyrat financiare të përpiluara nga ana e komunës së Podujevës dhe verifikimi i

këtyre pasqyrave financiare duke u bazuar në shpenzimin e buxhetit publik prezantohet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme me ligjin nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe rregulloren nr.03/1-2017 për raportim vjetor financiar nga ana e organizatave buxhetore. Qysh e ceka edhe në fillim që e thotë edhe raporti i auditorit komuna e Podujevës ka një raport të kualifikuar për këtë vit dhe në bazën për raport të kualifikuar ashtu siç është edhe në raportin e auditorit është arsyeshja po thuajse e vetme është keq klasifikimi në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë prej 2,166,110.00€, të cilat janë ekzekutuar përmes vendimeve përmbarimore gjyqësore dhe këto vendime përmbarimore gjyqësore do të thotë kanë ardhë si rezultat i kontratës kolektive për të cilën kemi diskutuar shpesh edhe kur ka qenë çështja e raportit të auditimit mirëpo edhe te raporti financiar për shpenzimet të janë duke u bërë përmes vendimeve gjyqësore ku një shumë e konsiderueshme po ekzekutohet për shkak të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me zbatimin e kontratës kolektive. Ne si komunë e Podujevës sikurse edhe gjitha komunat tjera nuk e kanë ndonjë bazë ligjore do të thotë nuk është në kompetencën e tyre që të ofrojnë ndonjë zgjidhje për këtë kontratën kolektive, dihet që kjo kontratë është shfuqizuar në vitin 2022, mirëpo këtu bëhet fjalë për vendime të cilat ndikojnë në shpenzime para vitit 2022, mirëpo të cilat reflektojnë edhe në buxhetin e viti 2023-2024, e fatkeqësisht po ndikojnë edhe në buxhetin e vitit 2025 ku veç e keni pa edhe në bazë të raportit financiar ku kemi prezantuar tre mujorshin mirëpo fatkeqësisht prapë ka pasë vendim të gjykatës ku deri më tani që po flasim edhe për vitin 2025, është një shumë afër 2,000,000.00€ e cila është ekzekutuar për çështje të kontratës kolektive. Vendimi tash i Ministrisë së Financave është që nga kategoria e pagave nuk i ekzekutojnë se po në rast se do i kishin ekzekutuar nga kategoria e pagave nuk konsiderohet keq klasifikim dhe rrjedhimisht nuk do ishte kualifikuar raporti i këtij auditori dhe janë të ekzekutuara nga kategoritë tjera dhe ka ndikuar në kualifikimin e raportit të auditorit. Sigurisht përpos kësaj asye që e ka kualifikuar raportin e auditorit janë edhe disa të gjetura të cilat janë të fushave të ndryshme të veprimtarisë së komunës të cilat do i diskutoj edhe në përgjigje se ndoshta janë çështje të cilat do të trajtohen gjatë diskutimit mirëpo një gjë është e konstatuar edhe nga raporti i auditorit që nuk bëhet fjalë për komplet këto të gjetura të cilat kanë pasë ndonjë ndikim material në humbje buxhetore të komunës së Podujevës po e them përjashtimisht asaj kontratës kolektive që nuk është pjesë e komunës asnjë nga këto 12 të gjetura tjera, nuk është një e gjetur e cila ka ndikuar për asnjë euro dëmtimin e buxhetit të komunës së Podujevës, po flasim për këto të gjetura të auditorit. Ju falënderoj për vëmendje pastaj pyetjeve ose diskutimeve do të përpiqem që t'i japim sqarimet e nevojshme.

z.Haki Rudari, theksoi, raporti i auditimit është një kontroll i pavarur i pasqyrave financiare të një etniteti qëllimi i të cilave është dhënia e opinionit lidhur me atë se sa japin pasqyrat financiare pamjen e vërtetë dhe sa janë në aspektin financiar dhe ligjor për periudhën për të cilën po raportohet, këtë rast për vitin 2024. Ky raport i auditimit duhet të bazohet në disa parime;

1-Ligjshmërinë, 2-integritetin, 3-paansinë dhe objektivitetin, 4-shehtësinë profesionale, 5-Kompetencat që ka ky komision që e bënë auditimin dhe në fund 6-pavarësia e auditorit.

Tash nëse ndalemi dhe e analizojmë raportin e auditimit që u tha nga ana e drejtorit dhe është e vërtetë që është i kualifikuar, ne i kemi këtu bazat për konkluzion lidhur me opinionin e auditimit pse është i kualifikuar, njëri prej atyre bazave është e vërtetë që u përmend edhe kontrata kolektive ky problem thuajse ju ka pri gjitha komunave të Kosovës për arsye se komunat nuk kanë kompetencë ligjore që ta ndalojnë këtë të drejtë që e ka pasë qeveria kur është nënshkruar kjo në vitin 2017.

Një çështje tjetër për të cilën po ashtu mendoj që është mirë të diskutohet që unë do e ceki në emër të grupit janë rekomandimet, gjithsej i kemi 13 rekomandime të reja të vitit 2024, prej tyre 5 rekomandime janë të reja ndërsa 8 rekomandime janë të përsëritura. Këtu kërkoj nga ekzekutivi pa dallim që secila drejtori në fushën e vet të merret e të angazhohet dhe secila drejtori për ato gjetje të auditorit të angazhohet dhe në të ardhmen raporti të vjen me rekomandime sa më pak të përsëritura e do dëshiroja që mos të ketë fare rekomandime të përsëritura por ato të zbatohen para se të bëhet auditimi.

z.Naim Çunaku, theksoi, tai kur kemi para vetës trajtimin e raportit të auditorit gjegjësisht të pasqyrave financiare vjetore të komunës së Podujevës për vitin 2024 e dimë mirëfilli se Kuvendi komunal është shtylla e parë e cila bën monitorimin, gjegjësisht implementimin e buxhetit të aprovuar po nga ky kuvend dhe kemi auditorin e brendshëm si element kryesor që është i specializuar dhe autorizuar që është i pa anshëm politik që merret me rregullsinë e çështjes së buxhetit që i nënshtrohet edhe auditorit të përgjithshëm të Kosovës duke u bazuar në kompetencën e tij edhe kësaj radhe auditori ka dhënë fjalën e vet për menaxhimin e financave të komunës së Podujevës për vitin 2024. Ç'është e vërteta e kemi të njëjtin kualifikim si në vitet 2022, 2023 dhe 2024, do të thotë në një formë që as ky raport i pa anshëm politikisht dhe meritore profesionalisht se nuk kemi instancë tjetër të kontrollit të buxheteve më kompetente edhe pse tri vite radhazi e kemi këtë raport të kualifikuar. E dëgjova me vëmendje drejtorin dhe një prej rrugëdaljeve të gjithë atyre komunave që kanë pasë pasqyra financiare dhe ju kanë dalë raportet e kualifikuara e kanë gjetje si kujdestar kontratën kolektive të punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë por çdo njëri prej nesh dhe të gjithë ata të interesuar që kanë dashur ta shohin raportin e auditimit aty shihet që vetëm një prej kriterëve ka mund të jetë për vendime të gjykatave gjegjësisht kontrata kolektive por kemi edhe një mal të gjeturash për keq menaxhim, keq klasifikim, dikush e tha dhe edhe një fjalë tentim mashtrimi po shkruan këtu në raport. Kjo që drejtori e potencoi para nesh që të gjitha këto kanë mund me qenë lëshime me nuanca se fundja nuk kemi humbje buxhetore, drejtor nëse tani jemi në fund të muajit qershor dhe kemi vapë dhe kemi projektuar që në muajin qershor para fillimit të korrikut kemi nevojë për mjete trupa ftohëse por jo trupa ngrohëse dhe nëse ne këtë muaj harxhojmë mjete për qymyr sigurisht që ia kemi huq keq dhe kemi bërë një investim për mos me thënë të dështuar dhe s'ka si mos me qenë tjetër veç si humbje. E përmenda qershorin dhe korrikun por jam i bindur sikurse unë dhe ju të gjithë se kushtet në këtë sallë as për punë nuk ka, çfarë vape kemi dhe po mundohemi shumë shkurt jo të flet Naimi por te lexoj atë që e ka thënë auditori si organi kompetent më i lartë që e jep vlerësimin e tij se si është menaxhuar një vit buxhetor. Po i lexoj disa nga të gjeturat e auditorit sigurisht që ne këtu e dimë por fundja me vetë faktin që ky raport duhet të diskutohet në kuvend ne duhet ta diskutojmë dhe ta njoftojmë edhe ata ëq janë këtu e ata që s'janë këtu për të gjeturat e këtij raporti, po filloj nga e para pagesa nga një projekt në projektin tjetër pa vendim të kuvendit e fillova të parën anashkalimin e kuvendit, vonesa në lëshimin e leje ndërtimore, drejtpërsëdrejti dëmtim të operatorëve ekonomik, përzgjedhja e kontraktuesve operatorëve ekonomik në mungesë të plotësimin të plotë të kriterëve, kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare apo pa zotim të mjeteve si themi ne, ke shkuar ke ble mall por paratë s'janë askund, komuna nuk ka mbajtur rethistrat e kontratave përmes platformës E Prokurimi, komuna kishte paguar nga projektet adekuate pa vendim të kuvendit, mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Neve mund të na doket e lehtë kjo por llogaritni ata operator ekonomik që kanë hy në obligime e kanë kryer obligimin dhe kanë pritë pagesën dhe i vonohet pagesa dhe në mënyrë zingjirore ka obligime shtesë, mungese e projekteve ekzekutive, mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave. Nuk po shkoj më tej vetëm po dal te një segment tjetër në vitin e kaluar ne kemi pasë një raport dhe kemi pasë rekomandime ku prej

13 rekomandimeve thënë shqip që i janë thënë fjalë ekzekutivit përmirësohu, vetëm 5 nga to janë përmirësuar ndërsa 8 rekomandime tjera s'ju kanë bërë përshtypje hiç. Një element shumë kohë na ka marrë gjatë punës së kuvendit me vite është dhënia e pronave komunale në shfrytëzim dhe çka ka ndodh me ato prona dhe këtu ka vërejtje mos raportimi për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, ne kemi mund të marrim një vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale dhe aty kemi përfunduar dhe më s'kemi kurrfarë impakti apo raporti kthyes çka ka ndodh me to. Nuk po e zgjasë më tepër po e përmbyll me këtë që nuk ka diçka tjetër të thuhet përpos se është raport i kualifikuar do të thotë raport që nuk është bërë shpenzimi konform rregullatave ligjore në fuqi.

z.Bashkim Syla, theksoi, raporti i auditimit për komunën e Podujevës për vitin 2024, ka dhënë opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore, çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit sipas rregullores financiare nr.01/213, shpenzimet duhet të kenë kode adekuate. Baza pse auditori ka dhënë opinion të kualifikuar është keq klasifikim në kategori të ndryshme ekonomike dhe nuk është çështja vetëm te kontrata kolektive, ka edhe shumë faktor dhe çështje tjera dhe nuk ka qenë vendimtarja kjo kontrata kolektive sepse ka edhe çështje tjera që e kanë bërë këtë raport të kualifikuar. Te kategoritë e ndryshme ekonomike keq klasifikim ka ndodh në 2,166,110.00€, të cilat janë realizuar përmes vendimeve gjyqësore, është e vërtetë kjo që e tha drejtori që përmes kodit të pagave nuk realizohen këto vendime gjyqësore mirëpo një çështje tjetër e din edhe drejtori se çështja e mësimdhënësve dhe padive gjyqësore nuk është e vitit të kaluar ose par dy viteve por është para 4 ose 5 viteve dhe ka qenë një premtim i tyre që do e bëjmë një marrëveshje me mësimdhënësit, kështu që veç vendimet gjyqësore se tha s'ka pasë keq menaxhim dhe humbje të parasë publike, veç vendimet gjyqësore dhe përmbaruese më shumë se 1,000,000.00€ janë dëm në buxhetin e komunës së Podujevës. Kemi disa të gjetura të përsëritura që 4 ose 5 vite siç janë pasuritë kapitale mbi 1,000.00€ të raportuara, unë nuk e di ai komision që e bën vlerësimin e këtyre pasurive do të thotë 115,000,000.00, thuajse gati 100,000.00€ ka bërë gabim në vlerësimin e tyre edhe te pasuritë nën 1,000.00€, 2,736,000.00€, janë vlerësuar dhe janë nën vlerësuar 203,000.00€, vonesa në lëshim të lejeve të ndërtimit që e përmendi edhe Naimi kjo që është pengesë veç për operatorët por është pengesë edhe për të hyrat e komunës, do të thotë është pengesë në mos realizim të të hyrave të komunës, përzgjedhja e kontraktuesve me mungesë të plotësimit të kriterëve, kontraktimi i projekteve me mungesë të fondeve financiare, shpërblim me kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve në dosje do të thotë janë shpërblyer kompanitë me tendera të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret që këta vetë i kanë qitë në dosje edhe 4 kontrata janë dhënë duke anashkaluar kuvendin komunal pa kriterë. Te kontraktimi i projekteve në mungesë të fondeve dihet janë disa projekte të cilat janë në listë dhe janë dy vjeçare, unë nuk e besoj që i ka marrë për bazë ato se KAB për ata është shembull një projekt i madh nuk mund të përfundohet për një vit por për dy ose tri vite mirëpo këtu s'ka pasë projekt hiç. Rexhistrat e menaxhimit të kontratave përmes platformës E Prokurimit, nuk besoi që është çështje shumë e ndërlikuar, ky kriter i njëjti është duke u përsëritur që 5 ose 6 herë, pagesa e projektit nga fondi i një projekti tjetër pa miratim nga kuvendi komunal, mungesa e projekteve ekzistuese, mos respektim i hapur për procesin e pagesave, mos raportim i rregullt për shfrytëzim të pronave komunale.

z.Adnan Zymeri, theksoi, raporti i auditorit për pasqyrat financiare është raporti më i rëndësishëm që pranon komuna lidhur me aktivitetin e saj financiar dhe procedural gjatë vitit fiskal nga zyra kombëtare e auditimit dikur institucion kredibil, në këtë raport pasqyrohen të gjeturat e auditorëve nga masat e marra për trajtim. Fatkeqësisht sikur vitin e kaluar dhe raportin e kaluar edhe në këtë raport komuna e Podujevës ka opinion të kualifikuar që nënkupton për mos përpunje apo gabime në prezantimin e raporteve financiare siç janë keq klasifikimi dhe çështje tjera të cekura si të gjetura, sa do që mund të relativizohen të gjeturat e këtij raporti prapë mbetet i pa ndryshueshëm

fakti që për shkak të raportit të kualifikuar komuna e Podujevës nuk ka arritur as edhe një herë të vetme gjatë kësaj qeverisje të jetë përfituese e garndit të performancës pasi siç e dimë raporti i auditorit është njëri nga kriteret minimale për të qenë në listën e komunave përfituese. Ndoshta për dikë mund të mos duket ajo vlerë e grandit asgjë mirëpo për mua secili grand që përmirëson jetën e qytetarëve të Podujevës do të thotë shumë bazë për konkluzion të pajtueshmërisë lidhur me raportin e auditorit do të thotë janë vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore. Kjo ndikon edhe në atraktimin e investitorëve, rrjedhimisht uljen e të hyrave vetanake ngase nëse në një komunë tjetër një investitor pret prej 30 deri në 45 ditë për një leje, në komunën tonë kjo pritje zgjatë nga 60 deri në 200 ditë. Kjo është e faktuar në tri mostra të auditimit, arsyeja e dytë është edhe shpërblimi me kontratë në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit kjo i bie që komuna edhe t'i kërkon dokumentet edhe të shpërblen pse nuk i ke sjellë dokumentet, prandaj auditori konstaton se kjo ka ndikim në eliminimin në tërësi të proceseve të mirëfillta të tenderimit. Se kuvendi është totalisht i pa rëndësishëm në trajtim tregon edhe fakti ku bëhen pagesat nga fondet e projekteve që ne bashkë i kemi miratuar për projekte të tjera pa miratim paraprak të kuvendit, çështja B4, çështjet e të gjeturave të tjera jo më pak të rëndësishme janë lehtë të paraqitura me ndikimet dhe rekomandimet e auditorit. Se si do të trajtohet ky raport dhe si do të zbatohen rekomandimet e tij tregon shkalla e realizimit të rekomandimeve nga raporti i auditimit të vitit 2023 ku nga 13 rekomandime siç e përmenden parafolësit janë realizuar vetëm 5 apo thënë përqindje rreth 40% e rekomandimeve janë realizuar kurse 60 % e rekomandimeve janë të pa realizuara. Duke shpresuar që qeverisja nuk do ta trajtoj këtë raport vetëm si dokument në letër shpresoj që raporti i auditimit për vitin 2025, ti shërbej komunës tonë që ta përmirësoj performancën dhe të jetë përfituese e grandeve dhe donacioneve tjera në të ardhmen.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe pse shumica e pikave u përmenden unë e pata një arsye shtesë që të marrë fjalën sepse shumica e gjetjeve janë që unë për vete jam krenarë që të njëjtat i kam përmendur që 3 vite e tani janë shumë prej tyre që i ka gjet edhe auditori.

Ishte vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore, duhet cekur që për kategorinë 1 nga data e kërkesës mundet 30 ditë të vonohet leja ndërtimore, për kategorinë 2 dhe 3 apo për ndërtime të larta deri në 45 ditë, kurse këtu janë vonuar prej 60 deri në 200 ditë, arsyen përse i kanë vonuar besoj që shumica e dinë por edhe këta vet e dinë.

Pastaj ishte përzgjedhja e kontraktuesve në mungesë të plotësimit të plotë të kriterëve, edhe këtë çështje mbi 100 herë e kam përmendur këtu në këtë foltore se qysh ka mundësi t'iu jepet tender operatorëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret ose që ka operator të cilët i plotësojnë dhe bëjnë ndërtime edhe më të mira dhe tani kur janë disa edhe më të dobëta këta thonë që këta nuk i plotësojnë kriteret. Mirëpo ndoshta për shumicën e qytetarëve t'ju thuhet se opinioni i auditorit është i kualifikuar, mendojnë që është mirë të jetë i kualifikuar, mirëpo unë këtij raporti i them raport i keq dhe i zi.

Brenda këtij raporti në 10 vende përmendet fjala mashtrim dhe njërin prej tyre do ta lexoj në vazhdim, por paraprakisht e them atë që drejtori i DBF-së e përmendi tek Kontrata Kolektive, unë e kam dëgjuar krye auditorin në një emision dhe e kam prerë videon dhe e kam këtu që mund edhe t'jua lëshoj nëse veç e kundërshton drejtori e DBF-së atë, pra është vetëm njëra prej arsyeve që e ka kualifikuar kështu raportin, pra nuk është baza e asaj që po thirrreni në raport.

Për ta zbërthyer fjalën mashtrim që është cekur këtu në raport e që nuk ka ndodh ë histori të Komunës së Podujevës në asnjë raport prej pas luftës e këndeje të përmende kjo fjalë kështu kaq shpesh, pra njëra prej pikave thotë; identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos pajtueshmërisë me autoritet qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura të auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme që

janë të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzion për pajtueshmërinë me autoritetet, rreziku i mos zbatimit të një rasti të mos pajtueshmërisë që vë nga mashtrimi është më i lartë se sa që rezultojn gabimi pasi që mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim dhe lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm. Do të thotë është përmendur shumë herë fjala mashtrim, manipulim, e për këtë po e marrë shembull që më moti e kam pas një shok/mik dhe ku luani futboll, ai hupte, unë fitoja, mirëpo më shumë e shitke ai humbjen e tij si fitore mua, se sa unë fitoren, prandaj edhe ju nuk e di përse nuk e pranoni ose pse mundoheni a bëni të mirë raportin e kualifikuar, e që realisht edhe që e kemi humb si Komunë atë grand të Ministrisë që është njëra prej kërkesave të mos jetë raporti i kualifikuar i auditorit sepse gjasat pastaj nuk janë për të përfituar në grand, pra bile edhe ju mos na e shitni si të mirë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, fillimisht fjalën mashtrim që e ceku kolegu z.Ekrem Rrahmani do ta zëvendësoja me fjalën zhvillim, përndryshe të nderuar paravetës kemi një raport teorik të auditorit të përgjithshëm i cili e përshkruan një gjendje se si do të duhej të ishte, do të thotë më tepër është në aspektin dëshiror, kurse realiteti është diçka tjetër dhe mendoj se nuk mund të dalim prej realitetit dhe në këtë aspekt po dua t'i shkëpus tri gjetje të cilat janë më të rëndësishme dhe t'i argumentoj ato pse ndodhin. Gjetja e parë është vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore, ne e dim se pse e kemi fatin e mirë apo të keqe të jemi pjesë e kësaj legjislature ku kemi miratuar Hartën Zonale dhe duke u bazuar në këtë argument ne i kemi dhënë mundësi ndërtimeve të larta në Komunën tonë. Ne si Komunë siç e dim kemi një staf të kufizuar administrativ edhe në aspektin profesional arkitektë dhe inxhinier të cilës merren me këtë fushveprimtari, ndërsa në anën tjetër kemi një valë të madhe të kërkesave për ndërtime të larta, një valë e cila është e pa pritshme ose një diçka që më parë nuk ka ndodh në Komunën e Podujevës edhe mendoj se pikërisht këtu është vonesa për shkak se ka kërkesa shumë të mëdha kurse ka numër të vogël të personelit dhe të njerëzve profesionist të cilët arrijnë t'i marrin ato leje, t'i shikojnë dhe t'i detajizojnë se a përputhen me rrethanat, a janë në përputhje me pronën, a e respektojnë rregullativën e brendshme, a e respektojnë Hartën Zonale e të tjera e të tjera, pra pikërisht këtu është problemi se nuk është qëllimi që t'iu bëhet dëm operatorëve ekonomik, mirëpo qëllimi është që të shikohen këto me përpikëri në mënyrë që të mos ketë defekte dhe mangësi sepse fundja secili punonjës administrativ që merre një leje të tillë ka përgjegjësi jetike për të ardhmen e qytetit se çfarë leje lëshon.

Elementi i dytë është përzgjedhja e operatorëve ekonomik, pra aty thuhet se është favorizuar një operator ekonomik pa i plotësuar kushte dhe kriteret e që kjo teorikisht është në rregull por unë personalisht mendoj që po të kisha mundësi të gjitha bizneseve lokale të cilat funksionojnë në Komunën tonë do t'i favorizoj se ka shumë punëtorë dhe shumë familje të këtij vendi që mbahen duke u bazuar në këto para të cilat i lëshon Komuna dhe ato projekte mënojnë që punohen prej operatorëve ekonomik lokal këtu janë më të përgjegjshme dhe më të mira sepse fundja është interes i tyre që këto shërbime të kryhen sa më mirë, e që kemi përvojë në Komunën tonë sepse ka operator të cilët kanë ardhur nga komunat tjera dhe që kanë kryer punët jo ashtu siç ne duam, mirëpo në anën tjetër kemi edhe operator ekonomik lokal të cilët marrin kontrata prej Komunës së Podujevës dhe i kryejnë punët dhe shërbimet shumë mirë.

Çështja e tretë, çka është me rëndësi të potencohet është fillimi i projekteve pa zotim të mjeteve, ne e dimë prej shoqërisë tradicionale që thuhet se “me rëndësi të niset shtëpia se parat i qon Zoti”, pra veç le të fillojnë projekte dhe veç të nisen projektet se për para besoj se nuk do të jetë shumë problem, andaj kjo e gjetur nuk paraqet kurrfarë problemi mendoj unë sepse nuk ka asnjë shkelje mirëpo është thjeshtë një vullnet i madh i punës dhe angazhimit të Ekzekutivit për të punuar dhe ndoshta edhe “më shumë se sa që na mbulon plafi” se si themi ne. Pra është shumë pozitive kjo që kemi më shumë projekte dhe më pak mjete sepse në të kaluarën çdo herë kishim tepëri të mjeteve

financiare nga buxheti komunal e që teprica e mjeteve financiare do të thotë që nuk ka pasë ide të mjaftueshme dhe këtë e kemi kritikuar në vazhdimësi, kurse nëse tani e kritikojmë këtë që i kemi filluar projektet pa pasë mjete ndërsa në anën tjetër në vazhdimësi në të kaluarën e kemi kritikuar atë që kemi pasë mjete por s'ka pasë projekte, a e dini çka i bie kjo, është fjala popullor “me i ra nalt na hajn ujkit, me i ra poshtë na hajn qentë”.

Kështu që mendoj se puna është shumë pozitive dhe gjetjet që janë këtu në raport janë gjetje teorike e që unë në asnjë mënyrë nuk i mohoj dhe i takon Drejtorisë kompetente që në të ardhmen të merret më seriozisht në plotësimin teorik të këtyre kritereve dhe në plotësimin e rekomandimeve të cilat i ka dhënë Auditori i përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

znj.Edona Shabani, theksoi, të nderuar kolegë unë nuk po merrem me të ardhmen sepse e kemi mendjen të qëndrojmë në të tashmen, më kollaj po na bie, dhe kam pyetje për drejtorin e DBF-së se qysh ndihet që për çdo vit raporti i auditimit vie i kualifikuar, a i bie kjo me qenë analfabet sepse nuk po mundesh të bësh progres por vetëm regres dhe a ke menduar dorëheqjen sepse e ke keq klasifikimin, tentim mashtrimin e të tjera, andaj a ke ndonjë shpjegim për këtë, të paktën morale para qytetarëve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar kolegë z.Ragip Fetahu edhe unë do kisha qejf që në vend të kësaj fjalës mashtrim të ishte zhvillim sepse edhe unë jam banorë i Komunës së Podujevës dhe këtu e mbaj familjen e që shumë do të kisha pasë qejfe të ishte ashtu, ndërsa to që ti i përmende janë çështje që nuk funksionojnë ashtu sepse e kemi Kushtetutën, kemi Ligjet, dhe nuk mundesh shembull ta marrin qysh tani të shkosh në shesh dhe të fillosh diçka, është rregullativa ligjore dhe duhet t'i kesh mjetet buxhetore, meqë ti po don me gjuhen popullore, të them se duhet t'i kesh parat në xhep për ta blerë një thes miell në mulli, sepse nuk mundesh ndryshe me borxhe ose ngjashëm, pra nuk shkon ajo punë ashtu, përndryshe nuk jemi ne kundër që të zhvillohet ky vend. Sa përket asaj që u tha se ka pasë tepricë të mjeteve në të kaluarën, unë të them se edhe tani ka pas tepricë të mjeteve për çdo vit nga 2 milion euro, 2.5 milion euro, pra nuk është që nuk ka pasë tepricë të mjeteve, edhe pse ka pasë vonesa të pagesave dhe që nuk i ka kryer obligimet komuna brenda afatit ligjor që është 30 dit, prandaj realisht edhe unë kam qejf që në vend të këtyre fjalëve siç është mashtrim të ishte zhvillim.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, falënderoj të gjithë për diskutimet ku u jepen vërejtje dhe çështje tjera sa i përket raportit të auditorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit po kryefjala e raportit është që ky raport është i kualifikuar dhe po më bie ta përsëris këtë çështje por që kjo është e vërteta që kualifikimi i tillë i raportit është bërë për shkak të keq klasifikimit. Meqë jemi drejtpërdrejtë edhe në TV e ndoshta janë duke na dëgjuar edhe qytetarët, keq klasifikimi është kur mjetet janë të kategorisë së pagave sepse buxheti ndahet në disa kategori; paga, mallra, kapitale, subvencione dhe komunal, dhe kur mjetet janë të Kontratës Kolektive janë mjete të cilat i takojnë kategorisë së pagave e që kur janë marrë disa vendime gjyqësore ai vendi shkon në Thesarin e Republikës së Kosovës i cili pastaj i shkruan Organizatës buxhetore në këtë rast Komunës së Podujevës një e-mail zyrtar ku thotë (ka një vendim gjyqësor për t'i ekzekutuar ta zëm 400,000.00€ andaj kërkojmë nga ju që nga cilat projekte dhe ku të erren ato mjete duke dhënë edhe një afat që brenda 5 ditëve duam përgjigje), ndërsa ne jua kthejmë atë e-mail ku ju themi që ju lutem mjetet të merren nga kategoria e pagave për arsye që ne të mos kemi keq klasifikim dhe rrjedhimisht të na kualifikohet raporti i auditorit, mirëpo ka një vendim të Ministrisë së Financave që na është thënë neve përmes komunikimeve me zyrtarët e Thesarit, jo që e kemi parë, se mjetet të mos merren nga kategoria pagave për arsye se kategorinë e pagave pastaj në fund të vitit po duhet që kjo Ministri ta mbuloj me fonde sepse punëtorët e shërbimit publik normale që nuk mund t'i lësh pa paga sepse pagat që merren ta zëm siç është nga Kontrata Kolektive, ato mjete janë të

planifikuara për paga të rregullta të sektorit publik për këta 2040 të punësuar që janë tek ne, dhe për këtë arsye bëhet keq klasifikimi dhe kjo është arsyeja që ky raport ka dalë i kualifikuar.

Ne bashkërisht këtu kemi qenë kur e kemi diskutuar raportin e auditorit për vitin 2021 në rast se ju kujtohet, raport i cili i ka pasë 13 ose 14 të gjetura, mirëpo nuk ka qenë raport i kualifikuar, por i pakualifikuar për arsye se Komuna e Podujevës nuk ka qenë në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Pastaj nga vitit 2022 deri në vitin 2024 ka rezultuar me këtë gjendje në të cilën jemi tani dhe fatkeqësisht edhe në vitin 2025 qysh tani janë të ekzekutuara rreth 2 milion euro prej vendimeve gjyqësore e që i bie se raporti sërish do të vie i kualifikuar për arsye se limiti për të mos u kualifikuar një raport është deri në 350,000.00€, pra ta zëm në qoftë se do të ishin 340,000.00€ të cilat janë marrë përmes vendimeve gjyqësore, kjo do të nënkuptonte që raporti nuk do të ishte i kualifikuar sepse nuk janë 350,000.00€ e më shumë, por fatkeqësisht qysh tani janë 2,100,000.00€ për të cilat në fakt është një humbje për Komunën e Podujevës por pa fajin e saj, madje jo vetëm Komunës tonë por janë 22 Komuna tjera të cilat në këtë vit e kanë pasë të njëjtin fat dhe fatkeqësisht do ta kenë sërish në vitin 2025 në raportin e auditorit që do të sjellët sa i përket keq klasifikimit të mjeteve.

Gjetjet tjera janë të përmirësueshme edhe pse disa të vështira për arsye të ndryshme të cilat në vijim do t'ju elaboroj, mirëpo edhe një gjë e them se gjithmonë dhe asnjëherë nuk mund të funksionoj një Organizatë Buxhetore në këtë rast me komplet këto aktivitete dhe me komplet këtë infrastrukturë, në perfeksionin e saj, do të thotë që nëse nuk ka asnjë të gjetur nënkupton se je duke funksionuar në perfeksionin e saj, mirëpo çështja më e rëndësishme është që si rezultat i veprimeve tona të mos ketë humbje buxhetore në Komunën e Podujevës apo humbje tjera të cilat rezultojnë nga veprimet tona si institucion.

Në vazhdim po përpiqem që t'i përmbledh edhe disa çështje dhe të jap sqarime që u përmenden nga disa prej parafolësve. U përmend fjala mashttrim që është përmend edhe në raport, kjo fjalë ceket kur Zyra Kombëtare e Auditimit-ZKA i ceketë përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare dhe thuhet, do të thotë ZKA i drejtohet vetës, thotë; objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përbëjnë keq deklarime materiale që quhet për shkak të mashttrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshijmë ne në opinionin tonë, do të thotë kjo është synimi i ZKA që ta paraqet këtë raport dhe kjo Zyrë, për Komunën e Podujevës e thotë të kundërtën e saj, pra thuhet; sipas mendimit tonë përveç që është e përshkruar në sesionin baza për konkluzion, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Podujevës kanë qenë në të gjitha aspektet materiale të përputhura me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e burimeve financiare, apo një element thotë; sipas opinionit tonë përveç ndikimit të çështjeve të përcaktuara të cilat kanë të bëjnë me keq klasifikimin tek pasurit, pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik bazuar në Ligjin 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe Rregulloren 01/2017, do të thotë është e kundërta e kësaj.

Tek çështjet që kanë të bëjnë me të gjeturat për të cilat po them ë formë të përmbledhur po i jap disa sqarime sepse ndoshta prej disa diskutuesve veç u cekën ngase bëhet fjalë për të gjetura të njëjta, një ndër to është vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore çështje të cilën do ta sqaron edhe drejtori i DPUMM, mirëpo vetëm një fjali e kam për këtë sepse këtu bëhet fjalë për nga momenti kur është protokolluar kërkesa për leje deri në momentin e lëshimit, pala mund të ketë gabime të projekt dhe Drejtoria kërkojnë përmirësim dhe deri në përmirësimin e saj ndoshta kalojnë 30 ditë.

Te përzgjedhja e kontraktuesve, Zyra e prokurimit ka dhënë një sqarim ku mund ta gjeni te Plani i veprimit e që nuk dua të marrë kohë më shumë sepse bëhet fjalë për një Zyrë e cila është jashtë juridiksionit tim por vetëm deshta t'ju informoj se sqarimet e kësaj Zyre mund t'i gjeni te Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Sa i përket kontraktim të projekteve në mungesë të mjeteve fondeve, po ka te disa projekte të cilat janë të kontraktuara në mungesë të fondeve, shembull ne i kemi disa projekte të cilat ceket edhe në të gjeturat e raportit siç është ndërtimi i shkollës së mesme profesionale që është në Zonën Industriale e që në këtë projekt nuk kemi pasë të planifikuar në buxhet por që më herëte kemi aplikuar por në ndërkohë diku në muajin mars neve na është aprovuar nga ana e Ministrisë së Arsimit kërkesa që kjo Ministri të bashkë financoj ndërtimin e kësaj shkolle, do të thotë Ministria e ka pasë pjesën e ve kurse ne kemi pas pjesën tonë në Memorandum, mirëpo çështja është që ne fondet tona nuk i kemi pasë të planifikuara në buxhet por kanë mjaftuar mjetet buxhetore të Ministrisë së Arsimit që të filloj si projekt, edhe në këtë vit ne nuk i kemi të planifikuara fondet por që me bartjen e të hyrave vetanake të cilat do të bëhen në vitin 2026, sepse është projekt trevjeçar, do të planifikohen mjetet të cilat na takojnë neve si Komunë, pjesën tjetër ta zëm për vitin 2025 Ministria e Arsimit i ka të planifikuara rreth 1 milion euro, punët vazhdojnë, janë të kontraktuara nga ana e Komunes së Podujevës dhe pagesat i bënë Ministria e Arsimit, pra unë e përmenda vetëm një rast por që edhe rastet tjera janë të kësaj natyre apo natyrës tjetër ku projekti ka qenë trevjeçar dhe kur ne e kemi planifikuar buxhetin ta zëm te viti 2024 dhe kemi parashikuar ta zëm siç është te ndërtimi i kolektorit mjete për 2024, 2025 dhe 2026 dhe tani në vitin 2026 neve na mjaftojnë fonde që ai projekt të përmbyllet financiarisht.

Po ashtu kemi të gjeturën ku thuhet se Komuna nuk ka mbajtur regjistra të menaxhimit të kontratave, kjo është një çështje të cilën çdo menaxher i kontratës që normalisht janë të Drejtorive të ndryshme, përmes platformës së prokurimit çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin t'i mbajnë shënimet në mënyrë elektronike e që në disa raste qoftë për shkak të ngarkesës në punë qoftë për shkak të sistemit qoftë për shkak të trajnimit, do të thotë nuk janë mbajtur.

Te pagesa e disa projekteve, sërish po e them se në muajt nëntor-dhjetor jemi ballafaquar me disa raste kur kemi pasë mungesë të fondeve dhe për shkak që të mos ballafaqohemi ndoshta me suficid dhe me vendime gjyqësore i kemi ekzekutuar sepse kemi konsideruar që rruga më e mirë për realizmin e atyre projekteve.

Kemi edhe mungesën e obligimeve brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, dhe aty ceket edhe një rast ku vonesa ka qenë 6 muaj, bëhet fjalë ta zëm për ndërtimin e një rruge ku fatura ta zëm ka qenë 400,000.00€ e që Komuna e Podujevës për vitin 2024 ka pasë ta zëm vetëm 200,000.00€ por që neve na është dorëzuar fatura por që pjesa tjetër i është paguar në fillimin e vitit 2025.

Mungesa e projekteve ekzekutuese, po ka disa projekte për disa rrugë apo rrugica ose diçka të ngjashme që nuk i kanë projektet ekzekutuese.

Pastaj kemi edhe të gjeturën ku thuhet mosrespektimi i hapave në procedimin për pagesë, po e them që edhe kjo është një çështje teknike ku fillimisht e kemi marrë mallin kurse si çështje thuhet se së pari duhet të bëhet zotimi i mjeteve e pastaj të merret malli e pastaj të bëhet pagesa , pra ka disa raste e që shembull ta zëm furnizimi me naftë, shkojnë automjetet mbushen si këto të administratës, ato të shëndetësisë, të zjarrfikësve apo shpenzime tjera që kanë të bëjnë për ngrohje, pra bëhet furnizimi përgjatë tërë muajit dhe në fund të muajit operatori ekonomik e sjellë faturën dhe ne e procedojmë pagesën, por në këtë çështje sipas procedurës është që fillimisht të bëhet zotim i mjeteve, pastaj të blihet nafta dhe mandej pagesa, pra kjo është një çështje teknike për të cilën nuk është se ka rezultuar diçka në të keqe të Komunes së Podujevës, por që normalisht kemi vepruar kështu për arsye të menaxhimit më të lehtë në këtë formë.

Bëra përpjekje që në formë të përmbledhur të jap disa sqarime rreth çështjeve që u ngritën, kështu që faleminderit për vëmendje.

z.Liridon Gashi, theksoi, deshta të them disa fjalë sa përket pikës për lejet ndërtimore, është e vërtetë që afati 60 dhe 200 ditë është afat i tejkaluar ligjor sepse afati ligjor e thotë që leja ndërtimore për kategorinë e parë është 30 ditë ndërsa për kategorinë e dytë është 45 ditë, por realisht jo vetëm në Podujevë por në asnjë komunë të Kosovës nuk mund të ndodh që leja ndërtimore të lëshohet brenda afatit ligjor. Do të thotë kjo është interpretuar edhe në disa raste të vlerësimit të Ligjit për ndërtim dhe në vlerësimin ex-post ku kam marrë pjesë edhe unë është thënë që është një afat jo real krahasuar me zhvillimet që janë duke ndodhë në secilin qytet të Kosovës. Ligji i ndërtimit është i vitit 2012 dhe pikërisht në këto ditë që jemi i bënë 13 vite, dhe tranzicioni dhe zhvillimi që ndodh në Kosovë është në shpërputhje diametralisht të kundërta me Ligjin e miratuar aso kohe, andaj afati ligjor është tërësisht i papërmbytshëm dhe i pamundur të realizohet për shumë arsye e që arsyeja e parë është arsye krejt teknike që zakonisht ndodh vonesa tek kategoria e dytë e cila parasheh një plotësim dokumentacioni që edhe ajo ka një afat ligjor, por shumësia e punëve në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje së Mjedisit, drejtori këto të cilat zakonisht kanë mungesë të resurseve njerëzore, me numër të kufizuar e që në rastin konkret janë vetëm 4 arkitektë bartës të lëndës, do të thotë që kanë ë drejtë të jenë bartës të lëndës për lëshimin e lejes ndërtimore.

Ndërkohë që Podujeva është në një tranzicion të ndërtimit, do të thotë prej banimit individual ka kaluar tek ndërtimi i lartë dhe është një zhvillim i hovshëm urbanistik, andaj realisht konsideroj se kjo zgjatja e afateve është në pajtueshmëri të plotë edhe me vet operatorët të cilët në rastin e parë të aplikimit dhe afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit, edhe ata e kanë të pamundur për ta plotësuar dokumentacionin e kërkuar në rastet kur është mangësi e tyre në dokumentacion ose në projekt, pra në një formë është një pajtueshmëri ose një fleksibilitet në zgjatjen e afateve për marrjen e lejes ndërtimore.

Afatet janë të zgjatura por besoj që në raportin e auditorit për vitin 2025, ky afat do të jetë shumë më i shkurtër sepse jemi duke punuar shumë në këtë drejtim dhe shpresoj në një rezultat shumë më të mirë, jo sipas afatit të Ligjit (nenit 17), por do të arrijmë një përmirësim të dukshëm në fleksibilitet dhe në afat të lejeve ndërtimore.

Në rastin konkret, si DPUMM i kemi disa inxhinier - arkitekt të cilët janë të multiplifikuar në punën e tyre sepse përveç trajtimit të lejeve ndërtimore janë edhe menaxherë të kontratave, në komisione për specifika, në komisione të pranimit, në punë teknike e të tjera, e që do të thotë se qoftë logjikisht, qoftë praktikisht, qoftë realisht, konsideroj që deri diku arsyetohet vonesa, ndoshta jo ajo vonesë e paraqitur por që besoj se vonesat në vitin 2025 do të jenë më të pranueshme dhe më reale, mirëpo jo asnjëherë në përputhje me dispozitën ligjore sepse është një vlerësim i përgjithshëm edhe i institucioneve qendrore që Ligji është i vjetërsuar dhe e ka kaluar afatin e zbatueshmërisë së tij si dhe fleksibiliteti dhe tranzicioni i ndërtimit kudo është në shpërputhje me këto afate, andaj konsideroj vlerësimi i auditorit është i drejtë por praktikisht i pamundur për t'u realizuar sipas dispozitave të parapara q janë në fuqi.

z.Naim Çunaku, theksoi, për gjitha tjerat në rregull jemi dhe nuk po dua të diskutoj, por të prezantohet këtu që fajtor për këtë gjendje është Ligji vërtetë e pakuptimtë. Nëse një ligj është i tejkaluar dhe është i pazbatueshëm është niveli qendrorë ai i cili merret me atë çështje, por nuk guxojmë të thirremi në atë se ligji është pengesë dhe tani t'i bëjmë obstrukcione ligjit, andaj i nderuar drejtor i DPUMM kjo për mua është e pashpjegueshme. Nëse një lgj nuk zbatohet ka mekanizma të cilët e abrogojnë atë ligj dhe e tërheqin duke e zëvendësuar me tjetrin, por të fajësosh ligjin për vonesa të tilla vërtetë e pakuptueshme.

Meqë jam këtu në foltore, nuk do të doja që të na bëhet përshkrimi i vendeve të punës sepse ne organogramin e Komunës e kemi të gjithë dhe e dim si funksionon Komuna dhe qysh është i organizuar shërbimi civil në Komunën e Podujevës, mirëpo ne jemi duke e debatuar raportin e auditorit dhe nëse ka pasë kundërshti atë ka und ta kundërshtoj auditori, por jo tani këtu me ato arsye qysh u ceken sepse fundja ai është organi kredibil që i ka parasysh të gjithat ato që i ka thënë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, çështje A3 të raportit e përmendi drejtori i DBF-së i cili e potencoj se është shkolla profesionale, por auditori në gjetjet e veta prej mostrave që ka marrë janë gjashtë të tilla, kurse ti drejtor e përmende një më të lehtë prej tyre, pra ishin te kontrata e ndërtimit të kanalizimit, ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc, ndërtimi i shkollës së mesme profesionale, ndërtimi i rrugës lidhëse me magjistralen Podujevë-Prishtinë si dhe ndërtimi tregut të gjelbër, që dua ë them se janë më shumë se ajo që e përmendi drejtori si të vetme shkollën profesionale sepse tek ajo ndoshta nuk ke pas çfarë të bësh tjetër, por pati edhe të tjera këtu kur e përmende te A3 i raportit që ka të bëjë me kontraktimin e projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare.

Sa i përket çështjes A1 të raportit që ka të bëjë me vonesat e lëshimit të lejeve ndërtimore, edhe në këtë prej tri mostrave që ka marrë auditori ka hasë në gjetje dhe kjo vlerë është 137,177.00€, andaj nëse drejtori i DPUMM ka probleme me ligjin, lehtë është, ju edhe ashtu e kështu jeni duke vazhduar në Qeveri qendrore me 51% dhe vetëm bëjani një kërkesë dhe kryeni, edhe ashtu vendime po merrni pa krye, ju e bëni ligjin e ri, mirëpo në vitin 2012 që u tha se në Podujevë nuk ka pas ndërtime, mirëpo ka pasë në gjithë Kosovën dhe nuk besoj se ligji mund ë jetë në kundërshtim me kohën, ndoshta në Podujevë paksa me vonesë ka filluar ndërtimi i lartë por gjithandej Kosovës ka pas ndërtim.

z.Liridon Gashi, theksoi, realisht unë nuk e atakova Ligjin për ndërtim, por është vlerësim i përgjithshëm, dhe sa për dijeninë tuaj prej vitit 2022 është duke u punuar në ligjin e ri të ndërtimit dhe atë goxha në mënyrë intensive, përndryshe ne i zbatojmë ligjet për aq kohë sa janë në fuqi por zbatueshmëria e dispozitës sa i përket afateve e thash që realisht është e pamundur, si dhe në fund të fjalisë e thash që kualifikimi është i drejtë, është jashtë ligjshmërisë por praktikisht është e pamundur të realizohet brenda afatit ligjor për shkak të arsyeve të cilat i ceka, besoj që ligji i ri do të ketë afate tjera.

Jo vetëm Podujeva nuk ka ndërtim, por ta marrim shembull, unë kam vlerësime të auditorit ku vonesat për leje ndërtimore janë 265 - 280 ditë jashtë Podujevës, pra nuk është që vetëm Podujeva është duke e shkel këtë afat ligjor dhe është më së keqi në Kosovë sa i përket lëshimit të lejeve ndërtimore, mirëpo është paksa e çuditshme sepse më shumë kam ankesa sot në asamble komunale për afatet ligjore sesa të ndërtuesve prej se jam këtu, kështu që nuk po e di, ndoshta paksa edhe fleksibiliteti dhe bashkëpunimi jonë me investitorë për të mos shkuar në procedura të tej zgjatura, sepse ne brenda afatit ligjor nëse veç nuk kryhet plotësimi i dokumentacionit ne mund ta refuzuar dhe për këtë kemi përkrahje ligjore, por që pastaj riaplikimi dhe rishqyrtimi na merr shumë më shumë kohë dhe është shumë më i ngarkuar për neve sesa për vet aplikuesin, andaj në këtë formë shkojmë me një lloj fleksibiliteti në afate për ta arritur më të mirën, jo për ndonjë arsye tjetër.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk po diskutoj për kuorum e as për të votuar diçka por thjesht po ndihem i obliguar të sqaroj një çështje që u përmend këtu e madje është përmendur nëpër portale dhe kam parë duke u përmendur edhe nëpër konferenca për media që është çështja e kolektorit të ujërave të zeza. Vërtetë është interesant të bisedohet dhe të kritikohet një prej projekteve që është më e nevojshme dhe më e arsyeshme për qytetarët e Komunës së Podujevës.

Tani qysh ka ardhur forma e lidhjes së kontratës dhe qysh është lidhë kontrata dhe se qysh janë kursyer ato 7 milion euro unë besoj se këtë e kemi biseduar edhe më parë. Pra ne e kemi lidhë një kontratë e cila sot po kritikohet me pak mbi 3 milion euro kur në tavolinë e kemi pasë një para

marrëveshje me përfundimin e segmentit të parë dhe fillimin e segmentit të dytë e që ka qenë në vlerë 10 milion euro, dhe tani Komuna e Podujevës duke bërë analizat, një paramasë të drejtë dhe të arsyeshme me çmimet e tregut në terren kemi arrite që këtë kontratë ta lidhim pak mbi 3 milion euro, prandaj tani asnjëherë nuk bisedohet për kursime por folët për çmime ë larta dhe për harxhime, folët për keq klasifikime, por më e mira është që nuk po folët për keqpërdorime ku asnjëherë nuk e dëgjova fjalën keqpërdorim e që as në raport nuk kam hasë në askund fjalën keqpërdorim, por kam parë fjalën keq klasifikim, prandaj e mira e krejt kësaj është kjo, madje sa i përket kursimeve asnjëherë nuk diskutohet këtu në Kuvend sepse siç e ceka dhe që e kemi biseduar edhe më parë 7 milion euro janë të kursyera në kolektorin e ujërave të zeza çështje kjo e cila është bërë bujë aq e madhe nëpër konferenca se gjoja është lidh kontratë e shtrenjtë.

Janë mbi 14 km gyp F1000, janë mbi 20 km gyp F500, ndërsa është thënë se është pa kontratë, mirëpo ju them se kontrata është ekzistente dhe kontrata ashtu qysh ka qenë për segmentin e parë për atë projektin të cilin ju e dini qysh ka ngecë dhe qysh nuk është përfunduar ende, është edhe për segmentin e dytë, dhe në këtë projektin e rrjetit të kanalizimeve ku bënë pjesë edhe kolektori e vetmja që nuk ka pasë kontratë ka qenë Lot 3 i kësaj kontrate që i ka përfshirë disa rrjete të kanalizimeve të shkurtra apo trajtim i rasteve emergjente të kanalizimeve e që realisht nuk ka pasë mundësi as të bëhet projekt qoftë për shkak të vonesës qoftë për shkak të kërkesave të shumta të kanalizimeve emergjente të cilat janë shumë të arsyeshme të kryhen.

Prandaj mirë do të ishte të bisedohen paksa edhe të mirat e këtyre projekteve, e jo të shihet vetëm zi sepse ka edhe bardh, ka punë që kursehen shumë para dhe me ato para nga kursimi është investuar në shumë projekte tjera, në shumë projekte madhore e që nuk dua të përmend at fjalën e z.Ragip Fetahu që e ceku më herët Zhvillim, sepse vërtetë të flitet për zhvillim mund të flasim shumë, por që asnjëherë nuk po flasim për zhvillim, për projekte të mëdha, për projekte të mira që po ndërtohen, por po flitet për disa imtësira që realisht është punë e auditorit dhe që auditori duhet të bëjë vërejtje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në fakt nuk kemi kuorum tani por meqë nuk kemi ndonjë vendim për të votuar mund ë vazhdojmë me diskutime.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk e kam përqesh atë projekt të cilin e përmendi drejtoi parafolës i DSHPMSh, madje disa herë i kam bërë pyetje në kontekstin që të hyjë në projekte prioritare sepse Komuna e Podujevës më së shumti është duke heq për kolektor të ujërave ë zeza, madje ne që i kemi shtëpitë afër lumenjve e dim sakt qysh jetojmë 2-3 muaj në verë nga kundërmimet e që i mbyllim gjithë shtëpitë për të mos hyrë era brenda. Pra ai është një prej projekteve më të mira, madje për këtë arsye të projektit të ujërave të zeza unë para një viti e kam votuar KAB, mirëpo jo për t'iu ikë procedurave dhe për të hasë në gjetje auditori, ndërsa për që është punë e mirë puna e kolektorit ajo nuk diskutohet.

Sa herë që ke nevojë për diçka rreth kolektorit dhe eventualisht nuk i ke numrat për ta votuar, veç thirrëm dhe unë 1 votë e kam atë ta jap.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë mënoj se vetëm kolektori mund t'i pastroj këta lumenjtë tanë qysh janë të ndotur tani.

znj.Edona Shabani, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, ti nihesh si i drejtë dhe parimorë, por do të mbetesh në histori besoj për mos menaxhimin më të keq të kualifikimit që e ke bërë.

Unë mund të gabojë ndonjë gjë dhe e pranoj, por ju i bëni gjërat me qëllim, aty është problemi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, debati përfundoj për këtë pikë të rendit të ditës e cila nuk ka nevojë të votohet, kështu që e konstatojmë të përfunduar edhe këtë ikë të rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

7. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për momentin kuorum nuk kemi mirëpo meqë jemi në pikën të ndryshme dhe nuk ka ndonjë çështje për tu votuar, mund të vazhdojmë ë ka të interesuar për të marrë fjalën për ndonjë pyetje apo ndonjë çështje tjetër për ta ngritur.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ka dy pyetje;

1-unë jam nga fshati Siboc i Poshtëm dhe ujë kam nonstop sepse e kam bunarin, por janë duke u ankuar qytetarët për mungesë të ujit të pijes, madje një mik i imi më thirri në telefon duke mu ankuar se ka tri ditë që nuk kanë ujë, madje në formë humori më tha që po detyrohem ta marrë fërqën e dhëmbëve me vete që t'i pastroj dhëmbët tek pompa e derivateve HIB në rrugën Podujevë-Prishtinë, ndërsa në anën tjetër pushteti po lavdërohet me disa projekte.

2-Ky TV monitori në korridorin në hyrje të Komunës a është i destinuar për sistemin e radhës, apo është për të bërë propagandë, madje i pash disa projekte të cilat janë kryer qe rreth 12 vite por që tani ishin aty siç janë sheshe i qytetit, shkolla në Batllavë, shkolla në Balloc, mirëpo ne të këtu jemi dhe e dim kur janë kryer ato projekte që ka qenë në vitin 2018 e që nuk keni qenë ju në pushtet, përndryshe mund t'i fusni aty edhe disa projekte të vitit 2000 ose të vitit 1968 që janë kryer. Çfarë propagande ishte aty, në vend që të shfrytëzohet për radhë të qytetarëve, të keqpërdoret në atë formë sepse ne këtu e kemi votuar dhe në raportin financiar është sjellë që ai TV monitor dhe sistemi përkatës është blerë për menaxhim të radhës, jo për të bërë propagandë aty. Mos mendoni që e keni privatizuar Komunës për këto 4 vite sepse ka pasë edhe të tjerë para juve që kanë menduar se e kanë privatizuar Komunës por sot rrinë në shtëpi. Nuk ka mundësi të bëhen këtu gjëra këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk po vërej të interesuar të tjerë për të marrë fjalën, kështu që duke ju falënderuar të gjithëve e konstatojmë të mbyllur dhe përfunduar këtë mbledhje.

Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja ndërpritet në orën 14:40

Procesverbalin e mbajti;

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0036067/25

Podujevë,

26 qershor 2025

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosova
Komuna e Podujevës | Opština Podujevo | Municipality of Podujeva

Kryetari i Komunës

Për/Za/To:	Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi Komunal.
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunes Z.Shpejtim Bulliqi
Tema/Subjekat/Subje	Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar Janar – Qershor 2025) dhe Rekomandimet .
Referencë:	
Data/Datum/Date:	24.06.2025

1. Qëllimi i Raportit

Ky raport ka për qëllim të paraqesë të dhëna të detajuara mbi implementimin dhe respektimin e kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesit , si dhe të identifikoj shkeljet , vonesat në pagesa dhe rekomandimet për përmirësim. Raporti paraqitet duke u bazuar në në nenin 22 pika 2 të Ligjit Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092.

2. Përmbledhja ekzekutive

- Numri total i kontratave aktive ; **20**
- Sipërfaqja totale e dhëne në shfrytëzim ; 10906,95 m² (totali sipërfaqe tokësorë dhe lokale afariste) dhe 63.259,43 ha (Shoqata e Gjuetisë Llapi si vend -gjueti)
- Qëllimi i shfrytëzimit ;Afarizëm

Përmbledhje e përgjithshme.

Në Drejtorinë për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi në Janar 2025 kanë qen aktive gjithsejtë 131 kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në pronësi të komunës.

Shumica e këtyre kontratave 111 lidhen me shfrytëzimin e hapësirave për veprimtari afariste , kryesisht për lokale tregtare dhe tezga të vendosura në tregun e qytetit.

Për shkak të implementimit të projektit “ Banimi i përballueshëm dhe social ” të gjitha këto kontrata janë shkëputur bazuar në nenin 5 të kushteve kontraktuale . Shkëputja është realizuar nga ana e komunës në përputhje me nevojat e planifikimit urban.

Disa prej tyre kanë qen pagues të rregullt e disa kanë obligime të bartura. Gjithashtu një kontratë për shfrytëzimin e parcelës në fshatin Sallabaj ka skaduar.

Momentalisht kontrata aktive janë 20 disa lokale afariste qe gjinden në Rr” Skënderbeu “ dhe disa njësi kadastrale.

Sa i përket përmbushjes së obligimeve financiare , vërehet se një pjesë e qiramarrësve janë të rregullt në pagesa , ndërsa të tjerët kanë detyrime të prapambetura dhe borxhe të bartura nga vitet paraprake.

Prej tyre 8 janë pagues të rregullt 4 prej tyre paguajnë por jo rregullisht ndërsa të tjerët 6 kanë obligime të papaguara edhe të bartura nga vitet tjera.

Të gjithë janë njoftuar me shkrim për obligimet të cilat i kanë dhe për pasojat që bartin ato obligime, pas njoftimit me shkrim në disa raste kemi dal edhe i kemi vizituar duke i njoftuar për se afërmi që ti paguajnë obligimet kontraktuale.

Disa prej tyre pas njoftimeve kanë bërë pagesa.

Ndërsa në përgjithësi në DKPGJ Sektori i Pronës janë iniciuar disa procedura të shpronësimit, është përfunduar një procedurë e këmbimit, janë realizuar disa dalje në terren dhe identifikime të uzurpimeve.



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtoria/Njesia
Kuvendi Komunal

Data 17/07/2025

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Numri personal

Drejtoria e Pronës gjeodezisë, Kadastrit dhe
Gjeodezisë

0000000000

Adresa e vendbanimit

E-mail Adresa

Podujevë

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Raport

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-355/02-0041597/25

Afati i zgjedhjes

16/08/2025

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Raport i Monitorimit të Komunes për Dhenjen në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtsmerias të Komunës (periudha e raportuar Janar-Qershor 2025) dhe Rekomandimet.

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Drejtoria e Pronës vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

gjeodezisë, Kadastrit dhe

Gjeodezisë

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Fatime.Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCIVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin “Furnizimi me mëshqerra” në vlerë 141,428.40€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 471,428.00€, financon shumën 329,999,60€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shumën e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 141,428.40€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kod i programit 47005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 02-400/03-0042364/25
Podujevë, datë; 29/07/2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCIVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi me makineri prodhuese për biznese" në vlerë 85,714.28€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 285,714.28€, financon shumën 199,999.99€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 285,714.28€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik – kodi i programit 48005

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 02-400/03-0042362/25
Podujevë, datë; 29/07/2025





KUVENDI I KOMUNËS

Mbështetur nenet 11; 12.2 shkronja d), 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 13 dhe 8 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në pajtim me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, si dhe nenet 17 dhe 19 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2025, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë:

1.1. E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht të Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon:
Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

1.2. Pjesët tjera të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025 dhe Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, mbeten të pandryshuar.

Neni 2

Arsyeja e ndryshim-plotësimit, përkatësisht riformulimit të tekstit të cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi (nga afatshkurtër në afatgjatë), është se Njësia kadastrale nr.P-00202-3 me sipërfaqe 137157 m², vendi i quajtur "Bugurdoll" Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm-Komuna e Podujevës, sipas planifikimeve vite me radhë është proceduar për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, por që nuk ka pasur të interesuar për marrjen e kësaj prone në shfrytëzim, ndërsa interesimet si shprehje e interesit të vazhdueshme kanë qenë që kjo pronë të merret në shfrytëzim për periudhë afatgjatë, dhe atë duke synuar për investime kapitale shumë të rëndësishme zhvillimore për Komunën, qytetarët dhe interesit të përgjithshëm publik qoftë me mundësitë e gjenerimit të vendeve të punës, krijimi të hyrave vetanake të Komunës si dhe zhvillimit ekonomik lokal. Rrjedhimisht, është mëse i nevojshëm riformulimi sipas nenet 1 të këtij vendimi, në mënyrë që në aspektin procedural dhe ligjor të krijohen mundësitë e procedimit të mëtutjeshëm në funksion të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së cekur.

Neni 3

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.01-463/06-0078836 për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, i miratuar nga Kuvendi i Komunës më 11 dhjetor 2024

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-463/06-0029235/25
Podujevë, datë; 28 maj 2025





KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 5 shkronja b), 11, 12.2 shkronja d), 14 paragrafët 1 dhe 2, dhe nenin 17 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 6 paragrafi 1.2, neneve 8, dhe 14 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 3 paragrafi 1.2, nenet 14, 15 paragrafi 2, nenet 17 dhe 19 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2025, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS - NJËSIA KADASTRALE P-71712029-00202-3, NË SIPËRFAQE 137157 M², ZONA KADASTRALE LUPÇ I POSHTËM

Neni 1

Miratohet vendimi paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik, prona e paluajtshme e evidentuar në Certifikatën pronësore 08-942/06-0027999/25 të datës 22.05.2025, Njësia kadastrale parcelë P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², vendi i quajtur "Bugurdoll", Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, pronë e Komunës, dhe sipas Kopjes së Planit si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste dhe investime kapitale të rëndësishme zhvillimore për Komunën, qytetarët dhe interesit të përgjithshëm publik, mundësive për gjenerim të vendeve të punës, krijimit dhe rritjes së të hyrave vetanake të Komunës si dhe zhvillimit ekonomik lokal.

Neni 3

Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij vendimi është afatgjatë, përkatësisht në periudhë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

Neni 4

Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes Shprehjes së Interesit, të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-463/06-0029237/25
Podujevë, datë; 28 maj 2025



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712029-00202-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/06-0027999/25
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.05.2025 - 09:52
Komuna / Opština / Municipality:	PODUEVË / PODUEVO / PODUEVË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	Lupç I Poshtëm / Donje Ljupe / Lupç I Poshtëm
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	PODUEVË / PODUEVO / PODUEVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA						
Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On
P-71712029-00202-3	PARCELE / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	137157	REXHISTRU I PARAQITJEVE NR.REND.4/07 DT.15.05.07	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BUGURDOLL-BUGURDOLL				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjaci/pasture	Kulllosë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	137157

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseidim individual / Individuálna Državina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEJË / PODUEVO / PODJEVĚ /		NUHI GASHI	1/1	REXHISTRU I PARAQITJEVE NR.REND.4/07 DT.15.05.07	




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lupç I Poshtëm

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712029-00202-3	Parcelë / Parcela / Parcel	137157



Shkalla/Razmera/Scale: 1:5421

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 22.05.2025
Koha/ Vreme/ Time: 09:55:12

Registru Lendës - Sistemi për

Kosovo Cadastre

172.20.19.55:8080/ProcessManagement

Managed bookmarks

Registru Lendës - S...

Procesi

Harta

Shqip | Sërbi | English

Harta kadastrale e Kosovës - Menaxhimi i proceseve | Përdoruesi: Valon Beselica

Menaxhimi i proceseve

Kufizimi i procesit (Kufizimi i kopjes zyrtare të planit)

1 : 5000

Auto

Antibulet ne mblakim te nrit

Kerko adresë

Harta bazike

ARIS_DEV_ORTO_LAYER

Orthophoto_2012

Orthophoto2018Rural

Orthophoto2018Urban

Ortho2024Rural

Orthophoto2024Urban

Mozajku i Imazheve

71712082_7917-41-3.tif

71712082_7917-41-2.tif

71910069_7916-41-1.tif

71712007_7916-41-5.tif

71712007_7917-41-4.tif

71712038_7917-41-5.tif

71712047_7917-41-5.tif

71712029_7916-41-4.tif

71712029_7916-41-3.tif

71712029_7917-41-1.tif

71712029_7917-41-2.tif

71712050_7916-41-5.tif

71712050_7917-41-5.tif

71712077_7916-41-7.tif

Njesite administrative

Komune

Zone kadastrale

Regjistrimi i adresave

Shtresat e Harta kadastrale (Iqendja e tanis

Parcelat dhe Ndertesa (Iqendja e tanis

Pila kultivare e parcelës

Vija kultivare e parcelës

Parcelat

KosovaRef01

9:55 AM

9/22/2025



KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 17 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe bazuar në nenin 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2025, mori këtë,

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 13757 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit përkatës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale parcelë P71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, në këtë përbërje:

1. **Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
2. **Adelinë Stublla**, nga Ekzekutivi i Komunës
3. **Haki Rudari**, nga Kuvendi i Komunës
4. **Burim Hasani**, nga Kuvendi i Komunës
5. **Shqipdon Rushiti**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e Vendimit nr.prot.01-463/06-0029237/25 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës të datës 28 maj 2025.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-020/p4-0029236/25
Podujevë, datë; 28 maj 2025



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha